



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

Udhëzues për praktikën gjqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Mjedisi

Përditësuar më 31 gusht 2024

Përgatitur nga Regjistri. Kjo nuk e detyron Gjykatën.

Botuesi ose organizatat që dëshirojnë të përkthejnë dhe/ose të riprodhojnë të gjithë ose një pjesë të këtij raporti në formën e një botimi të printuar ose elektronik janë të ftuar të plotësojnë formularin e kontaktit: [request to reproduce or republish a translation](#) për informacion mbi procedurën e autorizimit.

Nëse dëshironi të dini se cilat përkthime të Udhëzuesve të praktikës gjyqësore janë duke u zhvilluar, ju lutemi shikoni listën e [Pending translations](#).

Ky udhëzues është hartuar fillimisht në frëngjisht. Përditësohet rregullisht dhe, përditësimi i fundit është bërë më 31 gusht 2024. Mund t'i nënshtrohet rishikimit editorial.

Udhëzuesit e praktikës gjyqësore janë në dispozicion për shkarkim në <https://ks.echr.coe.int>. Për të rejt lidhur me përditësimet, ju lutemi ndiqni llogarinë e Gjykatës në X në https://x.com/ECHR_CEDH.

Ky përkthim është përgatitur dhe botuar në kuadër të Projektit Rajonal të Këshillit të Evropës për “[Të drejtat e njeriut dhe mjedisin e qëndrueshëm në Evropën Juglindore](#)”, financuar nga Fondi I Mirëbesimit për të Drejtat e Njeriut.

© Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2025

Tabela e përmbajtjes

Shënim për lexuesit.....	7
Neni 1 (detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut)	8
Neni 2 (e drejta për jetën)	9
I. Aktivitetet industriale dhe fatkeqësitë e parashikueshme natyrore	10
A. Zbatueshmëria	10
B. Përmbajtja e detyrimit pozitiv për të mbrojtur jetën	11
1. Detyrimi substancial: korniza legjislative dhe administrative parandaluese.....	11
a. Parimet	12
i. Rregulloret parandaluese	12
ii. Hapësira e vlerësimit	12
iii. Fatkeqësitë e parashikueshme natyrore	12
iv. Neni 2 dhe Neni 8	13
b. Shembuj.....	13
2. Detyrimi procedural	15
a. Zbatimi i një hetimi <i>ex officio</i> efektiv.....	16
b. Procedura gjyqësore	16
c. Shembuj	17
II. Duhanpirja pasive	19
Nenit 3 (ndalimi i torturës)	19
Neni 5 (e drejta për liri dhe siguri)	20
Neni 6 (detyrimi civil) (e drejta për proces të rregullt)	20
I. Procedurat e ngritura nga personat e prekur nga dëmtimi mjedisor	20
A. Zbatueshmëria e Nenit 6 § 1 (detyrimi civil)	20
1. Parimet e përgjithshme për zbatueshmërinë e nenit 6 § 1	21
a. E drejta civile e njohur sipas legjislacionit kombëtar, së cilës kërkuesi mund t'i drejtohet ...	21
b. Mosmarrëveshje "e vërtetë dhe serioze"	24
2. Mosmarrëveshje që është "drejtpërdrejt vendimtare" për të drejtën civile të kërkuesit .	24
Zbatueshmëria e nenit 6 § 1 në kontekstin e ndryshimeve klimatike.....	25
B. Shembuj të zbatimit të nenit 6 § 1 në kuadrin e çështjeve gjyqësore mjedisore	26
II. Barazpesha e forcave në çështjet gjyqësore mjedisore	28
III. Procedura të ngritura nga individë kundër masave për mbrojtjen e mjedisit	29
IV. Të tjera	29
Neni 6 (detyrimi penal) (e drejta për proces të rregullt)	29
Neni 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)	30
I. Ekspozimi ndaj ndotjes dhe shqetësimit ose ndaj rrezikut mjedisor	30
A. Zbatueshmëria	31

1. Ekspozimi ndaj ndotjes dhe shqetësimit: nevoja e një ndikimi të drejtpërdrejtë dhe të rëndë në jetën privat edhe familjare dhe banesën	31
a. Ndikimi i drejtpërdrejtë	31
b. Pragu i seriozitetit	32
2. Ekspozimi ndaj kërcënimit mjedisor	34
3. Shembuj	35
4. Ndryshimet klimatike	36
5. Provat	37
a. Në përgjithësi	37
b. Specifike: prova e lidhjes shkakësore midis sëmundjes dhe një burimi ndotjeje dhe shqetësimi – mundësia e një qasjeje probabiliste	44
5. Faktorë të tjerë të lidhur me zbatueshmërinë	44
B. Detyrimet e shteteve dhe mbikqyrja nga Gjykata	46
1. Detyrime negative dhe detyrime pozitive	46
2. Mbikqyrja e Gjykatës	47
a. Konsiderata të përgjithshme	48
i. Detyrimi substancial	48
α. Detyrimet negative: ndërhyrje nga një autoritet publik	48
• Ndërhyrje e parashikuar me ligj	48
• Qëllimi i ligjshëm	48
• Domosdoshmëria e ndërhyrjes	49
β. Detyrimet pozitive: masat mbrojtëse	49
• Të përgjithshme	49
• Specifike për aktivitete të rrezikshme: parandalimi dhe informacioni	58
• Informacion për personat e ekspozuar ndaj një rreziku shëndetësor, jashtë çdo procesi vendimmarrës	59
ii. Procesi i vendimmarrjes	61
χ. Hetimet dhe studimet e mëparshme	63
ii. Qasja në informacion	63
iii. Qasja në gjykata	63
iv. Shembuj	64
b. Konsiderata specifike në lidhje me ndryshimet klimatike**	65
i. Hapësira e vlerësimit	66
ii. Përmbajtja e detyrimeve pozitive	66
α. Parimet	66
• Rregulloret dhe masat	66
• Procesi i vendimmarrjes	67
β. Rasti i Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës [DhM] (paragrafët 555-573)	67
II. Kufizimi i të drejtave të garantuara nga neni 8 për arsye të mbrojtjes mjedisore	68
Neni 9 (Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë)	69
Neni 10 (liria e shprehjes)	71
I. Protesta dhe fushata mjedisore	71
II. Shprehja e mendimeve për temat mjedisore: nivel i lartë mbrojtjeje	71

III. Njohja e rolit të veçantë të shoqatave të ruajtjes së mjedisit në shpërndarjen e informacionit mbi veprimet e autoriteteve publike	73
IV. Qasje në informacion mbi çështjet mjedisore	74
A. Njohja e kualifikuar dhe e kushtëzuar e së drejtës për qasje në informacionin e mbajtur nga shteti	74
B. Qasja në një mjet që lehtëson shqyrtimin e përmbajtjes dhe cilësisë së informacionit të dhënë	75
V. Arsyet në lidhje me mbrojtjen e mjedisit mund të përbëjnë një qëllim të ligjshëm që justifikon ndërhyrjet në ushtrimin e lirisë së shprehjes	75
Neni 11 (liria e tubimit dhe organizimit)	76
I. Protesta ambientaliste	76
II. Liria e organizimit dhe e mjedisit	77
Neni 13 (e drejta për zgjidhje efektive)	78
Neni 14 (ndalimi i diskriminimit)	78
Neni 1 i Protokollit nr. 1 (mbrojtja e pronës)	79
I. Kufizimet e së drejtës së respektimit të pronës për arsye mjedisore	79
A. Ruajtja e mjedisit: një shkak me interes të përgjithshëm ose publik	79
B. Hapësirë më e gjerë e vlerësimit	82
C. Mbikqyrja nga Gjykata	82
II. Shkelja e të drejtave pronësore për shkak të dëmtimit mjedisor	83
A. Përgjegjësia e drejtpërdrejtë e shtetit	84
1. Shkatërrimi ose dëmtimi i pronës - shembull	84
2. Humbja e vlerës - shembuj	84
B. Dështimi i shtetit për të përmbushur detyrimin e tij pozitiv për të mbrojtur pronën	85
1. Shkatërrimi ose dëmtimi i pronës	86
a. Shkatërrimi ose dëmtimi i pronës si rezultat i fatkeqësive mjedisore	86
i. Fatkeqësitë mjedisore të tipit industrial	86
ii. Fatkeqësitë natyrore mjedisore të parashikueshme	86
b. Shkatërrimi ose dëmtimi i pronës i shkaktuar nga përkeqësimi i mjedisit për shkak të aktiviteteve private	87
2. Humbja e vlerës së pronës për shkak të dëmtimit të mjedisit përreth	87
Neni 34 i Konventës (kërkesat individuale)	87
I. Actio popularis /statusi i viktimës	88
A. Parimet e përgjithshme	88
1. Viktima e drejtpërdrejtë – çështja e locus standi e shoqatave të ruajtjes së mjedisit	88
2. Viktima e mundshme: ekspozimi ndaj rrezikut të dëmtimit mjedisor	90
B. Parimet e zbatueshme në kontekstin e ndryshimeve klimatike	90
1. Individët	90
2. Shoqatat: statusi i viktimës/në pritje për të paraqitur një kërkesë në Gjykatë	91
II. Humbja e statusit të viktimës	93
Neni 35 (kushtet e pranueshmërisë)	95

A. Shterimi i mjeteve të brendshme juridike	95
B. Afati kohor gjashtëmuor - situata e vazhdueshme e ndotjes	96
C. Ratione personae – përfshirja në dëmtimin e mjedisit e ndërmarrjeve të drejtuara nga ligjet e shteteve të tjera anëtare	96
D. Ratione materiae – nuk ka të drejtë universale individuale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore specifike	96
E. Abuzimi me të drejtën e ankimit	96
F. Nuk ka dëm të konsiderueshëm – pragu minimal i seriozitetit të një shkeljeje të supozuar dhe ndikimi mjedisor dhe shëndeti publik i situatës së kontestuar	97
Neni 46 (forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve)	97
• Vendime që përmendin një të drejtë individuale për mjedisin	98
• Vendime që përmendin parimin e kujdesit paraprak:	98
• Vendime që e referojnë arsyetimin e tyre në Konventën e Aarhusit për qasjen në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore:	98
Lista e rasteve të cituara	99

Shënim për lexuesit

Ky Udhëzues është pjesë e serisë së udhëzuesve të praktikës gjyqësore botuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim "Gjykata", "Gjykata Evropiane" ose "Gjykata e Strasburgut") për të informuar praktikuesit ligjorë lidhur me vendimet themelore të nxjerra nga Gjykata e Strasburgut. Ky udhëzues i veçantë analizon dhe përmbledh praktikën gjyqësore sipas neneve të ndryshme të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "Konventa" ose "Konventa Evropiane") lidhur me mjedisin. Ai duhet të lexohet së bashku me udhëzuesit e praktikës gjyqësore sipas nenit, të cilit i referohet sistematikisht.

Praktika gjyqësore e cituar është përzgjedhur ndër vendimet kryesore dhe/ose të kohëve të fundit.*

Vendimet e Gjykatës shërbejnë jo vetëm për të vendosur për lëndët e paraqitura para saj, por, në përgjithësi, për të sqaruar, mbrojtur dhe zhvilluar rregullat e vendosura nga Konventa, duke kontribuar kështu në respektimin nga shtetet të zotimeve të ndërmarra prej tyre si Palë Kontraktuese (*Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*, 18 janar 1978, § 154, Seria A nr. 25, dhe së fundmi, *Jeronovičs k. Letonisë* [DhM], 44898/10, § 109, 5 korrik 2016).

Misioni i sistemit të krijuar nga Konventa është pra të vendosë për lëndë të politikës publike në interes të përgjithshëm, duke ngritur kështu standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe duke zgjeruar jurisprudencën e të drejtave të njeriut në të gjithë komunitetin e shteteve të Konventës (*Konstantin Markin k. Rusisë* [DhM], nr. 30078/06, § 89, GJEDNJ 2012).

Në të vërtetë, Gjykata ka theksuar rolin e Konventës si një "instrument kushtetues i rendit publik evropian" në fushën e të drejtave të njeriut (*Bosphorus Hava Yolları Turizm ve Ticaret Anonim Şirketi k. Irlandës* [DhM], nr. 45036/98, § 156, GJEDNJ 2005-VI, dhe së fundmi, *N.D. dhe N.T. k. Spanjës* [DhM], nr. 8675/15 dhe 8697/15, § 110, 13 shkurt 2020).

Protokolli nr. 15 i Konventës së fundi ka futur parimin e subsidiaritetit në Preambulën e Konventës. Ky parim "imponon një përgjegjësi të përbashkët ndërmjet Shteteve Palë dhe Gjykatës" në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe u kërkon autoriteteve dhe gjykatave kombëtare të interpretojnë dhe zbatojnë legjislacionin kombëtar në një mënyrë që u jep efekt të plotë të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë dhe Protokollet e tyre (*Grzęda k. Polonisë* [DhM], nr. 43572/18, § 324, 15 mars 2022).

* Hiperlidhjet e rasteve të cituara në versionin elektronik të Udhëzuesit i drejtohen teksteve në anglisht ose frëngjisht (dy gjuhët zyrtare të Gjykatës) të vendimeve të dhëna nga Gjykata dhe, sipas rastit, të vendimeve dhe raporteve të Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut (në vijim "Komisioni"). Përveç nëse tregohet ndryshe, të gjitha referencat i referohen një vendim mbi themelin e dhënë nga një Dhomë e Gjykatës. Shkurtesa "(ven.)" tregon se citimi është i një vendimi të Gjykatës dhe "[DhM]" se çështja është dëgjuar nga Dhoma e Madhe. Vendimet e Dhomës që nuk kanë qenë përfundimtare kur është publikuar ky përditësim shënohen me një yll (*).

“[M]brojtja e mjedisit, në kuptimin e gjerë, dhe, në këtë kontekst, mbrojtja më specifike e fshatit dhe pyjeve, specieve të rrezikuara, burimeve biologjike, trashëgimisë apo shëndetit publik, përfshihen midis synimeve të konsideruara deri më sot si të lidhura me ‘interesin e përgjithshëm’ për qëllimet e Konventës. [N]dërsa asnjë prej neneve të Konventës nuk është projektuar në mënyrë specifike për të ofruar mbrojtje të përgjithshme të mjedisit si të tillë..., përgjegjësia e autoriteteve publike në këtë fushë duhet të rezultojë në praktikë në ndërhyrjen e tyre në kohën e duhur, në mënyrë që të sigurohet që dispozitat statutores të miratuara me qëllim mbrojtjen e mjedisit të mos jenë plotësisht joefektive...” (*Opinion këshillues mbi ndryshimin në trajtimin ndërmjet shoqatave të pronarëve të tokave "që ka një ekzistencë të njohur në datën e krijimit të një shoqate gjuetarësh të miratuar në komunë" dhe shoqatat e pronarëve të tokave të krijuara pas kësaj date* [DhM], kërkesa nr. P16-2021-002, § 80).

“... Gjykata do të vazhdojë me vlerësimin e çështjeve që dalin në këtë çështje duke e marrë në fakt se ka indikacione mjaftueshëm të besueshme që ndryshimet klimatike antropogjene ekzistojnë, se ai përbën një kërcënim serioz aktual dhe të ardhshëm për gezimin e të drejtave të njeriut të garantuara sipas Konventës, që shtetet janë të vetëdijshme për këtë dhe të afta të marrin masa për ta trajtuar atë në mënyrë efektive, se rreziku përkatës është i kufizuar nëse rritja e temperaturës kufizohet deri në 1.5°C mbi nivelet para-industriale dhe nëse ndërmerren urgjentisht masa, dhe se përpjekjet aktuale globale zbutëse nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur objektivin e fundit.” (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 436).

Neni 1 (detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut)

Neni 1 i Konventës

“Palët e Larta Kontraktuese i sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Titullin I të kësaj Konvente.”

1. Juridiksioni i një shteti sipas kuptimit të nenit 1 të Konventës është kryesisht territorial. Në parim, faktet për të cilat ankohet kërkesi në kontekstin e ankesave të tij/saj në Gjykatë duhet të kenë ndodhur në territorin e shtetit të paditur. Sidoqoftë, rrethanat e jashtëzakonshme mund ta bëjnë Gjykatën të pranojë se aktet e shteteve kontraktuese të kryera jashtë territorit të tyre, ose që prodhojnë efekte atje, mund të çojë për ata ushtrimin e juridiksionit të tyre: 1. kur një shtet ushtron kontroll efektiv të një zone jashtë territorit të tij kombëtar; 2. kur, jashtë territorit kombëtar, një agjent shtetëror ka ushtruar autoritet ose kontroll mbi viktimën; 3. kur, në prani të një pretendimi për mospërmbushje të detyrimeve procedurale sipas nenit 2 në lidhje me një vdekje që ndodh jashtë territorit të shtetit, ekziston një lidhje juridiksionale me atë shtet në lidhje me këto detyrime procedurale; 4. në rast të “tipareve të veçanta” në një çështje, që shkakton ushtrimin e juridiksionit nga një shtet kontraktues jashtë kufijve të tij territorialë. Kjo pyetje është zhvilluar më tej në Udhëzuesin e praktikës gjyqësore mbi nenin 1 të Konventës.

2. Kështu, kur të drejtat ose liritë e Konventës së një individi preken nga degradimi mjedisor ose një rrezik mjedisor dhe shkak i pretenduar nuk ndodhet në territorin e shtetit ku ai ose ajo banon, por në atë të një shteti tjetër, lind pyetja nëse, si përjashtim nga parimi i territorialitetit, Shteti i dytë ka juridiksion.

3. Gjykata e shqyrtoi këtë çështje në kontekstin e një kërkesë të paraqitur nga gjashtë shtetas të rinj portugez që jetojnë në Portugali, kundër atij Shteti dhe tridhjetë e dy shteteve të tjera palë, të cilët u ankuan për shkelje të të drejtave të tyre siç garantohen nga nenet 2, 3, 8 dhe 14 të Konventës për shkak të ndikimeve ekzistuese dhe serioze në të ardhmen e ndryshimeve klimatike (*Duarte Aghostinho dhe të tjerët k. Portugalisë dhe 32 të tjerëve* (aktv.) [GC], 2024). Duke e lënë të hapur çështjen e juridiksionit ekstraterritorial në kontekstin e dëmtimit më të lokalizuar mjedisor ndërkufitar (§ 167), Gjykata konstatoi se megjithëse kërkesit bien në juridiksionin (territorial) të Portugalisë – gjë që e nxori nga fakti se ata jetonin në atë vend (§ 178; shih edhe *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, §§ 287 dhe 443) –, ato nuk bien në juridiksionin e tridhjetë e dy shteteve të tjera të paditura. Në këtë drejtim, duke vënë në dukje mungesën e juridiksionit territorial dhe duke

vënë në dukje se situata e kërkuar nuk korrespondonte me asnjë nga tre përjashtimet e para të përcaktuara në paragrafin 1 më sipër, ajo konstatoi se nuk kishte gjithashtu “tipare të veçanta” të çështjes që mund të përcaktonin juridiksionin e këtyre shteteve. Kërkuar argumentuan se këto shtete kishin juridiksion ekstraterritorial, për shkak se, në rrethana të jashtëzakonshme të kërkesës, emetimet e tyre dhe/ose dështimet për të rregulluar/kufizuar emetimet e tyre prodhonin efekte jashtë territorit të tyre. Gjykata pranoi disa aspekte të ndryshimit të klimës që ishin theksuar nga kërkuar në këtë kontekst: 1. Shtetet kanë kontrollin përfundimtar mbi aktivitetet publike dhe private që prodhojnë emetime të gazeve serrë në territoret e tyre; 2. ndonëse komplekse dhe shumëshitesore, ekziston një lidhje e caktuar shkakësore midis aktiviteteve publike dhe private që prodhojnë emetime të gazeve serrë në territoret e një shteti dhe ndikimit negativ në të drejtat dhe mirëqenien e njerëzve që banojnë jashtë kufijve të tij dhe si rrjedhim jashtë fushëveprimit të procesit demokratik të atij shteti; ndryshimi i klimës është një fenomen global dhe çdo shtet mban pjesën e tij të përgjegjësisë për sfidat globale të krijuara nga ndryshimet klimatike dhe ka një rol për të luajtur në gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme; 3. problemi i ndryshimit të klimës është i një natyre vërtet ekzistenciale për njerëzimin, në një mënyrë që e veçon atë nga situatat e tjera shkak-pasojë. Megjithatë, Gjykata konstatoi se këto konsiderata nuk mund të shërbenin në vetvete si bazë për të krijuar me anë të interpretimit gjyqësor një bazë të re për juridiksionin ekstraterritorial ose si justifikim për zgjerimin e atyre ekzistuese. Duke trajtuar të gjitha argumentet e paraqitura nga kërkuar, ajo arriti në përfundimin në përgjithësi se nuk kishte arsye në Konventë për zgjerimin, nëpërmjet interpretimit gjyqësor, të juridiksionit ekstraterritorial të shteteve të paditura në mënyrën e kërkuar nga kërkuar (*Duarte Aghostinho dhe të tjerët k. Portugalisë dhe 32 të tjerëve* (aktv.) [GC], 2024, §§ 179-214).

Neni 2 (e drejta për jetën)

Neni 2 i Konventës

“1. E drejta e çdo njeriu për jetë do të mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

2. Marrja e jetës nuk konsiderohet të jetë shkaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme:

(a) në mbrojtje e çdo personi nga dhuna e paligjshme;

(b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjërisht;

(c) për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.”

4. Detyrimi pozitiv i shteteve për të ndërmarrë hapat e duhur për të mbrojtur jetën e atyre që jetojnë brenda juridiksionit të tyre, që rezulton nga fjalja e parë e paragrafit të parë të nenit 2, zbatohet në kontekstin e çdo aktiviteti, qoftë publik ose jo, në të cilin mund të vihet në rrezik e drejta për jetën. Gjykata shtoi se sqarimi në kuadrin e një çështjeje mjedisore, konkretisht *Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 71, në të cilin një shpërthim metani në prill 1993 në një landfill mbeturinash në një periferi të Stambollit kishte shkaktuar një rrëshqitje dheu që kishte varrosur banesat e lagjeve të varfra në tokë të ulët; tridhjetë e nëntë persona kishin humbur jetën, duke përfshirë nëntë anëtarë të familjes së kërkuar (shih edhe *Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, § 130; *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, § 158; *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 101; *M. Özel dhe të tjerët k. Turqisë*, 2015, § 170; *Istanbulu dhe Ayden k. Turqisë* (aktv.), 2015, § 31; *Erdal Muhammet Arslan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, § 114).

I. Aktivitetet industriale dhe fatkeqësitë e parashikueshme natyrore

A. Zbatueshmëria

5. Detyrimi pozitiv për të mbrojtur jetën vlen *a fortiori* ndaj aktiviteteve industriale, të cilat janë të rrezikshme nga vetë natyra e tyre (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 71; *Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, § 130); *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, § 158; *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 101).

Përtej funksionimit të një landfilli mbeturinash shtëpiake në fjalë në rastin *Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, aktivitetet e mëposhtme industriale janë konsideruar të jenë të rrezikshme:

- mënyra e menaxhimit të një rezervuari të vendosur në një rajon të ndikuar nga musonet, duke përfshirë lëshimin e ujit në një periudhë reshesh të dendura, kishte shkaktuar përmbytje në një pjesë të një aglomerat urban (zonë e bashkuar urbane) në gusht 2001 (*Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, § 164);
- një seri testesh atmosferike të armëve bërthamore të kryera nga autoritetet britanike në ishullin e Krishtlindjeve në fund të viteve 1950, gjatë të cilave personeli ushtarak ishte ekspozuar ndaj rrezatimit (*L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1998, siç përmendet në rastin *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2012, § 80);
- emetimet toksike nga një fabrikë plehrash (*Guerra dhe të tjerët k. Italisë*, 1998, siç përmendet në rastin *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 80);
- ekspozimi ndaj substancave toksike si azbesti në një vend pune që drejtohej nga një korporatë publike në pronësi dhe e kontrolluar nga qeveria (*Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 81);
- prodhimi sekret i karburantit të përbërë të ngurtë për raketa nën kujdesin e Shërbimit Informativ Shtetëror (*Mučibabić k. Serbisë*, 2016, §§ 126-127);
- menaxhimi i një objekti të çmontimit të armëve (*Durdaj dhe të tjerët k. Shqipërisë*, 2023, § 260).

Gjykata konstatoi se ankesat në lidhje me dështimet e pretenduara të një shteti për të luftuar ndryshimet klimatike binin në kategorinë e rasteve në lidhje me një aktivitet i cili, nga vetë natyra e tij, ishte në gjendje të vinte në rrezik jetën e një individi. Ajo vuri në dukje, në veçanti, gjetjet e panelit ndërqeveritar të ekspertëve për ndryshimet klimatike, të cilat deklaruan se ndryshimi antropogjen i klimës, veçanërisht përmes rritjes së shpeshtësisë dhe ashpërsisë së ngjarjeve ekstreme, rriti vdekshmërinë njerëzore të lidhura me nxehtësinë (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM] (2024, §§ 508-510).

6. Detyrimi për të mbrojtur jetën zbatohet gjithashtu kur e drejta për jetë kërcënohet nga një fatkeqësi natyrore dhe rreziku është i pashmangshëm dhe i identifikueshëm qartë. Për shembull:

- rrëshqitjet e dheut që kishin vrarë njerëz në Rusi në korrik 2000 (*Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, §§ 137 dhe 142);
- tërmetet në rajonet e Izmitit (në vitin 1999) dhe Van (në vitin 2011) të cilët kishin shkaktuar vdekje të shumta (*M. Özel dhe të tjerët k. Turqisë*, 2015, §§ 170-171); *Istanbulu dhe Ayden k. Turqisë* (aktv.), 2015, § 31; *Erdal Muhammet Arslan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, § 114-115).

7. Në fushën e mjedisit, si në sferat e tjera, neni 2 zbatohet jo vetëm kur veprimet ose mosveprimet nga ana e shtetit kanë çuar në vdekjen e një personi, por edhe kur nuk ka pasur vdekje, por një person është ekspozuar dukshëm ndaj një rreziku për jetën e tij ose të saj (*Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, §§ 151-155 dhe 191; *Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, § 146).

Megjithatë, ai rrezik për jetën duhet të jetë "serioz" (*Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 82), dhe "real dhe i menjëhershëm" (*Fadeyeva k. Rusisë* (aktv.), 2003; *Ledyayeva dhe të tjerët k. Rusisë* (aktv.), 2004, ose – në lidhje me ankesat e veprimit dhe/ose mosveprimit të shtetit në kontekstin e ndryshimeve klimatike – "real dhe i menjëhershëm" (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët*

k. Zvicrës [DhM] (2024, §§ 511 - 513).

Termi rrezik “real” korrespondon me kërkesën e ekzistencës së një kërcënimi serioz, të vërtetë dhe mjaftueshëm të konstatueshëm për jetën. “I menjëhershëm”: rreziku i tillë përfshin një element të afërsisë fizike të kërcënimit (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM] (2024, § 512).

Në kontekstin e ndryshimeve klimatike, një rrezik i tillë për jetën duhet kuptuar në dritën e faktit se ekziston një rrezik i madh i pashmangshmërisë dhe pakthyeshmërisë së efekteve negative të ndryshimeve klimatike, dukuritë e të cilave kanë më shumë gjasa të rriten në frekuencë dhe gravitet. Kështu, testi “real dhe i menjëhershëm” mund të kuptohet si referencë ndaj një kërcënimi serioz, të vërtetë dhe mjaftueshëm të konstatueshëm për jetën, që përmban një element të afërsisë materiale dhe kohore të kërcënimit ndaj dëmit të ankuar nga kërkuesi. Kjo gjithashtu nënkupton se kur statusi i viktimës së një kërkuesi individual është vendosur në përputhje me kriteret e përcaktuara në paragrafin 231 më poshtë, do të jetë e mundur të supozohet se rreziku serioz i rënies së konsiderueshme të jetëgjatësisë së një personi për shkak të ndryshimeve klimatike duhet të sjellë gjithashtu zbatimin e Nenit 2 (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM] (2024, § 513).

8. Gjykata duhet gjithashtu të shqyrtojë nëse autoritetet kishin dijeni ose duhet të kishin dijeni, në kohën materiale, se kërkuesi ishte ekspozuar ndaj një rreziku vdekjeprurës (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 101; *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, §§ 105-106).

9. Në kontekstin e aktiviteteve të rrezikshme, kur nuk është vërtetuar se rreziku ndaj të cilit ishte ekspozuar një person ishte vdekjeprurës, në mënyrë që neni 2 të mos ishte i zbatueshëm, situata e tij ose e saj mund të vlerësohet sipas nenit 8, ku është prekur jeta e tij ose e saj private ose familjare. Gjykata arriti në këtë përfundim në rastin e individëve që ishin ekspozuar ndaj asbestit, por nuk kishin zhvilluar ndonjë sëmundje ose gjendje kërcënuese për jetën (*Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, §§ 84-85).

B. Përmbajtja e detyrimit pozitiv për të mbrojtur jetën

10. Detyrimi pozitiv që rrjedh nga neni 2 përfshin mbi të gjitha një detyrë parësore për të vendosur një kornizë legislative dhe administrative të krijuar për të siguruar parandalim efektiv kundër kërcënimeve ndaj të drejtës për jetë, veçanërisht me anë të ligjit penal (*Öneryıldız dhe të tjerët k. Turqisë* [DhM], 2004, §§ 89-90; *Istanbulu dhe Ayden k. Turqisë* (aktv.), 2015, § 32; shih, edhe, vendimin në rastin *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 112, në të cilin Gjykata deklaroi se kjo detyrë parësore nuk e përjashtonte mundësinë, *a priori*, që në rrethana të caktuara specifike, në mungesë të dispozitave ligjore përkatëse, detyrimet pozitive mund të përmbushen në praktikë.

11. Ai gjithashtu kërkon, që kur një individ ka pësuar lëndime që rrezikojnë jetën ose në rast vdekjeje, shteti të krijojë një sistem gjyqësor efektiv të aftë për të vërtetuar faktet, për të mbajtur përgjegjës fajtorët dhe për t'i ofruar dëmshpërblim të duhur viktimës (*Istanbulu dhe Ayden k. Turqisë* (aktv.), 2015, § 32; *Erdal Muhammet Arslan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, § 126). Neni 2 i Konventës nuk do të përmbushet nëse mekanizmi mbrojtës i parashikuar nga legjislacioni kombëtar ekziston vetëm në teori: mbi të gjitha, ajo duhet të funksionojë në mënyrë efektive edhe në praktikë, gjë që kërkon një shqyrtim të shpejtë të çështjes pa zvarritje të panevojshme të çështjeve të paraqitura pranë autoriteteve kompetente (*Istanbulu dhe Ayden k. Turqisë* (aktv.), 2015, § 34; *Erdal Muhammet Arslan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, § 151).

1. Detyrimi substancial: korniza legislative dhe administrative parandaluese

12. Gjykata duhet të marrë në konsideratë nëse, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, shteti bëri gjithçka që mund t'i ishte kërkuar për të parandaluar që jeta e kërkuesit "të vihej në rrezik në mënyrë të evitueshme" (*L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1998, § 36).

a. Parimet**i. Rregulloret parandaluese**

13. Në kontekstin e veçantë të aktiviteteve të rrezikshme, theks i veçantë duhet t'i kushtohet rregulloreve të përshtatura me tiparet e veçanta të aktivitetit në fjalë, veçanërisht në lidhje me nivelin e rrezikut të mundshëm për jetët njerëzore (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 90; *Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, § 132; *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, § 158; *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 101).

Rregullore të tilla parandaluese duhet të rregullojnë licencimin, ngritjen, funksionimin, sigurinë dhe mbikëqyrjen e aktivitetit dhe duhet ta bëjnë të detyrueshme për të gjithë personat e interesuar të marrin masa praktike për të garantuar mbrojtjen efektive të qytetarëve, jetët e të cilëve mund të rrezikohen nga rreziqet e qenësishme (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 90; *Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, § 132; *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, § 158; *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 101).

Rregulloret parandaluese duhet, në veçanti, të garantojnë të drejtën e publikut për informacion (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, §§ 90 dhe 108; *Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, §§ 132 dhe 152-155; *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, §§ 159, 177, 181-182 dhe 185; *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, §§ 101 dhe 113-114), duke u mundësuar kështu të vlerësojnë rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar.

Nga vendimet e cituara rezulton se në sferën e aktiviteteve të rrezikshme dhe fatkeqësive natyrore të parashikueshme, e drejta e tillë për informacion përforcohet nga detyrimi i Shteteve për të ofruar informacionin përkatës në mënyrë spontane për personat e ekspozuar ndaj një rreziku vdekjeprurës (shih edhe *L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1998, §§ 38-41).

14. Rregulloret parandaluese duhet gjithashtu të parashikojnë procedura të përshtatshme, duke marrë parasysh aspektet teknike të aktivitetit në fjalë, për identifikimin e mangësive në proceset në fjalë dhe çdo gabim të kryer nga personat përgjegjës në nivele të ndryshme (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 90; *Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, § 132; *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, § 159; *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 101).

15. Rregulloret që synojnë mbrojtjen e jetës së njerëzve jo vetëm që duhet të ekzistojnë dhe të jenë të përshtatshme, por autoritetet duhet gjithashtu t'i zbatojnë ato (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 97).

ii. Hapësira e vlerësimit

16. Zgjedhja e masave specifike është, në parim, një çështje që bie në hapësirën e vlerësimit të shtetit. Në veçanti, duke qenë se ka rrugë të ndryshme për të siguruar të drejtat e Konventës, dhe edhe nëse shteti ka dështuar të zbatojë një masë të caktuar të parashikuar nga legjislacioni kombëtar, ai ende mund të përmbushë detyrimin e tij pozitiv me mjete të tjera. Në këtë aspekt, një barrë e pamundur ose joproporcionale nuk duhet t'i imponohet autoriteteve pa marrë parasysh, në veçanti, zgjedhjet operacionale që ato duhet të bëjnë për sa i përket prioriteteve dhe burimeve; kjo rezulton nga hapësira e gjerë e vlerësimit që shtetet gëzojnë në sfera të vështira sociale dhe teknike (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 107; *Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, § 134-135; *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, § 160; *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 101).

17. Në vlerësimin nëse shteti i paditur kishte respektuar detyrimin pozitiv sipas nenit 2, Gjykata duhet të marrë parasysh rrethanat e veçanta të çështjes, të tilla si ligjshmëria kombëtare e veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve, procesi kombëtar i vendimmarrjes, duke përfshirë hetimet dhe studimet e dhura, dhe kompleksitetin e çështjes, veçanërisht kur përfshihen interesa kontradiktore të Konventës (*Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, § 136; *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, § 161; *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 101).

iii. Fatkeqësitë e parashikueshme natyrore

18. Në rastin *Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, § 137, ku rrëshqitjet e dheut kishin shkaktuar vdekjen e disa personave, Gjykata vuri në dukje se parimet e lartpërmendura ishin të zbatueshme në

sferën e ndihmës emergjente, ku shteti është i përfshirë drejtpërdrejt në mbrojtjen e jetëve njerëzore nëpërmjet zbutjes së rreziqeve natyrore, për aq sa rrethanat e një rasti të veçantë tregojnë shfaqjen e afërt të një rreziku natyror që kishte qenë qartësisht i identifikueshëm, dhe veçanërisht kur kishte të bënte me një fatkeqësi të përsëritur që prek një zonë të veçantë të zhvilluar për banim ose përdorim njerëzor. Shtrirja e detyrimeve pozitive që i ngarkohen shtetit në rrethana të veçanta do të varej nga origjina e kërcënimit dhe shkalla në të cilën një ose tjetri rrezik është i tillë që mund të zbutet ose minimizohet.

Gjykata theksoi veçanërisht shtrirjen e hapësirës së vlerësimit të shtetit në sferën e ndihmës emergjente në lidhje me një ngjarje meteorologjike. Meqenëse ngjarje të tilla janë përtej kontrollit njerëzor, argumenti se një barrë e pamundur ose joproporcionale nuk duhet t'u imponohet autoriteteve, pavarësisht nga zgjedhjet operationale që duhet të bëjnë në aspektin e prioriteteve dhe burimeve, merr peshë edhe më të madhe sesa në sferën e aktiviteteve të rrezikshme të një natyre të krijuar nga njeriu (*Budayeva dhe të tjerët k. Ruisë*, 2008, § 135).

19. Në lidhje specifike me tërmetet, Gjykata deklaroi në rastin *Erdal Muhammet Arslan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, § 128 (shih edhe rastin *M. Özel dhe të tjerët k. Turqisë*, 2015, §§ 173-174) se, megjithëse tërmetet janë ngjarje mbi të cilat shtetet nuk kanë kontroll, megjithatë shtetet kanë për detyrë të parashikojnë rreziqe të parashikueshme natyrore dhe të marrin masa që synojnë reduktimin e efekteve të tyre në mënyrë që të mbajnë në minimum ndikimin e tyre katastrofik. Ajo shtoi se qëllimi i detyrimit parandalues, i cili mbetet një detyrim mjetësh, konsiston në forcimin e kapacitetit të shtetit për t'u marrë me natyrën e papritur dhe të dhunshme të fenomeneve të tilla natyrore si tërmetet. Gjykata sqaroi më tej (*Erdal Muhammet Arslan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, §§ 129-133) që parandalimi përfshin planifikimin e duhur të territorit dhe zhvillimin e kontrolluar urban; prandaj, autoritetet lokale përgjegjëse për rregullimin e përdorimit të tokës duke lëshuar leje ndërtimi kanë një rol të parë në parandalimin e rrezikut dhe mbajnë përgjegjësinë kryesore për një parandalim të tillë dhe për respektimin e rregullave të ndërtimit rezistent ndaj lëkundjeve sizmike. Më pas, autoritetet kombëtare kanë detyrimin të mbikëqyrin dhe inspektojnë ndërtesat ekzistuese për të parandaluar, sa më shumë që të jetë e mundur, çdo rrezik për popullsinë në përgjithësi. Në rast ankese, autoritetet gjyqësore janë të detyruara të sigurojnë që detyrimet në fjalë janë përmbushur nga autoritetet përkatëse. Për më tepër, duhet të hartohet një “plan tërmetesh”, ndër hapa të tjerë, me qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve, autoriteteve lokale dhe profesionistëve dhe informimin e tyre për rrezikun sizmik. Së fundi, duhet të hartohen plane të menaxhimit të krizës. Këto plane duhet të përpiqen të identifikojnë gjithçka që duhet bërë nëse ndodh një tërmet shkatërrues. Këto masa të planifikimit dhe të menaxhimit të krizave duhet të bazohen në plane të hartuara më parë për reagimin dhe shpëtimin ndaj fatkeqësive në nivele të ndryshme territoriale, në varësi të nevojave.

iv. Neni 2 dhe neni 8

20. Meqenëse fushëveprimi i detyrimeve pozitive sipas nenit 2 të Konventës mbivendoset kryesisht me ato sipas nenit 8, parimet e zhvilluara në praktikën gjyqësore të Gjykatës në lidhje me çështjet e planifikimit dhe mjedisit që prekin jetën private dhe banesën mund të përdoren gjithashtu për mbrojtjen e të drejtës për jetë (*Budayeva dhe të tjerët k. Ruisë*, 2008, § 133).

b. Shembuj

21. Në rastin *L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1998, Gjykata vlerësoi, nga këndvështrimi i detyrimit pozitiv për të mbrojtur jetën, rastin e një gruaje që parashtrroi se leukemia që ajo kishte zhvilluar në fëmijëri kishte ardhur nga fakti se para konceptimit të saj babai i saj ishte rrezatuar nga testimi bërthamor i kryer nga Mbretëria e Bashkuar. Gjykata konstatoi se në qoftëse se, gjatë periudhës ndërmjet njohjes nga Mbretëria e Bashkuar të kompetencës së Komisionit për të marrë kërkesa më 14 janar 1966 dhe diagnozës së kërkueses me leukemi në tetor 1970, autoritetet kishin pasur informacion që i shkaktonte frikën se babai i kërkueses ishte ekspozuar ndaj rrezatimit dhe nëse do të ishte shfaqur e mundshme që një rrezatim i tillë mund të kishte paraqitur rreziqe reale për shëndetin e kërkueses, ishte e pritshme që me iniciativë të saj, Mbretëria e Bashkuar të merrte masa për të këshilluar prindërit e kërkueses dhe për të monitoruar shëndetin e saj. Megjithatë, në dritën e dosjes së çështjes dhe duke pasur parasysh informacionin e disponueshëm të

autoriteteve për këtë çështje në kohën konkrete, Gjykata konstatoi se nuk ishte vërtetuar se autoritetet duhet të vepronin me iniciativë të tyre për të njoftuar prindërit e kërkueses për këto çështje ose për të ndërmarrë ndonjë veprim tjetër të veçantë në lidhje me të. Prandaj, Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 2.

22. Në rastin *Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, §§ 97-110, Gjykata para së gjithash vuri në dukje se në të dyja fushat e veprimtarisë kryesore në këtë çështje – funksionimi i landfillit të mbeturinave shtëpiake dhe rehabilitimi dhe pastrimi i zonave të lagjeve të varfra – kishte rregulla sigurie në fuqi në Turqi. Së dyti, duke u mbështetur në dosjen e çështjes, ajo konsideroi se autoritetet turke kishin dijeni ose duhej të kishin dijeni se ekzistonte një rrezik real dhe i menjëhershëm për një numër personash që jetonin pranë landfillit të mbeturinave. Si rrjedhojë, ata kishin pasur një detyrim pozitiv sipas nenit 2 të Konventës për të marrë masa të tilla parandaluese operationale që ishin të nevojshme dhe të mjaftueshme për të mbrojtur ata individë, veçanërisht pasi ata vetë kishin ngritur landfillin dhe autorizuar funksionimin e tij, gjë që kishte shkaktuar rrezikun në fjalë. Përkundrazi, Këshilli i Qytetit të Stambollit nuk kishte marrë masat e nevojshme urgjente për marrjen dijeni për rrezikun, kishte kundërshtuar një rekomandim të Zyrës së Mjedisit të Kryeministrit për përshtatjen e vendit me standardet normale, të cilat kërkonin, *ndër të tjera*, instalimin e një sistemi që lejon çlirimin e kontrolluar në atmosferë të gazit të akumuluar dhe kishte refuzuar një kërkesë për mbylljen e përkohshme të vendit të grumbullimit të mbetjeve. Autoritetet e kishin lejuar gjithashtu kërkuesin dhe familjen e tij të jetonin pranë landfillit të mbeturinave për disa vite. Ndërsa iu referua hapësirës së vlerësimit që gëzojnë Shtetet Kontraktuese, Gjykata theksoi se instalimi në kohë i një sistemi të çlirimit të gazit mund të ishte një masë efektive pa devijuar burimet e shtetit në një shkallë të tepruar ose pa shkaktuar ndonjë problem të madh politik. Një masë e tillë do të ishte gjithashtu në përputhje me rregulloret turke dhe praktikën e përgjithshme në këtë zonë. Më në fund, Gjykata vuri në dukje se qeveria nuk kishte treguar se ishte ndërmarrë ndonjë veprim për t'u dhënë banorëve të lagjeve të varfra informacion që u mundësonte atyre të vlerësonin rreziqet që ata mund të përballonin si rezultat i zgjedhjeve që kishin bërë dhe vuri në dukje se në mungesë të masave më praktike për të shmangur rreziqet për jetën e tyre, edhe fakti i respektimit të së drejtës për informacion nuk do të ishte i mjaftueshëm për të shlyer përgjegjësinë e shtetit. Gjykata arriti në përfundimin se shteti kishte përgjegjësi në bazë të nenit 2 për shkak të kuadrit të pamjaftueshëm rregullator në lidhje me hapjen, funksionimin dhe mbikëqyrjen e grumbullimit të mbetjeve dhe për faktin se autoritetet shtetërore nuk kishin bërë gjithçka në fuqinë e tyre për të mbrojtur banorët e lagjeve të varfra nga rreziqet e menjëhershme dhe të njohura ndaj të cilave ata ishin ekspozuar.

23. Në rastin *Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, §§ 147-160, Gjykata vuri në dukje se qyteti i goditur ndodhej në një zonë të prirur për rrëshqitje dheu dhe se shfaqja e rregullt e kësaj fatkeqësie në sezonin e verës dhe ekzistenca e mëparshme e skemave të mbrojtjes të krijuara për të mbrojtur zonën tregoi se autoritetet dhe popullata kishin supozuar në mënyrë të arsyeshme se një rrëshqitje e dheut ndoshta do të ndodhte në verën e vitit 2000. Gjykata më pas nxori njohuritë e mëparshme të autoriteteve se rrëshqitja e dheut në vitin 2000 kishte të ngjarë të shkaktonte shkatërrim në një shkallë më të madhe se zakonisht, nga fakti se ata kishin marrë disa paralajmërime: verën e kaluar ata ishin informuar nga agjencia kompetente e mbikëqyrjes për nevojën për të riparuar digën mbrojtëse nga balta, e cila ishte dëmtuar nga një rrëshqitje e fortë balte; agjencia kishte kërkuar gjithashtu ngritjen e një sistemi të paralajmërimit të hershëm që do të lejonte evakuimin në kohë të civilëve në rast të një rrëshqitjeje dheu. Megjithatë, autoritetet as nuk kishin instaluar asnjë infrastrukturë sigurie apo mbrojtjeje dhe as nuk kishin paralajmëruar popullatën; ata më tej nuk kishin futur një sistem evakuimi emergjent ose nuk kishin marrë ndonjë masë tjetër për të parandaluar materializimin e rrezikut. Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte justifikim për autoritetet për mungesën e zbatimit të politikave të planifikimit të tokës dhe ndihmës emergjente në zonat e rrezikshme në lidhje me ekspozimin e parashikueshëm të banorëve ndaj rrezikut vdekjeprurës. Për më tepër, Gjykata konstatoi se kishte pasur një lidhje shkakësore midis të metave serioze administrative që penguan zbatimin e tyre dhe vdekjes së bashkëshortit të kërkuesit të parë, si dhe lëndimeve të pësuar nga kërkuesi i parë dhe i dytë dhe anëtarët e familjes së tyre. Ajo arriti në përfundimin se autoritetet kishin dështuar në përmbushjen e detyrimit pozitiv për të krijuar një kornizë legislative dhe administrative për të ofruar parandalim efektiv kundër kërcënimeve të së drejtës për jetë.

24. Në rastin *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, § 161, Gjykata vuri në dukje se autoritetet kishin dështuar në zbatimin e rregulloreve kombëtare të zbatueshme që ndalonin ndarjen e parcelave të tokës për ndërtesa individuale në zonat e mbrojtjes së ujit (burimeve natyrore) pa masa parandaluese dhe ndalonin, në veçanti, zonimin e zonave urbane të rrezikuara nga përmbajtjet dhe zonave të mbrojtjes së ujit, për të miratuar masa parandaluese dhe emergjente, për të mirëmbajtur dhe përshtatur kanalin e lumit dhe për të informuar publikun për rrezikun. Gjykata konstatoi se autoritetet kishin dështuar në detyrimin e tyre pozitiv për të mbrojtur jetën e kërkuesve, duke u mbështetur në faktet e mëposhtme: 1. autoritetet nuk kishin krijuar një kuadër të qartë legjislativ dhe administrativ që u mundësonte atyre të vlerësonin në mënyrë efektive rreziqet e natyrshme në funksionimin e një rezervuari dhe të zbatonin politikat e zhvillimit urban në afërsi të rezervuarit në përputhje me standardet teknike përkatëse; 2. nuk kishte pasur një sistem koherent mbikëqyrës për të inkurajuar përgjegjësit që të merrnin hapa për të garantuar mbrojtjen e duhur të popullatës që jeton në zonë, dhe në veçanti për të mbajtur kanalin e lumit mjaft të pastër për të përballuar shkarkimet urgjente të ujit nga rezervuari, për të vendosur atje një sistem paralajmërimi emergjent dhe për të informuar popullsinë lokale për rreziqet e mundshme që lidhen me funksionimin e rezervuarit; 3. nuk ishte vërtetuar se kishte pasur një koordinim dhe bashkëpunim të mjaftueshëm midis autoriteteve të ndryshme administrative për të siguruar që rreziqet e sjella në vëmendje të tyre nuk do të bëheshin aq serioze sa të rrezikonin jetët e njerëzve. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se autoritetet kishin mbetur joaktive edhe pas përmbajtjes për të cilën ankoheshin kërkuesit, me rezultat që rreziku për jetën e atyre që jetonin pranë rezervuarit dukej se vazhdonte deri në ditën e vendimit.

25. Në rastin *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, §§ 103-117, Gjykata konkludoi nga dosja e çështjes se në kohën materiale autoritetet kishin dijeni ose duhet të kishin dijeni për rreziqet që lindin nga ekspozimi ndaj asbestit. Më tej, ajo vuri në dukje se nga informacioni i dhënë rezulton që legjislacioni kishte qenë i mangët, për aq sa ai nuk kishte rregulluar në mënyrë të përshtatshme funksionimin e aktiviteteve të lidhura me asbestin dhe as nuk kishte dhënë ndonjë masë praktike për të siguruar mbrojtjen efektive të punonjësve, jeta e të cilëve mund të ishte rrezikuar nga rreziku i natyrshëm i ekspozimit ndaj asbestit. Për më tepër, edhe mbrojtja e kufizuar e ofruar nga ai legjislacion nuk kishte pasur asnjë ndikim tek kërkuesit pasi duket se ka mbetur e pazbatuar. Gjykata vazhdoi të vuri në dukje se e vetmja masë praktike e marrë nga shteti, si punëdhënësi, kishte qenë shpërndarja e maskave, të cilat ishin rezultuar të pamjaftueshme, dhe se asnjë informacion që u mundësonte kërkuesve të vlerësonin rreziqet për shëndetin dhe jetën e tyre, në fakt nuk u ishte dhënë apo u ishte vënë në dispozicion atyre gjatë periudhës përkatëse të karrierës së tyre. Gjykata arriti në përfundimin se, pavarësisht nga hapësira e vlerësimit të shtetit për zgjedhjen e mjeteve, qeveria nuk kishte përmbushur detyrimet e saj pozitive për të nxjerrë ligje ose për të marrë masa të tjera praktike. Prandaj, ajo gjeti se kishte pasur një shkelje të nenit 2 në lidhje me kërkuesin që kishte vdekur nga mesotelioma.

2. Detyrimi procedural

26. Kur kanë humbur jetë në rrethana që potencialisht përfshijnë përgjegjësinë e shtetit, neni 2 sjell një detyrë për shtetin që të sigurojë, me të gjitha mjetet që disponon, një përgjigje të përshtatshme – gjyqësore ose ndryshe – në mënyrë që kuadri legjislativ dhe administrativ i krijuar për të mbrojtur të drejtën për jetën të zbatohet siç duhet dhe çdo shkelje e kësaj të drejte të ndalohet dhe ndëshkohet (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 91; *Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, § 138; *Smaltini k. Italisë* (aktv.), 2015, § 52; *Durdaj dhe të tjerët k. Shqipërisë*, 2023, § 183).

27. Në kontekstin specifik të **aktiviteteve të rrezikshme dhe fatkeqësive natyrore të parashikueshme**, duhet të kryhet një hetim gjyqësor, pasi autoritetet shtetërore janë shpesh të vetmet subjekte që kanë njohuri të mjaftueshme përkatëse për të identifikuar dhe vërtetuar fenomenet komplekse që mund të kenë shkaktuar incidente të tilla (shih, edhe, vendimin *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, §§ 121-126, ku Gjykata vendosi, në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme juridike në lidhje me një ankesë sipas detyrimit procedural të nenit 2, se kërkesa për të kryer një hetim *ex officio* nuk zbatohet kur nuk është e qartë se rrethanat e vdekjes janë të njohura vetëm për autoritetet publike).

Për më tepër, kur ato autoritete, duke kuptuar plotësisht pasojat e mundshme dhe duke shpërfillur kompetencat e dhëna atyre, nuk kishin marrë masat që ishin të nevojshme dhe të mjaftueshme për të

shmangur rreziqet e qenësishme të një aktiviteti të rrezikshëm, fakti që ata që janë përgjegjës për cenimin e jetës nuk ishin akuzuar për një vepër penale ose nuk ishin ndjekur penalisht, mund të përbënte shkelje të nenit 2, pavarësisht çdo mjeti tjetër juridik që paditësit mund të ushtronin me iniciativën e tyre (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 93; *Budayeva dhe të tjerët k. Rosisë*, 2008, §§ 140 dhe 142; *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rosisë*, 2012, § 190).

a. Zbatimi i një hetimi efektiv *ex officio*

28. Sistemi gjyqësor duhet të parashikojë një procedurë hetimi zyrtare të pavarur dhe të paanshme që plotëson disa standarde minimale për sa i përket efektivitetit dhe është e aftë të sigurojë zbatimin e dënimeve penale kur humben jetë si rezultat i një aktiviteti të rrezikshëm, nëse dhe në masën që kjo justifikohet nga gjetjet e hetimit. Në raste të tilla, autoritetet kompetente duhet të veprojnë me zell dhe shpejtësi të veçantë dhe duhet me iniciativën e tyre të nisin hetime që të mundësojnë konstatimin, së pari, të rrethanave në të cilat ndodhi incidenti dhe çdo mangësi në funksionimin e sistemit rregullator dhe, së dyti, identifikimin e zyrtarëve ose autoriteteve shtetërore të përfshira në çfarëdo cilësie në zinxhirin e ngjarjeve në fjalë (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 94; *Budayeva dhe të tjerët k. Rosisë*, 2008, § 142; *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rosisë*, 2012, § 191; *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 121; *Smaltini k. Italisë* (aktv.), 2015, § 53; *Mučibabić k. Serbisë*, 2016, § 125; *Durdaj dhe të tjerët k. Shqipërisë*, 2023, § 187).

29. Qëllimi thelbësor i një hetimi të tillë është të sigurojë zbatimin efektiv të legjislacioneve kombëtare që mbrojnë të drejtën për jetë dhe, në ato raste që përfshijnë agjentë ose organe shtetërore, të sigurojë llogaridhënien e tyre për vdekjet që ndodhin nën përgjegjësinë e tyre (*M. Özel dhe të tjerët k. Turqisë*, 2015, § 188).

b. Procedura gjyqësore

30. Aty ku hetimi *ex officio* ka çuar në fillimin e procedurave në gjykatat kombëtare, procedurat në tërësi, duke përfshirë fazën e gjykimit, duhet të përmbushin kërkesat e detyrimit pozitiv për të mbrojtur jetën nëpërmjet ligjit (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 95; *Budayeva dhe të tjerët k. Rosisë*, 2008, § 143; *M. Özel dhe të tjerët k. Turqisë*, 2015, § 190). Kjo nuk do të thotë se neni 2 nënkupton të drejtën e një kërkuesi për të kërkuar ndjekjen penale ose dënimin e palëve të treta për një vepër penale ose një detyrim absolut që të gjitha ndjekjet penale të rezultojnë në dënim, ose në të vërtetë në një dënim të caktuar (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 96; *Budayeva dhe të tjerët k. Rosisë*, 2008, § 144; *M. Özel dhe të tjerët k. Turqisë*, 2015, §§ 187 dhe 190; *Istanbulu dhe Ayden k. Turqisë* (aktv.), 2015, § 41; *Erdal Muhammet Arslan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, § 138). Nga ana tjetër, gjykatat kombëtare në asnjë rrethanë nuk duhet të lejojnë që veprat që rrezikojnë jetën të mbeten të pandëshkuara. Kjo është thelbësore për ruajtjen e besimit të publikut dhe garantimin e respektimit të sundimit të ligjit dhe për parandalimin e çdo shfaqjeje të tolerancës ose marrëveshjes së fshehtë në akte të paligjshme (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 96; *Budayeva dhe të tjerët k. Rosisë*, 2008, § 145; *M. Özel dhe të tjerët k. Turqisë*, 2015, § 187). Prandaj, detyra e Gjykatës konsiston në shqyrtimin nëse dhe në çfarë mase gjykatat, në arritjen e konkluzionit të tyre, mund të konsiderohet se ia kanë nënshtuar çështjen një shqyrtimi të kujdesshëm, ashtu siç kërkohet nga neni 2 i Konventës, në mënyrë që efekti parandalues i sistemit gjyqësor në vend dhe rëndësia e rolit që kërkohet të luajë në parandalimin e shkeljeve të së drejtës për jetën nuk janë cenuar (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 96; *Budayeva dhe të tjerët k. Rosisë*, 2008, § 145; *Smaltini k. Italisë* (aktv.), 2015, § 54; *Durdaj dhe të tjerët k. Shqipërisë*, 2023, § 212).

31. Aty ku cenimi i së drejtës për jetën nuk shkaktohet me dashje, detyrimi pozitiv për të ngritur një sistem gjyqësor efektiv nuk kërkon domosdoshmërisht ngritjen e procedurave penale.

Ky detyrim mund të përmbushet gjithashtu nëse sistemi ligjor u mundëson viktimave një mjet juridik në gjykatat civile, vetëm ose së bashku me një mjet juridik në gjykatat penale, duke mundësuar përcaktimin e çdo përgjegjësie të individëve në fjalë dhe marrjen e çdo dëmshpërblimi të duhur civil, siç është urdhri për dëmshpërblim (*Istanbulu dhe Ayden k. Turqisë* (aktv.), 2015, § 33; *Erdal Muhammet Arslan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, §§ 137 dhe 141). Gjykata ndoqi këtë qasje në rastet në lidhje me vdekjet si rezultat i tërmeteve (*Istanbulu dhe Ayden k. Turqisë* (aktv.), 2015, § 33; *Erdal Muhammet Arslan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, § 137). Kur përfshihen agjentë të shtetit ose anëtarë të profesioneve të caktuara, mund të parashikohen edhe masa disiplinore (*Erdal Muhammet Arslan*

dhe të tjerët k. Turqisë, 2023, § 137).

c. Shembuj

32. Në rastin *Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, §§ 111-118, Gjykata vuri në dukje se autoritetet hetuese kishin vepruar me shpejtësi shembullore dhe kishin treguar zell për të përcaktuar rrethanat që kishin çuar në aksident dhe vdekje, se ishin identifikuar përgjegjësit për ngjarjet në fjalë dhe se ishte nisur një procedurë penale në gjykatën penale kundër kryetarit të komunës së Stambollit dhe kryetarit të qarkut në të cilin ndodhej lanfilli i mbeturinave. Megjithatë, ata nuk ishin ndjekur penalisht për shkelje të së drejtës për jetë, por për neglizhencë në kryerjen e detyrave të tyre, dhe ishin dënuar vetëm me gjoba të pezulluara prej 9.70 euro, të cilat Gjykata i cilësoi si “përçmuese”. Gjykata arriti në përfundimin se mënyra se si funksionoi sistemi i drejtësisë penale turke në përgjigje të tragjedisë kishte dështuar të siguronte përgjegjësinë e plotë të zyrtarëve ose autoriteteve shtetërore për rolin e tyre në të dhe zbatimin efektiv të dispozitave të legjislacionit kombëtar që garantojnë respektimin e të drejtës për jetë, në veçanti funksionin parandalues të ligjit penal. Ajo konstatoi shkelje të nenit 2 të Konventës në aspektin e tij procedural, për shkak të mungesës, në lidhje me një aksident fatal të shkaktuar nga kryerja e një aktiviteti të rrezikshëm, të mbrojtjes adekuate “me ligj” që mbron të drejtën për jetë dhe parandalon sjellje të ngjashme të rrezikshme për jetën në të ardhmen.

33. Në rastin *Budayeva dhe të tjerët k. Rosisë*, 2008, §§ 161-165, Gjykata konstatoi një shkelje sipas detyrimit procedural të nenit 2 për shkak të faktit se aksidenti në fjalë nuk ishte hetuar apo shqyrtuar kurrë si i tillë nga ndonjë autoritet gjyqësor apo administrativ.

34. Në rastin *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rosisë*, 2012, §§ 194-203, Gjykata vërejti se kishte pasur një hetim paraprak, por se autoritetet kompetente nuk kishin treguar ndonjë vendosmëri të veçantë për të vërtetuar rrethanat e rastit ose për të identifikuar dhe sjellë përgjegjësit para drejtësisë. Ata nuk ishin përpjekur siç duhet për të identifikuar përgjegjësit për mirëmbajtjen e dobët të kanalit të lumit, edhe pse ishte vërtetuar se kjo kishte qenë arsyeja kryesore e përmytjes, dhe kishin vendosur të mbyllnin hetimet për dështimet e autoriteteve lokale në planin urbanistik.

35. Në rastin *M. Özel dhe të tjerët k. Turqisë*, 2015, §§ 192-200, në lidhje me një tërmet që kishte shkaktuar vdekje të shumta në rajonin e Izmitit në vitin 1999, ishte ngritur procedurë penale për vdekjet në fjalë kundër ndërtuesve të pronave përgjegjëse për ndërtesat që ishin shembur dhe kundër individëve të caktuar të përfshirë drejtpërdrejt në ndërtimin e tyre, dhe kërkuesit kishin mundur të merrnin pjesë në procedurë. Pesë persona ishin proceduar penalisht. Gjykata megjithatë vuri në dukje se kohëzgjatja e procedurave - dymbëdhjetë vjet - nuk e kishte përmbushur kërkesën e shqyrtimit të shpejtë të çështjes pa vonesa të panevojshme. Ajo gjithashtu vuri në dukje se procedurat ishin zhvilluar në atë mënyrë që vetëm dy nga të akuzuarit ishin shpallur më në fund përgjegjës për ngjarjet, ndërsa tre të tjerët kishin përfituar nga parashkrimi. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se në mungesë të autorizimit paraprak administrativ të kërkuar sipas legjislacionit kombëtar, pavarësisht nga të gjitha kërkesat e kërkuesve, nuk ishte nisur asnjë hetim penal kundër zyrtarëve publikë, mangësitë dhe dështimet e të cilëve në mbikëqyrjen dhe inspektimin e ndërtesave që ishin shembur përndryshe mund të ishin vërtetuar.

Në rastin *Istanbulu dhe Ayden k. Turqisë* (aktv.), 2015, § 36-43, në lidhje me të njëjtin tërmet, kërkuesit u ankuan për zhvillimin e procedurave penale të nisura pas vdekjes së të afërmeve të tyre nën rrënojat e ndërtesës ku ata jetonin, dhe mungesën e efektivitetit të sistemit gjyqësor turk. Procedurat penale që ishin nisur ndaj punonjësit teknik me përgjegjësi për ndërtimin e objektit dhe zhvilluesit të pronës kishte përfunduar me shpalljen e pafajësisë së të parit, me arsyetimin se nuk përgjigjej për defekte në ndërtim dhe me konstatimin se procedura ishte parashkruar për këtë të fundit, për shkak të mungesës së shpejtësisë së duhur të autoriteteve gjyqësore. Gjykata vuri në dukje se periudha e gjatë e pasivitetit nga ana e gjykatave kombëtare e kishte bërë të pamundur që procedurat penale të vërtetonin nëse ndërtuesi i pronës kishte kryer një vepër penale. Megjithatë, ajo konsideroi se nuk kishte asgjë pengesë për të vendosur përgjegjësinë për vdekjen e të afërmeve të kërkuesve përmes përdorimit të mjeteve juridike ekzistuese civile. Ajo arriti në përfundimin se, pavarësisht nga mangësitë në procedurat penale të hapura në këtë çështje, legjislacioni kombëtar u siguronte kërkuesve mjete juridike civile që ishin në gjendje të përmbushnin detyrimin e shtetit sipas nenit 2 të Konventës për të ngritur një sistem gjyqësor efektiv, i aftë për të dhënë një përgjigje të përshtatshme

për vdekjen e të afërmeve të tyre, dhe se për këtë arsye kërkesa ishte qartazi e pabazuar.

Në rastin *Erdal Muhammet Arslan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, §§ 142-137, në lidhje me një tërmet në rajonin e Van në vitin 2011, Gjykata, duke shqyrtuar një kërkesë të paraqitur nga anëtarët e familjes së një individi që ishte varrosur nën një hotel të shembur, arriti në përfundimin se legjislacioni kombëtar u kishte ofruar kërkuësve një mjet juridik që mund të përmbushte detyrimin e shtetit të paditur për të vendosur një sistem gjyqësor efektiv me anë të të cilit mund të jepej një përgjigje e përshtatshme ligjore për vdekjen e të afërmit të tyre në rrethanat e rastit. Në lidhje me këtë, Gjykata theksoi se shtetit i kërkohej t'u ofronte kërkuësve një mjet juridik me anë të të cilit të përcaktonin përgjegjësinë e mundshme të autoriteteve në fjalë dhe të merrnin kompensim aty ku ishte e përshtatshme. Sipas ligjit turk, ky mjet juridik mori formën e një veprimi përpara gjykatave administrative që vendosin me juridiksion të plotë. Kërkuësit kishin ndjekur atë rrugë. Gjykata administrative kishte vendosur se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Urban dhe autoritetet komunale të Vanit nuk kishin inspektuar siç duhet projektin e ndërtimit të hotelit dhe punimet e ndërtimit, dhe se organi publik turk për menaxhimin e fatkeqësive natyrore nuk kishte kryer as hetimin e nevojshëm për fatkeqësinë dhe as nuk kishte kryer një inspektim në kohë pas një tërmeti të mëparshëm. Prandaj, ajo u kishte dhënë atyre 71,694 euro si kompensim, të cilin Gjykata e konstatoi si kompensim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm në rrethanat e çështjes. Gjykata mori gjithashtu parasysh faktin se një hetim penal ishte hapur disa ditë pas shembjes së ndërtesës, gjatë të cilit ishte autorizuar një raport i pavarur i ekspertit dhe në mbyllje të të cilit ishte identifikuar personi kryesor përgjegjës – operatori i hotelit, përpara se të ndiqej penalisht dhe të dënohej për pakujdesi me dashje që shkaktoi vdekje. Ajo vuri në dukje se gjykatat penale kishin konstatuar, në veçanti, se ndërtesa e hotelit nuk ishte në përputhje me rregulloret antisizmike; që hotelit i ishin shtuar zgjerime pa autorizim, duke komprometuar kështu strukturën e ndërtesës; se i pandehuri kishte vazhduar të operonte hotelin, pavarësisht nga tërmeti i parë, i cili kishte dobësuar strukturën; dhe se në këtë mënyrë ai kishte vepruar në mënyrë të pakujdesshme me dashje. Ajo arriti në përfundimin se çështja e përputhshmërisë me standardet e sigurisë ishte shqyrtuar si duhet nga autoritetet gjyqësore dhe hetime penale ishin zhvilluar. Edhe pse procedurat penale ishin vonuar në mënyrë të konsiderueshme dhe ishin ende në pritje, pavarësisht detyrimit të autoriteteve për të treguar kujdes dhe shpejtësi në zhvillimin e hetimit dhe të procedurave gjyqësore, Gjykata konstatoi se kjo nuk e kishte penguar përcaktimin e fakteve dhe të përgjegjësisë, dhe se nuk kishte asgjë që të tregonte se gjykatat penale kishin qenë të gatshme të lejonin që veprat penale që rrezikonin jetën të mbeteshin të ndëshkuara. Ajo gjithashtu konstatoi se, duke pasur parasysh vendimin e gjykatës administrative, dështimi për të ndjekur penalisht zyrtarët të cilët kërkuësit i konsideronin si përgjegjës nuk e kishte penguar vendosjen e përgjegjësisë përkatëse të autoriteteve administrative për vdekjen e anëtarit të familjes së kërkuësve, ose kompensimin e dhënë atyre në këtë drejtim.

36. Në rastin *Smaltini k. Italisë* (aktv.), 2015, §§ 56-61, kërkuësi, i cili vdiq gjatë kohës së zhvillimit të procedurave përpara Gjykatës, kishte jetuar në Taranto, e cila posedon fabrikën më të madhe të çelikut në Evropë, ndikimi i së cilës në shëndet dhe mjedis ka shkaktuar debate të ndezura (shih gjithashtu *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019).

Kërkuësja, e cila konsideroi se leukemia akute mieloidë që ajo kishte zhvilluar ishte shkaktuar nga emetimet ndotëse nga fabrika, kishte bërë kallëzim penal kundër një prej drejtuesve të fabrikës për dëmtim të vërtetë trupor për shkak të shkeljes së standardeve në lidhje me mbikëqyrjen e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit. Çështja ishte pushuar me arsyetimin se nuk ishte vendosur asnjë lidhje shkakësore midis ndotjes dhe sëmundjes së kërkuësit. Gjykata ishte bindur se gjykatat kombëtare kishin kryer shqyrtimin e kujdesshëm të kërkuar sipas nenit 2. Duke vepruar kështu, ajo kishte vlerësuar nëse gjykatat kishin dhënë arsyet e duhura për pushimin e çështjes ose nëse, përkundrazi, kishin prova të mjaftueshme në dispozicion për të vendosur një lidhje shkakësore midis emetimeve toksike nga fabrika dhe sëmundjes së kërkuësit. Ajo vuri në dukje se gjykatat ishin mbështetur në tre raporte mbi gjendjen shëndetësore dhe shkaqet e vdekjes në popullatën e rajonit të Pulias, si dhe në një anketë epidemiologjike, e cila nuk kishte arritur të tregonte se kishte pasur një incidencë më të lartë të leukemisë në Taranto sesa gjetkë në vend. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se kërkuësja kishte përfituar nga procedurat kontencioze, gjatë së cilës ishin kryer hetime shtesë me kërkesën e saj. Duke pasur parasysh ato rrethana dhe *pa paragjykuar ndonjë studim shkencor të ardhshëm*, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuësja nuk kishte provuar se në dritën e njohurive

shkencore të disponueshme në kohën materiale, Qeveria kishte dështuar në detyrimin e saj për të mbrojtur jetën e saj sipas kuptimit të nenit 2 të Konventës sipas detyrimit të saj procedural.

37. Në rastin *Durdaj dhe të tjerët k. Shqipërisë*, 2023, §§ 183-238, një shpërthim i vitit 2008 në një objekt për çmontimin e armëve ushtarake kishte shkaktuar njëzet e gjashtë të vdekur dhe plagosur më shumë se treqind njerëz. Gjykata konstatoi se hetimi, i cili kishte nisur menjëherë pas shpërthimit, kishte qenë i mjaftueshëm në atë që përgjithësisht kishte arritur të vërtetonte rrethanat dhe faktet përkatëse, dhe kishte identifikuar përgjegjësit për të, dhe kërkuesve iu ishte dhënë qasje në hetim në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime. Në lidhje me procedurat gjyqësore të mëvonshme, Gjykata vuri në dukje se megjithëse asnjë nga individët e identifikuar si përgjegjës në mbyllje të hetimeve nuk ishte dënuar përfundimisht për vrasje, të gjitha veprat për të cilat u dënuan të akuzuarit kryesorë kishin të bënin me incidentin dhe dënimet e tyre i ishin referuar në mënyrë specifike shkaktimit të vdekjes dhe lëndimit të shumë personave, në kuptimin që kishin të bënin me vepra të rrezikshme për jetën dhe mbrojtjen e të drejtës për jetë në kuptim të nenit 2. Gjykata më pas vuri në dukje se dënimet me burg të vendosura ndaj të akuzuarve kryesorë dhe koha që ata kishin kaluar realisht në burg (duke filluar nga gjashtë vjet e shtatë muaj deri në dhjetë vjet e njëzet e shtatë ditë) nuk mund të konsideroheshin si të buta në mënyrë disproporcionale. Megjithatë, ajo konstatoi një shkelje procedurale të nenit 2, së pari sepse kërkuesit nuk kishin pasur të drejta procedurale në procesin penal dhe për rrjedhojë nuk kishin pasur mundësi të merrnin pjesë në proces në mënyrë efektive; dhe së dyti, sepse procedura penale për shpërdorim detyre kundër Ministrit të Mbrojtjes në kohën përkatëse ishte ende në pritje më shumë se katërmëdhjetë vjet pas incidentit, dhe disa aspekte ngritën pikëpyetje serioze për gatishmërinë e autoriteteve për ta ndjekur çështjen në përputhje me kërkesat e nenit 2, duke krijuar kështu një potencial për mosndëshkim.

II. Duhanpirja pasive

38. Në rastin *Botti k. Italisë* (aktv.), 2004, Gjykata trajtoi sipas neneve 2 dhe 8 çështjen e ekspozimit të joduhanpirësve ndaj tymit të dorës së dytë në vendet ku publiku ka qasje. Gjykata, duke marrë parasysh se interesat e kërkuesit si jo-duhanpirës binin ndesh me ato të individëve të tjerë në vazhdimin e duhanpirjes, dhe duke pasur parasysh hapësirën e vlerësimit në dispozicion të autoriteteve kombëtare, konstatoi se mungesa e një ndalimi të gjerë për duhanpirjen në vende publike nuk mund të konsiderohet si një dështim nga ana e shtetit italian për të mbrojtur të drejtat e kërkuesit sipas neneve 2 dhe 8 të Konventës.

Në rastin *Aparicio Benito k. Spanjës* (aktv.), 2006, një i burgosur u ankua sipas nenit 2 për ekspozimin e tij ndaj tymit që nxirrnin bashkë-të burgosurit e tij në ambientet e përbashkëta të qendrës së paraburgimit ku ishte mbajtur. Ai argumentoi se kishte vuajtur nga probleme të frymëmarrjes të cilat ishin të papajtueshme me thithjen e tymit. Gjykata vuri në dukje se kërkuesi ishte mbajtur në një qeli individuale, se shtatë muaj pas depozitimit të kërkesës, rregulloret ishin ndryshuar për ta bërë dhomën e televizorit të vetmen zonë të përbashkët ku të burgosurit mund të pinin duhan dhe se ai nuk kishte vërtetuar çështjet e supozuara të tij shëndetësore. Rrjedhimisht, Gjykata nuk gjeti asnjë provë që kërkuesi kishte pësuar efekte të pafavorshme të tilla që të përbënin shkelje të nenit 2, dhe e hodhi poshtë ankesën si qartazi të pabazuar.

Nenit 3 (ndalimi i torturës)

Neni 3 i Konventës

“Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.”

39. Gjykata ka shqyrtuar rastet në të cilat individët parashtuan se ndotja ose problemet mjedisore ndaj të cilave ata ishin ekspozuar përbënin trajtim në kundërshtim me nenin 3. Në shumë raste të tilla, ajo vendosi se nuk ishte vërtetuar se ishte arritur pragu i ashpërsisë për zbatueshmërinë e kësaj dispozite (*López Ostra k. Spanjës*, 1994, § 60; *Fadeyeva k. Rusisë* (aktv.), 2003; *Ward k. Mbretërisë së Bashkuar* (aktv.), 2004; *Ruano Morcuende k. Spanjës* (aktv.), 2005; *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*,

2014, § 130).

40. Megjithatë, do të ishte e dobishme të shqyrtohej praktika gjyqësore për kushtet e paraburgimit në këtë kontekst. Nga kjo praktikë gjyqësore rezulton se ekspozimi i një të burgosuri ndaj ndotësve, shqetësimeve mjedisore ose mjedisit të ndotur të burgut është së paku një faktor që duhet marrë parasysh në vlerësimin e rasteve në dritën e nenit 3.

41. Kështu, Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 3 në lidhje me të burgosurit që ishin ekspozuar ndaj tymit të nxjerrë nga të burgosurit e tjerë. Pothuajse në të gjitha rastet në fjalë, duhanpirja pasive ishte kombinuar me faktorë të tjerë fizikë si mbipopullimi dhe kushtet johigjienike (*Florea k. Rumanisë*, 2010, § 50-65; *Pavalache k. Rumanisë*, 2011, §§ 87-101; *Vasilescu k. Belgjikës*, 2014, §§ 88-107; *Sylla dhe Nollomont k. Belgjikës*, 2017, §§ 35-42).

Në rastin *Elefteriadis k. Rumanisë*, 2011, §§ 46-55, megjithatë, konstatimi i shkeljes së nenit 3 bazohej vetëm në faktin se kërkuesi, i cili vuante nga fibroza pulmonare, ishte ekspozuar ndaj tymit të cigares nga shokët e tij të burgosur. Gjykata theksoi, në veçanti, detyrimin e shteteve për të organizuar sistemet e tyre të burgjeve në mënyrë të tillë që të garantojë respektimin e dinjitetit njerëzor të të burgosurve, duke përfshirë ndoshta një kërkesë për të ndër marrë veprime për të mbrojtur një të burgosur të caktuar nga efektet e dëmshme të duhanpirjes pasive, kur gjendja e tij shëndetësore e kërkon këtë, siç vërtetohet nga ekzaminimet dhe rekomandimet mjekësore.

42. Për më tepër, në rastin *Plathey k. Francës*, 2011, §§ 47-57, Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 3 me arsyetimin e vetëm se kërkuesi ishte mbajtur për njëzet e tetë ditë, njëzet e tre orë në ditë, në një qeli disiplinore të cilës i ishte vënë zjarri një javë më parë dhe që ende kishte aromë të fortë djegieje. Gjykata vlerësoi se ky fakt kishte cenuar dinjitetin njerëzor të kërkuesit dhe ishte një trajtim poshtërues.

Neni 5 (e drejta për liri dhe siguri)

43. Në rastin *Bryan dhe të tjerët k. Rusisë*, 2023, Gjykata konstatoi se arrestimi, në Arktikun Rus, dhe ndalimi i aktivistëve nga OJQ Greenpeace pas përpjekjes së tyre për të hipur në një platformë naftë ishte në kundërshtim me nenin 5 § 1 (ndalimi i papranuar, i ndjekur nga ndalimi i paligjshëm). Ajo konstatoi gjithashtu shkelje të nenit 5 § 1 në rastin *Friedrich dhe të tjerët k. Polonisë*, 2024, në lidhje me arrestimin dhe ndalimin e aktivistëve të Greenpeace për pjesëmarrje në një operacion për të bllokuar një anije mallrash që transportonte qymyr, si dhe një shkelje të nenit 5 § 2 (e drejta për çdo njeri që arrestohet të informohet menjëherë, në një gjuhë që ai ose ajo e kupton, për arsyet e arrestimit të tij ose të saj dhe për çdo akuzë kundër tij ose saj).

Neni 6 (detyrimi civil) (e drejta për një proces të rregullt)

I. Procedurat e ngritura nga personat e prekur nga dëmtimi mjedisor

Neni 6 i Konventës

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykit mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ku kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces, ose në shkallën që kjo çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.”

A. Zbatueshmëria e Nenit 6 § 1 (detyrimi civil)

44. Në sferën mjedisore, si në çdo sferë tjetër, që neni 6 § 1 në detyrimin e tij “civil” të jetë i zbatueshëm, duhet të ketë një mosmarrëveshje (“kontestim” (contestation) në tekstin frëngjisht) mbi “të drejtat civile” (ose “detyrimet civile”) që mund të thuhet, të paktën për arsye të diskutueshme, që duhet të njihen sipas legjislacionit kombëtar. Kjo mosmarrëveshje duhet të jetë e vërtetë dhe serioze; ajo mund të lidhet jo vetëm me ekzistencën e një të drejte, por edhe me fushëveprimin dhe mënyrën e ushtrimit të saj. Rezultati i procedurave duhet të jetë drejtpërdrejt vendimtar për të drejtën në fjalë, lidhjet e thjeshta të dobëta ose pasojat e largëta nuk janë të mjaftueshme për të vënë në zbatim Nenin 6 § 1 (Çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin në të cilin janë përcaktuar këto parime: *Zander k. Suedisë*, 1993, § 22; *Balmer-Schafroth dhe të tjerët k. Zvicrës*, 1997, § 30; *Athanasoglou dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2000, § 43; *Ünver k. Turqisë* (aktv.), 2000; *Lam dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* (aktv.), 2001; *Kyrtatou dhe Kyrtatos k. Greqisë* (aktv.), 2001; *Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët k. Spanjës*, 2004, § 43; *Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 130; *Okyay dhe të tjerët k. Turqisë*, 2005, § 64; *Collectif national d’information et d’opposition à l’usine Melox – Collectif Stop Melox dhe Mox k. Francës* (aktv.), 2006; *Folkman dhe të tjerët k. Republikës Çeke* (aktv.), 2006; *Sdružení Jihočeské Matky k. Republikës Çeke* (aktv.), 2006; *Lorentzatou k. Greqisë* (aktv.), 2010; *Zapletal k. Republikës Çeke* (aktv.), 2010; *Ivan Atanasov k. Bullgarisë*, 2010, § 90; *Bursa Barosu Başkanlığı dhe të tjerët k. Turqisë*, 2018, § 125; *Vecbaştika dhe të tjerët k. Letonisë* (aktv.), 2019, § 65; *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, § 52; *Çöçelli dhe të tjerët k. Turqisë*, 2022, § 42; *Cangı dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, § 34; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 595). Karakteri i legjislacionit që rregullon mënyrën se si do të përcaktohet çështja dhe ai i autoritetit që është investuar me juridiksion në këtë çështje kanë pak rëndësi (*Ivan Atanasov k. Bullgarisë*, 2010, § 90).

45. Pasoja kryesore është se neni 6 § 1 është i pazbatueshëm sipas detyrimit të tij civil për procedurat që synojnë mbrojtjen e mjedisit si vlerë me interes publik. Megjithatë, Gjykata sqaroi, në rastin *Collectif National d’information et d’opposition à l’usine Melox – Collectif Stop Melox dhe Mox k. Francës* (aktv.), 2006, në lidhje me një padi për të anuluar një dekret që autorizon zgjerimin e një fabrike karburanti bërthamor të paraqitur në një gjykatë administrative nga një shoqatë e mbrojtjes së mjedisit, që këto kritere duhet të zbatohen në mënyrë fleksibël kur një shoqatë ankohet për shkelje të kësaj dispozite. Në lidhje me këtë, ajo theksoi se megjithëse një lexim strikt i nenit 6 § 1 mund të sugjeronte se ai ishte i pazbatueshëm në mungesë të një mosmarrëveshjeje mbi një të drejtë civile të cilën vetë shoqata kërkuese mund të pretendonte se e kishte, “një qasje e tillë do të ishte në kundërshtim me realitetet e shoqërisë civile të sotme, ku shoqatat luajnë një rol të rëndësishëm, *inter alia* duke mbrojtur shkaqe specifike përpara autoriteteve apo gjykatave kombëtare, veçanërisht në sferën e mbrojtjes së mjedisit” (shih gjithashtu rastin *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 602).

1. Parime e përgjithshme për zbatueshmërinë e nenit 6 § 1

a. E drejta civile e njohur sipas legjislacionit kombëtar, së cilës kërkuesi mund t'i drejtohet

46. Zbatueshmëria e nenit 6 § 1 për çështjet gjyqësore mjedisore varet kryesisht nga gjendja e legjislacionit kombëtar.

47. Legjislacioni kombëtar mund të ofrojë një të drejtë individuale për mjedisin (*Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, §§ 131-133; *Okyay dhe të tjerët k. Turqisë*, 2005, § 65; *Ivan Atanasov k. Bullgarisë*, 2010, § 91; *Association Greenpeace France k. Francës* (aktv.), 2011; *Cangı dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, § 35), ose ligji mund të garantojë një nga aspektet e një të drejte të tillë, siç është e drejta e publikut për informacion dhe pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes, kur një aktivitet që paraqet rrezik për shëndetin ose mjedisin duhet të autorizohet (*Collectif national d’information et d’opposition à l’usine Melox - Collectif Stop Melox dhe Mox k. Francës* (aktv.), 2006; *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, § 57).

Kur një e drejtë e tillë ekziston në legjislacionin kombëtar, ka të ngjarë të jetë “civile” për qëllimet e nenit 6 § 1 (*Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, §§ 133; *Okyay dhe të tjerët k. Turqisë*, 2005, §§ 66-67; *Collectif national d’information et d’opposition à l’usine Melox – Collectif Stop Melox dhe Mox*

k. Francës (aktv.), 2006; *Folkman dhe të tjerët k. Republikës Çeke* (aktv.), 2006; *Sdružení Jihočeské Matky k. Republikës Çeke* (aktv.), 2006; *Ivan Atanasov k. Bullgarisë*, 2010, § 91; *Association Greenpeace France k. Francës* (aktv.), 2011; *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, § 57; *Efgan Çetin dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, § 33; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 600).

Duke vendosur kështu në rastin *Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 133, në të cilin personat që jetonin pranë një miniere ari që përdorte një proces cianidimi ishin ankuar për moszbatimin e vendimeve gjyqësore që anulonin lejen e funksionimit të minierës, Gjykata vuri në dukje se e drejta në fjalë u jepte të drejtë individëve për mbrojtjen e duhur të integritetit të tyre fizik kundër rreziqeve që buronin nga miniera. Ajo konkludoi se kjo e drejtë njihej në ligjin turk, pasi Kushtetuta garantonte të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të ekuilibruar, dhe konstatoi se kërkuesit mund të kishin pretenduar për rrjedhojë se kishin të drejtën sipas ligjit turk për t'u mbrojtur kundër dëmtimit mjedisor të shkaktuar nga miniera. Në përfundim për sa i përket natyrës civile të kësaj të drejte, Gjykata vuri në dukje se shkalla e rrezikut të paraqitur nga metoda e cianidimit të funksionimit të minierës ishte përcaktuar nga gjykata kombëtare, e cila ishte mbështetur në studimet e ndikimit dhe arriti në përfundimin se mbrojtja e integritetit fizik të kërkuesve ishte ndikuar drejtpërdrejt.

Ngjashëm, në rastin *Okyay dhe të tjerët k. Turqisë*, 2005, §§ 66-67, individë të ekspozuar ndaj ndotjes nga termocentralet ishin ankuar për moszbatimin e vendimeve gjyqësore që urdhëronin mbylljen e tyre. Kërkuesit u mbështetën në të drejtën e tyre për të “jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të ekuilibruar” siç parashikohet në ligjin kushtetues turk. Duke konstatuar se e drejta në fjalë ishte e një natyre civile, Gjykata mori parasysh faktet se mbrojtja e integritetit fizik të kërkuesve ishte cenuar për shkak të ekspozimit të tyre ndaj ndotjes së kontestuar dhe se ata kishin *locus standi* në gjykatat turke të ankohen për aktivitete që kërcënojnë mjedisin dhe të kërkojnë dëmshpërblim në rast të moszbatimit të vendimeve të favorshme.

Në rastin e *Collectif national d'information et d'opposition à l'usine Melox – Collectif Stop Melox dhe Mox k. Francës* (aktv.), 2006, në lidhje me një padi për të anuluar një dekret që autorizonte zgjerimin e një fabrike karburanti bërthamor të paraqitur në një gjykatë administrative nga një shoqatë e mbrojtjes së mjedisit, e drejta në fjalë i jepte publikut të drejtën për informim dhe pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes. Gjykata arriti në përfundimin se kjo e drejtë ishte një e drejtë civile nga fakti që çdo palë e interesuar mund të kërkonte, në baza individuale, përmbushjen e saj përpara gjykatave kombëtare.

48. Ndryshe, e drejta përkatëse mund të ketë të bëjë me mbrojtjen e jetës, të integritetit fizik ose të pronës.

Në rastin *Balmer-Schafroth dhe të tjerët k. Zvicrës*, 1997, §§ 33-34, në të cilin personat që jetonin në afërsi të një centrali bërthamor ishin ankuar për shkelje të së drejtës së tyre të qasjes në gjykatë për të kundërshtuar vendimin e Këshillit Federal për zgjatjen e licencës së funksionimit të tij, Gjykata vlerësoi se ai kusht ishte përmbushur. Ajo vuri në dukje se e drejta në të cilën mbështeteshin kërkuesit ishte e drejta për të mbrojtur integritetin e tyre fizik në mënyrë adekuate nga rreziqet e shkaktuara nga përdorimi i energjisë bërthamore, e cila bazohej në seksionin 5 (1) të Aktit të Energjisë Bërthamore (që thotë se autorizimi për të ndërtuar ose operuar një instalim bërthamor duhet të refuzohet ose të kushtëzohet kur është e nevojshme për mbrojtjen e njerëzve, pronës së të tjerëve dhe të drejtave të rëndësishme) dhe në të drejtën kushtetuese për jetë. Gjykata arriti në një përfundim të ngjashëm në rastin *Athanassoglou dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2000, § 44, i cili kishte të bënte me një situatë të krahaseshme në të cilën kërkuesit kishin kërkuar, në nivel kombëtar, të mbështesnin jo vetëm të drejtën e tyre për integritet fizik, por edhe të drejtat e tyre për jetën dhe respektimin e pronës së tyre. Gjykata vuri në dukje se sistemi ligjor zviceran, duke përfshirë Kushtetutën dhe dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë të drejtat e fqinjëve, ia garantonte këto të drejta të gjithëve (shih gjithashtu *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 617).

Në rastin *Zander k. Suedisë*, 1993, § 27, personat që jetonin pranë një instalimi që ruan dhe përpunon mbetje shtëpiake dhe industriale, dhe kishin një pus të kontaminuar me cianid, të vendosur në pronën e tyre, ishin ankuar se sipas legjislacionit kombëtar nuk kishin mundur t'i referonin gjykatës një vendim administrativ që rinovonte lejen e funksionimit të instalimit dhe autorizonte zgjerimin e aktiviteteve

të tij, ndërkohë që refuzonin masën paraprake të urdhëruar. Gjykata vuri në dukje se kërkesa e kërkuësve kishte të bënte drejtpërdrejt me aftësinë e tyre për të përdorur ujin në pusin e tyre si ujë të pijshëm, si një aspekt i të drejtës së tyre si pronarë të tokës në të cilën ndodhej pusi dhe se e drejta e pronësisë ishte qartësisht një "e drejtë civile" sipas kuptimit të nenit 6 § 1.

Në rastin *Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët k. Spanjës*, 2004, §§ 45-46, në lidhje me procedurat për të anuluar një Dekret ministror për miratimin e një projekti të ndërtimit të digave, Gjykata vuri në dukje se përveç mbrojtjes së interesit publik, procedura kishte për qëllim mbrojtjen e disa interesave specifike të një numri personash që jetonin në luginën që do të përmytej dhe stili i jetesës dhe pronat e të cilëve do të prekeshin. Ajo nxori përfundimin se procedurat kishin një dimension "ekonomik" dhe civil dhe ishin bazuar në një shkelje të pretenduar të të drejtave të cilat ishin gjithashtu ekonomike.

49. Çështja duhet të ketë të bëjë me një të drejtë ose detyrim që i përket kërkuësit (*Kyrtatou dhe Kyrtatos k. Greqisë* (aktv.), 2001). Në veçanti, në rastin e një të drejte civile, kërkuësit duhet të jenë në gjendje ta kërkojnë atë në emër të tyre (*Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët k. Spanjës*, 2004, § 46; *Collectif national d'information et d'opposition à l'usine Melox – Collectif Stop Melox dhe Mox k. Francës* (aktv.), 2006; *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, § 57); *TMMOB dhe Karakuş Candan k. Turqisë* (aktv.), 2024, § 42).

Në rastin *Collectif national d'information et d'opposition à l'usine Melox – Collectif Stop Melox dhe Mox k. Francës* (aktv.), 2006 (shih edhe *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021), Gjykata vendosi që një shoqatë për mbrojtjen e mjedisit mund të pretendonte në emër të saj të drejtën përkatëse të publikut për informacion dhe pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes në sferën mjedisore, siç njihet nga legjislacioni kombëtar. Ajo arriti në përfundimin se si aktorë të shoqërisë civile, organizatat joqeveritare me personalitet juridik përbënin pjesë të publikut të gjerë dhe vuri në dukje se Konventa e Aarhusit për qasjen në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore, në të cilën Franca është palë, përfshinte shoqatat në përkufizimin e këtij koncepti.

50. Gjykata miratoi një qasje "fleksibël" (*Collectif national d'information et d'opposition à l'usine Melox – Collectif Stop Melox dhe Mox k. Francës* (aktv.), 2006) për çështjen se kush e kishte të drejtën civile në fjalë në një rast kur procedurat ishin nisur nga shoqatat e mbrojtjes së mjedisit me synimin për të mbrojtur të drejtat e anëtarëve të tyre dhe banorëve lokalë të prekur nga një projekt ose aktivitet që ngre çështje mjedisore. Në të vërtetë, zbatueshmëria e nenit 6 § 1 për shoqata të tilla mund të nxirret nga fakti se procedurat në fjalë ishin vendimtare për sa i përket të drejtave civile të anëtarëve të saj ose të banorëve lokalë.

Në rastin *Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët k. Spanjës*, 2004, §§ 45-48, për shembull, procedurat kombëtare të shqyrtuara nga Gjykata nuk kishin lidhje me asnjë të drejtë që shoqata kërkuëse mund të pretendonte në emër të saj. Gjykata e nxori zbatueshmërinë e nenit 6 § 1, në lidhje, veçanërisht, me shoqatën kërkuëse, nga fakti se procedurat kombëtare ishin orientuar në mbrojtjen e të drejtave civile që gëzonin anëtarët e shoqatës (të cilët ishin gjithashtu kërkuës para Gjykatës, por nuk kishin qenë palë në procedurat kombëtare).

Në rastin *L'Erablère A.S.B.L. k. Belgjikës*, 2009, §§ 28-30, shoqata kërkuëse kishte paraqitur një padi në gjykatat kombëtare për anulimin e lejes së planifikimit për zgjerimin e një vend-depozitimi teknik. Në përfundimin se mosmarrëveshja e ngritur nga shoqata kërkuëse kishte pasur një lidhje të mjaftueshme me një të drejtë që ajo mund ta pretendonte në emër të saj, Gjykata ishte mbështetur në faktet se statutet e saj kishin përcaktuar se qëllimi i saj ishte mbrojtja e mjedisit në nivel lokal, se të gjithë anëtarët themelues dhe zyrtarët e saj administrativ kishin jetuar pranë vendit në fjalë dhe se të drejtat civile të këtij të fundit ishin nën kërcënim, duke qenë se rritja e kapacitetit të saj kishte rrezikuar të shqetësonte cilësinë e tyre të përditshme të jetës dhe të ndikonte në vlerën e pronave të tyre në treg.

Në rastin e *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 59, një shoqatë e grave të moshuara, e krijuar për të promovuar dhe zbatuar mbrojtjen efektive të klimës në emër të anëtarëve të saj, dhe katër prej anëtarëve të saj, ishte ankuar pa sukses në Gjykatën Administrative Federale, më pas në Gjykatën Supreme Federale, për papërshtatshmërinë e masave të marra në këtë fushë nga Zvicra. Gjykata vuri në dukje se veprimi i shoqatës ishte bazuar në kërcënimin që lindte nga

efektet negative të ndryshimeve klimatike pasi ato prekin shëndetin dhe mirëqenien e anëtarëve të saj, dhe ishte e kënaqur që interesat e mbrojtura prej saj ishin të tilla që "mosmarrëveshja" e ngritur prej saj kishte një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të mjaftueshme me të drejtat e anëtarëve të saj në fjalë, duke pasur parasysh rolin specifik të shoqatave në kontekstin e ndryshimit të klimës.

51. Një mosmarrëveshje që lidhet ekskluzivisht me mbrojtjen e mjedisit si një komponent i interesit publik nuk ka të bëjë me një të drejtë civile sipas kuptimit të nenit 6 § 1 (*TMMOB dhe Karakuş Candan k. Turqisë* (aktv.), 2024, § 47). Megjithatë, fakti që procedurat e ndërlidhura synojnë mbrojtjen e interesit publik në mjedis nuk përjashton mundësinë që ato të jenë gjithashtu drejtpërdrejt vendimtare për të drejtat specifike civile (*Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët k. Spanjës*, 2004, §§ 45-47; *Collectif national d'information et d'opposition à l'usine Melox – Collectif Stop Melox dhe Mox k. Francës* (aktv.), 2006; *L'Erablière A.S.B.L. k. Belgjikës*, 2009, § 25; *Karin Andersson dhe të tjerët k. Suedisë*, 2014, § 46; *Bursa Barosu Başkanlığı dhe të tjerët k. Turqisë*, 2018, § 128; *Stichting Landgoed Steenberghe dhe të tjerët k. Holandës*, 2021, § 30; *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, § 57; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, §§ 615-616 dhe 633-634).

b. Mosmarrëveshje "e vërtetë dhe serioze"

52. Njerëzit që jetonin pranë një termocentrali bërthamor, të cilët kishin paraqitur ankesa në gjykatat kombëtare në lidhje me ligjshmërinë, për sa i përket të drejtave të tyre, të një vendimi për zgjatjen e lejes së funksionimit të termocentralit kishin ngritur një mosmarrëveshje (*kontestim*) (*Balmer-Schafroth dhe të tjerët k. Zvicrës*, 1997, § 37; *Athanassoglou dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2000, §§ 45-46).

53. Vërtetësia dhe serioziteti i mosmarrëveshjes mund të nxirret, për shembull, nga fakti që ankesa përkatëse u shpall e pranueshme në nivelin kombëtar (*Balmer-Schafroth dhe të tjerët k. Zvicrës*, 1997, § 38; *Athanassoglou dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2000, § 45; *Kyrtatou dhe Kyrtatos k. Greqisë* (aktv.), 2001), nga thelbi i pretendimeve para gjykatave kombëtare (*Association Greenpeace France k. Francës* (aktv.), 2011; *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, § 59), ose nga argumentet e përdorura nga autoriteti kompetent ose gjyqtari për të hedhur poshtë ankesën (*Balmer-Schafroth dhe të tjerët k. Zvicrës*, 1997, §§ 37-38; *Athanassoglou dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2000, § 45; *Collectif national d'information et d'opposition à l'usine Melox – Collectif Stop Melox dhe Mox k. Francës* (aktv.), 2006; *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, § 59).

2. Mosmarrëveshje që është "drejtpërdrejt vendimtare" për të drejtën civile të kërkuarit

54. Në rastin *Balmer-Schafroth dhe të tjerët k. Zvicrës*, 1997, §§ 39-40, Gjykata vendosi se lidhja midis vendimit të Këshillit Federal për të zgatur licencën e funksionimit të një termocentrali bërthamor dhe të drejtës së kërkuarësve, të cilët jetonin pranë termocentralit, për mbrojtjen e integritetit të tyre fizik kishte qenë shumë e dobët dhe e largët për t'u zbatuar në nenin 6 § 1. Ajo vuri re në atë kontekst se kërkuarësit nuk kishin treguar se funksionimi i termocentralit i kishte ekspozuar ata personalisht ndaj një rreziku që ishte jo vetëm serioz, por edhe specifik dhe, mbi të gjitha, i pashmangshëm. Gjykata arriti në një përfundim të ngjashëm në rastin *Athanassoglou dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2000, §§ 49-55. Në veçanti, ajo vërejti se në asnjë rast kërkuarësit në asnjë fazë të procesit nuk kishin pretenduar se kishin pësuar ndonjë humbje, ekonomike apo tjetër, për të cilën ata synonin të kërkonin kompensim. Më tej, ajo vuri në dukje se kërkuarësit po kërkonin në mënyrë të padrejtë të nxirrin nga neni 6 § 1 i Konventës një mjet juridik për të kundërshtuar vetë parimin e përdorimit të energjisë bërthamore, ose të paktën një mjet për transferimin nga qeveria te gjykatat e përgjegjësish për marrjen, në bazë të provave teknike, të vendimit përfundimtar për funksionimin e centraleve të veçanta të energjisë bërthamore. Gjykata theksoi se mënyra më e mirë për të rregulluar përdorimin e energjisë bërthamore ishte që çdo Shtet Kontraktues të merrte një vendim politik sipas proceseve të tij demokratike (shih edhe rastin: *Folkman dhe të tjerët k. Republikës Çeke* (aktv.), 2006; *South Bohemian Mothers Association k. Republikës Çeke* (aktv.), 2006).

55. Gjykata bëri një konstatim të ngjashëm në rastin *Ünver k. Turqisë* (aktv.), 2000, me kuptimin se neni 6 § 1 nuk ishte zbatuar për procedurat për anulimin e një leje ndërtimi dhe për pezullimin e punimeve të nisura nga një banor lokal, me qëllim, në veçanti, të ruajtjes së bukurisë natyrore të zonës me interes publik. Ajo vuri në dukje se rezultati i procedurave nuk kishte qenë drejtpërdrejt vendimtar

për të drejtat e kërkuarit, duke vënë në dukje se nuk kishte pasur interes monetar në rrezik në procedurat dhe se kërkuari nuk kishte pohuar kurrë para gjykatave kombëtare se zhvillimi i kundërshtuar kishte pasur një efekt negativ në vlerën e pronës së tij.

56. Në rastin *Zapletal k. Republikës Çeke* (aktv.), 2010, një person që jetonte pranë një fabrike që prodhonte pjesë makinash me ngjeshje të pllakave metalike, duke shkaktuar ndotje akustike, kishte ngritur procedura kombëtare duke kërkuar rishikimin e ligjshmërisë së vendimit për miratimin e fabrikës. Gjykata pranoi se duke vepruar kështu kërkuari kishte kërkuar të mbështeste të drejtat civile të njohura në legjislacionin kombëtar, të cilat ai mund t'i pretendonte në emër të tij, por arriti në përfundimin se neni 6 § 1 ishte i pazbatueshëm për arsye se procedura e miratimit nuk kishte qenë drejtpërdrejt vendimtare për këto të drejta. Ajo vuri në dukje se kushtet që rregullojnë ndërtimin dhe funksionimin e fabrikës, duke përfshirë kërkesën për të respektuar standardet e zhurmës, ishin vendosur në kuadrin e procedurave të mëparshme dhe se procedura e miratimit thjesht kishte konfirmuar përputhjen e fabrikës me këto kushte.

Gjykata gjithashtu vuri në dukje se kërkuari nuk kishte treguar se miratimi i ndotjes akustike pas miratimit kishte qenë mjaft i rëndë sa të përbënte shkelje të të drejtave të tij dhe se as procedura e miratimit zyrtar dhe as procedurat e ngritura nga kërkuari nuk mund të çonin në pagesën e kompensimit për dëmin që rrjedh nga ndotja akustike e kundërshtuar.

57. Mund të përmendim edhe rastet *Ivan Atanasov k. Bullgarisë*, 2010, §§ 89-96, dhe *Vecbaštika dhe të tjerët k. Letonisë* (aktv.), 2019, në të cilat Gjykata vendosi se kushti i “të qenit drejtpërdrejtë vendimtar” për mosmarrëveshjen nuk ishte përmbushur në lidhje me aspektet e mëposhtme: një veprim për të anuluar një leje për transportimin e llumit nga një impiant i trajtimit të ujit në një pellg mbeturinash që i përket një ish-miniere bakri që ndodhet rreth një kilometër nga shtëpia e kërkuarit, me qëllim depozitimin në pellg në kuadrin e një operacioni të rikuperimit të tokës; dhe një ankim në Gjykatën Kushtetuese nga banorët për anulimin e një projekti urbanistik për ndërtimin e parqeve me erë.

58. Në rastin *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, § 59, një numër shoqatash për mbrojtjen e mjedisit kishin, në kontekstin e projektit *Cigéo* që synonte ruajtjen në depo të thella gjeologjike të mbetjeve radioaktive të nivelit të lartë dhe jetëgjatë, paditën Agjencinë Kombëtare për menaxhimin e mbetjeve radioaktive në gjykatat civile, duke kërkuar kompensim për dëmin që ata pretendonin se kishin pësuar për shkak të dështimit të agjencisë për t'i dhënë publikut informacionin në lidhje me menaxhimin e mbetjeve radioaktive siç kërkohet nga legjislacioni kombëtar. Gjykata arriti në përfundimin se këto procedura kishin qenë drejtpërdrejt vendimtare për të drejtën e shoqatave kërkuese për informacion dhe pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes mjedisore.

59. Në rastin *Cangi dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, §§ 36-37, kërkuarit kishin aplikuar në gjykatat administrative duke kërkuar të anulonin një vendim ministror për miratimin e një studimi të ndikimit në mjedis për nxjerrjen e arit duke përdorur shpëlarjen e cianidit në një minierë. Gjykata konstatoi se rezultati i procedurave kishte qenë "drejtpërsëdrejti vendimtar" për të drejtën "civile" për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm (të garantuar nga kushtetuta turke) të atyre kërkuarve që jetonin ose zotëronin prona në afërsi të minierës së arit. Prandaj, ajo konstatoi se neni 6 § 1 ishte i zbatueshëm në rastin e tyre. Në të kundërt, ajo hodhi poshtë si të papranueshme ankesat e kërkuarve të tjerë, me arsyetimin se ata nuk jetonin në afërsi të minierës dhe se funksionimi i saj nuk i prekte drejtpërdrejt dhe personalisht. Ajo theksoi se, për zbatueshmërinë e nenit 6 § 1, ishte e pamjaftueshme të argumentohej se ata kishin vepruar para gjykatave si “mbrojtës publikë” për mbrojtjen e mjedisit, pasi i përkisnin një lëvizjeje të krijuar për të studiuar dhe vlerësuar implikimet ligjore, sociale dhe mjedisore të minierave të arit në rajonin në fjalë.

60. Kështu, për të cituar vendimin në rastin *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 607, kur efektet e pafavorshme mjedisore mbi të drejtat e një kërkuari janë të menjëhershme dhe të sigurta, Gjykata vlerëson se mosmarrëveshja në lidhje me këtë çështje bie nën nenin 6 § 1.

Zbatueshmëria e nenit 6 § 1 në kontekstin e ndryshimeve klimatike

61. Gjykata theksoi në rastin *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024,

§ 608, se parimet e përgjithshme të parashtruara më sipër mbizotëronin edhe në kontekstin e ndryshimeve klimatike, por që karakteristikat e çështjes në fjalë kanë pasur domosdoshmërisht implikime në zbatimin e praktikës gjyqësore të saj.

62. Kështu, ajo konstatoi (§ 614) se nuk ishte e mundur të zbatoheshin elementet e kriterit të tretë (nëse rezultati i procedurës ishte "drejtpërsëdrejti vendimtar" për të drejtën e kërkuarit), veçanërisht nocioni i dëmit ose rrezikut të afërt, pa marrë parasysh siç duhet natyrën specifike të rreziqeve të lidhura me ndryshimet klimatike, duke përfshirë potencialin e tyre për pasoja të pakthyeshme dhe madhësinë e dëmit. Aty ku dëmet e ardhshme nuk ishin thjesht spekulative, por reale dhe shumë të mundshme (ose praktikisht të sigurta) në mungesë të veprimeve korrigjuese të përshtatshme, fakti që dëmi nuk ishte rreptësisht i pashmangshëm nuk duhet të shpie në përfundimin se rezultati i procedurës nuk do të ishte vendimtar për lehtësimin ose reduktimin e tij.

Një qasje e tillë do të kufizonte në mënyrë të padrejtë qasjen në gjykatë për shumë nga rreziqet më serioze që lidhen me ndryshimet klimatike, veçanërisht për veprimet ligjore të ndërmarra nga shoqatat. Gjykata shtoi se, në kontekstin e ndryshimit klimatik, veprimet e tyre ligjore duheshin parë në dritën e rolit të tyre si një mjet përmes të cilit mund të mbroheshin të drejtat e Konventës të atyre që preken nga ndryshimet klimatike, duke përfshirë ato në disavantazh të dukshëm përfaqësues, dhe nëpërmjet të cilit ata mund të kërkonin të merrnin një veprim i përshtatshëm korrigjues për dështimet dhe lëshimet e pretenduara nga ana e autoriteteve në këtë fushë.

Në këtë rast, një shoqatë e grave të moshuara, e krijuar për të promovuar dhe zbatuar mbrojtjen efektive të klimës në emër të anëtarëve të saj, dhe katër prej anëtarëve të saj, ishte ankuar pa sukses në Gjykatën Administrative Federale, më pas në Gjykatën Supreme Federale, për papërshtatshmërinë e masave të marra në këtë fushë nga Zvicra. Para Gjykatës, ata pretenduan shkelje të së drejtës së tyre për qasje në gjykatë.

Gjykata arriti në përfundimin se neni 6 § 1 zbatohet për ankesën për aq sa ishte paraqitur nga shoqata kërkuuese (§§ 621-623). Ajo vuri në dukje se shoqata, e cila kishte treguar se kishte një lidhje aktuale dhe mjaftueshëm të ngushtë me çështjen për të cilën u ankua dhe me individët që kërkonin mbrojtje kundër efekteve negative të ndryshimeve klimatike në jetën, shëndetin dhe cilësinë e tyre të jetës, kishte kërkuar të mbronte të drejtat specifike civile të anëtarëve të saj në lidhje me efektet negative të ndryshimeve klimatike. Ajo kishte vepruar si një mjet përmes të cilit mund të mbroheshin të drejtat e atyre që preken nga ndryshimet klimatike dhe nëpërmjet të cilit ata mund të kërkonin të merrnin një veprim korrigjues të duhur për dështimin e shtetit për të zbatuar efektivisht masat zbutëse sipas ligjit ekzistues. Gjykata gjithashtu përsëriti rolin e rëndësishëm të shoqatave në mbrojtjen e çështjeve specifike në sferën e mbrojtjes së mjedisit, siç është konstatuar tashmë në praktikën e saj gjyqësore, si dhe rëndësinë e veçantë të padive kolektive në kontekstin e ndryshimeve klimatike, pasojat e të cilave nuk kufizohen në mënyrë specifike për individë të caktuar. Gjykata shtoi se, në mënyrë të ngjashme, për aq sa një mosmarrëveshje pasqyrore këtë dimension kolektiv, kërkesa për një rezultat "drejtpërdrejt vendimtar" duhet interpretuar në një kuptim më të gjerë, si një synim për të siguruar një formë korrigjimi të veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve, të cilat ndikojnë mbi të drejtat civile të anëtarëve të saj, sipas legjislacionit kombëtar..

Në të kundërt, Gjykata konstatoi se neni 6 § 1 nuk ishte i zbatueshëm për ankesën për aq sa ishte ngritur nga katër anëtarët e shoqatës të cilët ishin gjithashtu kërkuar në këtë çështje (§ 624), në atë që ata nuk kishin ngritur një çështje që tregonte se veprimi i kërkuar nga autoritetet - domethënë zbatimi efektiv i masave zbutëse sipas ligjit kombëtar ekzistues – vetëm do të kishte krijuar efekte mjaft të shpejta dhe të caktuara në të drejtat e tyre individuale në kontekstin e ndryshimeve klimatike. Ajo arriti në përfundimin se mosmarrëveshja e tyre kishte thjesht një lidhje të dobët ose pasoja të largëta për të drejtat e tyre të mbështetura nga legjislacioni kombëtar dhe se rezultati i mosmarrëveshjes nuk ishte kështu drejtpërdrejt vendimtar për të drejtat e tyre civile.

B. Shembuj të zbatimit të nenit 6 § 1 në kuadrin e çështjeve gjyqësore mjedisore

63. Çështjet mjedisore në të cilat Gjykata ka shqyrtuar bazueshmërinë e ankesave sipas nenit 6 § 1

kanë të bëjnë me çështje të tilla si në vijim:

- kohëzgjatja e procedurave në lidhje me zhurmën e lagjes (*Ekholm k. Finlandës*, 2007, §§ 92-66);
- e drejta e qasjes në gjykatë për të kundërshtuar një masë që prek mjedisin, si p.sh. një leje operimi ose autorizim për të zgjeruar një vendgrumbullim mbeturinash (*Zander k. Suedisë*, 1993, § 29; *L'Erablière A.S.B.L. k. Belgjikës*, 2009, §§ 35-44); një leje ndërtimi për një linjë hekurudhore (*Karin Andersson dhe të tjerët k. Suedisë*, 2014, §§ 68-70); ose një vendim administrativ për të mos kërkuar një vlerësim paraprak të ndikimit në mjedis në lidhje me një implant gjeotermik (*Efgan Çetin dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023);
- e drejta e qasjes në gjykatë për të ngritur një padi për dëmshpërblim kundër një autoriteti lokal i cili kishte autorizuar nga pakujdesia instalimin e një biznesi ndotës dhe nuk kishte marrë masat e nevojshme (*Lam dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* (aktv.), 2001), kundër një punëdhënësi privat dhe një fondi sigurimi për shkak të vdekjes së një punonjësi i cili ishte ekspozuar ndaj asbestit në kontekstin e aktiviteteve të tij profesionale (*Howald Moor dhe të tjerët k. Zvicrës*, 2014, §§ 70-80), ose kundër një rafinerie naftë përgjegjëse për një shpërthim që kishte dëmtuar pronën e kërkuarit (*Kurşun k. Turqisë*, 2018, §§ 93-105);
- e drejta e qasjes në gjykatë në lidhje me një shoqatë për mbrojtjen e mjedisit me një kërkesë kompensimi për dëmin e shkaktuar nga një shkelje e pretenduar e një kërkesë sipas legjislacionit kombëtar për të dhënë informacion mbi menaxhimin e mbetjeve radioaktive (*Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, §§ 64-72);
- e drejta e qasjes në gjykatë për t'u ankuar për pamjaftueshmërinë e masave për mbrojtjen e klimës (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024);
- qasja në dokumentet që mbaheshin nga autoritetet, por që ishin të nevojshme për të provuar rastin e ushtarakëve që ishin ekspozuar ndaj rrezatimit gjatë testeve atmosferike të armëve bërthamore, në kuadër të procedurave për marrjen e një pensioni invaliditeti (*McGinley dhe Egan k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1998, §§ 85-90 dhe 99);
- detyrimi për të zbatuar ose siguruar zbatimin e vendimeve gjyqësore në lidhje me zhurmën e lagjes (*Ekholm k. Finlandës*, 2007, §§ 72-75; *Apanasewicz k. Polonisë*, 2011, §§ 72-83), të vendimeve të favorshme për mbrojtjen e mjedisit, të tilla si vendimet që urdhërojnë mbylljen e termocentraleve ndotëse (*Okay dhe të tjerët k. Turqisë*, 2005, §§ 72-75), anulimi i vendimeve administrative që autorizojnë ndërtimin dhe funksionimin e një fabrike niseshteje (*Bursa Barosu Başkanlığı dhe të tjerët k. Turqisë*, 2018, §§ 133-145) ose të një miniere ari të operuar me cianidin dhe që përbën një kërcënim për shëndetin dhe mjedisin (*Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, §§ 135-138; *Lemke k. Turqisë*, 2007, §§ 51-53; *Genç dhe Demirgan k. Turqisë*, 2017, §§ 45-46), një vendim që urdhëron prishjen e ndërtesave të ngritura në mënyrë të paligjshme në dëm të mjedisit (*Kyrtatos k. Greqisë*, 2003, §§ 30-32) ose urdhëron heqjen e antenave të telekomunikacionit të vendosura pranë një manastiri, me arsyetimin se valët elektromagnetike tejkaluan kufijtë e sigurisë në ekspozimin publik (*Iera Moni Profitou Iliou Thiras k. Greqisë*, 2005, §§ 34-38);
- pajtueshmëria me parimin e sigurisë juridike në kontekstin e rivendosjes në afatin e ankimit dhe pranimit të ankesave të paraqitura jashtë afatit kundër vendimit të formës së prerë që jep pagesë dhe kompensim shtesë për personat që kishin marrë pjesë në operacionet e shpëtimit emergjent në vendin e fatkeqësisë së Çernobilit (*Magomedov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2017, §§ 86-101);
- neutraliteti i ekspertëve të caktuar për të vlerësuar rreziqet mjedisore nga dy fabrika të çimentos, në kontekstin e procedurave që kundërshtojnë vendimet administrative për miratimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis të fabrikave (*Çoçelli dhe të tjerët k. Turqisë*, 2022, §§ 57-64);
- pjesëmarrja e banorëve lokalë në shqyrtimin kundërthënës të një raportit të ekspertizës të urdhëruar nga gjykata në kontekstin e procedurave në lidhje me kërkesën e tyre për të anuluar një vendim ministror që miraton një vlerësim të ndikimit mjedisor për nxjerrjen e arit duke përdorur shpëlarje cianidi në një minierë (*Cangi dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, §§ 43-56).

64. Në rastin *Iera Moni Profitou Iliou Thiras k. Greqisë* 2005, § 38, i cili kishte të bënte me moszbatimin e një vendimi gjyqësor që urdhëronte heqjen e antenave të telekomunikacionit të vendosura në afërsi të një manastiri me arsyetimin se valët elektromagnetike tejkaluan kufijtë e sigurisë për ekspozimin publik, Gjykata duket se i ka kushtuar rëndësi të veçantë aspektit mjedisor të çështjes, duke konstatuar shkelje të nenit 6 § 1 “duke pasur parasysh [në veçanti] atë që rrezikohet për ruajtjen e mjedisit natyror dhe kulturor”.

65. Në rastin e *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, §§ 635-638, Gjykata mori parasysh urgjencën e trajtimit të efekteve negative të ndryshimeve klimatike. Në këtë rast, gjykatat zvicerane e kishin shpallur të papranueshme ankesën e paraqitur pranë tyre nga një shoqatë e grave të moshuara, e krijuar për të promovuar dhe zbatuar mbrojtjen efektive të klimës në emër të anëtarëve të saj, dhe disa prej anëtarëve të saj, në mënyrë që të ankoheshin për papërshtatshmërinë e masave të marra në këtë fushë nga Zvicra. Ata kishin konstatuar se të drejtat e kërkuar nuk ishin prekur nga lëshimet e pretenduara me intensitet të mjaftueshëm në kuptim të seksionit 25a të Ligjit Federal të Procedurës Administrative (përcaktimi i qëndrimit për të kërkuar një vendim mbi aktet reale, përkatësisht aktet e bazuara në të drejtën publike federale që prekin të drejtat dhe detyrimet, por që nuk lindin nga vendimet formale) dhe se ankimi i tyre ishte i natyrës *actio popularis*. Gjykata deklaroi se nuk ishte e bindur nga gjetjet e gjykatave kombëtare se kishte ende pak kohë për të parandaluar ngrohjen globale që të arrinte kufirin kritik. Ajo theksoi se ky përfundim nuk ishte bazuar në ekzaminimin e mjaftueshëm të provave shkencore në lidhje me ndryshimet klimatike, si dhe në pranimin e përgjithshëm se ekziston urgjenca për sa i përket ndikimeve ekzistuese dhe të pashmangshme në të ardhmen të ndryshimeve klimatike në aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut. Ajo shtoi se, në të vërtetë, provat ekzistuese dhe gjetjet shkencore mbi urgjencën e trajtimit të efekteve negative të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë rrezikun e madh të pashmangshmërisë dhe pakthyeshmërisë së tyre, sugjerorin se ekzistonte një nevojë urgjente për të garantuar mbrojtjen ligjore të të drejtave të njeriut në lidhje me veprimet e supozuara të pamjaftueshme të autoriteteve për të trajtuar ndryshimet klimatike. Duke vënë në dukje më tej se gjykatat kombëtare nuk e kishin trajtuar çështjen e pozitës së shoqatës kërkuese dhe nuk ishin përfshirë seriozisht ose fare me padinë e ngritur prej saj, Gjykata konstatoi se e drejta e saj për qasje në gjykatë ishte kufizuar në një mënyrë dhe në atë masë sa që vetë thelbi i së drejtës ishte cenuar, në kundërshtim me nenin 6 § 1.

II. Barazpesha e forcave në çështjet gjyqësore mjedisore

66. Në rastin *Steel dhe Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2005, §§ 59-72, dhe *Collectif national d'information et d'opposition à l'usine Melox – Collectif Stop Melox dhe Mox k. Francës*, 2007, §§ 13-16, Gjykata mori në konsideratë mosbalancimin e mundshëm në procedurat “civile” në dëm të agjencive të mbrojtjes së mjedisit.

Në të parën nga këto dy raste, aktivistët ekologjikë kishin shpërndarë trakte duke kritikuar një kompani të ushqimit të shpejtë, duke pretenduar në veçanti se ajo po kontribuonte në praktikën bujqësore abuzive dhe imorale dhe shpyllëzimin, dhe duke shitur ushqime të pashëndetshme. Ata ishin paditur nga kompania për shpifje dhe pas procedurave të gjata ishin urdhëruar të paguanin shuma të mëdha si dëmshpërblim. Aktivistët nuk kishin mundësi të përballonin një avokat dhe për këtë arsye kishin kërkuar ndihmë juridike. Pasi kjo kërkesë u rrëzua, ata pretenduan shkelje të së drejtës së tyre për një gjykim të drejtë. Gjykata u shpreh në favor të tyre, duke vendosur se mohimi i ndihmës juridike për kërkuar në kushte hequr atyre mundësinë për të paraqitur çështjen e tyre në mënyrë efektive përpara gjykatës dhe kishte kontribuar në një pabarazi të papranueshme të armëve me kompaninë paditëse.

Në rastin e dytë, një shoqatë për mbrojtjen e mjedisit dhe një parti politike ekologjike kishin paraqitur një padi në gjykatat kombëtare për të anuluar një dekret që autorizonte zgjerimin e një fabrike të karburantit bërthamor. Shoqata u ankua para Gjykatës se kompania private që operonte fabrikën ishte lejuar të bashkohej në procedurë si palë. Ajo pretendoi se kjo do të thoshte përballje me dy kundërshtarë, dhe për këtë arsye u ankua se ekuilibri i duhur i kërkuar midis palëve ishte prishur, i rënduar nga urdhri për të paguar shpenzimet e kompanisë. Gjykata vendosi se fakti që kërkuar kishin qenë në këtë mënyrë “përballë dy gjigantëve – Shtetit dhe një kompanie shumëkombëshe” kishte qenë i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se ata kishin qenë në disavantazh të qartë në

paraqitjen e çështjes së tyre të përbashkët. Megjithatë, Gjykata vazhdoi të shprehte habinë që gjykata kombëtare e kishte konsideruar të drejtë të urdhëronte shoqatën, e cila kishte burime të kufizuara, të paguante shpenzimet e bëra nga një kompani e pasur shumëkombëshe.

Ajo vuri në dukje se gjykata jo vetëm që kishte penalizuar palën më të dobët, por gjithashtu kishte miratuar një masë që mund të pengonte shoqatën kërkuese nga çdo përdorim i ardhshëm i kanaleve gjyqësore për të kryer detyrën e saj ligjore, ndërsa në fakt mbrojtja e shkaqeve të tilla si mbrojtja e mjedisit para gjykatave ishte pjesë e rolit kryesor që luanin organizatat joqeveritare në një shoqëri demokratike. Më tej, ajo u përmbajt nga përjashtimi i mundësisë, në rastet kur neni 6 § 1 ishte i zbatueshëm, që rrethanat e atij lloji të bien ndesh me të drejtën për një gjykatë siç parashikohet në atë dispozitë, por nuk konstatoi shkelje të kësaj të fundit, veçanërisht për shkak se shoqata kërkuese kishte mundur të pretendonte kundër urdhrit për të paguar shpenzimet, se kishte prova që sugjerorin se gjykata vendase kishte marrë parasysh kapacitetet e kufizuara financiare të shoqatës në përcaktimin e shumës së shpërblimit dhe se kjo shumë kishte qenë modeste.

III. Procedura të ngritura nga individë kundër masave për mbrojtjen e mjedisit

67. Neni 6 § 1 mund të zbatohet kur masat për mbrojtjen e mjedisit prekin të drejtat civile të një individi, siç është e drejta për mbrojtjen e pronës. Rrjedhimisht, kërkuesit përfitojnë nga një e drejtë praktike dhe efektive për qasje në gjykatë (*De Geouffre de la Pradelle k. Francës*, 1992, §§ 27-35; *Posti dhe Rahko k. Finlandës*, 2002, §§ 52-66; *Geffre k. Francës* (aktv.), 2003; *Alatulkkila dhe të tjerët k. Finlandës*, 2005, §§ 49-54; *De Mortemart k. Francës* (aktv.), 2017; *Sakskoburggotski dhe Chrobok k. Bullgarisë*, 2021, §§ 271-275; shih gjithashtu vendimin në rastin *CRASH 2000 OOD dhe të tjerët k. Bullgarisë* (aktv.), 2013, ku Gjykata vuri në dukje, në kontekstin e themelimit të një parku kombëtar, se Konventa nuk garantonte qasje në gjykatë për të kundërshtuar vendimet e politikave të përgjithshme).

IV. Tjetër

68. Në rastin *Dimopoulos k. Turqisë*, 2019, § 39, kërkuesja kishte paraqitur në gjykatat kombëtare një padi duke kërkuar njohjen e të drejtave të saj të pronësisë me posedim pa titull mbi tokën e listuar si "vend i ruajtjes së natyrës". Gjykata kombëtare e kishte rrëzuar padinë me arsyetimin se në bazë të një ligji që kishte hyrë në fuqi pas ngritjes së padisë, vendet e ruajtjes së natyrës nuk mund të fitoheshin më, me anë të posedimit pa titull. Në kuadrin e shqyrtimit të ankesës së kërkueses për shkeljen e të drejtës së saj për një gjykim të drejtë, Gjykata vuri në dukje se mbrojtja e mjedisit ishte një bazë e interesit të përgjithshëm që mund të justifikonte zbatimin retroaktiv të legjislacionit të ri për procedurat e drejtpërdrejta (gjithsesi konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 në dritën e rrethanave të çështjes).

Neni 6 (detyrimi penal) (e drejta për proces të rregullt)

69. Në rastin *European Air Transport Leipzig GmbH k. Belgjikës*, 2023, Gjykata konstatoi se neni 6 § 1 ishte i zbatueshëm sipas detyrimit të tij penal për procedurat në lidhje me gjobat administrative të vendosura ndaj kompanisë kërkuese për kryerjen e shkeljeve sipas rregullave për luftën kundër zhurmës së trafikut ajror.

Neni 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)

Neni 8 i Konventës

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, për parandalimin e trazirave apo krimin ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.”

I. Ekspozimi ndaj ndotjes dhe shqetësimit ose ndaj rrezikut mjedisor

70. Praktika gjyqësore mjedisore është zhvilluar në një masë të madhe në bazë të konstatimit të Gjykatës në rastin *López Ostra k. Spanjës*, 1994, se ndotja e rëndë mjedisore mund të ndikojë në mirëqenien e individëve dhe t'i pengojë ata të gëzojnë banesat e tyre në mënyrë të tillë që të ndikojë negativisht në jetën e tyre private dhe familjare (*López Ostra k. Spanjës*, 1994, § 51; shih edhe: *Guerra dhe të tjerët k. Italisë*, 1998, § 60; *Gronuś k. Polonisë* (aktv.), 1999; *Băcilă k. Rumanisë*, 2010, § 59; *Sciavilla k. Italisë* (aktv.), 2000; *Kyrtatos k. Greqisë*, 2003, § 52; *Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 113; *Botti k. Italisë* (aktv.), 2004; *Fägerskiöld k. Suedisë* (aktv.), 2008; *Furlepa k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Greenpeace E.V. dhe të tjerët k. Gjermanisë* (aktv.), 2009; *Marchiş dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2011; *Frankowski dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2011; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 36; *Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë*, 2012, § 104; *Dzemyuk k. Ukrainës*, 2014, § 88; *Fieroiu dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2017; *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, § 157; *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, § 62; *Yevgeniy Dmitriyev k. Rusisë*, 2020, § 32), edhe nëse nuk rrezikon seriozisht shëndetin e tyre (*López Ostra k. Spanjës*, 1994, § 51; shih edhe: *Sciavilla k. Italisë* (aktv.), 2000; *Botti k. Italisë* (aktv.), 2004; *Kyrtatos k. Greqisë*, 2003, § 52; *Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 113; *Fägerskiöld k. Suedisë* (aktv.), 2008; *Furlepa k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Greenpeace E.V. dhe të tjerët k. Gjermanisë* (aktv.), 2009; *Băcilă k. Rumanisë*, 2010, §§ 63-64; *Marchiş dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2011; *Frankowski dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2011; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 36; *Dzemyuk k. Ukrainës*, 2014, § 88; *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, § 62; *Tolić dhe të tjerët k. Kroacisë* (aktv.), 2019, § 91; *Yevgeniy Dmitriyev k. Rusisë*, 2020, § 32); *Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 69; *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 120; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 517).

71. Kështu, edhe pse nuk ka asnjë të drejtë të qartë në Konventë për një mjedis të pastër dhe të qetë, një çështje mund të lindë sipas nenit 8 kur një individ ndikohet drejtpërdrejt dhe seriozisht nga zhurma ose nga një formë tjetër ndotjeje ose shqetësimi (*Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003, § 96; *Fägerskiöld k. Suedisë* (aktv.), 2008; *Furlepa k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Tătar k. Rumanisë*, 2009, § 86; *Greenpeace E.V. dhe të tjerët k. Gjermanisë* (aktv.), 2009; *Oluić k. Kroacisë*, 2010, § 45; *Leon dhe Agnieszka Kania k. Polonisë*, 2009, § 98; *Apanasewicz k. Polonisë*, 2011, § 94; *Marchiş dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2011; *Frankowski dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2011; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 36; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 133; *Udovičić k. Kroacisë*, 2014, § 137; *Fieroiu dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2017, § 18; *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, § 62; *Kožul dhe të tjerët k. Bosnjë dhe Hercegovinës*, 2019, § 31; *Tolić dhe të tjerët k. Kroacisë* (aktv.), 2019, § 91; *Çiçek dhe të tjerët k. Turqisë* (aktv.), 2020, § 22; *Yevgeniy Dmitriyev k. Rusisë*, 2020, § 32); *Kapa dhe të tjerët k. Polonisë*, § 149, 2021; *Thibaut k. Francës* (aktv.), 2022, § 38).

Në veçanti, shkeljet që nuk janë konkrete ose fizike, të tilla si zhurma, emetimet, erërat ose forma të tjera ndërhyrjeje, mund të ndikojnë në të drejtën e një personi për respektimin e jetës së tij private dhe banesës së tij, që do të thotë të drejtën jo vetëm për zonën aktuale fizike, por edhe për gëzimin e qetë të asaj zone (*Moreno Gómez k. Spanjës*, 2004; *Luginbühl k. Zvicrës* (aktv.), 2006; *Wałkuska k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Oluić k. Kroacisë*, 2010, § 44; *Deés k. Hungarisë*, 2010, § 21; *Apanasewicz k. Polonisë*, 2011, § 93; *Martínez dhe Pino Manzano k. Spanjës*, 2012, § 40; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 133); *Kapa dhe të tjerët k. Polonisë*, § 148, 2021; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz*

dhe të tjerët k. Zvicrës [DhM], 2024, § 516).

A. Zbatueshmëria

72. Në rastet mjedisore (*Solyanik k. Rusisë*, 2022, §§ 39-45) si kudo tjetër, Gjykata si rregull do ta trajtojë zbatueshmërinë e nenit 8 si një çështje pranueshmërie *ratione materiae*. Megjithatë, ajo ka gjetur gjithashtu se ankesat që nuk plotësonin kërkesat e zbatueshmërisë së Nenit 8 ishin të papranueshme, për shkak se ishin qartazi të pabazuara (shih, për shembull, *Calancea dhe të tjerët k. Republikës së Moldavisë* (aktv.), 2018, §§ 27-33, dhe *Thibaut k. Francës* (aktv.), 2022, §§ 38-48).

73. Distanca nga burimi i ndotjes për të cilën është ankuar është një nga faktorët përkatës që duhet të merret parasysh, por fakti që një kërkues nuk jeton në afërsi të drejtpërdrejtë nuk mjafton për të përjashtuar zbatueshmërinë e nenit 8 (*Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, §§ 63-66).

1. Ekspozimi ndaj ndotjes dhe shqetësimit: nevoja e një ndikimi të drejtpërdrejtë dhe të rëndë në jetën privat edhe familjare dhe banesën

74. Që neni 8 të jetë i zbatueshëm, kërkuesi duhet të jetë në gjendje të tregojë se: 1. ka pasur ndërhyrje aktuale në sferën e tij private për shkak të situatës mjedisore për të cilën është ankuar, dhe 2. ajo ndërhyrje ka arritur një nivel minimal serioziteti (*Çiçek dhe të tjerët k. Turqisë* (aktv.), 2020, § 29; *Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 61; *Kotov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 101; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 515).

a. Ndikimi i drejtpërdrejtë

75. Gjykata pranon se në shoqërinë e sotme mbrojtja e mjedisit është një konsideratë gjithnjë e më e rëndësishme. Megjithatë, neni 8 nuk zbatohet sa herë që ndodh përkeqësimi i mjedisit. Kështu, Gjykata ka konstatuar se nuk ka asnjë të drejtë të qartë në Konventë për një mjedis të pastër dhe të qetë (*Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003, § 96), se as neni 8 dhe as ndonjë prej neneve të tjera të Konventës nuk janë krijuar posaçërisht për të ofruar mbrojtje të përgjithshme të mjedisit si të tillë (*Kyrtatos k. Greqisë*, 2003, § 52), dhe se asnjë e drejtë për ruajtjen e natyrës nuk përfshihet si e tillë midis të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa (*Fadeyeva k. Rusisë*, 2005, § 68; *Ivan Atanasov k. Bullgarisë*, 2010, § 66). Në lidhje me këtë, detyrimet e shtetit sipas nenit 8 hyjnë në lojë vetëm nëse ka një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme midis shqetësimit të pretenduar mjedisor dhe banesës së kërkuesit, ose jetës së tij private ose familjare (*Ivan Atanasov k. Bullgarisë*, 2010, § 66). Me fjalë të tjera, për të ngritur një çështje sipas nenit 8, dëmtimi mjedisor duhet të ketë një efekt të drejtpërdrejtë në të drejtën për respektimin e banesës, jetës familjare ose jetës private të kërkuesit (*Guerra dhe të tjerët k. Italisë*, 1998, § 57; *Luginbühl k. Zvicrës* (aktv.), 2006); (*Fadeyeva k. Rusisë*, 2005, § 68; *Thibaut k. Francës* (aktv.), 2022, § 38); (*Borysiewicz k. Polonisë*, 2008, § 51; *Fägerskiöld k. Suedisë* (aktv.), 2008; *Leon dhe Agnieszka Kania k. Polonisë*, 2009, § 100; *Marchiş dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2011; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 187; *Dzemyuk k. Ukrainës*, 2014, § 77; *Kožul dhe të tjerët k. Bosnje dhe Hercegovinës*, 2019, § 34; *Solyanik k. Rusisë*, 2022, § 40), ose përbën një "ndërhyrje aktuale" në gëzimin e jetës private ose familjare ose banesës së kërkuesit (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, §§ 514-515).

76. Kjo do të thotë se përkeqësimi i përgjithshëm i mjedisit nuk është i mjaftueshëm; duhet të ketë një efekt negativ në sferën private ose familjare të një individi (*Kyrtatos k. Greqisë*, 2003, § 52; *Martínez dhe Pino Manzano k. Spanjës*, 2012, § 42) që mund të karakterizohet si një ndërhyrje (*Fadeyeva k. Rusisë*, 2005, § 70; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 515).

Në rastin *Kyrtatos k. Greqisë*, 2003, § 53, kërkuesit u ankuan se zhvillimi urban kishte shkatërruar kënetën që ishte ngjitur me pronën e tyre dhe se zona ku ndodhej shtëpia e tyre kishte humbur të gjithë bukurinë e saj piktoreske. Gjykata vuri në dukje se edhe duke supozuar se mjedisi ishte dëmtuar rëndë nga zhvillimi urban i zonës, kërkuesit nuk kishin paraqitur ndonjë argument bindës për të treguar se dëmi i pretenduar i shpendëve dhe specieve të tjera të mbrojtura që jetonin në moçal ishte i tillë

që ndikonte drejtpërdrejt në të drejtat e tyre sipas nenit 8 § 1 të Konventës. Ndërsa vërente se mund të kishte qenë ndryshe nëse, për shembull, përkeqësimi i mjedisit për të cilin u ankua do të konsistonte në shkatërrimin e një zone pyjore në afërsi të shtëpisë së kërkuësve, një situatë e cila mund të kishte më drejtpërdrejt mirëqenien e vetë kërkuësve, ajo nuk pranoi që ndërhyrja në kushtet e jetës së kafshëve në moçalpërbënte një sulm ndaj jetës private ose familjare të kërkuësve.

Në rastin *Ivan Atanasov k. Bullgarisë*, 2010, §§ 76-79, kërkuesi u ankua për një plan për të pastruar një pellg të mbeturinave që përmbante mbetje nga një ish-minierë bakri që ndodhej një kilometër larg shtëpisë së tij, duke përfshirë hedhjen e llumit nga një stacion i ujërave të zeza në pellg. Gjykata deklaroi se megjithëse nuk kishte dyshime se ajo procedurë kishte krijuar një situatë të pakëndshme në mjedis, nuk ishte e bindur se ndotja që rezultoi kishte prekur sferën private të kërkuësit në masën e nevojshme për të nxitur zbatimin e nenit 8. Para së gjithash, shtëpia dhe toka e kërkuësit ishin në një distancë të konsiderueshme larg nga burimi i ndotjes. Së dyti, ndotja që buronte nga pellgu nuk kishte qenë rezultat i proceseve aktive të prodhimit që mund të çonin në çlirimin e papritur të sasive të mëdha të gazeve ose substancave toksike, në mënyrë që të kishte më pak rrezik për një përkeqësim të papritur të situatës. Së treti, nuk kishte asnjë tregues se kishte pasur incidente me pasoja negative për shëndetin e banorëve të zonës. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se nuk kishte asnjë provë për ndonjë ndikim të drejtpërdrejtë të kërkuësit ose familjen e tij të shkaktuar nga ndotja e pretenduar nga llumi i ujërave të zeza.

Në rastin *Çiçek dhe të tjerët k. Turqisë* (aktv.), 2020, §§ 30-32, ku kërkuësit ishin ankuar për tymrat e lëshuar nga një fabrikë prodhimi gëlqereje që ndodhej disa qindra metra larg shtëpive të tyre, Gjykata, duke vënë në dukje mungesën e ndonjë prove të një ndikimi të drejtpërdrejtë mbi kërkuësit ose cilësinë e tyre të jetës, deklaroi se nuk ishte e bindur se kishte pasur një ndërhyrje në jetën e tyre private. Prandaj, ajo arriti në përfundimin se neni 8 ishte i pazbatueshëm.

77. Paligjshmëria e një biznesi privat që prodhon ndotje ose shqetësime të tjera është e pamjaftueshme për të çuar në një ndërhyrje në të drejtat e siguruara sipas nenit 8 (shih rastet e *Furlepa k. Polonisë* (aktv.), 2008, në lidhje me zhurmën dhe ndotjen e ajrit nga një garazh i ndërtuar ilegalisht për riparimin e makinave, *Galev dhe të tjerët k. Bullgarisë* (aktv.), 2009, në lidhje me zhurmën e prodhuar nga kirurgjia e një dentisti të instaluar në mënyrë të paligjshme në pallatin e banimit të kërkuësve, dhe *Mileva dhe të tjerët k. Bullgarisë*, 2010, § 91, në lidhje me zhurmën nga një klub i paligjshëm kompjuterik në pallatin e banimit të kërkuësve; shih edhe *Çiçek dhe të tjerët k. Turqisë* (aktv.), 2020, § 29).

b. Pragu i seriozitetit

78. Efektet e padëshiruara të ndotjes së mjedisit duhet të arrijnë një nivel të caktuar minimal të seriozitetit, që të përfshihen në objektin e nenit 8 (*Kyrtatos k. Greqisë*, 2003, § 54; *Fadeyeva k. Rusisë*, 2005, § 69; *Borysiewicz k. Polonisë*, 2008, § 51; *Fägerskiöld k. Suedisë* (aktv.), 2008; *Furlepa k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Mileva dhe të tjerët k. Bullgarisë*, 2010, § 90; *Leon dhe Agnieszka Kania k. Polonisë*, 2009, § 100; *Marchiş dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2011; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 37; *Apanasiewicz k. Polonisë*, 2011, § 96; *Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011, § 105; *Grimkovskaya k. Ukrainës*, 2011, § 58; *Martínez Martínez dhe Pino Manzano k. Spanjës*, 2012, § 46; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 188; *Udovičić k. Kroacisë*, 2014, § 139; *Dzemyuk k. Ukrainës*, 2014, § 77; *Plachta dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2014, § 80; *Fieroiu dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2017, § 19; *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, § 62; *Calancea dhe të tjerët k. Moldavisë* (aktv.), 2018; *Kožul dhe të tjerët k. Bosnje dhe Hercegovinës*, 2019, § 34; *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, § 157; *Çiçek dhe të tjerët k. Turqisë* (aktv.), 2020, § 22; *Yevgeniy Dmitriyev k. Rusisë*, 2020, § 32; *Kapa dhe të tjerët k. Polonisë*, § 153, 2021; *Solyanik k. Rusisë*, 2022, § 40; *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 121).

Është e nevojshme të tregohet se shqetësimi i pretenduar mjedisor ishte mjaft serioz për të ndikuar negativisht, në një masë të mjaftueshme, në gëzimin e një kërkuësi të së drejtës për respektimin e jetës së tij private dhe familjare ose të banesës së tij ose të saj (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 514).

79. Vlerësimi i këtij minimumi është relativ dhe varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, si intensiteti dhe kohëzgjatja e shqetësimit, dhe efektet e tij fizike ose mendore në shëndetin ose cilësinë e jetës së

kërkuesit (*Fadeyeva k. Rusisë*, 2005, § 69; *Borysiewicz k. Polonisë*, 2008, § 51; *Fägerskiöld k. Suedisë* (aktv.), 2008; *Oluic k. Kroacisë*, 2010, § 49; *Mileva dhe të tjerët k. Bullgarisë*, 2010, § 90; *Leon dhe Agnieszka Kania k. Polonisë*, 2009, § 100; *Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011, § 105; *Apanasewicz k. Polonisë*, 2011, § 96; *Marchiş dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2011; *Grimkovskaya k. Ukrainës*, 2011, § 58; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 37; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 188; *Martínez dhe Pino Manzano k. Spanjës*, 2012, § 46; *Udovičić k. Kroacisë*, 2014, § 139; *Dzemyuk k. Ukrainës*, 2014, § 78; *Plachta dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2014, § 80; *Fieroiu dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2017, § 19; *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, § 62; *Calancea dhe të tjerët k. Moldavisë* (aktv.), 2018, § 27; *Kožul dhe të tjerët k. Bosnje dhe Hercegovinës*, 2019, § 34; *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, § 157; *Çiçek dhe të tjerët k. Turqisë* (aktv.), 2020, § 22; *Yevgeniy Dmitriyev k. Rusisë*, 2020, § 32; *Solyanik k. Rusisë*, 2022, § 40; *Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 61; *Kotov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 101; *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 121; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 516).

Konteksti i përgjithshëm mjedisor duhet gjithashtu të merret parasysh. Nuk do të kishte asnjë pretendim të diskutueshëm sipas nenit 8 nëse dëmi për të cilin ankohej ishte i papërfillshëm në krahasim me rreziqet mjedisore të qenësishme në jetën në çdo qytet modern (*Fadeyeva k. Rusisë*, 2005, § 69; *Fägerskiöld k. Suedisë* (aktv.), 2008; *Galev dhe të tjerët k. Bullgarisë* (aktv.), 2009; *Mileva dhe të tjerët k. Bullgarisë*, 2010, § 90; *Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011, § 105; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 37; *Apanasewicz k. Polonisë*, 2011, § 96; *Marchiş dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2011; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 188; *Plachta dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2014, § 80; *Fieroiu dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2017, § 19; *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, § 62; *Kožul dhe të tjerët k. Bosnje dhe Hercegovinës*, 2019, § 34; *Çiçek dhe të tjerët k. Turqisë* (aktv.), 2020, § 22; *Solyanik k. Rusisë*, 2022, § 40; *Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 71; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 517).

Në rastin *Mileva dhe të tjerët k. Bullgarisë*, 2010, §§ 95-96, Gjykata konkludoi në përputhje me rrethanat se nuk mund të supozohej se zhurma që dilte nga një zyrë në një bllok apartamentesh, ose nga punimet që kryheshin në atë bllok, si rregull, kishte tejkaluar nivelin e zakonshëm të zhurmës në një bllok apartamentesh në një qytet modern.

80. Në varësi të rrethanave, pragu i seriozitetit mund të arrihet edhe kur ndotja ose zhurma e ankuar është vetëm rastësore (shih rastin *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 38, në lidhje me zhurmën nga fishekzjarrët e lëshuara vetëm gjatë dy javëve të veçanta në vit).

81. Shëndeti i një personi nuk duhet domosdoshmërisht të ndikohet, apo edhe të kërcënohet, që një çështje të lindë sipas nenit 8 për shkak të ekspozimit të tij/saj ndaj ndotjes ose shqetësimeve të tjera (*López Ostra k. Spanjës*, 1994, § 51; shih gjithashtu: *Sciavilla k. Italisë* (aktv.), 2000; *Botti k. Italisë* (aktv.), 2004; *Kyrtatos k. Greqisë*, 2003, § 52; *Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 113; *Fägerskiöld k. Suedisë* (aktv.), 2008; *Furlepa k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Greenpeace E.V. dhe të tjerët k. Gjermanisë* (aktv.), 2009; *Marchiş dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2011; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 36; *Dzemyuk k. Ukrainës*, 2014, § 88; *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, § 62; *Yevgeniy Dmitriyev k. Rusisë*, 2020, § 32; *Solyanik k. Rusisë*, 2022, § 41; *Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 69; *Kotov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 108; *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 131).

Kjo ilustron nga rasti *Brândușe k. Rumanisë*, 2006, § 67, në lidhje me aromat e pakëndshme që prekin një person të burgosur në një burg pranë një depozitimi mbeturinash. Gjykata vuri në dukje se fakti që gjendja shëndetësore e kërkuesit nuk ishte përkeqësuar ishte i pamjaftueshëm për të përjashtuar zbatueshmërinë e nenit 8. Ajo nxori zbatueshmërinë e dispozitës nga fakti se shqetësimi i kundërshtuar kishte ndikuar në cilësinë e jetës dhe mirëqenien e tij. Në mënyrë të ngjashme, në rastin *Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë*, 2012, § 108, Gjykata vuri në dukje se kërkuesit, të cilët ishin detyruar të jetonin në një mjedis të ndotur nga mbeturinat e mbetura në rrugë për disa muaj, nuk kishin pretenduar se ishin sëmurë dhe se nuk kishte prova që jeta dhe shëndeti i tyre ishin në rrezik. Megjithatë, ajo konsideroi se kjo situatë mund të kishte çuar në një përkeqësim të cilësisë së jetës së kërkuesve dhe, në veçanti, të kishte ndikuar negativisht në të drejtën e tyre për respektimin e banesave dhe jetës së tyre familjare, dhe theksoi se “neni 8 mund të zbatohet edhe në mungesë të ndonjë prove për një rrezik serioz për shëndetin e njerëzve”.

Duke qenë kështu, fakti që është arritur pragu i seriozitetit mund të konkludohet edhe më lehtë ku ndotja ose një shqetësim tjetër ka ndikuar në shëndetin e njeriut (*Fadeyeva k. Rusisë*, 2005, § 88; *Ledyayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2006, § 100; *Băcilă k. Rumanisë*, 2010, §§ 63-64; shih, në të kundërt, sa vijon: *Borysiewicz k. Polonisë*, 2008, § 54; *Ruano Morcuende k. Spanjës* (aktv.), 2005; *Fägerskiöld k. Suedisë* (aktv.), 2008; *Furlepa k. Polonisë* (aktv.), 2008).

2. Ekspozimi ndaj një kërcënimi mjedisor

82. Ekspozimi i një personi ndaj një rreziku mjedisor në krahasim me ndotjen ose shqetësimin, efektet e të cilit ai ose ajo i përjeton drejtpërdrejt mund të jetë i mjaftueshëm për të nxitur zbatimin e nenit 8. Rreziku mjedisor në fjalë duhet të jetë i tillë që të cenojë ndjeshëm aftësinë e personit për të gëzuar banesën ose jetën e tij private ose familjare (*McGinley dhe Egan k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1998, §§ 96-97; *Roche k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2005, § 155-156; *Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011, §§ 105 dhe 111; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 192; *Dzemyuk k. Ukrainës*, 2014, §§ 81-84; *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, §§ 157 dhe 172). Me fjalë të tjera, rreziku mjedisor ndaj të cilit është i ekspozuar individ duhet të jetë "serioz" (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, §§ 435 dhe 518).

83. Gjykata, në veçanti, ka gjetur se Neni 8 zbatohet kur efektet e rrezikshme të një aktiviteti ndaj të cilit individët në fjalë ka të ngjarë të ekspozohen janë përcaktuar sipas një procedure të vlerësimit të ndikimit mjedisor, në mënyrë të tillë që të krijojë një lidhje mjaft të ngushtë me jetën private dhe familjare për qëllimet e nenit 8 të Konventës (*Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, §§ 112-113; *Öçkan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2006, § 39; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 189; *Thibaut k. Francës* (aktv.), 2022, § 38), edhe kur aktiviteti i rrezikshëm është ende në fazat e planifikimit (*Thibaut k. Francës* (aktv.), 2022, § 38).

Gjykata ka theksuar se nëse nuk do të ishte kështu, detyrimi pozitiv i shtetit për të marrë masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të siguruar të drejtat e kërkuesit sipas paragrafit 1 të nenit 8 nuk do të kishte vlerë (*Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 113).

84. Rreziku në fjalë duhet të karakterizohet në dritën e situatës së kërkuesit, siç ilustron nga vendimet në rastet e *Folkman dhe të tjerët k. Republikës Çeke* (aktv.), 2006 dhe *Sdružení Jihočeské Matky k. Republikës Çeke* (aktv.), 2006. Në ato raste, individët që banonin në zonën e mbuluar nga plani i kontrollit të dëmeve për centralin bërthamor të Temelinit, të cilët kishin vlerësuar se funksionimi i termocentralit përbënte kërcënim për mjedisin, shëndetin publik dhe jetën e njerëzve, kishin depozituar pa sukses një padi në Gjykatën Kushtetuese për anulimin e vendimit për fillimin e funksionimit të centralit bërthamor. Duke vërejtur, gjatë vlerësimit të ankesës sipas nenit 6, se kërkuesit ishin ankuar për rrezikun e përgjithshëm të përdorimit të energjisë bërthamore dhe jo një kërcënim specifik dhe të menjëhershëm për shëndetin ose jetën e tyre, duke paraqitur kështu argumente të rëndësishme për *actio popularis*, Gjykata e shpalli ankesën sipas nenit 8 të paargumentuar, duke pasur parasysh lidhjen shumë të dobët midis vendimit të kundërshtuar dhe të drejtave që kjo dispozitë garanton.

85. Në rastin e *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, §§ 127-130, mbi krizën e menaxhimit të mbetjeve në rajonin e Campania-s, Gjykata konstatoi se megjithëse nuk ishte e mundur, duke pasur parasysh mungesën e provave mjekësore, të thuhej se ndotja që rezultonte nga kriza e mbetjeve kishte shkaktuar domosdoshmërisht dëm në shëndetin e kërkuesve, ishte e mundur të përcaktohej, duke marrë parasysh raportet zyrtare dhe provat e disponueshme, se ekspozimi i gjerë i të jetuarit në zonë në shkelje të standardeve të zbatueshme të sigurisë i kishin bërë kërkuesit më të prekshëm ndaj sëmundjeve të ndryshme. Gjykata u mbështet në disa studime mbi situatën mjedisore në zonën në fjalë, të cilat treguan se rreziku i vdekshmërisë i lidhur me tumoret dhe probleme të tjera shëndetësore ishte më i lartë se në pjesën tjetër të Campania-s dhe nuk pa asnjë arsye për të vënë në dyshim se, siç sugjerohet nga këto studime, ekzistonte një lidhje shkakësore midis ekspozimit ndaj trajtimit të mbetjeve dhe rritjes së rrezikut të zhvillimit të patologjive të tilla si kanceri ose keqformimet kongjenitale, edhe pse faktorë të tjerë si historia familjare, ushqyerja dhe zakonet e pirjes së duhanit në zonë mund të kenë pasur gjithashtu ndikim. Ajo iu referua gjithashtu faktit se ekzistenca e një rreziku për shëndetin e njerëzve si pasojë e krizës së menaxhimit të mbetjeve ishte njohur nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian dhe nga një komision parlamentar italian.

86. Çështjet e shqyrtuara në themel nga Gjykata kanë të bëjnë kryesisht me situata në të cilat njerëzit janë ekspozuar ndaj një rreziku për shëndetin ose integritetin e tyre fizik. Megjithatë, përdorimi i termave "rrezik mjedisor" ose "kërcënim mjedisor" nga Gjykata në vendimet e saj mund të sugjerojë që neni 8 mund të zbatohet për rastet e rreziqeve mjedisore, materializimi i të cilave nuk do të kishte pasojë shumë të rënda (shih rastin *Dzemyuk k. Ukrainës*, 2014, §§ 81-84, ku kërkuesi ishte ankuar për ndërtimin e një varreze pranë shtëpisë së tij, duke pretenduar se ajo mund të kontaminonte ujin në pusin që e furnizonte me ujë, në mungesë të furnizimit me energji elektrike).

3. Shembuj

87. Ndotja dhe shqetësimet dhe sulmet ndaj cilësisë së jetës së njerëzve:

- zhurma e trafikut ajror të shkaktuar nga aeroporti Heathrow në përgjithësi (*Powell dhe Rayner k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1990) dhe në veçanti gjatë natës (*Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003), ose shkaktuar nga shtrirja e brezit kryesor të uljes në një aeroport (*Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012) ose nga një aeroport ushtarak (*Plachta dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2014);
- zhurma e natës nga një lokal (*Sciavilla k. Italisë* (aktv.), 2000; *Oluić k. Kroacisë*, 2010; *Udovičić k. Kroacisë*, 2014), klubet e natës (*Moreno Gómez k. Spanjës*, 2004) ose bare, pabe dhe diskoteka (*Cuenca Zarzoso k. Spanjës*, 2018);
- zhurma nga një punishte rrobaqepësie (*Borysiewicz k. Polonisë*, 2008);
- zhurma e shkaktuar nga një park me erë (*Fägerskiöld k. Suedisë* (aktv.), 2008);
- zhurma dhe dridhjet e shkaktuara nga një klub lojërash kompjuterike (*Mileva dhe të tjerët k. Bullgarisë*, 2010);
- zhurma e shkaktuar nga shfaqjet e fishekzjarrëve gjatë dy javëve të veçanta në vit (*Zammit Maempel k. Maltës*, 2011);
- erërat, zhurmat dhe tymrat toksikë nga një fabrikë për trajtimin e mbetjeve të lëngshme dhe të ngurta (*López Ostra k. Spanjës*, 1994);
- aroma të pakëndshme që burojnë nga një landfill komunal mbeturinash (*Brândușe k. Rumanisë*, 2009);
- erërat e pakëndshme, ndotja e ajrit dhe ndotja e ujërave nëntokësore të shkaktuara nga një vend depozitimi (*Kotov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022);
- ndotje dhe shqetësime të tjera të shkaktuara nga keqmenaxhimi i grumbullimit dhe përpunimit të mbetjeve (*Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë*, 2012); *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, §§ 131-132).
- zhurma, dridhjet dhe ndotja që do të dilnin nga një linjë hekurudhore e planifikuar (*Maatschap Smits dhe të tjerët k. Holandës* (aktv.), 2001);
- zhurma dhe ndotja e shkaktuar nga një autostradë (*Ward k. Mbretërisë së Bashkuar* (aktv.), 2004);
- zhurma, dridhjet, ndotja dhe erërat e shkaktuara nga trafiku rrugor (*Deés k. Hungarisë*, 2010; *Grimkovskaya k. Ukrainës*, 2011); *Kapa dhe të tjerët k. Polonisë*, 2021 ;
- zhurma nga një stacion hekurudhor urban (*Bor k. Hungarisë*, 2013);
- ndotja e ajrit nga fabrikat e çelikut dhe impiantet e tjera industriale (*Fadeyeva k. Rusisë*, 2005; *Ledyayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2006; *Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022);
- zhurma dhe ndotja e ajrit të prodhuar nga një garazh riparimi i makinave të ndërtuara ilegalisht (*Furlepa k. Polonisë* (aktv.), 2008);
- ekspozimi ndaj ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës të shkaktuar nga një minierë qymyrguri, një fabrikë përpunimi qymyri dhe grumbuj plehrash (*Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011);
- zhurma dhe pluhuri që vijnë nga funksionimi i një fabrike prodhimi betoni dhe lëvizja e kamionëve që transportojnë materiale (*Apanasewicz k. Polonisë*, 2011);
- zhurma e shkaktuar nga operacionet e gurores (*Martínez Martínez dhe Pino Manzano k. Spanjës*, 2012);

- ndotja e ajrit të prodhuar nga një termocentral (*Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017);
- zhurma nga një fabrikë guri gëlqeror dhe çimentoje (*Podelean k. Rumanisë* (aktv.), 2019).

88. Ndotja dhe shqetësime dhe dëmtime të tjera për shëndetin:

- ndotja e ajrit nga një fabrikë çeliku (*Fadeyeva k. Rusisë*, 2005; *Ledyayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2006);
- ekspozimi i një personi që jeton pranë një miniere ari dhe argjendi ndaj cianidit të natriumit të përdorur në procesin e minierave (*Tătar k. Rumanisë*, 2009);
- ndotja e ajrit e prodhuar nga një fabrikë plumbi dhe zinku (*Băcilă k. Rumanisë*, 2010);
- ndotja e ajrit e shkaktuar nga një termocentral (*Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017).

89. Ekspozimi ndaj një rreziku mjedisor:

- afërsia e një fabrike kimike të klasifikuar "Seveso me rrezik të lartë", që lëshon sasi të mëdha gazi të ndezshëm dhe substanca toksike gjatë ciklit të saj të prodhimit; kishte pasur një aksident në fabrikë në të kaluarën, duke çuar në shtrimin e 150 personave në spital (*Guerra dhe të tjerët k. Italisë*, 1998);
- ekspozimi i ushtarëve ndaj rrezatimit gjatë testeve atmosferike të armëve bërthamore të kryera nga Mbretëria e Bashkuar në ishullin e Krishtlindjeve në fund të viteve 1950 (*McGinley dhe Egan k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1998, §§ 96-97 dhe 99);
- afërsia e një impianti për ruajtjen dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme me anë të kimikateve "që potencialisht sjellin rreziqe të rëndësishme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut" (*Giacomelli k. Italisë*, 2006, §§ 85 dhe 89);
- një rrezik për shëndetin dhe sigurinë me të cilin përballen banorët e fshatrave që ndodhen pranë një miniere ari të autorizuar të funksionojë duke përdorur një proces cianidimi (*Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004; *Öçkan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2006, §§ 39-40);
- ekspozimi ndaj duhanpirjes pasive në hapësira publike (*Botti k. Italisë* (aktv.), 2004) ose në burg (*Aparicio Benito k. Spanjës* (aktv.), 2006);
- ekspozimi i një ushtari ndaj dozave të ulëta të gazit mustardë dhe gazit nervor për qëllime kërkimore (*Roche k. Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2005, §§ 155-156);
- ekspozimi ndaj rrezatimit nga kullat e qelizave telefonike (*Luginbühl k. Zvicrës* (aktv.), 2006) ose një stacion bazë telefoni celular (*Gaida k. Gjermanisë* (aktv.), 2007);
- afërsia e një miniere ari dhe argjendi duke përdorur një proces cianidimi dhe një pellg mbetjesh (*Tătar k. Rumanisë*, 2009);
- ekspozimi ndaj blozës dhe grimcave të pluhurit të emetuara nga automjetet me naftë (*Greenpeace E.V. dhe të tjerët k. Gjermanisë* (aktv.), 2009);
- ekspozimi ndaj ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës të shkaktuar nga një minierë qymyrguri, një fabrikë përpunimi qymyri dhe grumbuj plehrash (*Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011);
- afërsia e terminaleve të gazit natyror të lëngshëm që paraqet rrezik shpërthimi (*Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012);
- ndërtimi i një varreze komunale pranë shtëpisë së një personi, duke e ekspozuar atë ndaj një rreziku mjedisor, veçanërisht ndotjes së ujit, duke përfshirë ujin e tij të pijshëm (*Dzemyuk k. Ukrainës*, 2014; shih edhe *Solyanik k. Rusisë*, 2022);
- ekspozimi ndaj emetimeve ndotëse nga një punishte çeliku, duke shkaktuar një rrezik të mirë argumentuar për shëndetin (*Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019);
- ekspozimi ndaj fushës elektromagnetike të krijuar nga një linjë energjie me tension të lartë të shtuar (*Thibaut k. Francës* (aktv.), 2022);
- rreziqet për shëndetin në lidhje me krizën e menaxhimit të mbetjeve në rajonin e Campanias (*Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023).

90. Duhet të vëmë re gjithashtu rastin *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, në lidhje me përmbytjet e shkaktuara nga një shkarkimi i papritur në shkallë të gjerë i ujit nga një rezervuar me qëllim që të parandalohet çarja e kurorës së tij, kurorë e cila ishte dëmtuar nga përmbytjet, *ndër të*

tjera, shtëpitë në të cilat banonin kërkuesit. Gjykata e vlerësoi çështjen sipas nenit 8 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1, duke arritur në përfundimin se detyrimi pozitiv sipas këtyre dispozitave kërkonte që autoritetet kombëtare të ndërmerrnin të njëjtat masa praktike si detyrimi pozitiv sipas nenit 2 të Konventës (shih më poshtë).

4. Ndryshimet klimatike

91. Në rastin e *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, një shoqatë e grave të moshuara, e krijuar për të promovuar dhe zbatuar mbrojtjen efektive të klimës në emër të anëtarëve të saj dhe katër prej anëtarëve të saj, u ankuan, *ndër të tjera* sipas nenit 8, për papërshtatshmërinë e masave të marra në këtë fushë nga autoritetet zvicerane për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike.

92. Gjykata konstatoi (§§ 519-520) se neni 8 mund të zbatohet në fushën e ndryshimeve klimatike, duke theksuar se kjo dispozitë duhej parë si një e drejtë e individëve për mbrojtje efektive nga autoritetet shtetërore nga efektet serioze negative të ndryshimeve klimatike në jetën, shëndetin, mirëqenien dhe cilësinë e jetës së tyre. Megjithatë, ajo specifikoi se çështja e "ndërhyrjes aktuale" në gëzimin e kërkuesit të jetës së tij private ose familjare (shih paragrafin 75 më lart) ose në banesën ose ekzistencën e një rreziku të rëndësishëm dhe mjaft serioz që sjell zbatueshmërinë e nenit 8 në thelb varet nga vlerësimi i kriterëve të ngjashme me ato të përcaktuara në paragrafin 231 më poshtë, në lidhje me statusin e viktimës së individëve, ose në paragrafin 235, në lidhje me gjendjen e shoqatave. Prandaj, këto kritere janë përcaktues për të vërtetuar nëse të drejtat e Nenit 8 janë në rrezik dhe nëse kjo dispozitë zbatohet. Në secilin rast, këto janë çështje që mbeten për t'u shqyrtuar mbi faktet e një rasti të veçantë dhe në bazë të provave në dispozicion.

93. Duke zbatuar këto kritere, Gjykata vuri në dukje si më poshtë në vendimin (§§ 521-526): shoqata kërkuese, sipas Statutit të saj, është shoqatë jofitimprurëse e krijuar sipas ligjit zviceran për të promovuar dhe zbatuar mbrojtjen efektive të klimës në emër të anëtarëve të saj. Ajo ka më shumë se 2,000 anëtarë femra që jetojnë në Zvicër dhe mosha mesatare e të cilave është 73 vjeç. Afro 650 anëtarë janë 75 vjeç e lart. Statuti i saj parashikon më tej se ajo është e përkushtuar të angazhohet në aktivitete të ndryshme që synojnë reduktimin e emetimeve të gazeve serrë në Zvicër dhe adresimin e efekteve të tyre në ngrohjen globale. Ajo vepron jo vetëm në interes të anëtarëve të saj, por edhe në interes të publikut të gjerë dhe brezave të ardhshëm, me qëllim sigurimin e mbrojtjes efektive të klimës. Shoqata e kërkueseve ndjek qëllimet e saj nëpërmjet veprimeve të ndryshme, duke përfshirë marrjen e veprimeve ligjore për të adresuar efektet e ndryshimeve klimatike në interes të anëtarëve të saj. Gjykata më pas konstatoi se njohja e legjitimitetit të shoqatës kërkuese para Gjykatës ishte në interes të administrimit të duhur të drejtësisë. Në lidhje me këtë, ajo pranoi se, së pari, duke pasur parasysh bazën e anëtarësimit të shoqatës kërkuese, përfaqësimin dhe qëllimin e krijimit të saj, ajo përfaqëson një mjet rekursi kolektiv që synonte mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të individëve kundër kërcënimeve të ndryshimeve klimatike në shtetin e paditur dhe, së dyti, se kërkuesit individualë nuk kishin pasur qasje në gjykatë në shtetin e paditur.

Gjykata arriti në përfundimin se shoqata kërkuese ishte themeluar në mënyrë të ligjshme, ajo kishte treguar se ajo ndjek një qëllim të dedikuar në përputhje me objektivat e saj statutores në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të anëtarëve të saj dhe individëve të tjerë të prekur kundër kërcënimeve që lindin nga ndryshimet klimatike në shtetin e paditur dhe se ishte vërtet e kualifikuar dhe vepronte si përfaqësuese në emër të atyre individëve që mund të pretendonin se ishin subjekt i kërcënimeve specifike ose efekteve negative të ndryshimeve klimatike në jetën, shëndetin, mirëqenien dhe cilësinë e jetës së tyre siç mbrohen nga Konventa. Rrjedhimisht, ankesat e ndjekura nga shoqata kërkuese në emër të anëtarëve të saj binin në objektin e nenit 8, me pasojë që shoqata kërkuese kishte legjitimitet dhe se neni 8 ishte i zbatueshëm për ankesën e saj.

5. Provat

a. Në përgjithësi

94. Është detyrë e kërkuesit të provojë se ka pasur një ndërhyrje në jetën e tij private për shkak të

shqetësimi, ndotjes ose rrezikut mjedisor për të cilin ai ankohet (*Ivan Atanasov k. Bullgarisë*, 2010, § 75).

95. Ai gjithashtu duhet të provojë se është arritur një nivel minimal i seriozitetit ose se është i ekspozuar ndaj një rreziku mjedisor (shih, për shembull, *Furlepa k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Galev dhe të tjerët k. Bullgarisë* (aktv.), 2009; *Ivan Atanasov k. Bullgarisë*, 2010, § 75; *Calancea dhe të tjerët k. Republikës së Moldavisë* (aktv.), 2018, § 28; *Thibaut k. Francës* (aktv.), 2022, §§ 40-48).

96. Parashtrimet e kërkuarit janë, në parim, të pamjaftueshme. Megjithatë, mund të vërehet se në rastin *Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003, § 118, në lidhje me ndotjen akustike të vuajtur nga njerëzit që jetonin pranë aeroportit Heathrow në kontekstin e rregulloreve të ndryshuara për fluturimet e natës, Gjykata u mbështet kryesisht në parashtrësit e kërkuarve, duke theksuar se nuk kishte dyshim se situata kishte qenë e ndjeshme për të ndikuar negativisht në cilësinë e jetës së tyre private dhe hapësirën për të gëzuar komoditetet e banesave të tyre dhe se nuk shihte asnjë arsye për të dyshuar në sinqeritetin e tyre. Ajo vuri re se ndjeshmëria ndaj zhurmës përfshinte një element subjektiv, i tillë që shqetësimi i shkaktuar ndaj individëve në fjalë varej jo vetëm nga vendndodhja gjeografike e shtëpive të tyre në lidhje me korridoret e ndryshme të fluturimit, por edhe nga prirja e tyre individuale për t'u shqetësuar nga zhurma. Në mënyrë të ngjashme, në rastin *Ashworth dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* (aktv.), 2004, në të cilin personat që jetonin pranë një aeroporti privat ishin ankuar për ndotjen akustike, Gjykata thjesht vuri në dukje se sipas mendimit të saj niveli i zhurmës nga avioni kishte qenë i mjaftueshëm për zbatueshmërinë e nenit 8 të Konventës, me sa duket duke u mbështetur në parashtrimet e kërkuarve.

97. Gjykata në përgjithësi zbaton standardin e provës “përtej dyshimit të arsyeshëm”. Një provë e tillë mund të rrjedhë nga bashkëekzistenca e konkluzioneve mjaftueshëm të forta, të qarta dhe të përputhshme ose të supozimeve të ngjashme të pakundërshtuara të faktit. Gjykata lejon fleksibilitet në këtë drejtim, duke marrë parasysh natyrën e të drejtës substantive në fjalë dhe çdo vështirësi provuese të përfshirë. Në disa raste, vetëm qeveria e paditur ka qasje në informacione që mund të vërtetojnë ose hedhin poshtë pretendimet e kërkuarit; për rrjedhojë, një zbatim rigoroz i parimit *affirmanti, non neganti, incumbit probatio* është i pamundur (*Fadeyeva k. Rusisë*, 2005, § 79).

98. Për sa i përket ndotjes në veçanti, Gjykata vlerëson se nuk ka dyshim se ndotja serioze industriale ndikon negativisht në shëndetin publik në përgjithësi (*Ledyayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2006, § 90; *Wałkuska k. Polonisë* (aktv.), 2008) dhe mund të përkeqësojë cilësinë e jetës së një individi (*Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 61; *Kotov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 101). Megjithatë, është e vështirë të dallosh efektin e rreziqeve mjedisore nga efektet e faktorëve të tjerë të rëndësishëm, si mosha, profesioni ose mënyra e jetesës personale. E njëjta gjë vlen edhe për përkeqësimin e cilësisë së jetës si rezultat i ndotjes industriale, "cilësia e jetës" në vetvete është një karakteristikë subjektive e cila nuk i jep vetes një përkufizim të saktë (*Ledyayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2006, § 90; *Wałkuska k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 61; *Kotov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 101; *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 122). Këto konsiderata vlejné gjithashtu për ndotjen që nuk është me origjinë industriale (*Dzemyuk k. Ukrainës*, 2014, § 79).

99. Për rrjedhojë, në përcaktimin e rrethanave faktike të çështjeve përpara saj, Gjykata mbështetet kryesisht, edhe pse jo ekskluzivisht, në gjetjet e gjykatave kombëtare dhe autoriteteve të tjera kompetente kombëtare (*Ledyayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2006, § 90; *Wałkuska k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011, § 107; *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, § 63; *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, § 160); *Kapa dhe të tjerët k. Polonisë*, § 153, 2021; *Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 62; *Kotov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 102; *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 122).

100. Megjithatë, Gjykata ka theksuar gjithashtu se nuk mund të mbështetet verbërisht në vendimet e autoriteteve kombëtare. Ky është veçanërisht rasti kur ato janë dukshëm të papajtueshme ose kundërshtojnë njëra-tjetrën; në situata të tilla, Gjykata duhet të vlerësojë provat në tërësinë e tyre (*Ledyayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2006, § 90; *Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011, § 107; *Dzemyuk k. Ukrainës*, 2014, § 80; *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, § 63; *Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 62; *Kotov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 102).

101. Për të vlerësuar nëse është arritur pragu i seriozitetit ose nëse ekziston një rrezik mjedisor, Gjykata mund të ketë parasysh shkeljen jo vetëm të standardeve kombëtare të ndotjes së mjedisit

(*Kapa dhe të tjerët k. Polonisë*, § 153, 2021; *Kotov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 106) por edhe të standardeve ndërkombëtare (për shembull: *Fägerskiöld k. Suedisë* (aktv.), 2008; *Oluić k. Kroacisë*, 2010, §§ 52-62 dhe 65; *Frankowski dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2011). Ajo gjithashtu mund të marrë parasysh certifikatat mjekësore, si dhe vlerësimet, studimet dhe raportet e ekspertëve, duke përfshirë ato të hartuara nga ekspertë privatë (për shembull: *Oluić k. Kroacisë*, 2010, §§ 52-62 dhe 65). Për sa i përket ndryshimeve klimatike, ajo ka theksuar rëndësinë e veçantë të raporteve të përgatitura nga paneli ndërqeveritar i ekspertëve të pavarur (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 429).

Në fakt, Gjykata në shumë raste ka nxjerrë përfundimin se pragu është arritur në bazë të një kombinimi të të dhënave nga burime të ndryshme (shembull: *Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, §§ 65-71).

102. Shembuj

Në rastin *López Ostra k. Spanjës*, 1994, § 50, lidhur me erërat, zhurmën dhe tymrat e lëshuar nga një stacion për trajtimin e mbetjeve, Gjykata vërejti se gjykata kombëtare kishte pranuar që shqetësimi në fjalë kishte dëmtuar cilësinë e jetës së atyre që jetonin në afërsi.

Në rastin *Guerra dhe të tjerët k. Italisë*, 1998, § 57, Gjykata konkludoi se personat që jetonin pranë një fabrike kimike kishin qenë të ekspozuar ndaj një rreziku për shëndetin nga faktet se në nivel kombëtar, ajo fabrikë ishte klasifikuar "Seveso me rrezik të lartë", se kishte lëshuar në mënyrë të verifikueshme sasi të mëdha gazi të ndezshëm dhe substanca toksike gjatë ciklit të saj të prodhimit, se një aksident i rëndë kishte ndodhur në vend në të kaluarën dhe se një raport eksperti kishte vërtetuar se emetimet e tij në atmosferë shpesh ishin kanalizuar drejt qytetit ku jetonin kërkuesit.

Në rastin *McGinley dhe Egan k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1998, § 99, në lidhje me ekspozimin e ushtarëve ndaj rrezatimit gjatë provave atmosferike të armëve bërthamore, Gjykata, pasi vuri në dukje se kërkuesit, së bashku me ushtarakët e tjerë, ishin urdhëruar të rreshtoheshin në ambient të hapur me shpinën ndaj shpërthimeve, duke mbajtur sytë mbyllur për njëzet sekonda pas shpërthimeve, thjesht vuri re se ekspozimi ndaj niveleve të larta të rrezatimit dihej se kishte efekte të fshehta, por serioze dhe të gjata në shëndet.

Në rastin *Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 112 (shih gjithashtu *Öçkan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2006, § 40), në lidhje me autorizimin për të operuar një minierë ari duke përdorur një proces cianidimi, Gjykata vuri në dukje se, duke u mbështetur në disa studime, Gjykata Supreme Administrative kishte arritur në përfundimin se vendimi për lëshimin e një leje nuk kishte qenë në përputhje me interesin publik. Ajo vuri në dukje se ajo gjykatë më e lartë kishte konstatuar se, duke pasur parasysh vendndodhjen gjeografike të minierës së arit dhe veçoritë gjeologjike të rajonit, përdorimi i cianidit të natriumit në minierë përfaqësonte një kërcënim për mjedisin dhe të drejtën e jetës së popullatës fqinje, dhe se masat e sigurisë që kompania kishte ndërmarrë për të zbatuar kishin qenë të pamjaftueshme për të eliminuar rreziqet e përfshira në një aktivitet të tillë. Gjykata gjithashtu kishte parasysh studimin e ndikimit që ishte kryer në kuadër të procedurave kombëtare, duke vënë në dukje se kishte vërtetuar rrezikun shëndetësor ndaj të cilit ishin ekspozuar kërkuesit, duke vërtetuar kështu një lidhje mjaft të ngushtë me jetën e tyre private dhe familjare.

Në rastin *Moreno Gómez k. Spanjës*, 2004, §§ 58-59, në lidhje me zhurmën nga klubet e natës, Gjykata nuk e konsideroi vendimtar faktin që gjykatat kombëtare kishin konsideruar se kërkuesja nuk kishte arritur të përcaktonte nivelet e zhurmës brenda shtëpisë së saj. Ajo konstatoi se kishte qenë tepër formaliste që të kërkoheshin prova të tilla në çështjen në fjalë, pasi autoritetet e qytetit kishin përcaktuar tashmë zonën në të cilën kërkuesi jeton një zonë të ngopur akustikisht, që nënkuptonte një zonë në të cilën banorët lokalë ishin të ekspozuar ndaj niveleve të larta të zhurmës që u shkaktuan atyre shqetësime serioze dhe se fakti që nivelet maksimale të lejuara të zhurmës ishin tejkaluar ishte konfirmuar në disa raste nga stafi i këshillit. Ajo arriti në përfundimin se nuk kishte pasur nevojë të kërkohej nga një person nga një zonë e ngopur akustikisht, si ajo në të cilën kërkuesi jetonte, të jepte prova për një fakt për të cilin autoriteti komunal tashmë ishte në dijeni zyrtarisht. Duke pasur parasysh vëllimin e zhurmës – gjatë natës dhe përtej niveleve të lejuara – dhe faktit që ajo kishte vazhduar për disa vite, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të të drejtave të mbrojtura nga neni 8.

Në rastin *Ward k. Mbretërisë së Bashkuar* (aktv.), 2004, në lidhje me zhurmën dhe ndotjen që prek një person që jeton në një karvan në një vend udhëtarësh që ndodhet afër infrastrukturës rrugore dhe

hekurudhore, Gjykata u mbështet në raportet e hartuara nga zyrtarë të pavarur të shëndetit mjedisor, të cilët kishin gjetur se vendi nuk ishte një vend i përshtatshëm për parkimin e karvanëve, veçanërisht për shkak të zhurmës dhe niveleve të dioksidit të azotit.

Ngjashëm, në rastin *Brândușe k. Rumanisë*, 2009, § 66, në lidhje me aromat e pakëndshme të shkaktuara ndaj një personi që mbahej i ndaluar në një burg pranë një lanfilli komunal, Gjykata kishte marrë parasysh studimet e mëvonshme të ndikimit që kishin konfirmuar nivelin shumë të lartë të ndotjes së ajrit në afërsi të landfillit, duke shkaktuar shqetësim ekstrem për banorët lokalë.

Në rastin *Mileva dhe të tjerët k. Bullgarisë*, 2010, § 97, në lidhje me ndotjen akustike dhe dridhjet nga një klub lojërash kompjuterike, Gjykata, pasi vuri re se dosja e çështjes nuk përmbante matje të sakta të niveleve të zhurmës brenda banesave të kërkuesve, nxori përfundimin se pragu i seriozitetit ishte arritur nga fakti që kërkuesit kishin treguar se klubi kishte qenë i hapur njëzet e katër orë në ditë, shtatë ditë në javë për rreth katër vjet, dhe se klientët e klubit, të cilët duhet të kenë qenë të shumtë, duke qenë se kishte pothuajse pesëdhjetë kompjuterë, kishin gjeneruar një nivel të lartë zhurme, brenda dhe jashtë ndërtesës dhe kishin krijuar shqetësime të tjera të ndryshme, duke pasur parasysh se ndërtesa në fjalë në thellb ishte një ndërtesë banimi.

Në rastin *Fadeyeva k. Rusisë*, 2005, §§ 80-88, ku një person që jetonte në afërsi të një fabrike çeliku u ankua se ajo ishte ekspozuar ndaj ndotjes, Gjykata vuri në dukje se për një periudhë të gjatë përqendrimet e substancave të ndryshme toksike në ajër të matura afër shtëpisë së kërkueses kishin tejkaluar shumë nivelet maksimale të lejuara, që do të thotë, sipas ligjit rus, nivelin maksimal të përqendrimit të ndotësve toksikë, që nuk paraqesin rrezik për shëndetin. Ajo pranoi një supozim të kundërshtueshëm se kur ndotja në një zonë të caktuar i tejkalonte ato kufij, ajo bëhej potencialisht e rrezikshme për shëndetin dhe mirëqenien e personave të ekspozuar ndaj saj. Ajo gjithashtu vuri në dukje se kombinimi shumë i fortë i provave dhe supozimeve indirekte bëri të mundur konkludimin se shëndeti i kërkueses ishte përkeqësuar si rezultat i ekspozimit të saj të zgjatur ndaj emetimeve industriale, edhe pse kërkuesi nuk kishte paraqitur asnjë provë mjekësore që tregonte qartë se sëmundjet nga të cilat ajo vuante ishin të lidhura me një ekspozim të tillë. Gjykata shtoi se edhe duke supozuar se ndotja nuk kishte shkaktuar ndonjë dëm të matshëm për shëndetin e saj, ajo në mënyrë të pashmangshme e kishte bërë kërkuesen më të prekur ndaj sëmundjeve të ndryshme dhe padyshim që kishte ndikuar negativisht në cilësinë e jetës së saj në banesë. Prandaj, Gjykata pranoi se dëmi aktual për shëndetin dhe mirëqenien e kërkueses kishte arritur një nivel të mjaftueshëm për ta përfshirë atë në objektin e nenit 8 (krh. *Gronuś k. Polonisë* (aktv.), 1999).

Në rastin *Ruano Morcuende k. Spanjës* (aktv.), 2005, në lidhje me rrezatimin elektromagnetik dhe dridhjet e prodhuara nga një transformator elektrik ngjitur me banesën e kërkuesit, Gjykata vuri në dukje se gjykatat kombëtare kishin konsideruar, në vendime jo arbitrare mjaftueshëm të arsyetuara, bazuar në disa vlerësime ekspertësh, se nivelet e ndotjes në banesën e kërkuesit kishin mbetur nën vlerat e konsideruara të dëmshme për shëndetin. Ajo konsideroi se kërkuesja nuk kishte provuar se intensiteti i dridhjeve dhe rrezatimit në banesën e saj kishte tejkaluar pragu të seriozitetit.

Në rastin *Fägerskiöld k. Suedisë* (aktv.), 2008, në lidhje me zhurmën e krijuar nga turbinat me erë, Gjykata kishte parasysh faktin se megjithëse ato kishin tejkaluar paksa nivelet e rekomanduara në Suedi, ato nuk kishin tejkaluar nivelet maksimale të rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Në rastin *Tătar k. Rumanisë*, 2009, §§ 93-97 dhe 107, në lidhje me një minierë ari që përdor një proces cianidimi, Gjykata shqyrtoi faktin se asnjë vendim gjyqësor apo dokument tjetër zyrtar nuk ishte lëshuar, që tregonte qartë se sa i rrezikshëm ishte aktiviteti i kundërshtuar për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Ajo kishte parasysh raportet zyrtare të përgatitura nga Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Ministria Rumune e Mjedisit, si dhe studimet e ndikimit të kryera nga autoritetet rumune pas një aksidenti në janar 2000, kur sasi të mëdha uji të ndotur të depozituara në një pellg të mbeturinave ishin derdhur në një lumë pranë minierës dhe më pas në Danub, duke shkaktuar dëme të mëdha mjedisore. Ajo vuri re se raportet kishin treguar se për disa kohë pas aksidentit ndotës të ndryshëm (cianidi, plumbi, zink dhe kadmiumi) kishin tejkaluar nivelet e lejuara kombëtare dhe ndërkombëtare në mjedis, duke përfshirë edhe zonën në afërsi të banesës së kërkuesve, dhe se studimet e ndikimit në mjedis kishin vënë në dukje rrezikun e ndotjes nga kimikatet që përbënin

kërcënim për shëndetin e njeriut. Mbi këtë bazë, ajo arriti në përfundimin se ndotja e krijuar mund të kishte dëmтуar cilësinë e jetës së banorëve lokalë dhe, në veçanti, të kishte ndikuar në mirëqenien e kërkuesve dhe t'i privonte ata nga gëzimi i banesës së tyre, në mënyrë të tillë që të dëmтonte jetën e tyre private dhe familjare.

Në rastin *Greenpeace E.V. dhe të tjerët k. Gjermanisë* (aktv.), 2009, në të cilin personat që jetonin në afërsi të infrastrukturës rrugore ishin ankuar për ndotjen nga tymrat e lëshuar nga automjetet me naftë, Gjykata u mbështet në konkluzionet e gjykatave kombëtare si dhe në raportet e ekspertëve të paraqitura nga kërkuesit për të konstatuar se grimcat e blazës dhe pluhurit të frymëmarrjes mund të kenë një efekt serioz të dëmshëm për shëndetin, veçanërisht në zonat me popullsi të dendur dhe me trafik të rënduar.

Në rastin *Leon dhe Agnieszka Kania k. Polonisë*, 2009, § 102, në lidhje me zhurmën dhe ndotjen nga një kooperativë artizanale e specializuar në punimin e metaleve, Gjykata, në arritjen e përfundimit se pragu i seriozitetit nuk ishte arritur, u mbështet në konstatimin se inspektimet e shumta të kryera në ambientet kishin treguar se aktivitetet e kooperativës nuk kishin shkaktuar shqetësim dhe nuk kishin tejkaluar nivelin e lejuar të zhurmës. Ajo gjithashtu vuri në dukje se kooperativa përfundimisht kishte pushuar të gjitha aktivitetet e saj dhe se kërkuesit nuk kishin paraqitur një pretendim të vlefshëm se kishin pasur probleme serioze dhe afatgjata shëndetësore si pasojë e zhurmës për të cilën ishin ankuar.

Në rastin *Oluić k. Kroacisë*, 2010, §§ 52-62 dhe 65, në lidhje me zhurmën e natës nga një lokal, Gjykata u mbështet kryesisht në një seri matjesh akustike të kryera nga ekspertë të pavarur që tregonin se ishin tejkaluar standardet kombëtare dhe nivelet maksimale të përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Ajo konstatoi se duke pasur parasysh vëllimin e zhurmës dhe faktin se ajo kishte ndodhur gjatë natës dhe kishte vazhduar për disa vite, niveli i shqetësimit kishte arritur nivelin minimal të seriozitetit që kërkohej për zbatimin e Nenit 8, duke sjellë detyrimin pozitiv për të mbrojtur kërkuesin.

Në rastin *Apanasewicz k. Polonisë*, 2011, §§ 98-101, në lidhje me zhurmën dhe pluhurin e prodhuar nga funksionimi i një fabrike të prodhimit të betonit dhe lëvizjet e njëkohshme të kamionëve, Gjykata kishte parasysh faktin që gjykata kombëtare kishte urdhëruar ndërprerjen e funksionimit të uzinës me arsyetimin se ajo kishte prishur gëzimin paqësor të pronës të kërkueses në një mënyrë që shkonte përtej nivelit normal të shqetësimit të shkaktuar nga fqinjët. Ajo vuri në dukje se gjykata kombëtare e kishte bazuar vendimin e saj në natyrën e paligjshme të ndërtimit të kryer nga pronari i uzinës, periudhën e gjatë të shqetësimeve dhe intensitetin e tyre, faktin që pronat ishin në afërsi të drejtpërdrejtë dhe papajtueshmërinë e funksionimit të uzinës me destinacionin e përcaktuar të përdorimit të tokës sipas rregulloreve përkatëse të planifikimit urban. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se gjykata kombëtare ishte mbështetur në të dhënat teknike të mbledhura pas matjes së zhurmës në terren, gjë që kishte treguar për një nivel të lartë zhurme që tejkalonte standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Duke vërejtur se nuk kishte asnjë provë në dosje për të treguar se si nivelet e zhurmës kishin ndryshuar pas vendimit përfundimtar të çështjes në nivel kombëtar, Gjykata vuri në dukje se kishte pasur punime dhe zhvillime të mëtejshme të paligjshme në kantier me qëllim zgjerimin e aktiviteteve të tij.

Në rastin *Marchiş dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2011, në të cilin banorët lokalë ishin ankuar për shqetësime të shkaktuara nga një distileri dhe një pellg grumbullimi i mbetjeve të alkoolit që ndodhej në fshatin e tyre, Gjykata u mbështet në faktet e mëposhtme për të gjetur se këto shqetësime nuk kishin çuar në një ndërhyrje në të drejtat e tyre: gjykatat kombëtare kishin rrëzuar ankesën e kërkuesve, me arsyetimin se ata nuk i kishin plotësuar të gjitha kushtet për marrjen e lejes mjedisore dhe se autoritetet kompetente kishin arritur në përfundimin se distileria nuk shqetësonte as lagjen dhe as mjedisin; arsyet e dhëna nga autoritetet administrative dhe gjyqësore kanë qenë të besueshme dhe janë bazuar në një shqyrtim të kujdesshëm të çështjes dhe nuk ka pasur asnjë tregues për ndonjë arbitraritet në arsyetimin e tyre; kërkuesit nuk kishin arritur të vërtetësonin ankesën e tyre në lidhje me shqetësimin e pretenduar mjedisor përpara autoriteteve kombëtare. Ata nuk kishin dhënë asnjë opinion mjekësor ose ekspert mjedisor ose prova të tjera për dëmtimin ose shqetësimin që pretendohet se u ishte shkaktuar nga funksionimi i distilierisë në afërsi të pronave të tyre, qoftë në procedurat kombëtare apo në procedurat para Gjykatës, në mënyrë që të mos ishte vërtetuar me besueshmëri se funksionimi i fabrikës së pijeve kishte shkaktuar një rrezik mjedisor, ose se ndotja

kishte tejkaluar nivelet e sigurta të vendosura nga rregulloret e aplikueshme; nuk dukej se erërat ishin të tilla që të preknin seriozisht kërkuesit ose t'i pengonin ata të gëzonin banesat e tyre dhe jetën e tyre private dhe familjare; distileria ishte autorizuar të funksiononte vetëm tridhjetë ditë në vit, njëzet e katër orë në ditë, dhe kishte funksionuar vetëm për tre vjet.

Në rastin *Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011, § 111, në lidhje me ndotjen e ujit, ajrit dhe tokës dhe shqetësimin e shkaktuar nga funksionimi i një miniere qymyrguri, Gjykata vendosi se të jetuarit në një zonë të prekur nga ndotja në tejkallim të qartë të standardeve të sigurisë në fuqi i kishte ekspozuar kërkuesit ndaj një rreziku të madh shëndetësor.

Në rastin *Grimkovskaya k. Ukrainës*, 2011, §§ 59-62, në lidhje me ndotjen dhe zhurmën nga trafiku në rrugën ku jetonte kërkuesja dhe familja e saj, Gjykata vuri në dukje se nuk ishin matur as nivelet e zhurmës ndaj të cilave ajo ishte ekspozuar dhe as ndikimi i zhurmës në jetën e saj private dhe familjare. Megjithatë, duke pasur parasysh një raport hetimi të realizuar në vendndodhje të përgatitur nga autoritetet shëndetësore që tregonte se sipërfaqja e rrugës pranë shtëpisë së kërkuesit ishte dëmtuar rëndë dhe mbi të kishin kaluar më shumë se njëqind automjete gjatë një periudhe prej një ore, ajo e konsideroi të besueshme që kërkuesi të ishte shqetësuar rregullisht nga zhurma dhe dridhjet. Gjykata vuri në dukje më tej se nga raporti kishte rezultuar se mbi gjysma e automjeteve të ekzaminuara kishin lëshuar ndotës, duke përfshirë plumbin dhe bakrin, që tejkallonin standardet e aplikueshme të shëndetit dhe sigurisë dhe se djali i kërkueses ishte diagnostikuar me helmim kronik nga plumbi dhe kripërat e bakrit. Nga sa më sipër, ajo nxori përfundimin se efekti kumulativ i zhurmës, dridhjeve dhe ndotjes së ajrit dhe tokës të krijuar nga autostrada e kishte penguar në mënyrë të konsiderueshme kërkuesen të gëzonte të drejtat e saj sipas nenit 8, i cili për rrjedhojë ishte i zbatueshëm.

Në rastin *Martínez Martínez dhe Pino Manzano k. Spanjës*, 2012, § 46, në lidhje me shqetësimet e shkaktuara nga operacionet në një gurore, Gjykata u mbështet në një raport xhandarmërie të përgatitur në kuadër të procedurave penale të paraqitura nga kërkuesit në lidhje me shkeljet mjedisore dhe në përfundimet e raportit në lidhje me pajtueshmërinë me rregulloret kombëtare.

Në rastin *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 140, në lidhje me zhurmën nga një aeroport, Gjykata vuri në dukje se gjykatat kombëtare kishin konstatuar se kërkuesit mund të ishin ekspozuar ndaj një niveli të lartë zhurme kur avionët fluturonin sipër kokave të tyre. Ajo arriti në përfundimin se zhurma ndaj së cilës ata ishin ekspozuar arriti pragun e zbatimit të nenit 8.

Në rastin *Bor k. Hungarisë*, 2013, § 26, në lidhje me zhurmën që prek një person që jeton në afërsi të një stacioni hekurudhor urban, Gjykata i kushtoi rëndësi faktit, të padiskutueshëm nga Qeveria, se standardet kombëtare ligjore ishin tejkaluar.

Në rastin *Udovičić k. Kroacisë*, 2014, §§ 141-149, në lidhje me zhurmën nga një lokal, dosja përmbante disa raporte ekspertësh, disa prej të cilave kishin konstatuar se standardet ishin respektuar dhe të tjera se ato ishin tejkaluar. Gjykata kreu një analizë të detajuar të raporteve, duke vërejtur, në veçanti, se raporti më i fundit kishte gjetur se standardet ishin tejkaluar dhe se izolimi i zërit ishte i pamjaftueshëm. Më tej kishte parasysh faktin se lokali kishte dhjetë vjet që funksiononte dhe se policia ishte thirrur tetëdhjetë e shtatë herë, gjë që kishte rezultuar në dyzet e dy veprime për kundërvajtje ndaj individëve të ndryshëm për shkelje të qetësisë dhe rendit publik.

Në rastin *Plachta dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2014, §§ 83-84, në lidhje me zhurmën nga një aeroport ushtarak, Gjykata u mbështet në faktin se ekspertët e porositur nga gjykatat kombëtare kishin vërtetuar se zhurma e prodhuar nga avioni në afërsi të pronave të kërkuesve kishte tejkaluar shumë nivelet maksimale dhe se fluturimet e stërvitjes ushtarake me siguri kishin shqetësuar banorët lokalë.

Në rastin *Fieroiu dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2017, §§ 22-23, ku individët ishin ankuar për një vend të përkohshëm për përpunimin dhe ruajtjen e mbetjeve që ndodhej disa qindra metra larg banesave të tyre, Gjykata vuri në dukje se ky i fundit kishte qenë më shumë se 200 metra larg zonës, se asnjë raport apo dokument tjetër nuk kishte vërtetuar ekzistencën e ndotjes së mjedisit ose të efekteve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe se kërkuesit nuk kishin ofruar asnjë dokument mjekësor që vërtetonte ndikimin e ndotjes së pretenduar në shëndetin e tyre ose që përmendte ndonjë lloj rreziku shëndetësor. Ajo nxori përfundimin se nuk kishte asnjë arsye për të konkluduar se vendi në fjalë kishte ndikuar në cilësinë e jetës dhe mirëqenien e tyre në mënyrë të tillë që të

ndërhynte në jetën e tyre private dhe familjare dhe në gëzimin e banesave të tyre.

Në rastin *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, §§ 65-72, personat që jetonin në afërsi të një termocentrali ishin ankuar për ndotje të ajrit, ndotje akustike dhe elektromagnetike. Gjykata vuri në dukje se pretendimet për zhurmë dhe ndotje elektromagnetike nuk ishin vërtetuar nga vlerësimet e ekspertëve, të kryera në kuadër të procedurave kombëtare dhe se gjykatat kombëtare për këtë arsye kishin rrëzuar pretendimet e kërkuësve. Gjykata, në vazhdim, shpalli pjesën e mbetur të kërkesës të papranueshme (qartazi të pabazë). Në të kundërtën, ajo e konsideroi të zbatueshëm nenin 8 në lidhje me ndotjen e ajrit, duke vërejtur në lidhje me këtë se raportet e ekspertëve në fjalë kishin konfirmuar se mungesa e një zone tampon midis uzinës dhe ndërtesës ku kishin banuar kërkuësit, së bashku me mungesën e filtrave apo pajisjeve të tjera të pastrimit mbi oxhaqet e uzinës, kishin krijuar një rrezik real për banorët dhe se raportet kishin deklaruar se toksiteti i përqendruar i substancave të ndryshme të emetuara nga uzina kishte qenë dyfishi i normës. Ajo gjithashtu kishte parasysh një raport mjekoligjor të hartuar nga një organ përgjegjës ndaj Ministrisë së Punës, Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, i cili kishte treguar se disa kërkuës kishin vuajtur nga kushte kryesisht të ngjashme shëndetësore si neurastenia dhe sindroma astenike, të cilat mund të ishin shkaktuar "nga efekti i zgjatur dhe i kombinuar i ekspozimit ndaj faktorëve të dëmshëm". Gjykata konstatoi se edhe duke supozuar se ndotja nuk kishte shkaktuar ndonjë dëm të matshëm për shëndetin e tyre, ajo në mënyrë të pashmangshme i kishte bërë kërkuësit më të prekshëm ndaj sëmundjeve të ndryshme dhe padyshim kishte pasur një efekt negativ në cilësinë e jetës së tyre në banesë.

Në rastin *Calancea dhe të tjerët k. Republikës së Moldavisë* (aktv.), 2018, §§ 29-33 (shih gjithashtu rastin *Mastelica dhe të tjerët k. Serbisë* (aktv.), 2020, §§ 47-50), në të cilën personat që jetonin në afërsi të një linje të tensionit të lartë u ankuan për rreziqet ndaj të cilave ishin ekspozuar për shkak të afërsisë së tyre me linjën, Gjykata kishte parasysh faktin se forca e fushës elektrike, e matur në pronat e kërkuësve, ishte shumë nën kufirin e rekomanduar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Për sa i përket fushës magnetike, ajo vuri në dukje se nuk kishte asgjë në dosjen e çështjes në lidhje me ndonjë matje të forcës së saj. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se sëmundjet e raportuara nga disa prej kërkuësve ishin diagnostikuar përpara përfundimit të punimeve të ndërtimit në banesat e tyre, kështu që nuk kishte asnjë lidhje shkakësore midis këtyre çrregullimeve dhe linjës së tensionit të lartë.

Në rastin *Kožul dhe të tjerët k. Bosnje dhe Hercegovinës*, 2019, §§ 35-38, ku personat që jetonin pranë një impianti industrial, i cili ishte urdhëruar të prishej sepse ishte ngritur në mënyrë të paligjshme, u ankuan për zhurmën dhe pluhurin nga impianti, Gjykata konstatoi se pragu i seriozitetit nuk ishte arritur, duke qenë se një raport eksperti i paraqitur nga Qeveria kishte treguar se ishin respektuar normat përkatëse kombëtare. Ajo vuri në dukje se kërkuësit kishin kundërshtuar rezultatet e raportit, por nuk kishin ofruar asnjë provë që zhurma dhe cilësia e ajrit në banesat e tyre me të vërtetë i tejkalonin normat e përcaktuara ose nga legjislacioni kombëtar ose nga standardet mjedisore ndërkombëtare në fuqi, ose i tejkalonin rreziqet mjedisore të qenësishme në jetën në çdo qytet modern.

Në rastin *Yevgeniy Dmitriyev k. Rusisë*, 2020, § 33-34, në lidhje me zhurmën dhe shqetësimet e tjera nga një stacion policie i vendosur në një ndërtesë banimi, Gjykata vuri në dukje se kërkuësi nuk kishte paraqitur asnjë provë të drejtpërdrejtë për të treguar se zhurma kishte tejkaluar nivelet e pranueshme në banesën e tij ose se ishte kryer ndonjë matje përkatëse. Megjithatë, ajo konstatoi se pragu i seriozitetit ishte arritur, duke u mbështetur në një raport inspektimi të lëshuar nga një agjenci për mbrojtjen e konsumatorit të kontrolluar nga shteti, dhe në faktet që një gjykatë vendase kishte përcaktuar se e drejta e kërkuësit për pushim të qetë ishte shkelur, se autoritetet kishin pranuar se stacioni i policisë ishte vendosur në mënyrë të paligjshme në një ndërtesë banimi dhe se situata kishte zgjatur për trembëdhjetë vjet.

Në rastin *Kapa dhe të tjerët k. Polonisë*, 2021, § 155, në lidhje me ndotjen akustike nga trafiku rrugor, Gjykata vuri në dukje se gjykatat kombëtare kishin konstatuar shkelje të së drejtës së banorëve lokalë për shëndetin dhe gëzimin paqësor të banesave të tyre, me arsyetimin se ishin tejkaluar kufijtë ligjorë kombëtarë të zhurmës. Ajo vendosi se në dritën e rrethanave të çështjes, dhe duke pasur parasysh intensitetin, kohëzgjatjen dhe efektet fizike dhe mendore të saj, ndikimi i dëmshëm i ndotjes (zhurma, dridhje dhe tymi i shkarkimit) të kërkuësit kishte arritur pragu e nevojshëm për zbatueshmërinë e nenit 8.

Në rastin *Solyanik k. Rusisë*, 2022, §§ 42-45, kërkuesi u ankua se varrezat pranë pronës së tij kishin ndotur dheun në tokën e tij dhe pusin që furnizonte ujin e tij të pijshëm dhe se kjo kishte ndikuar në të drejtën e tij për respektimin e jetës dhe banesës së tij private. Në përfundimin e saj se ndërhyrja në fjalë kishte arritur një shkallë serioziteti të mjaftueshëm për të nxitur zbatimin e nenit 8, Gjykata kishte parasysh raportet e ekspertëve dhe faktin se zgjerimi gradual i varrezave e kishte vendosur banesën e kërkuesit brenda kufijve të "zonës së mbrojtjes sanitare" që duhej të ishte krijuar rreth varrezave në përputhje me rregulloret e brendshme shëndetësore.

Në rastin *Thibaut k. Francës* (aktv.), 2022, § 40-48, kërkuesit u ankuan se instalimi i planifikuar i një linje energjie me tension të lartë të shtuar do të përbënte rrezik për shëndetin e personave që jetonin pranë saj, përfshirë ata, dhe do të ndikonte në gëzimin e banesave të tyre. Gjykata vlerësoi se ata nuk kishin treguar se instalimi i linjës do t'i ekspozonte ata ndaj një rreziku mjedisor të një lloji që do të ndikonte drejtpërdrejt dhe seriozisht në aftësinë e tyre për të gëzuar jetën ose banesën e tyre private dhe familjare. Ajo vuri në dukje se kërkuesit kishin argumentuar kryesisht se ekspozimi ndaj fushave elektromagnetike të krijuara nga linjat e energjisë të tensionit të lartë të shtuar rrit rrezikun e leukemisë tek fëmijët. Ajo pranoi konstatimin e gjykatës kombëtare se gjendja e njohurive shkencore ishte e tillë që rreziku u konsiderua si mjaftueshëm i besueshëm për të garantuar zbatimin e parimit të kujdesit paraprak dhe përsëriti arsyetimin e saj në çështjen *Calancea dhe të tjerët k. Republikës së Moldavisë* (aktv.), 2018, § 19, se, sipas udhëzimeve të lëshuara nga Komisioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jo-jonizues, studimet epidemiologjike kishin treguar se ekspozimi i përditshëm ndaj fushave magnetike me intensitet të ulët shoqërohej me një rrezik në rritje të leukemisë në fëmijëri dhe Agjencia Ndërkombëtare për Kërkimin e Kancerit i kishte klasifikuar fusha të tilla si me gjasë kancerogjene për njerëzit, megjithëse nuk ishte vërtetuar një lidhje shkakësore midis fushave magnetike dhe leukemisë te fëmijët ose efekteve të tjera afatgjata. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se kërkuesit ishin të rritur, se ata nuk kishin deklaruar nëse kishte fëmijë në banesat e tyre dhe se shtëpia e tyre nuk ishte në afërsi të rrugës së parashikuar, por pak më shumë se 115 metra larg. Më tej, ajo vërejti se ata nuk kishin ofruar asnjë provë që zbatimi i projektit do t'i ekspozonte ata ndaj një fushe elektromagnetike që tejkalonte standardet kombëtare ose ndërkombëtare. Gjykata vuri në dukje më në përgjithësi se kërkuesit nuk i kishin vërtetuar pretendimet e tyre në lidhje me rrezikun ndaj të cilit ata personalisht do të ekspozoheshin.

b. Specifike: prova e lidhjes shkakësore midis sëmundjes dhe një burimi ndotjeje dhe shqetësimi – mundësia e një qasjeje probabiliste

103. Kur kërkuesit parashtrojnë se ndotja ose shqetësimet kanë pasur efekte negative në shëndetin e tyre, certifikatat mjekësore ose raportet duhet të paraqiten si dëshmi e sëmundjes së tyre dhe lidhjes shkakësore midis kësaj të fundit dhe ndotjes ose shqetësimit të diskutueshëm (shembuj: *Fägerskiöld k. Suedisë* (aktv.), 2008; *Cuenca Zarzoso k. Spanjës*, 2018, § 47). Megjithatë, në çështjen *Kotov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 107, në lidhje me ndotjen nga një vend depozitimi, Gjykata konstatoi se edhe pse nuk mund të thuhet, për shkak të mungesës së provave mjekësore, se ndotja për të cilën ankohej domosdoshmërisht kishte shkaktuar dëm në shëndetin e kërkuesit, ishte e mundur të vërtetohej, duke marrë parasysh raportet zyrtare dhe provat e disponueshme, se të jetuarit në një zonë të karakterizuar nga ndotje që tejkalon qartë standardet e sigurisë në fuqi, e kishte bërë atë më të prekshëm ndaj sëmundjeve të ndryshme.

104. Fakti që një patologji ka ndodhur përpara ekspozimit ndaj ndotjes ose shqetësimeve mund të parandalojë krijimin e një lidhjeje shkakësore midis dyve (*Calancea dhe të tjerët k. Republikës së Moldavisë* (aktv.), 2018, § 31).

105. Në rastin *Tătar k. Rumanisë*, 2009, §§ 102-106, Gjykata vuri në dukje se nuk mund të përjashtonte miratimin e një "qasjeje probabiliste". Një nga kërkuesit në këtë çështje kishte deklaruar se astma e tij ishte rënduar nga ekspozimi i tij ndaj cianidit të natriumit të përdorur në funksionimin e minierës. Gjykata vuri në dukje se fakti që kërkuesi vuante nga ajo sëmundje ishte vërtetuar nga certifikatat mjekësore, se cianidi i natriumit ishte padiskutim një substancë toksike që, në kushte specifike, mund të rrezikonte shëndetin e njeriut dhe se një shkallë e lartë ndotjeje ishte zbuluar në afërsi të banesës së kërkuesve pas një aksidenti mjedisor në janar 2000. Megjithatë, duke u mbështetur në studimet shkencore në dosje, ajo vuri re se askush nuk e dinte shkallën e përqendrimit

të cianidit të natriumit që kërkohet për të përkeqësuar sëmundjet e frymëmarrjes si astma. Ajo shtoi se “në mungesë të provave përkatëse, [ajo] mund të adoptojë një qasje probabiliste, pasi një tipar i përbashkët i shumë patologjive moderne ishte se ato kishin shumë shkaqe të ndryshme. Kjo do të ishte e mundur në rast të pasigurisë shkencore të shoqëruar me statistika të përshtatshme bindëse”. Duke vërejtur se nuk kishte asnjë provë të tillë në çështjen në fjalë, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesit nuk kishin arritur të provonin ekzistencën e një lidhjeje shkakësore të vërtetuar siç duhet midis ekspozimit ndaj niveleve specifike të cianidit të natriumit dhe përkeqësimit të astmës që pësoi një prej kërkuesve.

5. Faktorë të tjerë të lidhur me zbatueshmërinë

106. Në rastin *Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011, § 108, Gjykata vuri në dukje se për të përcaktuar nëse Shteti mund të mbahej ose jo përgjegjës sipas nenit 8 të Konventës, ajo gjithashtu duhej të konstatonte:

- nëse një situatë ishte rezultat i një kthese të menjëhershme dhe të papritur të ngjarjeve ose, përkundrazi, ishte e gjatë dhe e njohur për autoritetet shtetërore;
- nëse shteti ishte, ose duhej të kishte qenë i vetëdijshëm se rreziku ose shqetësimi po ndikonte në jetën private të kërkuesit;
- në çfarë mase kërkuesi kontribuoi në krijimin e kësaj situatë për veten e tij dhe ishte në gjendje ta rregullonte atë pa një shpenzim të papërbalueshëm.

107. Kështu, në çështjen e sipërpërmendur, e cila kishte të bënte me ndotjen e ujit, ajrit dhe tokës dhe shqetësimet e krijuara nga funksionimi i një miniere, një fabrike përpunimi të qymyrit dhe grumbujve të plehrave, që prekin banorët lokalë, Gjykata mori parasysh faktorët e mëposhtëm për të konstatuar se shqetësimet mjedisore për të cilat u ankuan kishin arritur kufirin e seriozitetit që ankesa të përfshihej në fushën e zbatimit të nenit 8:

- ekzistencën e një rreziku për shëndetin e kërkuesve, i nxjerrë nga fakti se ata jetonin në një zonë të ndikuar nga ndotje që tejkalon qartë standardet e sigurisë në fuqi;
- për sa i përket cilësisë së jetës së kërkuesve, fotografitë e ujit të ndotur dhe përshkrimet e jetës së tyre të përditshme;
- provat në dosje që tregojnë se funksionimi i minierës kishte kontribuar në problemet mjedisore të diskutueshme për disa vite, të paktën deri në një farë mase;
- legjislacioni kombëtar parashikonte që shtëpitë e banimit nuk mund të vendoseshin brenda zonave tampon të minierave, të përcaktuara grumbuj plehrash si *a priori* të rrezikshme për mjedisin dhe vlerësoi "distanca të sigurt" nga një shtëpi në një grumbull plehrash që kalon 50 metra lartësi në 500 metra, ndërsa shtëpitë e kërkuesve ndodheshin më pak se 500 metra nga grumbujt e plehrave në fjalë;
- matjet e ndotësve në afërsi të infrastrukturës së kontestuar që tregojnë se normat ishin tejkaluar;
- faktin që autoritetet kishin konsideruar në disa raste ristrehimin e kërkuesve dhe se gjykata kombëtare kishte konfirmuar nevojën për të ristrehuar disa prej tyre.

Gjykata konkludoi se për më shumë se dymbëdhjetë vjet nga hyrja në fuqi e Konventës në lidhje me Ukrainën, kërkuesit kishin banuar vazhdimisht në një zonë ku, sipas legjislacionit kombëtar dhe matjeve të kryera në vend, ishte e rrezikshme të jetosh për shkak të ndotjes së ajrit dhe ujit dhe uljes së tokës të shkatëruar nga funksionimi i dy impianteve industriale shtetërore. Ajo vazhdoi të shqyrtonte nëse kishte pasur një lidhje të përshtatshme midis ndotjes dhe shtetit për të ngritur çështjen e përgjegjësisë së këtij të fundit sipas nenit 8, të cilin e nxori nga faktet e mëposhtme:

- shteti, si pronar, duhet të ishte në dijeni, dhe në fakt të kishte qenë në dijeni, për efektet mjedisore të funksionimit të minierës së qymyrit dhe fabrikës së përpunimit të qymyrit;
- kërkuesit nuk kishin pasur shpresa reale për të lëvizur banesat;
- kërkuesit ishin vendosur në banesat e tyre përpara se instalimet e kundërshtuara të kishin filluar funksionimin.

108. Në rastin *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, § 72, në lidhje me ndotjen e ajrit që prek banorët lokalë pranë një termocentrali, Gjykata vuri në dukje se ndryshe nga ato në rastin *Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011, kërkuesit ishin zhvendosur në bllokun e tyre të banimit pasi termocentrali ishte vënë në funksion. Megjithatë, ajo konsideroi se ata mund të mos kishin qenë në gjendje të bënin një zgjedhje të informuar në atë kohë, ose ndoshta nuk kishin qenë në gjendje të refuzonin strehimin e ofruar nga shteti gjatë periudhës sovjetike. Ajo konkludoi, në shqyrtimin e zbatueshmërisë së nenit 8, se nuk mund të pretendohet se ata vetë e kishin krijuar situatën për të cilën u ankuan ose ishin disi përgjegjës për të.

109. Në rastin *Podelean k. Rumanisë* (aktv.), 2019, në të cilin një person që jetonte në një banesë ishte ankuar për zhurmën e shkaktuar nga një fabrikë guri gëlqeror dhe çimentoje aty pranë, Gjykata vlerësoi se vendimi i kërkuesit për të jetuar në shtëpi, edhe pse ai kishte dijeni për shqetësimin, kishte nisur situatën për të cilën ai ankohej. Ky fakt e shtyu atë të vinte në pikëpyetje zbatueshmërinë e nenit 8, edhe pse nga dosja e çështjes kishte dalë se kërkuesi ishte ekspozuar ndaj shqetësimeve të zhurmës që tejkalonin normat e përcaktuara nga legjislacioni kombëtar.

B. Detyrimet e shteteve dhe mbikqyrja nga Gjykata

1. Detyrime negative dhe detyrime pozitive

110. Neni 8 mund të zbatohet në rastet mjedisore nëse ndotja shkaktohet drejtpërdrejt nga shteti ose nëse përgjegjësia e shtetit lind nga dështimi për të rregulluar siç duhet industrinë private ose sektorin privat (*Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003, §§ 98 dhe 119; *Fadeyeva k. Rusisë*, 2005, § 89; *Borysiewicz k. Polonisë*, 2008, § 50; *Wałkuska k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Tătar k. Rumanisë*, 2009, § 87; *Giacomelli k. Italisë*, 2006, § 78; *Leon dhe Agnieszka Kania k. Polonisë*, 2009, § 99; *Frankowski dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2011; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 61; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 134); *Tolić dhe të tjerët k. Kroacisë* (aktv.), 2019, § 91).

Aty ku shqetësimet nga zhurma ose shqetësimet e tjera shkojnë përtej vështirësive të zakonshme të jetuarit me fqinjët, ato mund të ndikojnë në gëzimin paqësor të banesës së dikujt, qofshin ato të shkaktuara nga individë privatë, aktivitete biznesi ose agjenci publike (*Kapa dhe të tjerët k. Polonisë*, § 151, 2021).

111. Nëse një rast do të analizohet në kuptimin e detyrimit pozitiv të shtetit për të marrë masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të siguruar të drejtat e kërkuesve sipas paragrafit 1 të nenit 8 ose në termat e një ndërhyrjeje nga një autoritet publik që justifikohet në përputhje me paragrafin 2, parimet e zbatueshme janë gjerësisht të ngjashme. Në të dy kontekstet duhet pasur parasysh ekuilibrin e drejtë që duhet të arrihet ndërmjet interesave konkurruese të individit dhe të komunitetit në tërësi; dhe në të dy kontekstet, shteti gëzon një hapësirë të caktuar vlerësimi në përcaktimin e hapave që duhen ndërmarrë për të siguruar përputhjen me Konventën (*Powell dhe Rayner k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1990, § 41; *López Ostra k. Spanjës*, 1994, § 51; *Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003, § 98; *Sciavilla k. Italisë* (aktv.), 2000; *Apanasewicz k. Polonisë*, 2011; *Moreno Gómez k. Spanjës*, 2004, § 55; *Fadeyeva k. Rusisë*, 2005, § 94; *Giacomelli k. Italisë*, 2006, § 78; *Wałkuska k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Oluić k. Kroacisë*, 2010, § 46; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 61; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 134; *Greenpeace E.V. dhe të tjerët k. Gjermanisë* (aktv.), 2009; *Bor k. Hungarisë*, 2013, § 24; *Udovičić k. Kroacisë*, 2014, § 138; *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, §§ 64 dhe 73; *Kožul dhe të tjerët k. Bosnje dhe Hercegovinës*, 2019, § 33; *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, § 158); *Tolić dhe të tjerët k. Kroacisë* (aktv.), 2019, § 92; *Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 75; *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 123).

Për më tepër, edhe në lidhje me detyrimet pozitive që rrjedhin nga paragrafi i parë i nenit 8, për të arritur ekuilibrin e kërkuar, qëllimet e përmendura në paragrafin e dytë mund të jenë të një rëndësie të caktuar (*Powell dhe Rayner k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1990, § 41; *López Ostra k. Spanjës*, 1994, § 51; *Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003, § 98; *Moreno Gómez k. Spanjës*, 2004, § 55; *Gaida k. Gjermanisë* (aktv.), 2007; *Giacomelli k. Italisë*, 2006, § 78; *Wałkuska k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Greenpeace E.V. dhe të tjerët k. Gjermanisë* (aktv.), 2009; *Oluić k. Kroacisë*, 2010, § 46; *Apanasewicz k. Polonisë*, 2011; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 61; *Martínez dhe Pino Manzano k. Spanjës*, 2012, § 43; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 134; *Bor k. Hungarisë*, 2013, § 24;

Udovičić k. Kroacisë, 2014, § 138; *Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, § 75).

Kështu, në rastin *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, në lidhje me zhurmën e shkaktuar nga shfaqjet e fishekzjarrëve gjatë dy javëve të veçanta çdo vit në kuadër të festimeve lokale, Gjykata mori parasysh faktin se ato ngjarje kishin tërhequr turistë, duke gjeneruar kështu të ardhura dhe ishin pjesë e trashëgimisë kulturore dhe fetare të Maltës. Duke vënë në dukje lidhjen me disa nga qëllimet legjitime të përcaktuara në nenin 8 (2) – mirëqenien ekonomike të vendit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve – ajo vlerësoi se ishte legjitime që shteti të kishte marrë në konsideratë interesat e mësipërme në formësimin e kuadrit rregullator të zbatueshëm për kulturën e fishekzjarrëve.

112. Meqenëse çështja thelbësore është nëse është vendosur një ekuilibër i drejtë midis interesave të personave të prekur nga ndotja ose shqetësimet dhe interesave konkurruese të shoqërisë në tërësi, Gjykata ndonjëherë përmbahet nga specifikimi se ku duhet të shqyrtohet një çështje e caktuar nga këndi i detyrimit negativ për të mos ndërhyrë në ushtrimin e të drejtave të garantuara nga neni 8 ose në atë të detyrimit privat për të rregulluar në mënyrë pozitive ato të drejta të industrisë për të rregulluar këto të drejta (*Powell dhe Rayner k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1990; *López Ostra k. Spanjës*, 1994; *Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003, § 119; *Gaida k. Gjermanisë* (aktv.), 2007; *Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 63).

Në shumicën e këtyre rasteve, Gjykata kreu të njëjtin lloj shqyrtimi si në kontekstin e detyrimeve pozitive, në përgjithësi duke kërkuar të konstatojë nëse balanca e drejtë e lartpërmendur ishte arritur (*Powell dhe Rayner k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1990; *López Ostra k. Spanjës*, 1994; *Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003; *Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011; *Yevgeniy Dmitriyev k. Rusisë*, 2020).

Megjithatë, Gjykata ka pasur gjithashtu rastin të kryejë një lloj shqyrtimi të ngjashëm me atë që përdor në kontekstin e detyrimeve negative, duke konstatuar paraprakisht ekzistencën e një baze ligjore dhe një qëllimi legjitim. Kjo ishte qasja që adoptoi në rastin *Gaida k. Gjermanisë* (aktv.), 2007, në lidhje me rrezatimin nga një stacion bazë telefoni celular i instaluar nga një operator telefonik në të cilin shteti kishte qenë aksionari kryesor. Ajo verifikoi nëse leja për ndërtimin e infrastrukturës në fjalë ishte parashikuar me ligj, nëse leja ishte lëshuar në ndjekje të një qëllimi legjitim – në këtë rast mirëqenien ekonomike të vendit dhe interesin e publikut të gjerë në përdorimin e teknologjisë së telefonisë celulare – dhe nëse autoritetet kishin vendosur një ekuilibër të drejtë midis interesit publik dhe interesit të kërkuesit për t'u mbrojtur nga rrezatimi i mundshëm i dëmshëm.

113. Gjykata ka aplikuar ndonjëherë testin e detyrimit negativ për shqyrtimin e detyrimit pozitiv për të siguruar respektimin e të drejtave të siguruara sipas nenit 8 (*Fadeyeva k. Rusisë*, 2005). Për më tepër, ajo ka identifikuar herë pas here një ndërhyrje, ka vendosur ta konsiderojë atë sipas paragrafit të dytë të nenit 8 dhe më pas ka paraqitur arsyetimin e përdorur në lidhje me detyrimet pozitive (*Yevgeniy Dmitriyev k. Rusisë*, 2020, §§ 53-57).

114. Gjykata ka vënë në dukje se megjithëse mbrojtja e mjedisit duhet të merret në konsideratë nga shtetet duke vepruar brenda hapësirës së tyre të vlerësimit dhe nga vetë Gjykata në shqyrtimin e kësaj hapësire, nuk do të ishte e përshtatshme që Gjykata të adaptonte një qasje të veçantë në këtë drejtim duke iu referuar një statusi të veçantë të mbrojtjes së të drejtave mjedisore të njeriut (*Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003, § 122; *Ashworth dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* (aktv.), 2004).

115. Gjykata ka konstatuar gjithashtu se në rastet që ngrenë çështje mjedisore, shtetit duhet t'i lejohet një hapësirë e gjerë vlerësimi (*Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003, § 100; *Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 116; *Luginbühl k. Zvicrës* (aktv.), 2006; *Giacomelli k. Italisë*, 2006, § 80; *Gaida k. Gjermanisë* (aktv.), 2007; *Wałkuska k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Frankowski dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2011; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 218; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 136; *Plachta dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2014, § 79).

2. Mbikqyrja e Gjykatës

116. Në rastet që përfshijnë vendime shtetërore që prekin çështjet mjedisore, ka dy aspekte të hetimit që mund të kryhen nga Gjykata. Së pari, Gjykata mund të vlerësojë thelbin e vendimit të

qeverisë, për të siguruar që ai është në përputhje me nenin 8. Së dyti, mund të shqyrtojë me kujdes procesin e vendimmarrjes për të siguruar që i është dhënë pesha e duhur interesave të individit. Kjo zbatohet në rastet e shqyrtimit të vendimeve ose masave të marra nga autoritetet për të mbrojtur të drejtat e garantuara nga neni 8, si dhe në shqyrtimin e vendimeve ose masave që përbëjnë një ndërhyrje nga një autoritet publik në ushtrimin e këtyre të drejtave (*Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], 2003, § 99; *Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 115; *Öçkan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2006, § 41; *Gaida k. Gjermanisë* (aktv.), 2007; *Giacomelli k. Italisë*, 2006, § 79; *Wałkuska k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 217; *Brândușe k. Rumanisë*, 2009, § 62; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 135; *Udovičić k. Kroacisë*, 2014, § 150).

a. Konsiderata të përgjithshme

i. Detyrimi substancial

α. Detyrimet negative: ndërhyrje nga një autoritet publik

117. Shembuj të ndërhyrjeve nga një autoritet publik:

- *Maatschap Smits dhe të tjerët k. Holandës* (aktv.), 2001: linja hekurudhore publike e planifikuar;
143. Gjykata ka vënë në dukje se, në kontekstin e aktiviteteve të rrezikshme, fushëzbatimi i detyrimeve pozitive sipas neneve 2 dhe 8 të Konventës mbivendosen në masë të madhe. Kështu, detyrimi pozitiv sipas nenit 8 kërkon që autoritetet kombëtare të marrin të njëjtat masa praktike si ato që priten prej tyre në kontekstin e detyrimit të tyre pozitiv sipas nenit 2 (*Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, §§ 212 dhe 216; *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 102; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 538).

144. Në veçanti, si në kuadrin e nenit 2, detyrimi pozitiv për të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për të mbrojtur të drejtat e kërkuarve sipas nenit 8 § 1 përfshin mbi të gjitha një detyrë parësore për shtetin për të miratuar një kuadër legjislativ dhe administrativ për të siguruar parandalimin efektiv të dëmtimit të mjedisit dhe shëndetit të njeriut (*Tătar k. Rumanisë*, 2009, § 88).

Kur shqyrtohen ankesat sipas nenit 8, në rastet kur një shtet përballet me çështje komplekse të politikave mjedisore dhe ekonomike, veçanërisht rastet që përfshijnë aktivitete të rrezikshme, Gjykata ka theksuar se ai shtet duhet, përveç kësaj, të miratojë rregullore të përshtatura me veçoritë e veçanta të aktivitetit në fjalë, veçanërisht në lidhje me nivelin e rrezikut të përfshirë. Rregulloret duhet të mbulojnë licencimin, ngritjen, funksionimin, sigurinë dhe mbikëqyrjen e aktivitetit dhe ta bëjnë të detyrueshme për të gjithë personat e interesuar të marrin masa praktike për të garantuar mbrojtjen efektive të qytetarëve, jetët e të cilëve mund të rrezikohen nga rreziqet që mbart sfera në fjalë (*Tătar k. Rumanisë*, 2009, § 88; *Brândușe k. Rumanisë*, 2009, § 63; *Băcilă k. Rumanisë*, 2010, § 61; *Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë*, 2012, § 106; *Fieroiu dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2017; *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, § 75; *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, § 159; *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 124; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 538(a)).

145. Shembuj:

Në rastin *Băcilă k. Rumanisë*, 2010, §§ 66-73, kërkuari u ankua për paaftësinë e autoriteteve kombëtare për të detyruar një kompani që operon një fabrikë plumbi dhe zinku për të ulur ndotjen e

saj në nivele të përputhshme me mirëqenien e banorëve lokalë. Gjykata vuri në dukje se Qeveria nuk kishte paraqitur asnjë provë që masat që synonin reduktimin e ndotjes të bashkangjitur me lejet e funksionimit për impiantin ishin zbatuar siç duhet dhe se impianti kishte funksionuar për tre vjet pa autorizimin e duhur, edhe pse autoritetet kombëtare kishin qenë në dijeni të çështjeve serioze të ndotjes të përfshira në aktivitetet e uzinës dhe kishin pritur për disa vite për të ndërmarrë ndonjë veprim kundër operatorit. Gjykata vlerësoi se interesi i autoriteteve kombëtare për të ruajtur aktivitetet ekonomike të punëdhënësit më të madh të komunës nuk mund të kishte përparësi mbi të drejtën e të interesuarve për të gëzuar një mjedis të ekuilibruar dhe të shëndetshëm. Gjykata arriti në përfundimin se pavarësisht nga hapësira e vlerësimit, shteti i paditur kishte dështuar të arrinte një ekuilibër të drejtë midis interesave të mirëqenies ekonomike të qytetit (duke mbrojtur aktivitetet e punëdhënësit kryesor lokal) dhe gëzimit efektiv të së drejtës së kërkueses për respektimin e banesës së saj dhe jetës së saj private dhe familjare.

Në rastin *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, §§ 215-216, duke gjetur shkelje të nenit 8 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Gjykata iu referua përfundimit të saj sipas nenit 2 të Konventës (shih seksionin mbi nenin 2 më lart): 1. autoritetet nuk kishin krijuar një kuadër të qartë legjislativ dhe administrativ që u mundësonte atyre të vlerësonin në mënyrë efektive rreziqet e natyrshme në funksionimin e një rezervuari dhe të zbatonin politikat e zhvillimit urban në afërsi të rezervuarit në përputhje me standardet teknike përkatëse; 2. nuk kishte pasur një sistem koherent mbikëqyrës për të inkurajuar përgjegjësit që të merrnin hapa për të garantuar mbrojtjen e duhur të popullatës që jeton në zonë, dhe në veçanti për të mbajtur kanalin e lumit pastër për të përballuar shkarkimet urgjente të ujit nga rezervuari, për të vendosur atje një sistem paralajmërimi emergjent dhe për të informuar popullsinë lokale për rreziqet e mundshme që lidhen me funksionimin e rezervuarit; 3. nuk ishte vërtetuar se kishte pasur një koordinim dhe bashkëpunim të mjaftueshëm midis autoriteteve të ndryshme administrative për të siguruar që rreziqet e sjella në vëmendjen e tyre nuk do të bëheshin aq serioze sa të rrezikonin jetët e njerëzve. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se autoritetet kishin mbetur joaktive edhe pas përmbytjes për të cilën ankoheshin kërkuesit, me rezultatin që rreziku për jetën e atyre që jetonin pranë rezervuarit vazhdonte ende në kohën e dhënies së vensimit

Në rastin *Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, §§ 103-117, që kishte të bënte me ekspozimin e punëtorëve ndaj azbestit gjatë punës në një kantier detar shtetëror, Gjykata gjeti shkelje të nenit 2 në lidhje me një nga kërkuesit që kishte vdekur nga mesotelioma, për shkak të papërshtatshmërisë së rregulloreve dhe masave të pjesshme të zbatuara (shih seksionin në nenin 2 më lart). Duke u mbështetur në arsyetimin që e kishte çuar në atë përfundim, ajo konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 8 në lidhje me kërkuesit e mbijetuar.

Në rastin *Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2017, §§ 73-78, në lidhje me ndotjen e ajrit nga një termocentral, konstatimi i shkeljes nga Gjykata bazohej në dy fakte. Para së gjithash, ajo vuri në dukje se në kohën konkrete nuk kishte rregulla parandaluese për aktivitetet e rrezikshme, duke vënë re se mungesa virtuale e një kuadri rregullator të zbatueshëm për aktivitetet potencialisht të rrezikshme të termocentralit kishte nënkuptuar se ai ishte në gjendje të operonte në afërsi të shtëpive të kërkuesve pa asnjë masë mbrojtëse për të parandaluar ose të paktën reduktuar ndotjen e ajrit dhe ndikimin negativ në shëndetin dhe mirëqenien e kërkuesve. Së dyti, Gjykata vuri në dukje incernë e autoriteteve përballë asaj situate, pavarësisht se pranoi shqetësimin ekologjik të vuajtur nga popullata. Gjykata konkludoi se pavarësisht nga hapësira e vlerësimit në dispozicion të autoriteteve në rastet që kanë të bëjnë me çështje mjedisore, shteti i paditur nuk kishte ruajtur një ekuilibër të drejtë midis interesave të komunitetit për të pasur një termocentral funksional dhe gëzimit efektiv të së drejtës së kërkuesve për respektimin e banesës dhe jetës së tyre private.

Në rastin *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, §§ 162-174, ku banorët lokalë u ankuan për mungesën e veprimeve të shtetit për të mbrojtur shëndetin e tyre dhe mjedisin natyror nga emetimet toksike nga një fabrikë përpunimi çeliku në Taranto, Gjykata vuri në dukje se studime të ndryshme të kryera në nivel kombëtar kishin përmendur efektet e këtyre emetimeve në mjedis dhe në shëndetin publik dhe theksuan një lidhje shkakësore midis ekspozimit ndaj emetimeve dhe një sërë patologjish serioze, si dhe një rritje të shkallës së vdekshmërisë. Gjykata vuri në dukje se përpjekjet e autoriteteve për të dekontaminuar rajonin nuk kishin pasur rezultatet e dëshiruara dhe, në veçanti, se qeveria kishte

ndërhyrë në shumë raste për të garantuar vazhdimësinë e aktiviteteve të prodhimit të çelikut, pavarësisht konstatimit nga autoritetet përkatëse gjyqësore, bazuar në raportet e ekspertëve kimikë dhe epidemiologjikë, se kishte rreze serioze për shëndetin dhe mjedisin. Gjykata arriti në përfundimin se menaxhimi i çështjeve mjedisore që lidhen me aktivitetet e prodhimit të fabrikës nga autoritetet ishte bllokuar, duke vënë në dukje një vazhdimësi të një situatë të ndotjes së mjedisit që rrezikon shëndetin e kërkuesve dhe, në përgjithësi, të të gjithë popullatës që jeton në zonat në rrezik, të cilët, siç ishin gjërat, ishin privuar nga informacioni mbi progresin në dekontaminimin e zonave në fjalë, veçanërisht në lidhje me afatet kohore për punimet përkatëse. Rrjedhimisht, ajo arriti në përfundimin se autoritetet nuk kishin marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar mbrojtjen e të drejtës së kërkuesve për respektimin e jetës së tyre private.

• **Informacion për personat e ekspozuar ndaj një rreziku shëndetësor, jashtë çdo procesi vendimmarrës**

146. Në sferën e aktiviteteve të rrezikshme, neni 8 kërkon që personat e ekspozuar ndaj një rreziku shëndetësor të kenë qasje në informacionin e disponueshëm që u mundëson atyre të vlerësojnë rrezikun, duke përfshirë edhe qasjen jashtë çdo procesi vendimmarrës (*Guerra dhe të tjerët k. Italisë*, 1998, § 60; *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 125; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 538(f); (sa i përket qasjes në informacion në kuadrin e një procesi vendimmarrës, shih më poshtë).

Në vlerësimin e përmbushjes së kësaj të drejte, Gjykata mund të marrë në konsideratë detyrimet që rrjedhin nga instrumentet e tjera relevante ndërkombëtare, si Konventa e Aarhus-it, në veçanti neni 5 § 1 (c) i saj ("Çdo palë do të sigurojë që ... në rast të ndonjë kërcënimi të rëndësishëm të shëndetit të njeriut ose mjedisit, shkaktuar nga aktivitetet e njerëzve apo shkaqe natyrore, i gjithë informacioni i cili mund të ndihmojë publikun të marrë masa për të parandaluar ose zbutur dëmin që rrjedh nga ky kërcënim, dhe i cili zotërohet nga një autoritet publik t'u shpërndahet menjëherë dhe pa vonesë anëtarëve të publikut të cilët mund të jenë ndikuar.") (*Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë*, 2012, § 107; (*Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 125; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 539 (d)).

147. Kur një qeveri angazhohet në aktivitete të rrezikshme që mund të kenë pasoja negative të fshehura në shëndetin e atyre që janë përfshirë në aktivitete të tilla, respektimi i jetës private dhe familjare sipas nenit 8, në mungesë të konsideratave të sigurisë kombëtare, kërkon që të krijohet një procedurë efektive dhe e qasshme që u mundëson personave të tillë të kërkojnë të gjithë informacionin përkatës dhe të përshtatshëm (*McGinley dhe Egan k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1998, § 101; *Roche k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2005, § 162; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 246).

148. Disa vendime duket se sugjerojnë se shteti ka një detyrim sipas nenit 8 për të dhënë informacion *proprio motu* (*Tătar k. Rumanisë*, 2009, §§ 120-124; *Brândușe k. Rumanisë*, 2009, § 74; *Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë*, 2012, §§ 107 dhe 113; *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 152; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 539(d)), si dhe sipas nenit 2 (shih më lart).

149. **Shembuj:**

Në rastin *Guerra dhe të tjerët k. Italisë*, 1998, § 60, në lidhje me situatën e personave që jetonin në afërsi të një fabrike kimike të klasifikuar "Seveso me rrezik të lartë", e cila kishte lëshuar sasi të mëdha gazi të ndezshëm dhe substanca toksike gjatë ciklit të saj të prodhimit, duke çuar në shtrimin në spital të 150 personave, Gjykata konstatoi se shteti i paditur kishte dështuar në detyrimin e tij për të mbrojtur të drejtën e kërkuesve për respektimin e jetës së tyre private dhe familjare, sepse i kishte lënë ata në pritje të informacionit thelbësor që do t'i mundësonte të vlerësonin rreziqet që ata dhe familjet e tyre mund të përballonin nëse do të vazhdonin të jetonin në një qytet i cili gjithashtu ishte ekspozuar ndaj rrezikut në rast të një aksidenti në fabrikë.

Në rastin *McGinley dhe Egan k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1998, §§ 101-103, në lidhje me ekspozimin e personelit ushtarak ndaj rrezatimit gjatë një sërë testesh atmosferike të armëve bërthamore, Gjykata konstatoi që kur një qeveri angazhohet në aktivitete të rrezikshme që mund të kenë pasoja negative

të fshehura për shëndetin e atyre që janë përfshirë në aktivitete të tilla, respektimi i jetës private dhe familjare sipas nenit 8 kërkon që të krijohet një procedurë efektive dhe e qasshme që u mundëson personave të tillë të kërkojnë të gjithë informacionin përkatës dhe të përshtatshëm. Duke vënë në dukje se kërkuessit kishin qasje në një procedurë e cila, në rrethanat e çështjes së tyre, do t'i lejonte ata të kërkonin dokumente në lidhje me nivelin e rrezatimit të regjistruar në ishullin e Krishtlindjeve pas testeve, Gjykata nuk gjeti shkelje të kësaj dispozite.

Ngjashëm, në rastin *Roche k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2005, §§ 162-167, në lidhje me ekspozimin e një ushtaraku ndaj dozave të ulëta të gazit mustardë dhe gazit nervor për qëllime kërkimore, për të cilat më pas ishin diagnostikuar disa sëmundje (astma bronkiale me fillim të vonë, hipertensioni dhe sëmundja kronike obstruktive e rrugëve të frymëmarrjes), Gjykata konstatoi se autoritetet kishin pasur një detyrim pozitiv për t'i ofruar kërkuessit një procedurë efektive dhe të qasshme që i mundësonte atij qasje në të gjithë informacionin përkatës dhe të përshtatshëm që do ta lejonte atë të vlerësonte çdo rrezik ndaj të cilit ishte ekspozuar gjatë pjesëmarrjes së tij në teste. Ajo konsideroi se në këtë rast, procedura e përdorur në rastin *McGinley dhe Egan k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1998 nuk do të kishte përmbushur detyrimin në fjalë për atë që ajo ishte zbatuar vetëm për mosmarrëveshjet në lidhje me pensionet dhe konstatoi shkelje të nenit 8.

Në rastin *Tătar k. Rumanisë*, 2009, §§ 120-124, në lidhje me një aksident që kishte ndodhur në një minierë ari duke përdorur një proces cianidimi, pasojat kryesore të lidhura me shëndetin dhe mjedisin e të cilit ishin dokumentuar në studime dhe raporte ndërkombëtare, Gjykata theksoi se autoritetet u ishte kërkuar të siguronin informacion të përshtatshëm të detajuar mbi pasojat e kaluara, të tashme dhe të ardhshme të aksidentit në shëndetin e banorëve lokalë dhe mjedisin, si dhe masat parandaluese dhe rekomandimet për kujdesin ndaj popullatave që mund të ishin subjekt i ngjarjeve të ngjashme në të ardhmen. Gjykata vuri në dukje se një nga kërkuessit kishte bërë shumë përpjekje të pasuksesshme për të marrë informacion nga autoritetet administrative dhe gjyqësore në lidhje me rreziqet e mundshme ndaj të cilave ai dhe familja e tij ishin ekspozuar dhe për të siguruar ndjekjen penale të atyre që ishin përgjegjës. Më tej, ajo vuri në dukje se autoritetet kishin dështuar në detyrën e tyre për të informuar grupin e popullsisë në fjalë, dhe në veçanti kërkuessit, të cilët nuk kishin mundur të siguronin informacion mbi masat e mundshme për të parandaluar përsëritjen e një aksidenti të ngjashëm ose veprimet që do të ndërmerreshin në atë rast.

Në rastin *Brândușe k. Rumanisë*, 2009, § 74, ku një i burgosur ishte ankuar për një landfill komunal ngjitur me burgun në të cilin ishte mbajtur, Gjykata i kushtoi rëndësi të veçantë faktit se me fillimin e procedurës për mbylljen e landfillit, komuna ishte penalizuar për mosafishimin në objekt të çdo lloji informacioni publik ose paralajmërimesh në lidhje me rreziqet mjedisore dhe shëndetësore të landfillit. Më tej, ajo vuri në dukje se qeveria nuk kishte përshkruar masat e marra nga autoritetet për të siguruar që të burgosurit, veçanërisht kërkuessi – i cili kishte kërkuar informacion nga autoritetet për landfillin e kundërshtuar të mbeturinave – kishte qasje efektive në gjetjet e studimeve të ndikimit dhe në informacionin që do t'i lejonte ata të vlerësonin rrezikun shëndetësor ndaj të cilit ishin ekspozuar.

Në rastin *Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë* 2012, §§ 107 dhe 113, në të cilat kërkuessit ishin ankuar për ndotjen dhe shqetësimet e tjera të shkaktuara nga menaxhimi i dobët i shërbimeve të grumbullimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve në rajonin e Campania-s të Italisë, Gjykata theksoi rëndësinë e veçantë të qasjes publike ndaj informacionit që i lejon ata të vlerësojnë rrezikun ndaj të cilit ishin të ekspozuar. Ajo theksoi më tej se neni 5 § 1 (c) i Konventës së Aarhus-it për qasjen në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore, e cila ishte ratifikuar nga Italia, parashikonte se çdo palë duhet të sigurojë që “në rast të ndonjë kërcënimi të rëndësishëm të shëndetit të njeriut ose mjedisit, shkaktuar nga aktivitetet e njerëzve apo shkaqe natyrore, i gjithë informacioni i cili mund të ndihmojë publikun të marrë masa për të parandaluar ose zbutur dëmin që rrjedh nga ky kërcënim, dhe i cili zotërohet nga një autoritet publik t’u shpërndahet menjëherë dhe pa vonesë anëtarëve të publikut të cilët mund të jenë ndikuar.”. Megjithatë, në rastin konkret, ajo vuri në dukje se studimet e porositura nga departamenti i planifikimit të emergjencave civile ishin bërë publike. Ajo nxori përfundimin se autoritetet italiane kishin kryer detyrën e tyre për të informuar personat e interesuar, duke përfshirë kërkuessit, për rreziqet e mundshme ndaj të cilave ata ishin ekspozuar duke vazhduar të jetonin në Campania. Shih edhe rastin *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 152, i cili gjithashtu kishte të bënte me krizën e mbetjeve në Campania, në të cilën Gjykata

arriti në përfundimin se autoritetet kishin kryer detyrën e tyre për të informuar personat e interesuar, duke përfshirë kërkuesit, për rreziqet e mundshme ndaj të cilave ata ishin të ekspozuar, pasi Departamenti i Mbrojtjes Civile kishte publikuar studime të ndikimit në shëndet dhe informacioni për situatën mjedisore të landfillit në afërsi të shtëpive të kërkuesve ishte bërë publik nga një komision parlamentar, kryetarë komune dhe prokurori publik.

Në rastin *Hardy and Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, §§ 245-250, në të cilin kërkuesit u ankuan për informacionin e pamjaftueshëm publik mbi rreziqet që lidhen me termialet e gazit natyror të lëngshëm, Gjykata mori parasysh informacionin e bërë publik në kuadrin e procesit të vendimmarrjes dhe faktin që ligji vendas kishte parashikuar dhe organizuar gjerësisht të drejtën e qasjes në informacion mbi mjedisin dhe rreziqet që lindin nga aktivitetet e rrezikshme. Gjykata vuri në dukje se një pjesë e madhe e informacionit i ishte dhënë vullnetarisht publikut nga autoritetet dhe zhvilluesit e projekteve, duke vërejtur se kërkuesit nuk kishin arritur të demonstrojnë se asnjë dokument thelbësor nuk iu dha atyre. Ajo shtoi se në çdo rast ata kishin pasur një mekanizëm të krijuar me ligj për t'i lejuar ata në mënyrë specifike të kërkonin informacion për çdo procedurë në të cilën ata nuk kishin qasje. Gjykata arriti në përfundimin se shteti kishte përmbushur detyrimin e tij pozitiv sipas nenit 8.

ii. Procesi i vendimmarrjes

150. Sa herë që autoriteteve kombëtare u jepet diskrecion për të ndërhyrë në gëzimin e një të drejte të Konventës, si ajo e siguruar nga neni 8, garancitë procedurale në dispozicion të individit do të jenë veçanërisht materiale në përcaktimin nëse shteti i paditur ka vepruar brenda hapësirës së tij të vlerësimit (*Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 137; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 539).

151. Kështu, Gjykata ka vënë në dukje se ndërsa neni 8 nuk përmban kërkesa të qarta procedurale, procesi i vendimmarrjes duhet të jetë i drejtë dhe i tillë që të ofrojë respektin e duhur për interesat e individit siç mbrohen nga neni 8 (*Maatschap Smits dhe të tjerët k. Holandës* (aktv.), 2001; *Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 118; *Giacomelli k. Italisë*, 2006, § 82; *Wałkuska k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 62; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 219; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 137; *Udovičić k. Kroacisë*, 2014, § 151). Prandaj, Gjykatës i kërkohet të marrë në konsideratë të gjitha aspektet procedurale, duke përfshirë llojin e politikës ose vendimit të përfshirë, masën në të cilën pikëpamjet e individëve janë marrë parasysh gjatë procedurës së vendimmarrjes dhe masat mbrojtëse procedurale të disponueshme (*Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003, § 104; *Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 118; *Giacomelli k. Italisë*, 2006, § 82; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 62; *Hardy and Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 219; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 137; *Udovičić k. Kroacisë*, 2014, § 151; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 539 (b)).

152. Duke iu referuar drejtpërdrejt në disa nga vendimet e saj Konventës *Aarhus mbi qasjen në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore* (*Tătar k. Rumanisë*, 2009, § 118; *Grimkovskaya k. Ukrainës*, 2011, § 69; *Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë*, 2012, § 107), Gjykata ka vënë në dukje se kur një shtet duhet të përcaktojë çështje komplekse të politikës mjedisore dhe ekonomike, procesi i vendimmarrjes duhet:

- të përfshijë hetime dhe studime të përshtatshme me synim parandalimin dhe vlerësimin;
- të lejojë qasjen e publikut në përfundimet e studimeve të tilla si dhe në informacione që i mundëson të vlerësojnë rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuar;
- t'u mundësojë individëve në fjalë të apelojnë.

153. Në përgjithësi, individët në fjalë duhet të kenë mundësi për të mbrojtur interesat e tyre në procesin e vendimmarrjes mjedisore, gjë që nënkupton se ata duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë efektive në procedurat përkatëse dhe të shqyrtohen argumentet e tyre përkatëse, megjithëse forma aktuale e procesit është një çështje që bie brenda hapësirës së vlerësimit të shtetit (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 539(e)).

154. Në rastin e *Büttner dhe Krebs k. Gjermanisë* (aktv.) (2024, § 73), Gjykata theksoi se kërkesat në lidhje me proceset e vendimmarrjes shërbenin për të siguruar që t'u jepej pesha e duhur të drejtave

të mbrojtura nga neni 8 dhe kështu t'u mundësonin autoriteteve të balanconin siç duhet të drejtat individuale konkurruese dhe interesat e komunitetit në tërësi. Kërkesat nuk ishin një qëllim në vetvete, por ato synonin të siguronin që autoritetet të balanconin siç duhet interesat konkurruese dhe të vepronin brenda hapësirës së tyre të vlerësimit. Prandaj, një defekt në zbatimin e këtyre kërkesave në një procedurë planifikimi, si rregull, vinte në pikëpyetje nëse i ishte dhënë pesha e duhur interesave të individit dhe nëse vendimi i planifikimit ishte në përputhje me kërkesat e nenit 8. Megjithatë, nuk kishte asnjë bazë për konstatimin e shkeljes së nenit 8 nëse gjykatat kombëtare tregonin se autoritetet kishin marrë parasysh dhe kishin balancuar të drejtat në fjalë dhe nëse përjashtonin faktin, në përputhje me ligjin dhe pa pasur asnjë tregues arbitrariteti, që defekti procedural kishte ndikuar në rezultatin e vlerësimit të balancës në dëm të kërkuarit dhe nëse nuk kishte asnjë tregues tjetër që autoritetet kishin tejkaluar hapësirën e tyre të vlerësimit.

155. Në këtë rast, pas kësaj qasjeje, Gjykata e shpalli të papranueshme si qartazi të pabazuar kërkesën e paraqitur nga individë që jetonin në afërsi të projektit të Aeroportit të Brandenburgut të Berlinit, të cilët pretendonin se, gjatë procedurës së miratimit të planifikimit, autoritetet kishin dhënë me vetëdije informacion të pasaktë për korridoret e parashikuara të fluturimit, me rezultatin që ata kishin zbuluar pas miratimit të projektit se ndikimi i zhurmës mbi to do të ishte shumë më i madh nga sa mendohej fillimisht. Gjykata vuri në dukje, në veçanti, se gjykatat kombëtare, pas shqyrtimit të ankesave të kërkuarve në proceset gjyqësore, të cilat siguronin të gjitha garancitë e nevojshme procedurale, kishin gjetur se vlerësimi i balancës së interesave konkurruese i kryer nga autoritetet nuk kishte qenë i mangët dhe se mangësitë në procedurën e miratimit nuk kishin ndikuar në rezultatin e saj në lidhje me kërkuarët; Gjykata gjithashtu vuri në dukje se kërkuarët nuk kishin argumentuar përpara saj se korridoret e ndryshuara të fluturimit kishin ndikuar tek ata në një mënyrë të tillë që të përbënte një shkelje substantive të së drejtës së tyre për respektimin e banesës dhe jetës së tyre private dhe familjare.

χ. Hetimet dhe studimet e mëparshme

156. Kur një shtet duhet të përcaktojë çështje komplekse të politikës mjedisore dhe ekonomike, procesi i vendimmarrjes duhet së pari të përfshijë hetime dhe studime të përshtatshme, në mënyrë që t'u mundësojë atyre të arrijnë një ekuilibër të drejtë midis interesave të ndryshme konfliktuale në fjalë (*Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003, § 128; *Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 119; *Öçkan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2006, § 43; *Lemke k. Turqisë*, 2007, § 41; *Gaida k. Gjermanisë* (aktv.), 2007; *Giacomelli k. Italisë*, 2006, § 83; *Tătar k. Rumanisë*, 2009, § 88; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 220; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 138; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 539(c)), duke parashikuar dhe vlerësuar paraprakisht efektet e aktiviteteve që mund të dëmtojnë mjedisin dhe të cenojnë të drejtat e individëve (*Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 119; *Öçkan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2006, § 43; *Lemke k. Turqisë*, 2007, § 41; *Băcilă k. Rumanisë*, 2010, § 62; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 220; *Fieroiu dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2017, § 21).

157. Gjykata do të shqyrtojë në veçanti nëse autoritetet kanë kryer studime të mjaftueshme për të vlerësuar rreziqet e një aktiviteti potencialisht të rrezikshëm (*Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës*, 2011, § 143).

158. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se vendimet mund të merren vetëm nëse disponohen të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të matshme në lidhje me çdo aspekt të çështjes që do të vendoset (*Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003, § 128; *Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 118; *Gaida k. Gjermanisë* (aktv.), 2007; *Giacomelli k. Italisë*, 2006, § 82; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 70; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, §§ 219 dhe 231; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 138). Ajo që është e rëndësishme është që efektet e aktiviteteve që mund të dëmtojnë mjedisin dhe në këtë mënyrë të cenojnë të drejtat e individëve sipas Konventës mund të parashikohen dhe vlerësohen paraprakisht (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 539 (c)).

159. Në rastin *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 70, Gjykata nuk nxori përfundime nga fakti se autorizimi për të organizuar shfaqje fishekzjarrësh gjatë dy javëve të veçanta çdo vit në kontekstin e festimeve lokale nuk ishte paraprirë nga një studim ndikimi. Përkundrazi, në rastin *Brândușe k. Rumanisë*, 2009, § 73, në lidhje me aromat e pakëndshme nga një depozitim mbeturinash, ajo kishte

parasysh faktin se nuk kishte pasur asnjë studim paraprak të ndikimit në konstatimin e shkeljes së nenit 8.

ii. Qasja në informacion

160. Publiku duhet të ketë qasje në përfundimet e studimeve të tilla (*Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 119; *Öçkan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2006, § 43; *Lemke k. Turqisë*, 2007, § 41; *Tătar k. Rumanisë*, 2009, §§ 88 dhe 113; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 138; *Fieroiu dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2017; *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerë k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 539 (d)).

Kur është e përshtatshme, anëtarët e publikut duhet gjithashtu të kenë qasje në informacionin që i lejon ata të vlerësojnë rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuar (*Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 119; *Öçkan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2006, § 43; *Giacomelli k. Italisë*, 2006, § 83; *Tătar k. Rumanisë*, 2009, §§ 88 dhe 113; *Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë*, 2012, § 107).

iii. Qasja në gjykatë

161. Individët në fjalë duhet të jenë gjithashtu në gjendje të apelojnë në gjykata kundër çdo vendimi, veprimi ose mosveprimi kur ata konsiderojnë se interesave ose komenteve të tyre nuk u është dhënë peshë e mjaftueshme në procesin e vendimmarrjes (*Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004, § 119; *Öçkan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2006, § 43; *Wałkuska k. Polonisë* (aktv.), 2008; *Tătar k. Rumanisë*, 2009, § 88; *Giacomelli k. Italisë*, 2006, § 83; *Zammit Maempel k. Maltës*, 2011, § 62; *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, § 221; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, §§ 138 dhe 155; *Fieroiu dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2017, § 21).

iv. Shembuj

Në rastin *Maatschap Smits dhe të tjerët k. Holandës* (aktv.), 2001, në lidhje me një linjë hekurudhore publike të planifikuar, Gjykata vuri në dukje se efektet e mundshme të dëmshme ishin hetuar nga autoritetet holandeze në të gjitha fazat e procesit të planifikimit: një vendim paraprak i planifikimit që përfshin një studim ndikimi ishte paraqitur para publikut, i cili ishte ftuar të paraqiste komente, vendimi i planifikimit më pas ishte rishikuar gjerësisht, shpenzime të konsiderueshme publike ishin parashikuar për të trajtuar problemet e theksuara në këtë mënyrë, dhe kërkuesit kishin pasur qasje në gjykata.

Në rastin *Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë*, 2004 (shih gjithashtu *Öçkan dhe të tjerët k. Turqisë*, 2006; *Lemke k. Turqisë*, 2007, dhe *Genç dhe Demirgan k. Turqisë*, 2017), në lidhje me një leje për të operuar një minierë ari duke përdorur një proces cianidimi, Gjykata vuri në dukje se përpara lëshimit të lejes së funksionimit ishte kryer një studim i ndikimit dhe ishte organizuar një takim informues publik, në të cilin ishte paraqitur studimi i ndikimit dhe pjesëmarrësit ishin ftuar të bënin komente dhe se banorët e rajonit kishin qasje në të gjithë dokumentacionin përkatës. Më tej, ajo vuri në dukje se Gjykata Supreme Administrative, në të cilën banorët e fshatrave përreth minierës kishin apeluar, kishte hequr lejen, duke u mbështetur në detyrimin pozitiv të shtetit në lidhje me të drejtën për jetën dhe të drejtën për mjedisin; Duke iu referuar gjetjeve të studimit të ndikimit dhe raporteve të tjera, gjykata kishte konsideruar se duke pasur parasysh vendndodhjen gjeografike të minierës së arit dhe veçoritë gjeologjike të rajonit, leja e funksionimit kishte qenë e papajtueshme me interesin publik, pasi studimet kishin nxjerrë në pah rreziqet për ekosistemin lokal dhe për shëndetin dhe sigurinë e njerëzve nga përdorimi i cianurit të natriumit. Megjithatë, edhe pse vendimi i Gjykatës Supreme Administrative kishte qenë menjëherë i ekzekutueshëm, mbyllja e minierës ishte urdhëruar vetëm dhjetë muaj pas marrjes së tij dhe katër muaj pasi u ishte dorëzuar autoriteteve. Më pas, me një vendim që nuk u bë publik, Këshilli i Ministrave kishte autorizuar vazhdimin e prodhimit në minierën e arit. Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet i kishin hequr çdo efekt të dobishëm masave mbrojtëse procedurale në dispozicion të kërkuesve.

Në rastin *Giacomelli k. Italisë*, 2006, në lidhje me një licencë operimi për ruajtjen dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, Gjykata vuri në dukje se as lëshimi i licencës së operimit dhe as autorizimi për detoksifikimin e mbetjeve industriale nuk ishin paraprirë nga ndonjë studim apo hetim i duhur, edhe

pse legjislacioni kombëtar kërkonte një studim të tillë ndikimi paraprak. Autoritetet nuk i kishin kërkuar operatorit të kryente një studim të ndikimit deri në shtatë vjet pasi kishin filluar operacionet e detoksifikimit. Për më tepër, autoritetet administrative kishin dështuar të urdhëronin mbylljen e uzinës edhe pse gjykata kombëtare të cilës iu drejtua nga kërkuesi kishte konstatuar se aktivitetet e saj u mungonte baza ligjore dhe se këto aktivitete duhej të pezulloheshin menjëherë derisa të ishin përshtatur me rregulloret e mbrojtjes së mjedisit. Gjykata vlerësoi se autoritetet administrative nuk kishin respektuar legjislacionin kombëtar mjedisor dhe më pas kishin refuzuar të zbatonin vendimet gjyqësore që pranonin paligjshmërinë e aktivitetet të kundërshtuara, duke i bërë kështu të pafuqishme garancitë procedurale të gëzuara më parë nga kërkuesi dhe duke shkelur parimin e shtetit të së drejtës. Mekanizmi procedural i parashikuar në legjislacionin kombëtar për të garantuar mbrojtjen e të drejtave individuale, dhe në veçanti detyrimin për të kryer një vlerësim të ndikimit në mjedis përpara çdo projekti me pasoja potencialisht të dëmshme mjedisore dhe mundësinë e çdo shtetasi të interesuar për të marrë pjesë në procedurën e licencimit dhe për të paraqitur vërejtjet e veta tek autoritetet gjyqësore dhe, sipas rastit, për të marrë një urdhër për pezullimin e një aktiviteti të rrezikshëm, ishte privuar nga efekti i dobishëm në rastin në fjalë për një periudhë shumë të gjatë. Gjykata arriti në përfundimin, pavarësisht nga hapësira e vlerësimit që i ishte lënë shtetit të paditur, se shteti nuk kishte arritur të gjente një ekuilibër të drejtë midis interesit të komunitetit për të pasur një fabrikë për trajtimin e mbetjeve toksike industriale dhe gëzimit efektiv të së drejtës së kërkueses për respektimin e banesës dhe jetës së saj private dhe familjare.

Në rastin *Tătar k. Rumanisë*, 2009, § 101 dhe §§ 110-119, në lidhje me një leje operimi për një minierë ari dhe argjendi duke përdorur një proces cianidimi, Gjykata para së gjithash konsideroi se autoritetet kishin dështuar në detyrën e tyre për të kryer një vlerësim të kënaqshëm paraprak të rreziqeve të mundshme të aktivitetit të kundërshtuar dhe për të marrë hapat e duhur për të mbrojtur të drejtat e kërkuesve për respektimin e jetës së tyre private dhe për banesat e tyre, dhe, më gjerësisht, për gëzimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe të sigurt. Ajo vuri në dukje, në veçanti, se përderisa ishte kryer një vlerësim i ndikimit përpara lëshimit të lejes, dosja e çështjes nuk kishte treguar se autoritetet kishin diskutuar për rreziqet për mjedisin dhe shëndetin publik që kishin dalë nga vlerësimi. Më tej, Gjykata vërejti se gjetjet e studimit të ndikimit, të cilat përbënin bazën për dhënien e lejes, nuk ishin bërë publike, se ishte zhvilluar një debat publik, por asnjë studim i ndikimit nuk ishte paraqitur para pjesëmarrësve dhe se pyetjet e këtyre të fundit në lidhje me rrezikun e procesit të cianidimit kishin mbetur pa përgjigje.

Në rastin *Grimkovskaya k. Ukrainës*, 2011, §§ 67-72, në lidhje me ekspozimin e banorëve lokalë ndaj ndotjes dhe shqetësimeve të tjera të shkaktuara nga trafiku në një rrugë urbane në të cilën autoritetet kishin vendosur të devijonin trafikun e tipit autostradë, Gjykata i kushtoi rëndësi faktit që qeveria kishte dështuar të tregonte: se atij vendimi i ishte paraprirë një studim i përshtatshëm i fizibilitetit mjedisor dhe i ndjekur nga miratimi i një politike të arsyeshme të menaxhimit mjedisor; ose që kërkuesi kishte pasur ndonjë mundësi të rëndësishme për të kontribuar në procesin e vendimmarrjes, në veçanti duke sfiduar politikat komunale para një organi të pavarur. Ajo konkludoi se, duke pasur parasysh këta dy faktorë dhe duke pasur parasysh *Konventën e Aarhusit*, nuk ishte ruajtur ekuilibri i duhur.

Në rastin *Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2012, §§ 191-192, banorët lokalë ishin ankuar për ndërtimin dhe funksionimin e terminaleve të gazit natyror të lëngshëm në portin e qytetit të tyre, duke treguar rrezikun e një përplasjeje anijeje që çonte në një rrjedhje të madhe gazi e ndjekur nga një shpërthim ose zjarr. Kërkuesi parashittoi se autoritetet kishin kryer një vlerësim joadekuat të atij rreziku. Gjykata para së gjithash vuri në dukje se ekzistonte një kuadër i gjerë legjislativ dhe rregullator për të promovuar sigurinë dhe për të kufizuar rreziqet e paraqitura nga transferimi dhe përpunimi i gazit natyror të lëngshëm. Më tej, ajo vuri në dukje se gjykata kombëtare kishte konsideruar se autoritetet kishin kryer një vlerësim adekuat të rreziqeve dhe vuri re se të dy vendet kishin qenë objekt i Deklaratave të gjata Mjedisore, të cilat kishin identifikuar rreziqe të mundshme nga funksionimi i terminaleve të gazit të lëngshëm natyror dhe kishin propozuar masa zbutëse. Më në fund, Gjykata vërejti se kërkesat për leje planifikimi ishin publikuar, se anëtarët e publikut ishin ftuar të parashtronin komente dhe se kërkuesit kishin qenë në gjendje të kërkonin dhe të merrnin një shqyrtim gjyqësor. Ajo arriti në përfundimin se nuk dukej se kishte ndonjë gabim të dukshëm vlerësimi nga autoritetet kombëtare në arritjen e një ekuilibri të drejtë midis interesave konkurruese në këtë çështje, se si

rrjedhim shteti kishte përmbushur detyrimin e tij për të siguruar të drejtën e kërkuesve për respektimin e jetës dhe shtëpive të tyre private, dhe se si rrjedhojë nuk kishte pasur shkelje të nenit 8.

Në rastin *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, §§ 155-160, në lidhje me autorizimin për të zgjatur pistën kryesore të uljes në një aeroport, Gjykata vuri në dukje se zgjatja e planifikuar kishte qenë objekt i një vlerësimi të detajuar të ndikimit në lidhje me ndotjen akustike, se ishte mbajtur një hetim publik gjatë të cilit publiku i gjerë kishte pasur qasje në dosjen e projektit dhe ishte në gjendje të paraqiste komente, dhe se dy hetime të tjera publike ishin mbajtur në lidhje me servitutet e planifikuara aeronautike dhe radio-elektrike. Ajo nxori përfundimin se ishin kryer hetimet dhe studimet e duhura dhe se publiku kishte pasur qasje të kënaqshëm në gjetjet e tyre. Gjykata gjithashtu vërejti se kërkuesit kishin pasur qasje dhe ushtruan mjete juridike për të mbrojtur të drejtat e tyre. Ajo nuk pranoi kritikën e kërkuesve në lidhje me fragmentimin e procesit të vendimmarrjes dhe faktin se ata nuk kishin qenë në gjendje të lexonin të gjithë dokumentacionin për projektin. Gjykata vuri në dukje se në parim, shteti kishte pasur një zgjedhje të lirë të mënyrave dhe mjeteve për të përmbushur detyrimet e tij, e konsideroi të rëndësishëm argumentin e qeverisë se legjislacioni kombëtar nuk kishte lejuar asnjë qasje tjetër dhe vuri në dukje se në çdo rast kërkuesit kishin pasur mundësinë të merrnin pjesë në çdo fazë të njëpasnjëshme të procesit të vendimmarrjes dhe të parashtronin vëzhgimet e tyre.

Vendimi në rastin *Fieroiu dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2017, §§ 24-29, në lidhje me lejen për të ndërtuar një vend të përkohshëm për përpunimin dhe ruajtjen e mbetjeve, ofron një shembull të mëtijshëm të një procesi vendimmarrjeje që konsiderohet i pajtueshëm me kërkesat e praktikës gjyqësore.

b. Konsiderata specifike në lidhje me ndryshimet klimatike**

162. Neni 8 përfshin të drejtën e individëve për mbrojtje efektive nga autoritetet shtetërore nga efektet serioze negative të ndryshimeve klimatike në jetën, shëndetin, mirëqenien dhe cilësinë e jetës së tyre (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, §§ 519 dhe 544). Detyrimi i shtetit sipas nenit 8 është të bëjë pjesën e tij për të siguruar një mbrojtje të tillë (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 545).

i. Hapësira e vlerësimit

163. Duke pasur parasysh natyrën dhe peshën e kërcënimit dhe konsensusin e përgjithshëm në lidhje me rreziqet e përfshira në sigurimin e qëllimit kryesor të mbrojtjes efektive të klimës duke vendosur objektiva të përgjithshëm për reduktimin e gazit serrë në përputhje me angazhimet e pranuar të Palëve Kontraktuese për të arritur neutralitetin e karbonit, shtetet kanë vetëm një hapësirë të kufizuar vlerësimi për sa i përket angazhimit të tyre ndaj domosdoshmërisë së luftimit të ndryshimeve klimatike dhe efekteve të tyre negative, si dhe përcaktimit të synimeve dhe objektivave të nevojshme. Në të kundërt, ata kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi për sa i përket zgjedhjes së mjeteve për të arritur këto objektiva, duke përfshirë zgjedhjet operationale dhe politikat e miratuara për të përmbushur objektivat dhe angazhimet e marra ndërkombëtarisht, në dritën e prioriteteve dhe burimeve (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, §§ 541-543).

ii. Përmbajtja e detyrimeve pozitive

α. Parimet

• Rregulloret dhe masat

164. Detyra kryesore e shtetit është të miratojë, dhe të zbatojë në mënyrë efektive në praktikë, rregullore dhe masa të afta për të zbutur efektet ekzistuese dhe potencialisht të pakthyeshme, të ardhshme të ndryshimeve klimatike. Këto rregullore dhe masa duhet të synojnë parandalimin e rritjes së përqendrimit të gazit serrë në atmosferën e Tokës dhe rritjen e temperaturës mesatare botërore në nivele që mund të prodhojnë efekte negative serioze dhe të pakthyeshme mbi të drejtat e njeriut, veçanërisht të drejtën për jetën private dhe familjare dhe banesën sipas nenit 8 të Konventës. Më konkretisht, respektimi efektiv për këto të drejta kërkon që çdo Shtet Kontraktues të marrë masa për reduktimin thelbësor dhe progresiv të niveleve të tyre përkatëse të emetimit të gazeve serrë, me

synimin për të arritur neutralitetin neto brenda, në parim, tre dekadave të ardhshme. Për më tepër, në mënyrë që kjo të jetë vërtet e realizueshme dhe për të shmangur një barrë joproporcionale për brezat e ardhshëm, duhet të ndërmerren veprime të menjëhershme dhe duhet të vendosen synime të përshtatshme të ndërmjetme për reduktimin për periudhën që çon në neutralitetin neto. Masa të tilla, në radhë të parë, duhet të përfshihen në një kuadër rregullator të detyrueshëm në nivel kombëtar, i ndjekur nga zbatimi i përshtatshëm. Objektivat dhe afatet kohore përkatëse duhet të përbëjnë një pjesë integrale të kuadrit rregullator kombëtar, si bazë për masat zbutëse të përgjithshme dhe sektoriale. (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, §§ 545-549).

Kështu, kur vlerëson nëse një shtet ka vepruar brenda hapësirës së tij të vlerësimit, Gjykata do të shqyrtojë nëse, në përgjithësi, autoritetet kompetente kombëtare kanë pasur parasysh nevojën të (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 550):

- (a) miratojnë masa të përgjithshme që specifikojnë një afat kohor të synuar për arritjen e neutralitetit të karbonit dhe buxhetin e përgjithshëm të karbonit të mbetur për të njëjtën periudhë kohore, ose një metodë tjetër ekuivalente për përcaktimin sasior të emetimeve të gazeve serrë në të ardhmen, në përputhje me qëllimin kryesor për angazhimet kombëtare dhe/ose globale për zbutjen e ndryshimeve klimatike;
- (b) përcaktojnë objektivat dhe rrugët e ndërmjetme për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë (sipas sektorit ose metodologjive të tjera përkatëse) që konsiderohen të afta, në parim, të përmbushin synimet e përgjithshme kombëtare të reduktimit të GS-ve brenda kornizave kohore përkatëse të ndërmarra në politikat kombëtare;
- (c) sigurojnë prova që tregojnë nëse ata kanë përmbushur siç duhet, ose janë në proces të përmbushjes, objektivat përkatëse të reduktimit të gazit serrë (shih nën-paragrafët (a)-(b) më sipër);
- (d) përditësojnë objektivat përkatëse të reduktimit të gazrave serrë me kujdesin e duhur dhe bazuar në provat më të mira të disponueshme; dhe
- (e) veprojnë në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme dhe konsistente gjatë hartimit dhe zbatimit të legjislacionit dhe masave përkatëse.

165. Përveç këtyre masave zbutëse, Shtetet duhet të miratojnë masa përshtatëse që synojnë zbutjen e pasojave më të rënda ose më të afërta të ndryshimeve klimatike, duke marrë parasysh çdo nevojë të veçantë përkatëse për mbrojtje. Masa të tilla përshtatëse duhet të vendosen dhe zbatohen në mënyrë efektive në përputhje me provat më të mira në dispozicion dhe në përputhje me strukturën e përgjithshme të detyrimeve pozitive të shtetit në këtë kontekst (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 552).

• Procesi i vendimmarrjes

166. Së pari, informacioni i disponuar nga autoritetet publike me rëndësi për përcaktimin dhe zbatimin e rregulloreve dhe masave përkatëse për të trajtuar ndryshimet klimatike duhet t'i vihet në dispozicion publikut, dhe në veçanti atyre personave që mund të preken nga rregulloret dhe masat në fjalë ose mungesa e tyre. Në lidhje me këtë, masat mbrojtëse procedurale duhet të jenë të disponueshme për të siguruar që publiku të ketë qasje në përfundimet e studimeve përkatëse, duke i lejuar ata të vlerësojnë rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuar. Në të njëjtën kohë, duhet të jenë të disponueshme procedura përmes të cilave pikëpamjet e publikut, dhe në veçanti interesat e atyre që preken ose rrezikohen të preken nga rregulloret dhe masat përkatëse ose mungesa e tyre, mund të merren parasysh në procesin e vendimmarrjes (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 554).

β. Rasti i Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës [DhM] (paragrafët 555-573)

167. Një shoqatë kërkuese e grave të moshuara, e krijuar për të promovuar dhe zbatuar mbrojtjen efektive të klimës në emër të anëtarëve të saj, u ankua, ndër të tjera sipas nenit 8, për

mospërshtatshmërinë e supozuar të masave të marra nga autoritetet zvicerane për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike.

Duke zbatuar parimet e parashtruara më sipër, Gjykata konstatoi se Zvicra kishte dështuar të vepronte në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatshme dhe të qëndrueshme në lidhje me hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e kornizës përkatëse legjislative dhe administrative, dhe se si pasojë ajo kishte tejkaluar hapësirën e saj të vlerësimit dhe nuk kishte përmbushur detyrimet e saj pozitive në këtë fushë, duke shkelur kështu nenin 8.

Në lidhje me këtë, Gjykata vuri në dukje, së pari, se kishte disa boshllëqe kritike në procesin e autoriteteve zvicerane për miratimin e kuadrit rregullator kombëtar përkatës. Ajo vuri në dukje se Ligji Për CO₂ i vitit 2011 imponoi reduktimin me 20% deri në vitin 2020 krahasuar me nivelet e vitit 1990, megjithëse – sipas një vlerësimi të vitit 2009 nga Këshilli Federal Zviceran – vendet e industrializuara duhet të reduktojnë emetimet e tyre me 25-40% deri në atë datë. Për më tepër, propozimi i Këshillit Federal i vitit 2017 për të amenduar Aktin e vitit 2011 dhe për të vendosur objektivin e reduktimit në 30% midis viteve 2020 dhe 2030 ishte refuzuar në një referendum në 2021; kjo kishte lënë një boshllëk legjislativ për periudhën pas vitit 2020, të cilën shteti kishte kërkuar ta trajtonte duke miratuar një rishikim të pjesshëm të Aktit të vitit 2011, duke vendosur objektivin e reduktimit për vitet 2021 deri në 2024 në 1.5% në vit dhe nuk përmbante asnjë dispozitë për periudhën pasuese. Gjykata më pas vuri në dukje se, në kontekstin e monitorimit të Marrëveshjes së Parisit, Zvicra kishte paraqitur në dhjetor 2021 një "kontribut të përcaktuar kombëtarisht", që konsistonte në uljen deri në vitin 2030 të emetimeve të gazeve serrë me të paktën 50% krahasuar me nivelet e vitit 1990, ose një reduktim mesatar prej të paktën 35% për periudhën 2021-2030; ky "kontribut i përcaktuar në nivel kombëtar" u transpozua në Aktin e Klimës të 30 shtatorit 2022, i cili parashikonte një objektiv të emetimeve neto zero deri në vitin 2050, duke parashikuar që emetimet e gazeve serrë duhet të reduktohen "sa të jetë e mundur" dhe që përcakton masa të përkohshme për vitin 2040, për periudhën 2031-2040 dhe 2041-2050. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se ky ligj – i cili u konfirmua në një referendum në qershor 2023, por nuk kishte hyrë ende në fuqi kur nxorri vendimin e saj – përcakton objektivat e përgjithshme, por jo masat konkrete për arritjen e tyre, të cilat do të përcaktoheshin nga Këshilli Federal dhe do t'i propozoheshin Parlamentit "në kohën e duhur". Ajo gjithashtu vuri në dukje se periudha 2025-2030 mbeti e parregulluar. Gjykata deklaroi se, duke pasur parasysh urgjencën e ndryshimeve klimatike dhe mungesën aktuale të një kuadri rregullator të kënaqshëm, ajo kishte vështirësi të pranonte se angazhimi i thjeshtë legjislativ për të miratuar masat konkrete "në kohën e duhur" mund të plotësonte detyrën e shtetit për të siguruar dhe zbatuar efektivisht në praktikë, mbrojtje efektive të individëve brenda juridiksionit të tij nga efektet negative të ndryshimeve klimatike në jetën dhe shëndetin e tyre. Ajo konsideroi se prezantimi i legjislacionit të ri nuk ishte i mjaftueshëm për të korrigjuar mangësitë e identifikuara në kornizën ligjore të zbatueshme deri më tani. Më tej, ajo vuri në dukje se autoritetet zvicerane nuk kishin përcaktuar sasinë, nëpërmjet buxhetimit të karbonit ose ndryshe, kufizimet kombëtare mbi emetimet e gazeve serrë.

Në të njëjtën kohë, Gjykata vuri në dukje se Zvicra më parë kishte dështuar të përmbushte objektivat e saj të mëparshme për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë (një reduktim prej 20% deri në vitin 2020 krahasuar me nivelet e vitit 1990).

II. Kufizimi i të drejtave të garantuara nga neni 8 për arsye të mbrojtjes mjedisore

168. Mbrojtja e mjedisit është një qëllim legjitim i aftë për të justifikuar ndërhyrjen në të drejtat e siguruar nga neni 8.

Në rastin *Buckley k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1996, § 63 dhe §§ 74-85, Gjykata konstatoi se një refuzim për t'i dhënë leje planifikimi një Ciganeje që kishte vendosur karvane në një copë tokë që ajo zotëronte për të jetuar atje me familjen e saj dhe një njoftim për zbatimin e largimit të karvanëve kishte ndjekur qëllime legjitime sipas nenit 8. Këto vendime ishin marrë në zbatimin e kontrolleve të planifikuara që synonin avancimin e sigurisë në autostrada, ruajtjen e mjedisit dhe shëndetit publik, dhe synimet legjitime të ndjekura kishin qenë si rrjedhojë siguria publike, mirëqenia ekonomike e vendit, mbrojtja e shëndetit dhe mbrojtja e të drejtave të të tjerëve. Duke vënë në dukje se shtetet gëzojnë një hapësirë

të gjerë vlerësimi në sferën e politikave të planifikimit, duke mbuluar si përkufizimin e politikave të përgjithshme ashtu edhe zbatimin e masave individuale, Gjykata nuk konstatoi shkelje të së drejtës së kërkuar për respektimin e banesës së saj.

Në rastin *Chapman k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2001, §§ 82 dhe 90-116, lidhur me masa të ngjashme, Gjykata vuri në dukje se çështja në fjalë nuk ishte vetëm e drejta e kërkuar për respektimin e banesës së saj, si në *Buckley*, por edhe të drejtën e saj për respektimin e jetës së saj private dhe familjare. Gjykata vlerësoi se masat e kundërshtuara kishin ndjekur qëllimin legjitim të mbrojtjes së “të drejtave të të tjerëve” nëpërmjet ruajtjes së mjedisit. Më tej, ajo theksoi se përkatësia në një pakicë që ka një mënyrë jetese tradicionale të ndryshme nga ajo e shumicës nuk jep imunitet nga ligjet e përgjithshme që synojnë të mbrojnë pasuritë e komunitetit në tërësi, siç është mjedisi. Ajo shtoi se do të ishte e kujdesshme t’i jepte mbrojtje atyre që, në kundërshtim të vetëdijshëm ndaj ndalimeve të ligjit, ndërtonin shtëpi në një zonë të mbrojtur mjedisore. “Një vendimmarrje ndryshe e Gjykatës do të nënkuptonte inkurajimin e veprimeve të paligjshme në dëm të mbrojtjes së të drejtave mjedisore të njerëzve të tjerë në komunitet”. Duke vlerësuar se shtetet gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi në zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të planifikimit, ajo nuk gjeti shkelje të nenit 8.

Në rastin *Wells k. Mbretërisë së Bashkuar* (aktv.), 2007, në lidhje me procedurat penale kundër një cigani i cili kishte refuzuar të largonte një karvan nga një tokë që zotëronte dhe në të cilën kishte jetuar me familjen e tij, Gjykata e vlerësoi kërkesën nga aspekti i të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare dhe të banesës. Gjykata vuri në dukje se masa e kundërshtuar kishte ndjekur një nga qëllimet legjitime të renditura në nenin 8: mbrojtjen e “të drejtave të të tjerëve” nëpërmjet ruajtjes së mjedisit. Më pas, ajo theksoi se shtetet gëzonin një hapësirë të gjerë vlerësimi në balancimin e interesave të popullsisë në përgjithësi, veçanërisht në sferën e mbrojtjes së mjedisit, dhe interesave të një pakice me kërkesa ndoshta konfliktuale, dhe e shpalli ankesën qartazi të pabazuar.

Anasjelltas, Gjykata gjeti shkelje në rastin *Winterstein dhe të tjerët k. Francës*, 2013, § 146 dhe §§ 147-167, në lidhje me udhëtarët që ishin dëbuar nga toka në të cilën ishin vendosur për një kohë të gjatë me arsyetimin se ishte pjesë e një “zone natyrore që kualifikohej për mbrojtje për shkak të cilësisë së peizazhit të saj dhe karakteristikave të tij të ndryshme”. Gjykata vlerësoi se ajo masë kishte pasur një qëllim legjitim sipas nenit 8 § 2: mbrojtjen e “të drejtave të të tjerëve” nëpërmjet ruajtjes së mjedisit. Megjithatë, ajo konstatoi se gjykata nuk kishte kryer një shqyrtim të duhur të proporcionalitetit të ndërhyrjes, duke theksuar se humbja e banesës ishte një shkelje shumë e rëndë e së drejtës për respektimin e banesës. Për më tepër, Gjykata konstatoi se gjykata kombëtare nuk kishte marrë mjaftueshmërisht parasysh nevojat e disa prej kërkuarve, duke theksuar se ata i përkisnin një pakice të cenueshme.

Në rastin *Kaminskas k. Lituanisë*, 2020, §§ 48-66, në lidhje me një urdhër për prishjen e një shtëpie e cila ishte ndërtuar në mënyrë të paligjshme në tokë pyjore, Gjykata vuri në dukje se ruajtja e mjedisit ishte një konsideratë gjithnjë e më e rëndësishme në shoqërinë e sotme dhe konstatoi se masa e prishjes kishte për qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, duke synuar mbrojtjen e tokës pyjore, përveç parandalimit të çrregullimit dhe promovimit të mirëqenies ekonomike të vendit. Duke vënë në dukje se shtëpia ishte ndërtuar në mënyrë të paligjshme, Gjykata tha se do të ishte e kujdesshme në dhënien e mbrojtjes për ata që, në kundërshtim të vetëdijshëm ndaj ndalimeve të ligjit, ndërtuan shtëpi në një zonë të mbrojtur mjedisore, pasi kjo do të nënkuptonte inkurajimin e veprimeve të paligjshme në dëm të mbrojtjes së të drejtave mjedisore të njerëzve të tjerë në komunitet.

Neni 9 (Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë)

« 1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes e të fesë; kjo e drejtë nënkupton lirinë për të ndryshuar fenë ose besimin dhe lirinë, qoftë individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikave dhe kryerjes së riteve.

2. Liria e shfaqjes së fesë ose besimeve të dikujt nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.. »

169. Gjykata nuk duket se deri më sot ka konstatuar shprehimisht se besimet mjedisore hyjnë brenda fushës së nenit 9 (megjithatë, është e qartë, veçanërisht nga vendimet në rastet *A.S.P.A.S. dhe Lasgrezas k. Francës*, 2011, § 55, dhe *Chabauty k. Francës* [DhM], 2012, §§ 41-47, se kundërshtimi i gjuetisë mbi baza etike mund të përbëjë një besim të mbrojtur nga Konventa).

170. Në rastin *Executief van de Moslims van België dhe të tjerët k. Belgjikës*, 2024, §§ 92-101, në lidhje me ndalimin e therjes së kafshëve pa trulllosje paraprake në Rajonet Flamane dhe Valone, Gjykata konstatoi se mbrojtja e mirëqenies së kafshëve mund të konsiderohej një aspekt i "moralit publik", i cili ishte një qëllim legjitim sipas kuptimit të paragrafit 2 të nenit 9. Ajo vuri në dukje, në veçanti, se Konventa nuk mund të interpretohej si nxitje e mbrojtjes absolute të të drejtave dhe lirive që ajo ruante pa marrë parasysh vuajtjet e kafshëve, me arsyetimin se, në nenin 1 të saj, ajo njihte të drejtat dhe liritë vetëm në lidhje me personat. Ajo gjithashtu deklaroi se nuk shihte arsye për të kundërshtuar Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe Gjykatën Kushtetuese belge, të cilat të dyja kishin gjetur se mbrojtja e mirëqenies së kafshëve ishte një vlerë etike, së cilës shoqëritë demokratike bashkëkohore i kushtonin rëndësi në rritje dhe se kjo konsideratë duhet të merret parasysh kur shqyrtohen kufizimet në lirinë e manifestimit të fesë në botën e jashtme.

Neni 10 (Liria e shprehjes)

Neni 10 i Konventës

"1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me liçencë..

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.."

I. Protesta dhe fushata mjedisore

171. Pjesëmarrja në protestat ambientaliste nënkupton shprehjen e një mendimi sipas parashikimeve të nenit 10, edhe kur ato protesta kanë efektin e parandalimit fizik të aktiviteteve të kundërshtuara. Shembuj: duke protestuar kundër gjuetisë së thëllëzave ose një zgjatimi autostrade (*Steel dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, 1998, § 92), kundër gjuetisë së dhelprave (*Hashman dhe Harrup k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 1999, § 28), kundër një projekti të zhvillimit urban (*Peradze dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2022, § 41), ose për të tërhequr vëmendjen e publikut ndaj efekteve mjedisore të shpimit dhe shfrytëzimit të naftës (*Bryan dhe të tjerët k. Rosisë*, 2023, § 85) ose djegia e qymyrit dhe nevoja për një kalim në energjinë e rinovueshme (*Friedrich dhe të tjerët k. Polonisë*, 2024, § 248).

172. Një fushatë ambientaliste përbën gjithashtu shprehjen e mendimit sipas kuptimit të nenit 10.

Shembull: një fushatë e kryer nga OJQ Greenpeace kundër gjuetisë së balenave (*Drieman dhe të tjerët k. Norvegjisë* (aktv.), 2000).

II. Shprehja e mendimeve për temat mjedisore: nivel i lartë mbrojtjeje

173. Temat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit, shëndetin dhe respektimin e kafshëve janë *çështje me shqetësim të përgjithshëm* të cilat, në parim, gëzojnë një nivel të lartë mbrojtjeje nga e drejta e lirisë së shprehjes.

shembuj:

- mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit publik nga autoritetet franceze pas katastrofës së Çernobilit (*Mamère k. Francës*, 2006, § 20);
- trajtimi i kafshëve (*VgT Verein gegen Tierfabriken k. Zvicrës*, 2001, §§ 70-71; në këtë rast, i cili kishte të bënte me refuzimin për të transmetuar një "reklamë" televizive mbi prodhimin industrial të kafshëve të bëra nga një shoqatë për mbrojtjen e kafshëve, Gjykata vuri në dukje se shtrirja e hapësirës së vlerësimit të shtetit duhet të zvogëlohej, sepse meqenëse ajo që ishte në rrezik nuk ishin interesat thjesht "tregtare" të një individi të caktuar, por pjesëmarrja e tij në një debat që prek interesin e përgjithshëm; shih gjithashtu *Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) k. Zvicrës (n° 2)* [DhM], 2009, § 92, dhe *Verein gegen Tierfabriken k. Zvicrës* (aktv.), 2011; *PETA Deutschland k. Gjermanisë*, 2012, § 47; *Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2013, § 102; *Tierbefreier e.V. k. Gjermanisë*, 2014, §§ 51-52; *Guseva k. Bullgarisë*, 2015, §§ 41 dhe 55);
- praktikat abuzive dhe imorale të bujqësisë dhe punësimit, shpyllëzimi dhe shitja e ushqimeve të pashëndetshme (*Steel dhe Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2005, § 88);
- gjuetia e fokave në Norvegjinë veriore (*Bladet Tromsø dhe Stensaas k. Norvegjisë* [DhM], 1999, §§ 63-64);
- ndikimi mjedisor i një centrali bërthamor (*Sdružení Jihočeské Matky k. Republikës Çeke* (aktv.), 2006);
- ndërtimi i planifikuar i një rruge të re (*Almeida Azevedo k. Portugalisë*, 2007, § 28), dhe një projekt zhvillimi urban (*Peradze dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2022, §§ 41 dhe 45);
- mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit publik dhe menaxhimi i tij nga autoritetet turke në kontekstin e tërmetit katastrofik të 17 gushtit 1999 (*Artun dhe Güvener k. Turqisë*, 2007, § 29);
- cilësia e ujit (*Desjardin k. Francës*, 2007, § 46; *Šabanović k. Malit të Zi dhe Serbisë*, 2011, § 44; *Tănăsoaica k. Rumanisë*, 2012, §§ 43 dhe 48);
- ekspozimi ndaj ndotjes dhe shqetësimeve të tjera (*Sapundzhiev k. Bullgarisë*, 2018, § 40 dhe 45);
- ruajtja e një objekti të trashëgimisë (*Margulev k. Rusisë*, 2019, §§ 37 dhe 47);
- mbrojtja e përdorimit bujqësor dhe pyjor të tokës kundër përhapjes së shtëpive të dyta (*Österreichische Vereinigung zur Erhaltung, Stärkung dhe Schaffung k. Austrisë*, 2013, §§ 35-36);
- zhytja e një vendi antik si rezultat i ndërtimit të një dige (*Cangi k. Turqisë*, 2019, § 34);
- ndërtimi i hidrocentraleve (*Kılıçdaroğlu k. Turqisë*, 2020, § 49);
- rreziqet mjedisore dhe shëndetësore të një projekti që përfshin transitin, trajtimin dhe ruajtjen në depo të thella gjeologjike të sasive të mëdha të mbetjeve radioaktive të nivelit të lartë dhe jetëgjatë, që paraqesin rrezik të lartë për shëndetin publik dhe mjedisin (*Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, § 87);
- një plan për të minuar depozitat e arit dhe argjendit (*Bumbeş k. Rumanisë*, 2022, § 92).

174. Komentet e bëra në kuadër të përkushtimit ndaj çështjeve ekologjike kanë gjithashtu një nivel të lartë mbrojtjeje, pasi ato përbëjnë shprehje të pikëpamjeve politike apo veprimtare. Shembuj:

deklarata nga një përfaqësues i zgjedhur i përkushtuar ndaj çështjeve ekologjike (*Mamère k. Francës*, 2006, § 20) ose komente të bëra gjatë një fushate elektorale nga një kandidat për zgjedhjet lokale "Green" (*Desjardin k. Francës*, 2007, § 46).

175. Ky nivel i lartë mbrojtjeje do të thotë se hapësira e vlerësimit të Shteteve Palë në vlerësimin e nevojës së një ndërhyrjeje në lirinë e shprehjes së një personi është "veçanërisht e ngushtë" (*Mamère k. Francës*, 2006, § 20) ose "më e ngushtë" (*Artun dhe Güvener k. Turqisë*, 2007, § 29; shih gjithashtu *Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2013, § 102).

176. Niveli i lartë i mbrojtjes nuk zbatohet kur metodat dhe mjetet e shprehjes ambientaliste përbëjnë kërcënim; në raste të tilla, Shtetet Palë kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi (shih *Drieman dhe të tjerët k. Norvegjisë* (aktv.), 2000, në lidhje me pengimin në det nga aktivistët e Greenpeace në kuadër të një fushate kundër gjuetisë së balenave). Megjithatë, një mbrojtje e tillë mund t'i bashkëngjitet veprimeve mjedisore penguese jo të dhunshme, siç ilustron nga *Bumbeş k. Rumanisë*, 2022, §§ 92-102. Në atë rast, për të protestuar ndaj miratimit të një projekti minerar nga qeveria, kërkuesi dhe një person tjetër e kishin prangosur veten në një pengesë që të çonte në parkun e makinave të selisë së qeverisë rumune, ndërsa protestuesit e tjerë mbanin tabela. Më pas, kërkuesi ishte gjobitur për "formimin e një grupi prej tre ose më shumë personave për të kryer veprime të paligjshme në kundërshtim me rendin dhe qetësinë publike dhe me normat e bashkëjetesës shoqërore". Gjykata konstatoi shkelje të nenit 10 të lexuar në dritën e nenit 11; ajo konsideroi në veçanti se gjykatat kombëtare i kishin dhënë peshë mbizotëruese paligjshmërisë formale të ngjarjes dhe nuk kishin vlerësuar nivelin e shqetësimit të shkaktuar nga veprimet e kërkuesve.

177. Në rastin *Bryan dhe të tjerët k. Rusisë*, 2023, §§ 96-97, Gjykata konstatoi se arrestimi dhe ndalimi i aktivistëve nga OJQ Greenpeace, pas një përpjekjeje për të hipur në një platformë naftë me synimin për të tërhequr vëmendjen e publikut ndaj efekteve mjedisore të shpimit dhe shfrytëzimit të naftës, përbënte ndërhyrje në lirinë e tyre të shprehjes. Më pas, ajo konsideroi, duke pasur parasysh gjetjen e saj se arrestimi dhe ndalimi kishin qenë të paligjshëm sipas kuptimit të nenit 5 § 1, se ndërhyrja në lirinë e shprehjes së kërkuesve nuk ishte "e parashikuar me ligj" sipas kuptimit të nenit 10. Mbi këtë bazë, ajo arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 10, duke vërejtur se për këtë arsye nuk kërkohej të shqyrtonte nëse ndërhyrja në fjalë kishte pasur një qëllim legjitim dhe ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike sipas kuptimit të kësaj dispozite. Gjykata arriti të njëjtin përfundim në *Friedrich dhe të tjerët k. Polonisë*, 2024, § 255, i cili kishte të bënte me arrestimin dhe ndalimin e aktivistëve të Greenpeace, ndërsa ata po merrnin pjesë në një operacion për të bllokuar një anije mallrash që transportonte qymyr me qëllim që të tërhnin vëmendjen e publikut ndaj efekteve mjedisore të djegies së qymyrit dhe nevojës për të kaluar drejt energjisë së rinovueshme.

III. Njohja e rolit të veçantë të shoqatave të ruajtjes së mjedisit në shpërndarjen e informacionit mbi veprimet e autoriteteve publike

178. Në pjesëmarrjen në debatet me interes të përgjithshëm, OJQ-të ushtrojnë një rol mbikëqyrës publik me rëndësi të ngjashme me atë të shtypit; për të kryer këtë detyrë, ata duhet të jenë në gjendje të zbulojnë fakte që mund të jenë me interes për publikun e gjerë, t'u japin atyre një vlerësim dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në hapjen e aktiviteteve të autoriteteve publike. Prandaj, ata gëzojnë një nivel të lartë mbrojtjeje në drejtim të ushtrimit të lirisë së tyre të shprehjes. Kjo vlen edhe për OJQ-të mjedisore (*Vides Aizsardzības Klubs k. Letonisë*, 2004, § 42; shih gjithashtu *Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2013, § 103; *Cangi k. Turqisë*, 2019, § 35; *Margulev k. Rusisë*, 2019, § 47). Kjo zbatohet edhe për grupe të vogla aktiviste jozyrtare (*Steel dhe Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2005, § 89).

IV. Qasje në informacion mbi çështjet mjedisore

A. Njohja e kualifikuar dhe e kushtëzuar e së drejtës për qasje në informacionin e mbajtur nga shteti

179. Në rastin *Guerra dhe të tjerët k. Italisë*, 1998, §§ 53-60, të paraqitur nga persona që jetonin pranë

një fabrike industriale e cila përfaqëson një rrezik për shëndetin publik dhe mjedisin, kërkuesit dhe Komisioni kishin konsideruar se meqenëse dhënia e informacionit për publikun ishte tani një nga mjetet thelbësore për mbrojtjen e mirëqenies dhe shëndetit të popullsisë lokale në situata në të cilat mjedisi ishte në rrezik, liria për të marrë informacionin e garantuar në nenin 10 duhet të interpretohet si dhënie e një të drejte aktuale për të marrë informacion për anëtarët e popullatës lokale që ishin ose mund të preken nga një aktivitet që përfaqëson një kërcënim për mjedisin. Sipas kërkuesve dhe Komisionit, neni 10 u impononte shteteve jo vetëm detyrën për të vënë në dispozicion për publikun informacionin për çështjet mjedisore, por edhe detyrimin pozitiv për të mbledhur, përpunuar dhe shpërndarë një informacion të tillë, i cili për nga natyra e tij nuk mund të vihej ndryshe në dijeni të publikut; ata kishin konsideruar se mbrojtja e ofruar nga neni 10 kishte një funksion parandalues në lidhje me shkeljet e mundshme të Konventës në rast të dëmtimit serioz të mjedisit dhe se neni 10 hyri në veprim edhe përpara se të kishte ndodhur ndonjë cenim i drejtpërdrejtë i të drejtave të tjera themelore, si e drejta për jetën ose për respektimin e jetës private dhe familjare.

Gjykata e hodhi poshtë këtë argument. Duke vërejtur se liria për të marrë informacion "në thelb ndalon një qeveri të kufizojë një person nga marrja e informacionit që të tjerët dëshirojnë ose mund të jenë të gatshëm t'i japin atij", ajo konstatoi se kjo liri nuk mund të interpretohet si imponimi ndaj një Pale Kontraktuese të Konventës i detyrimeve pozitive për të mbledhur dhe shpërndarë informacion me iniciativën e tyre. Ajo nxori përfundimin se neni 10 nuk zbatohet. Megjithatë, ajo e shqyrtoi çështjen sipas nenit 8 (shih më lart).

180. Gjykata më pas vuri në dukje se ndërsa neni 10 as nuk i jepte individit të drejtën e qasjes në informacionin e mbajtur nga një autoritet publik dhe as nuk i kërkonte shtetit t'ia komunikonte atij një informacion të tillë, një e drejtë ose detyrim i tillë mund të lindte: 1. kur zbulimi i informacionit është vendosur me urdhër gjyqësor që ka marrë fuqi ligjore; 2. kur qasja në informacion është instrumentale për ushtrimin nga individit të së drejtës së tij/saj për lirinë e shprehjes, në veçanti "lirinë për të marrë dhe për të dhënë informacion" dhe kur mohimi i tij përbën një ndërhyrje në këtë të drejtë (*Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë* [DhM], 2016, § 156).

Në situatën e dytë, pyetja nëse dhe në çfarë mase refuzimi i informacionit përbënte një ndërhyrje duhet të vlerësohet rast pas rasti në dritën e rrethanave specifike të çështjes. Kriteret përkatëse për përcaktimin e mëtejshëm të fushëveprimit të kësaj të drejte janë:

1. qëllimi i kërkesës për informacion; 2. natyra e informacionit të kërkuar; 3. roli i kërkuesit; 4. disponueshmëria e informacionit të kërkuar (po aty, §§ 157-170). Në rastin *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, § 85, Gjykata theksoi se kjo qasje duhet të zbatohet gjithashtu kur ndërhyrja e pretenduar kishte qenë rezultat jo i një refuzimi për të ofruar qasje në informacion, por i pandershmërisë, pasaktësisë ose pamjaftueshmërisë së pretenduar të informacionit të dhënë nga një organ publik në përputhje me një kërkesë për të dhënë informacionin e parashikuar nga legjislacioni kombëtar. Gjykata konstatoi se dhënia e informacionit të pandershëm, të pasaktë ose të pamjaftueshëm në raste të tilla ishte e ngjashme me një refuzim për të dhënë informacion.

181. Në rastin *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, §§ 79 dhe 107, Gjykata e përmbledhi parimin e zbatueshëm si më poshtë: ndërsa neni 10 i Konventës nuk ofron një të drejtë të përgjithshme për qasje në informacionin e mbajtur nga autoritetet, ai, në një farë mase dhe në kushte të caktuara, mund të garantojë një të drejtë të tillë dhe një detyrim për autoritetet për të dhënë informacion.

182. Siç tregohet nga rastet *Cangi k. Turqisë*, 2019, §§ 30-37, dhe *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, §§ 78-90 dhe 107-117, ajo zbatohet veçanërisht për qasjen në informacionin mjedisor.

Në rastin *Cangi k. Turqisë*, në lidhje me një plan për një digë që do të kishte çuar në zhjtyjen e vendit antik të Allianoit, kërkesa e kërkuesit për një kopje të nënshkruar të procesverbalit të një mbledhjeje të Bordit të Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore ishte refuzuar. Gjykata vuri në dukje se informacioni në fjalë kishte të bënte me një subjekt me interes publik, "përmbytja e një vendi historik nga një digë është padyshim një çështje që mund të shkaktojë polemika të konsiderueshme, që ka të bëjë me një çështje të rëndësishme sociale, ose që përfshin një problem për të cilin publiku do të kishte interes të informohej". Ajo gjithashtu vuri në dukje se kërkuesi kishte qenë anëtar dhe përfaqësues i një OJQ-je

dhe se veprimi i tij për të mbrojtur vendin antik të Allianoit dhe për të shpërndarë informacion mbi procedurat aktuale në lidhje me atë vend nënkuptonte se ai kishte vepruar si një “mbrojtës publik”. Gjykata shtoi se kërkesa e kërkuarit ishte bazuar jo vetëm në dëshirën e tij për të paraqitur dokumentin në fjalë si provë të mangësive në procesin e vendimmarrjes në lidhje me digën, por gjithashtu dhe mbi të gjitha në dëshirën e tij për të informuar publikun dhe për të treguar se dokumenti ishte i disponueshëm, duke vendosur se duke hedhur poshtë kërkesën e kërkuarit, autoritetet kombëtare kishin penguar ushtrimin e lirisë së tij për të marrë dhe dhënë informacion në një mënyrë që cenon thelbin e të drejtave të siguruara sipas nenit 10. Më tej, duke theksuar se ajo ndërhyrje nuk ishte e parashikuar me ligj, Gjykata konstatoi shkelje të kësaj dispozite.

Në rastin *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, në vitin 2021, shoqatat e ruajtjes së mjedisit që kundërshtonin një zonë industriale të projektuar për ruajtjen në depo të thella gjeologjike të mbetjeve radioaktive të nivelit të lartë dhe jetëgjatë (vendi “Cigéo”) ishin ankuar se agjencia kombëtare për menaxhimin e mbetjeve radioaktive kishte dhënë informacion të pasaktë mbi rreziqet mjedisore dhe shëndetësore të projektit. Gjykata vlerësoi se katër kriteret e lartpërmendura ishin përmbushur dhe se për rrjedhojë zbatohet neni 10. Në përfundimin se informacioni i kundërshtuar kishte qenë vërtet i nevojshëm për ushtrimin e lirisë së shprehjes, ajo vuri në dukje se një pjesë e qëllimit statutor të shoqatave kërkuese ishte informimi i publikut për rreziqet mjedisore dhe shëndetësore të këtij projekti, në mënyrë që informacioni i kundërshtuar, pikërisht në lidhje me ato rreziqe, të kishte qenë i qenësishëm në ushtrimin e lirisë së tyre për të dhënë informacion. Për sa i përket natyrës së informacionit, Gjykata vuri në dukje se ishte drejtpërdrejt e rëndësishme për debatin mbi rreziqet e ngritura nga çdo plan për trajtimin dhe gruposjen e sasive të mëdha të mbetjeve radioaktive të nivelit të lartë dhe jetëgjatë, të cilat ishin jashtëzakonisht të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin, duke theksuar se kjo lloj teme ishte padyshim një çështje e interesit publik. Në lidhje me kriterin e tretë, Gjykata i kushtoi rëndësi të veçantë rolit të “mbrojtësit” të luajtur nga organizatat joqeveritare jo vetëm në tërheqjen e vëmendjes së publikut ndaj çështjeve me interes publik, por edhe në inkurajimin e autoriteteve për të ofruar informacion publik për çështje të tilla. Për sa i përket kriterit të katërt në lidhje me disponueshmërinë e informacionit të kundërshtuar, Gjykata vuri në dukje se ai ishte përmbushur në çështjen në fjalë. Ajo vazhdoi ta shqyrtonte rastin në dritën e qasjes në një mjet juridik që lehtëson rishikimin e përmbajtjes dhe cilësisë së informacionit të dhënë (shih më poshtë).

183. Do të ishte gjithashtu e dobishme të përmendet çështja *Sdružení Jihočeské Matky k. Republikës Çeke* (aktv.), 2006 – duke pasur parasysh se vendimi i Gjykatës në këtë çështje i ka paraprirë *Magyar Helsinki Bizottság* – ku një shoqatë e ruajtjes së mjedisit ishte ankuar se autoritetet i kishin mohuar qasjen në disa nga dokumentet e termocentralit bërthamor Temelin. Gjykata pranoi se kishte pasur një ndërhyrje në të drejtën e tij për të marrë informacion. Megjithatë, ajo konsideroi se neni 10 nuk mund të interpretohej si garantimi i një të drejte absolute për të pasur qasje në të gjitha detajet teknike në lidhje me ndërtimin e një centrali bërthamor, “një instalim shumë kompleks që kërkon një nivel shumë të lartë sigurie”, sepse, ndryshe nga informacioni mbi ndikimin mjedisor të një instalimi të tillë, të dhëna të tilla nuk ishin çështje me interes publik. Më tej, ajo vuri në dukje se mohimi i informacionit ishte bazuar në nevojën për të parandaluar shkeljen e konfidencialitetit tregtar dhe detyrimeve kontraktuale të mbështetura nga ndërtuesi, të cilat ishin nën mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, sigurisë publike dhe shëndetit sipas kuptimit të nenit 10 § 2. Duke pasur parasysh hapësirën e vlerësimit të shtetit, ajo arriti në përfundimin se ndërhyrja në lirinë e kërkuarit për të marrë informacion nuk mund të thuhet se ka qenë në disproporcion me qëllimet legjitime të ndjekura.

B. Qasja në një mjet që lehtëson shqyrtimin e përmbajtjes dhe cilësisë së informacionit të dhënë

184. Gjykata ka vënë në dukje se e drejta e qasjes në informacion (aty ku lind) do të ishte e privuar nga thelbi i saj nëse informacioni i dhënë nga autoritetet kompetente do të ishte i pandershëm, i pasaktë apo edhe i papërshtatshëm. Në të vërtetë, respektimi i së drejtës për qasje në informacion kërkon që informacioni i dhënë të jetë i besueshëm, veçanërisht kur kjo e drejtë buron nga një detyrim ligjor i shtetit. Prandaj, efektiviteti i kësaj të drejte kërkon që në rast të një mosmarrëveshjeje të lidhur, personat e interesuar duhet të kenë një mjet juridik që lehtëson shqyrtimin e përmbajtjes dhe cilësisë së informacionit të dhënë, në kuadrin e procedurave kontradiktore *Association Burestop 55 dhe të*

tjerët k. Francës, 2021, § 108).

185. Në rastin *Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, 2021, § 109, Gjykata vuri në dukje se qasja në një rishikim të tillë kishte një rëndësi të veçantë kur informacioni në fjalë kishte të bënte me një projekt që paraqet një rrezik të madh mjedisor. Kjo ishte veçanërisht e tillë në rastin e një rreziku bërthamor, sepse nëse një rrezik i tillë materializohej, ai mund të kishte një ndikim gjatë disa brezave.

Në këtë rast, duke vënë në dukje se shoqatat kërkuese kishin mundur të parashtronin në gjykatat kombëtare një ankim që plotësonte kërkesat e nenit 10, Gjykata nuk gjeti shkelje të kësaj dispozite, ndërsa vuri në dukje se arsyetimi i vendimit të gjykatës së apelit ishte i kritikueshëm.

V. Arsytet në lidhje me mbrojtjen e mjedisit mund të përbëjnë një qëllim të ligjshëm që justifikon ndërhyrjet në ushtrimin e lirisë së shprehjes

186. Në rastin *Ehrmann dhe SCI VHI k. Francës* (aktv.), 2011, një artist ishte dënuar për transformimin e një ndërtese në kuadër të një projekti artistik, shkelje të rregulloreve të planifikimit dhe kryerjes së punimeve, pa autorizim, duke ndikuar në pamjen e mureve të jashtme të ndërtesave të përfshira në listën dytësore të objekteve historike. Gjykata pranoi se qëllimi i asaj ndërhyrjeje kishte qenë “parandalimi i çrregullimit” dhe si rrjedhim edhe “mbrojtja e të drejtave të të tjerëve”. Ajo deklaroi në lidhje me këtë se ndërhyrja kishte pasur për qëllim të sigurote, duke inspektuar ndërtimet dhe punët e tjera në afërsi, cilësinë e mjediseve të strukturave të mbrojtura të trashëgimisë kombëtare, që në këtë rast kishte qenë “një synim legjitim për qëllimet e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të një vendi, duke pasur gjithashtu parasysh hapësirën e vlerësimit të autoriteteve kombëtare në përcaktimin e asaj që përbën interes të përgjithshëm për komunitetin”. Gjykata iu referua në veçanti Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Vlerën e Trashëgimisë Kulturore për shoqërinë, miratuar më 27 tetor 2005, e cila theksoi në veçanti se qëllimi i ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe përdorimit të qëndrueshëm të saj ishte zhvillimi njerëzor.

187. Në rastin *Tőkés k. Rumanisë*, 2021, §§ 81 dhe 96, një eurodeputet i ishte nënshtruar një sanksioni kundërvajtës, në formën e një paralajmërimi, për vendosjen e flamujve të pakicës për qëllime reklamimi në ndërtesën ku ndodhet zyra e tij, pa marrë më parë leje të përkohshme për të reklamuar siç parashikohet nga Ligji për vendosjen dhe autorizimin e materialeve reklamuese. Gjykata vuri në dukje se qëllimi i ligjit kishte qenë të sigurote që mjedisi i ndërtuar të ishte koherent, harmonik, i sigurt dhe i shëndetshëm, në mënyrë që të mbrohen asetet natyrore dhe të krijuara nga njeriu, të ruhet cilësia e peizazhit dhe të jetë në përputhje me standardet e kërkuara për sa i përket cilësisë së ndërtimit. Rrjedhimisht, ajo pranoi se ndërhyrja në lirinë e shprehjes së kërkuesit kishte ndjekur një nga qëllimet legjitime të renditura në nenin 10 § 2, përkatësisht mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.

Neni 11 (liria e tubimit dhe organizimit)

Neni 11 i Konventës

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindika

2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore.

I. Protestat ambientaliste

188. Parimet juridike në lidhje me të drejtën e lirisë së tubimit paqësor zbatohen në një mënyrë mjaft standarde për protestat mjedisore (shih, për shembull, rastet *Makhmudov k. Rusisë*, 2007 (ndalimi arbitrar i një proteste që një shoqatë për ruajtjen e mjedisit kishte dashur ta organizonte për të protestuar kundër ndërtimeve të reja të planifikuara), *Kotov dhe të tjerë k. Rusisë*, 2022 (arrestimi i personave që protestojnë kundër një vendgrumbullimi, vendosja e gjobave administrative dhe refuzimi për të miratuar njoftimin e ngjarjeve publike), dhe *Peradze dhe të tjerët k. Gjeorgjisë*, 2022 (arrestimi i personave që protestojnë kundër një projekti të zhvillimit urban dhe vendosja e gjobave administrative)).

189. Megjithatë, do të vlente të përmendeshin një sërë rastesh në lidhje me protestat ose veprimet penguese mjedisore.

Çështja *Drieman dhe të tjerët k. Norvegjisë* (aktv.), 2000. Ky rast kishte të bënte me arrestimin dhe gjëritjen e anëtarëve të Greenpeace për manovrimin e gomones së tyre midis një anije gjuetie balene dhe një balene në kuadër të një fushate kundër gjuetisë së balenave. Gjykata nuk dha asnjë vendim nëse veprimet e kësaj natyre binin në kuadër të nenit 11 të Konventës. Megjithatë, duke vënë në dukje se mënyra e veprimit të kërkuesve kishte korresponduar me një formë shtrëngimi, duke e detyruar anijen e gjuetisë së balenave të braktiste veprimtarinë e saj të ligjshme, ajo vërejti se masat e marra kundër kërkuesve kishin të bënin me një lloj sjelljeje që nuk mund të gëzonte të njëjtën mbrojtje të privilegjuar sipas Konventës si fjalimi politik ose debati për çështje me interes publik ose manifestimi paqësor i opinionëve për çështje të tilla. Përkundrazi, Gjykata arriti në përfundimin se shtetet gëzonin një hapësirë të gjerë vlerësimi për sa i përket vlerësimit të nevojës për veprim për të kufizuar sjelljen e këtij lloji, dhe e shpalli ankesën sipas nenit 11 qartazi të pabazuar.

Chernega dhe të tjerët k. Ukrainës, 2019. Rasti kishte të bënte me masat e marra ndaj individëve të cilët kishin protestuar në mënyrë penguese kundër një projekti të ndërtimit të rrugës dhe në veçanti prerjes së pemëve në një park urban. Kërkuesit kishin pohuar se arrestimi i tyre dhe dënimi i mëvonshëm për mosbindje ndaj urdhrit të policisë për t'u larguar nga kantieri, dhe në rastin e njërit prej tyre, për kundërshtimin e largimit të tij nga policia, si dhe, në një rast, përdorimi i dhunës fizike nga rojet private të sigurisë në vendngjarje, kishte çuar në shkelje të së drejtës për të protestuar në mënyrë paqësore. Duke vlerësuar arrestimet dhe dënimet nga këndvështrimi i detyrimeve negative të shtetit, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 11 në lidhje me kërkuesit që ishin dënuar me nëntë ditë burgim për mosbindje, me arsyetimin se gjykatat kombëtare kishin dhënë arsye të pamjaftueshme për vendosjen e dënimeve kaq të rënda, duke qenë se kërkohet justifikim i veçantë për vendosjen e dënimeve penale ndaj protestuesve. Anasjelltas, Gjykata nuk gjeti asnjë shkelje në lidhje me kërkuesit të cilët nuk ishin dënuar me burgim, duke vënë në dukje se ata kishin vepruar në mënyrë të qëllimshme penguese pavarësisht nga rreziku i situatës. Ajo gjithashtu nuk gjeti shkelje në lidhje me një kërkues i cili ishte dënuar me dhjetë ditë burgim për rezistencë ndaj arrestimit, duke vënë në dukje se një dënim me burg për veprime protestuese penguese nuk ishte në vetvete e papajtueshme me nenin 11. Gjykata e shqyrtoi më tej çështjen e përdorimit të dhunës nga rojet e sigurisë nga këndvështrimi i detyrimeve pozitive të shtetit, duke përsëritur se autoriteteve u kërkohet të merrnin hapat e nevojshëm për të garantuar zhvillimin e duhur të çdo demonstrimi të ligjshëm dhe për të garantuar sigurinë e qytetarëve, dhe duke theksuar se kjo vlen edhe për një tubim i cili, pavarësisht nëse lejohej apo jo sipas legjislacionit kombëtar, mbrohej nga neni 11 dhe ishte njoftuar në mënyrë të përshtatshme tek autoritetet, megjithëse joformalisht. Gjykata vendosi se duke mos (i) rregulluar në mënyrë të përshtatshme përdorimin e forcës nga rojet e sigurisë, (ii) për të organizuar siç duhet ndarjen e përgjegjësisë në drejtim të parandalimit të çrregullimeve ndërmjet personelit të sigurisë private dhe policisë, e cila do të kishte lehtësuar identifikimin e rojeve të përfshira të sigurisë, (iii) për të siguruar zbatimin e rregullave për identifikimin e duhur të personave të autorizuar për të përdorur forcën, dhe (iv) për të shpjeguar vendimin e policisë për të mos vepruar për të parandaluar ose kontrolluar efektivisht konfrontimet, shteti i paditur kishte dështuar në detyrimin e tij për të garantuar paqen e protestave.

II. Liria e organizimit dhe e mjedisit

190. Praktika gjyqësore mbi të drejtën e lirisë së organizimit zbatohet në një mënyrë mjaft standarde për shoqatat mjedisore (shih rastin *Tebieti Mühafize Cemiyyeti dhe Israfilov k. Azerbajxhanit*, 2009, *Costel Popa k. Rumanisë*, 2016, dhe *Ecodefence dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, në lidhje, përkatësisht, me shpërbërjen e një shoqate për ruajtjen e mjedisit, një refuzim për të regjistruar një shoqatë të përfshirë në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimin e Ligjit Për Agjentët e Huaj Rus 2012, ndër të tjera, për OJQ-të kërkuese dhe drejtorët e tyre).

191. Megjithatë, vlen të përmenden një sërë rastesh që kanë të bëjnë me të ashtuquajturën “liri negative të organizimit”, në të cilat Gjykata shqyrtoi çështjen e anëtarësimit të detyrueshëm të pronarëve të tokave kundër gjuetisë në shoqatat e gjuetisë, në kuadër të organizimit të gjuetisë dhe qitjes nëpërmjet bashkimit të zonave të gjahut.

Në rastin *Chassagnou dhe të tjerët k. Francës* [DhM], 1999, §§ 103-117, Qeveria argumentoi se ndërhyrja e ankimuar në të drejtën e kërkuesve për lirinë e organizimit kishte pasur si qëllim legjitim “mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve” sipas kuptimit të nenit 11 § 2, pasi kishte për qëllim garantimin e zhvillimit demokratik të gjuetisë. Gjykata vuri në dukje se aty ku “të drejtat dhe liritë” e invokuara në këtë drejtim ishin vetë ndër ato të garantuara nga Konventa ose Protokollet e saj, duhej pranuar se nevoja për t’i mbrojtur ato mund t’i shtyjë shtetet të kufizojnë të drejta ose liri të tjera të përcaktuara gjithashtu në Konventë. Prandaj, shtetet kishin një hapësirë të gjerë vlerësimi në balancimin e interesave konkurruese në atë sferë. Ndryshonte çështja kur vendoseshin kufizime ndaj një të drejte ose lirie të garantuar nga Konventa për të mbrojtur “të drejtat dhe liritë” të cilat, si të tilla, nuk parashikoheshin aty, si e drejta apo liria e gjuetisë (duke supozuar se një e drejtë apo liri e tillë ishte e përfshirë në legjislacionin kombëtar). Në një rast të tillë vetëm inevoja të qarta dhe të padiskutueshme mund të justifikojnë ndërhyrjen në gëzimin e një të drejte të garantuar nga Konventa. Duke vërejtur më tej se kërkuesit kishin qenë kundër gjuetisë për arsye etike, Gjykata konstatoi se “të detyrohet një person me ligj që t’i bashkohet një shoqate që është në thelb në kundërshtim me bindjet e tij për të qenë anëtar i saj” dhe ta detyrojë atë, për shkak të anëtarësimit të tij në atë shoqatë, të transferojë të drejtat e tij mbi tokën që zotëronte në mënyrë që shoqata në fjalë të mund të arrijë objektivat të cilat ai nuk i miratonte, shkon përtej asaj që ishte e nevojshme për të siguruar që të vendosej një balancë e drejtë midis interesave konkurruese dhe nuk mund të konsiderohej proporcionale me qëllimin e ndjekur (shih gjithashtu *Schneider k. Luksemburgut*, 2007, §§ 75-83, dhe *A.S.P.A.S. dhe Lasgrezas k. Francës*, 2011, §§ 55-57). Gjykata konfirmoi më pas se fakti që personat në fjalë ishin kundër gjuetisë për arsye etike ishte vendimtar (*Baudinière dhe Vauzelle k. Francës* (aktv.), 2007).

Neni 13 (e drejta për zgjidhje efektive)

Neni 13 i Konventës

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

192. Parimet e jurisprudencës në lidhje me të drejtën për zgjidhje efektive zbatohen në një mënyrë mjaft standarde për rastet me sfond mjedisor. Shih shembujt e mëposhtëm:

- *Athanassoglou dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2000, §§ 58-60;
- *VgT Verein gegen Tierfabriken k. Zvicrës*, 2001, §§ 82-83;
- *Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2003, §§ 137-142;
- *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, §§ 221-232;
- *Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë*, 2012, §§ 84-89 dhe 116-118, dhe *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, §§ 121-127 dhe 175-176.
- *Kotov dhe të tjerët k. Rusisë*, 2022, §§ 136 dhe 86-95.

Nenin 14 (ndalimi i diskriminimit)

Neni 14 i Konventës

"Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër."

193. Parimet e jurisprudencës në lidhje me ndalimin e diskriminimit zbatohen në një mënyrë mjaft standarde për rastet me sfond mjedisor. Shih shembujt e mëposhtëm:

- *Chassagnou dhe të tjerët k. Francës* [DhM], 1999, §§ 89-95 dhe 120-121, dhe *Chabauty k. Francës* [DhM], 2012, §§ 41-57;
- *Chapman k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], 2001, §§ 129-130;
- *VgT Verein gegen Tierfabriken k. Zvicrës*, 2001, §§ 87-89;
- *Wells k. Mbretërisë së Bashkuar* (aktv.), 2007.

Neni 1 i Protokollit nr. 1 (mbrojtja e pronës)

Neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera."

I. Kufizimet e së drejtës së respektimit të pronës për arsye mjedisore

194. Që një ndërhyrje në të drejtën e pronës të jetë në përputhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1, ajo duhet të jetë në përputhje me sundimin e ligjit dhe të ndjekë një qëllim legjitim në interesin e përgjithshëm ose publik. Duhet të ketë gjithashtu një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. Në këtë drejtim, Gjykata do të verifikojë nëse është arritur një ekuilibër i drejtë midis interesit publik dhe interesave të personit në fjalë. Duke vepruar kështu, ai do t'i japë shtetit një hapësirë të gjerë vlerësimi si në zgjedhjen e metodave dhe mjeteve të zbatimit, ashtu edhe në vlerësimin nëse pasojat e tyre janë legjitimuar, në interes të publikut, nga nevoja për të arritur qëllimin e ndjekur (shih Udhëzuesin mbi nenin 1 të Protokollit nr. 1).

A. Ruajtja e mjedisit: një shkak me interes të përgjithshëm ose publik

195. Mbrojtja e mjedisit, natyrës, pyjeve, vijës bregdetare, specieve të kërcënuara, burimeve biologjike, trashëgimisë dhe shëndetit publik janë çështjet të *interesit publik*. Prandaj, një argument mjedisor mund të përdoret për të justifikuar ndërhyrjen në të drejtën e respektimit të pronës.

Shembuj:

- revokimi i një leje për të shfrytëzuar një gropë zhavorri (*Fredin k. Suedisë (n° 1)*, 1991, § 48);
- revokimi i lejeve të planifikimit (*Pine Valley Developments Ltd dhe të tjerët k. Irlandës*, 1991, § 57);

- kohëzgjatja e procedurave të shpronësimit për ngritjen e një rezervati natyror, duke i lënë pronarët të pasigurt për të ardhmen e pronave të tyre dhe duke kufizuar përdorimin e tyre (*Matos e Silva, Lda., dhe të tjerët k. Portugalisë*, 1996, § 88);
- kontributi i detyrueshëm i tokës në një shoqatë gjuetie dhe kërkesa që një pronar toke të tolerojë gjuetinë në pronën e tij (*Chassagnou dhe të tjerët k. Francës* [DhM], 1999, § 79; *Schneider k. Luksemburgut*, 2007, § 46; *A.S.P.A.S. dhe Lasgrezas k. Francës*, 2011, § 36; *Herrmann k. Gjermanisë* [DhM], 2012, §§ 83-85);
- rikategorizimi i një prone si një vend për ruajtjen e natyrës, duke hequr kështu statusin e saj "tokë ndërtimi" (*Bahia Nova S.A. k. Spanjës* (aktv.), 2000);
- anulimi i dekreteve që autorizojnë zhvillimin e një zone, duke hequr statusin e saj "tokë ndërtimi" (*Kapsalis dhe Nima-Kapsali k. Greqisë* (aktv.), 2004);
- nxjerrja e urdhrit për prishjen e një ndërtese të ngritur pa leje planifikimi (*Saliba k. Maltës*, 2005, § 44; *Ivanova dhe Cherkezov k. Bullgarisë*, 2016, § 71);
- listimi i ndërtesave private si monumente historike, duke çuar në kufizime zhvillimi në ndërtesat ngjitur dhe kufizime ndërtimi në pjesën e mbetur të pronës (*SCEA Ferme de Fresnoy k. Francës* (aktv.), 2005);
- përcaktimi i tokës si zonë e mbrojtur pas një ndryshimi në skemën e planifikimit urban, duke rezultuar në ndalimin e ndërtimit për të mbrojtur ndërtesat me vlerë historike ose kulturore dhe për të zhvilluar një zonë të gjelbër në qytet (*Galtieri k. Italisë* (aktv.), 2006);
- përcaktimi i një pjese toke si "pasuri pyjore", duke rezultuar, në veçanti, me ndalimin e ndërtimit (*Ansay dhe të tjerët k. Turqisë* (aktv.), 2006);
- vendosja e një gjobe të madhe për punë ndërtimi në kundërshtim me rregulloret e planifikimit (*Valico S.r.l. k. Italisë* (aktv.), 2006);
- refuzimi për të lëshuar një leje përjashtimi për ndërtimin në tokën e përfshirë në një program ndërkombëtar për mbrojtjen e bregut (*Saarenpään Loma ky k. Finlandës* (aktv.), 2006);
- vendimi për heqjen e statusit të "tokës së ndërtimit" nga një ngastër toke për shkak të rëndësisë arkeologjike të zonës në të cilën ajo bënte pjesë (*Perinelli dhe të tjerët k. Italisë* (aktv.), 2007; *Longobardi dhe të tjerët k. Italisë* (aktv.), 2007);
- prishja e një shtëpie me arsyetimin se ajo ishte ndërtuar pa leje planifikimi në një zonë pyjore në të cilën nuk mund të jepej një leje e tillë (*Hamer k. Belgjikës*, 2007, § 81);
- revokimi i lejes së planifikimit dhe urdhri për prishjen e një rezidence verore (*Tumeliai k. Lituanisë*, 2018, § 75);
- vendime që kufizojnë dhe më vonë ndalojnë zhvillimin në një ishull të vogël ku breshkat kokëmadhe, një specie e kërcënuar, vendosin vezët e tyre (*Z.A.N.T.E. – Marathonisi A.E. k. Greqisë*, 2007, § 50);
- vendime që kufizojnë dhe më vonë ndalojnë zhvillimin në një ngastër toke të vendosur në një zonë të plotë të mbrojtur (*Anonymos Touristiki Etairia Xenodocheia Kriti k. Greqisë*, 2008, § 45);
- refuzimi i një kërkesë për një leje për nxjerrjen e torfe (*Pindstrup Mosebrug A/S k. Danimarkës* (aktv.), 2008);
- revokimi i një dokumenti pronësie dhe reregjistrimi i tij në emër të Thesarit Publik pa kompensim, me arsyetimin se toka në fjalë ishte pjesë e pronës pyjore publike (*Turgut dhe të tjerët k. Turqisë*, 2008, § 90; *Cin dhe të tjerët k. Turqisë*, 2009, § 29; *Temel Conta Sanayi Ve Ticaret A.Ş. k. Turqisë*, 2009, § 42; *Kök dhe të tjerët k. Turqisë*, 2009, § 22; *Keçeli dhe Başpınar k. Turqisë*, 2010, § 40);
- përcaktimi i tokës si "pasuri pyjore publike", duke e penguar pronarin nga kultivimi dhe korja e saj ose të hyjë në ndonjë transaksion në lidhje me tokën (*Köktepe k. Turqisë*, 2008, § 87);
- ndalimi i gjuetisë së dhelprave (*Friend dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* (aktv.), 2009, §§ 56-57);
- refuzimi i një kërkesë për leje ndërtimi për shkak të përcaktimit të tokës bujqësore si vend për ruajtjen e natyrës (*Tarim k. Turqisë* (aktv.), 2010);

- refuzimi, pas miratimit të Ligjit të 3 janarit 1986 "Për Zhvillimin, Mbrojtjen dhe Promovimin e Zonave Bregdetare", për të lejuar kërkuesin të vazhdonte të pushtonte pronën publike detare ku ai kishte pasur shtëpinë e tij për disa dekada, dhe një urdhër për prishjen e tij (*Depalle k. Francës* [DhM], 2010, § 81);
- vendimi për të ripyllëzuar një pjesë toke, duke hequr statusin e saj "tokë ndërtimi" (*Lazaridi k. Greqisë*, 2006, § 34);
- asgjësimi parandalues i deleve si përgjigje ndaj një shpërthimi të sëmundjes Afta Epizootike (*Chagnon dhe Fournier k. Francës*, 2010, § 50) dhe asgjësimi i bagëtive për të parandaluar përhapjen e brucelozës së gjedhit (*S.A. Bio d'Ardennes k. Belgjikës*, 2019, §§ 50 dhe 57, 12 nëntor 2019);
- refuzimi i kërkesave për leje planifikimi në ishullin Porquerolles (*Consorts Richet dhe Le Ber k. Francës*, 2010, § 116);
- revokimi i një dokumenti pronësie në lidhje me tokën që i nënshtrohet pronës publike detare (*Silahyürekli k. Turqisë*, 2013, § 47);
- revokimi i një dokumenti pronësie në lidhje me seksionet e Lagunës së Venecias të përdorura për kultivimin e peshkut (*Valle Pierimpiè Società Agricola S.P.A. k. Italisë*, 2014, § 67);
- ndalimi i ndërtimit në rrethinat e një parku kombëtar (*Matczyński k. Polonisë*, 2015, §§ 101-102);
- një masë parandaluese për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në lidhje me një ndërtesë tregtare, e cila kishte kufizuar përdorimin e kësaj të fundit (*Petar Matas k. Kroacisë*, 2016, § 35);
- refuzimi i pretendimeve për kompensim për servitutin e planit të zhvillimit që heq statusin e "tokës së ndërtimit" të parcelave të ndryshme të tokës (*Malfatto dhe Mieille k. Francës*, 2016, § 63);
- vendosja e gjobës dhe konfiskimi i një shume të madhe parash për operimin pa autorizim të një firme skrapit (*S.C. Fiercolect Impex S.R.L. k. Rumanisë*, 2016, § 60);
- kufizimet në zhvillimin e pronës së listuar si një vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s (*Kristiana Ltd. k. Lituanisë*, 2018, § 104-105);
- kufizimet e peshkimit të vendosura për të mbrojtur rezervat e peshkut (*Posti dhe Rahko k. Finlandës*, 2002, §§ 77) dhe një ndalim të përkohshëm për peshkimin e farave të midhjes (*O'Sullivan McCarthy Mussel Development Ltd k. Irlandës*, 2018, § 109);
- konfiskimi i një anijeje të përdorur për peshkim të paligjshëm (*Yaşar k. Rumanisë*, 2019, § 59);
- ndalimi i shfrytëzimit komercial të pyjeve, me qëllim ruajtjen e tyre (*Sakskoburggotski dhe Chrobok k. Bullgarisë*, 2021, § 260; shkelje e nenit 1 të Protokollit nr. 1).

196. Mbrojtja e shëndetit publik dhe e mjedisit është gjithashtu një çështje me interes të përgjithshëm sipas kuptimit të fjalisë së dytë të nenit 1 të Protokollit nr. 1.

Shembuj:

- prishja e një shtëpie të ndërtuar mbi bazën e një leje e cila ishte bërë e pavlefshme për faktin se ndodhej në një zonë mbrojtëse të ujërave nëntokësore, e cila nuk është tokë ndërtimi (*Yıldırım k. Turqisë*, 2009, § 43);
- revokimi i aktit të pronësisë mbi një ngastër toke e cila ndodhej në një vend të nominuar për t'u përfshirë në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe që ishte shitur në kundërshtim me ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, territoret e mbrojtura dhe planifikimin e territorit (*Bogdel k. Lituanisë*, 2013, §§ 60-61);
- anulimi i të drejtave pronësore mbi pronën e kthyer gabimisht pas rënies së regjimit komunist me arsyetimin se toka në fjalë mbulohej nga pyje me rëndësi kombëtare, të cilat mund t'i përkisnin vetëm shtetit (*Beinarovič dhe të tjerët k. Lituanisë*, 2018, §§ 135-137);
- revokimi i dokumenteve të pronësisë mbi parcelat e tokës që përbënin "burime pyjore" dhe për këtë arsye nuk mund të privatizoheshin (*Gavrilova dhe të tjerët k. Rusisë*, 2021, § 73).
- qasja e kufizuar dhe përdorimi i një parcele toke për shkak të përfshirjes së saj në një zonë mbrojtëse ujore me qëllim që të sigurohet qasje në ujë të pijshëm të pastër për të tjerët

(*Bërziņš dhe të tjerët k. Letonisë*, 2021, § 87).

197. E njëjta gjë është e vërtetë për sa i përket parandalimit të rreziqeve natyrore dhe lehtësimit të ofruar për ata që preken prej tyre (*Aktürk dhe të tjerët k. Turqisë*, 2023, §§ 70-73 dhe 76).

198. Gjykata ka theksuar shumë fort legjitimitetin e konsideratave të mbrojtjes së mjedisit në kontekstin e nenit 1 të Protokollit nr. 1. Kështu në rastin *Hamer k. Belgjikës*, 2007, § 79, në lidhje me prishjen e një shtëpie që ishte ndërtuar pa leje në tokën pyjore ku ndërtimi ishte i ndaluar, Gjykata vërejti se ndërsa asnjë dispozitë e Konventës nuk parashikonte në mënyrë specifike mbrojtjen e përgjithshme të mjedisit si e tillë, në shoqërinë e sotme mbrojtja e mjedisit ishte një konsideratë gjithnjë e më e rëndësishme dhe mjedisi ishte bërë një shkak, mbrojtja e të cilit zgjonte interesin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të publikut, dhe rrjedhimisht të autoriteteve publike. Ajo shtoi se nevojave financiare dhe madje edhe disa të drejtave themelore, si pronësia, nuk duhet t'u jepet përparësi ndaj konsideratave të mbrojtjes së mjedisit, veçanërisht kur shteti kishte nxjerrë ligje në lidhje me këtë. Më pas, ajo e ka riafirmuar këtë qëndrim, veçanërisht në rastin *Turgut dhe të tjerët k. Turqisë*, 2008, § 90 (shih gjithashtu *Köktepe k. Turqisë*, 2008, § 87, *Temel Conta Sanayi Ve Ticaret A.Ş. k. Turqisë*, 2009, § 42, dhe *Bil İnşaat Taahhüt Ticaret Limited Şirketi k. Turqisë*, 2013, § 29, në lidhje me revokimin e një dokumenti pronësie dhe reregjistrimin e tij në emër të Thesarit Publik pa kompensim, me arsyetimin se toka në fjalë ishte pjesë e pasurisë pyjore publike; shih gjithashtu, në një kontekst tjetër, *S.C. Fiercolect Impex S.R.L. k. Rumanisë*, 2016, § 65). Gjykata specifikoi se ky konstatim i interesit publik zbatohet veçanërisht për mbrojtjen e natyrës dhe pyjeve (*Nane dhe të tjerët k. Turqisë*, 2009, § 24). Ajo shtoi se autoritetet publike morën një përgjegjësi e cila në praktikë duhet të rezultojë në ndërhyrjen e tyre në kohën e duhur për të siguruar që dispozitat ligjore të miratuara me qëllim të mbrojtjes së mjedisit nuk ishin plotësisht joefektive (*Hamer k. Belgjikës*, 2007, § 79; *S.C. Fiercolect Impex S.R.L. k. Rumanisë*, 2016, § 65). Në rastin *Tarim k. Turqisë* (aktv.), 2010, në lidhje me refuzimin e një kërkesë për leje për të ndërtuar një restorant turistik në tokë bujqësore të caktuar si vend për ruajtjen e natyrës, Gjykata e përshkroi ruajtjen e mjedisit si "jashtëzakonisht të rëndësishme".

B. Hapësira më e gjerë e vlerësimit

199. Duke ndërmarrë, për qëllime të interesit të përgjithshëm, veprime që përbëjnë një ndërhyrje në të drejtën e pronës, shtetet gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi në lidhje me zgjedhjen e mjeteve të zbatimit për arritjen e qëllimit në fjalë dhe për vlerësimin e proporcionalitetit të këtyre mjeteve me qëllimin e synuar. Gjykata ka theksuar se ky është veçanërisht rasti kur interesi i përgjithshëm i ndjekur ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit (*Hamer k. Belgjikës*, 2007, § 78; *Depalle k. Francës* [DhM], 2010, §§ 84 dhe 87; *Maczyński k. Polonisë*, 2015, §§ 105-106; *S.C. Fiercolect Impex S.R.L. k. Rumanisë*, 2016, § 67; *Tumeliai k. Lituanisë*, 2018, § 72).

Në mënyrë të ngjashme, Gjykata ka vënë në dukje se hapësira e vlerësimit është më e gjerë kur ndërhyrja e pretenduar në të drejtën për respektimin e pronës lidhet me politikat e planifikimit territorial dhe të mbrojtjes së mjedisit (*Depalle k. Francës* [DhM], 2010, §§ 84 dhe 87; *Malfatto dhe Mieille k. Francës*, 2016, § 64; *Barcza dhe të tjerët k. Hungarisë*, 2016, § 46; *O'Sullivan McCarthy Mussel Development Ltd k. Irlandës*, 2018, § 124); (*Bërziņš dhe të tjerët k. Letonisë*, 2021, § 90).

200. Kështu, në një çështje në lidhje me rregulloret për përdorimin e pronës sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 1 të Protokollit nr. 1, Gjykata deklaroi se në fusha të tilla si mjedisi do të respektojë gjykimin e ligjvënësit për atë që është në interes të përgjithshëm, përveç rastit kur ai vendim është haptazi pa bazë të arsyeshme, në lidhje si me zgjedhjen e mjeteve të ekzekutimit ashtu dhe për të përcaktuar nëse pasojat e ekzekutimit janë të justifikuara në interesin e përgjithshëm me qëllim arritjen e synimit të ligjit në fjalë (*Plachta dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2014, § 101).

C. Mbikqyrja nga Gjykata

201. Përveç kufirit më të gjerë të vlerësimit të përmendur më lart, parimet e praktikës gjyqësore në lidhje me të drejtën për respektimin e pronës zbatohen në një mënyrë mjaft standarde për masat që kufizojnë këtë të drejtë, të cilat synojnë ruajtjen e mjedisit (shih Udhëzuesin mbi nenin 1 të Protokollit Nr. 1).

202. Nëse ndërhyrja i atribuohet shtetit të paditur ose për dështimin e shtetit për të vepruar, Gjykata shqyrton nëse sjellja e tij ishte e justifikueshme duke pasur parasysh parimet e ligjshmërisë, qëllimit legjitim të ndjekur dhe, nëse është e nevojshme, proporcionalitetit (*Associations of Communally-owned Forestry Proprietors Porceni Plesa dhe Piciorul Batran Banciu k. Rumanisë*, 2023, § 73).

203. Në rastin *Associations of Communally-owned Forestry Proprietors Porceni Plesa dhe Piciorul Batran Banciu k. Rumanisë*, 2023, shoqatat e pronarëve të pyjeve, të cilët, për shkak se pyjet e tyre ishin përfshirë në rrjetin evropian të mbrojtjes së natyrës “Natura 2000”, nuk mund t'i përdornin më, por duhej t'i mirëmbanin, u ankuan se nuk u ishte paguar kompensimi i parashikuar me ligj, pasi shteti nuk kishte miratuar legjislacionin zbatues. Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1, me arsyetimin se parimi i ligjshmërisë nuk ishte respektuar dhe se ky boshllëk ligjor nuk dukej se ndiqte një qëllim legjitim.

204. Në vlerësimin e proporcionalitetit, Gjykata do të verifikojë në veçanti nëse, duke pasur parasysh hapësirën e vlerësimit të shtetit, kërkuesi duhej të mbante një barrë individuale dhe të tepruar të tillë që ekuilibri i drejtë që duhej të ishte ruajtur midis mbrojtjes së të drejtës së pronës dhe kërkesave të interesit të përgjithshëm ishte prishur (*Hamer k. Belgjikës*, 2007, § 78; *Turgut dhe të tjerët k. Turqisë*, 2008, § 91; *Köktepe k. Turqisë*, 2008, §§ 91-92; *Consorts Richet dhe Le Ber k. Francës*, 2010, §§ 115 dhe 124; *Gavrilova dhe të tjerët k. Rusisë*, 2021, §§ 74 dhe 87; *Sakskoburggotski dhe Chrobok k. Bullgarisë*, 2021, §§ 261-268; *Bërziņš dhe të tjerët k. Letonisë*, 2021, § 90).

Kështu, për shembull, një privim i pronës pa pagesën e një shume të arsyeshme që lidhet me vlerën e saj normalisht do të përbëjë një ndërhyrje joproporcionale dhe mungesa totale e kompensimit mund të konsiderohet e justifikueshme sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 vetëm në rrethana të jashtëzakonshme; kjo vlen nëse shpronësimi kishte për qëllim mbrojtjen e mjedisit apo kishte një qëllim tjetër (*Turgut dhe të tjerët k. Turqisë*, 2008, §§ 91-92; *Cin dhe të tjerët k. Turqisë*, 2009, § 30; *Temel Conta Sanayi Ve Ticaret A.Ş. k. Turqisë*, 2009, § 43; *Kök dhe të tjerët k. Turqisë*, 2009, § 23; *Yıldırım k. Turqisë*, 2009, § 44; *Ocak k. Turqisë*, 2010, § 52; *Keçeli dhe Başpınar k. Turqisë*, 2010, § 41; *Bölükbaş dhe të tjerët k. Turqisë*, 2010, § 35; *Silahyürekli k. Turqisë*, 2013, § 48; *Valle Pierimpiè Società Agricola S.P.A. k. Italisë*, 2014, § 71).

205. Vendimi në rastin *Z.A.N.T.E. – Marathonisi A.E. k. Greqisë*, 2007, § 54, vlen të përmendet sepse tregon se kur një shtet miraton masa për të kufizuar të drejtën e pronës me qëllim mbrojtjen e mjedisit, ekuilibri i drejtë mund të prishet nëse autoritetet dështojnë të ndërmarrin veprime të tjera për të siguruar një mbrojtje të tillë (shih gjithashtu konsideratat e Gjykatës në rastin *G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët k. Italisë* [DhM], §§ 295-299, 2018).

Në rastin në fjalë, kompania kërkuese, e cila kishte blerë një ishull të vogël me qëllim ndërtimin e objekteve turistike, ishte penguar më pas nga vendimet e marra nga autoritetet që kufizonin dhe më pas ndalonin punimet e ndërtimit (ishulli përfundimisht ishte përfshirë në Parkun Kombëtar të Zakynthos), për arsye të mbrojtjes së vendeve ku breshkat kokëmadhe, një specie e kërcënuar, lëshonin vezët e tyre. Duke vënë në dukje se autoritetet kishin toleruar aktivitete në tokën në fjalë, të cilat ishin të papajtueshme me arsyet për të cilat prona e kompanisë kërkuese i ishte nënshtruar kufizimeve shumë të rënda operationale (ishulli i vogël ishte pushtuar nga turistët në baza ditore, plazhi i tij ishte ndotur rëndë dhe nuk kishte tualete), Gjykata konstatoi se ekuilibri i nevojshëm i drejtë ishte prishur midis interesit publik dhe interesave private në drejtim të rregullimit të përdorimit të pronës. Kjo theksoi si në vijim: “... kur shteti vendos kufizime të mëdha në shfrytëzimin e një prone private me synim garantimin e mbrojtjes efektive të mjedisit, ai duhet, së paku, të mos tolerojë aktivitete që mund të minojnë përpjekjet për të arritur këtë qëllim. Përndryshe, qëllimi i kufizimit mund të dështonte dhe barra e vendosur fillimisht mbi palën e interesuar do të bëhet më e patolerueshme për atë palë; ky është një faktor që duhet të merret parasysh në vlerësimin e proporcionalitetit të kufizimit me qëllimin e ndjekur. Në rastin konkret, do të ishte e paarsyeshme që shteti t'i kërkonte kërkuetit të respektojë kufizime të rrepta për gëzimin e pronës së tij me qëllim mbrojtjen e breshkës kokëmadhe, ndërkohë që autoritetet kompetente nuk marrin masat e nevojshme *vis-à-vis* aktivitetet që rrezikojnë arritjen e qëllimit të përmendur”.

II. Shkelja e të drejtave pronësore për shkak të dëmtimit mjedisor

206. Neni 1 i Protokollit nr. 1, në parim, nuk garanton të drejtën për gëzimin paqësor të pronave në një mjedis të këndshëm (*Ünver k. Turqisë* (aktv.), 2000; *Taşkin dhe të tjerët k. Turqisë* (aktv.), 2004; *Galev dhe të tjerët k. Bullgarisë* (aktv.), 2009; *Ivan Atanasov k. Bullgarisë*, 2010, § 83; *Marchiş dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2011, § 44; *Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 184; *Plachta dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2014; *Marchiş dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2011, § 44), në një mjedis të caktuar (*Cokarić dhe të tjerët k. Kroacisë* (aktv.) 2006; *Zapletal k. Republikës Çeke* (aktv.), 2010), ose në një mjedis rural të këndshëm e të pandryshuar (*Moore k. Mbretërisë së Bashkuar* (aktv.), 1999).

207. Megjithatë, aksidentet industriale, fatkeqësitë natyrore dhe, më gjerësisht, dëmtimi i mjedisit mund të rezultojnë në shkatërrim, përkeqësim ose ulje të vlerës së pronës. Shteti mund të jetë përgjegjës për këtë të fundit sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1, nëse efektet negative mbi pronën kanë qenë rezultat i dështimit të detyrimit pozitiv për të mbrojtur të drejtat e pronës ose i një ndërhyrjeje që i atribuohet autoriteteve.

A. Përgjegjësia e drejtpërdrejtë e shtetit

208. Shteti mund të jetë përgjegjës sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1 kur një pronë shkatërrohet ose dëmtohet ose është ulur në vlerë për shkak të një aksidenti mjedisor ose të dëmit mjedisor që i atribuohet një organi, institucioni ose ndërmarrjeje të së drejtës publike.

Parimet juridike në lidhje me të drejtën për respektimin e pronës zbatohen në një mënyrë mjaft standarde për ndërhyrjet e këtij lloji në të drejtën për mbrojtjen e pronës.

1. Shkatërrimi ose dëmtimi i pronës - shembull

209. Në rastin *Dimitar Yordanov k. Bullgarisë*, 2018, kërkuesi u ankua se operimi nga një ndërmarrje publike e një miniere thëngjilli të hapur, ndër të tjera duke përdorur lëndë plasëse, i kishte dëmtuar banesën, e cila ndodhej në një distancë prej 160-180 metrash, duke e detyruar të largohej nga banesa e tij. Gjykata vuri në dukje se në këtë çështje kishte pasur një ndërhyrje nga shteti në ushtrimin e të drejtës së tij për mbrojtjen e pronës. Duke marrë parasysh çështjen sipas fjalisë së parë të nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Gjykata konstatoi një shkelje të kësaj dispozite me arsyetimin se ndërhyrja kishte qenë e paligjshme, duke vënë në dukje se miniera e qymyrit kishte funksionuar brenda zonës tampon të parashikuar në ligjin e brendshëm dhe se gjykata e apelit kishte vendosur se shpërthimi i eksplozivëve në një distancë kaq të afërt me banesat ishte padiskutim në kundërshtim me legjislacionin kombëtar.

2. Humbja e vlerës - shembuj

210. Rasti *Ouzounoglou k. Greqisë*, 2005, §§ 28-32, dhe *Athanasίου dhe të tjerët k. Greqisë*, 2006, §§ 23-26, kishte të bënte me ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore (rrugë në rastin e parë dhe hekurudha në këtë të fundit) pranë shtëpive të kërkuesve, në pjesë të shpronësuara të tokës së tyre. Kërkuesit u ankuan për refuzimin e dhënies së kompensimit sipas procedurës së shpronësimit, për uljen e vlerës së pronave të tyre të mbetura për shkak të afërsisë së infrastrukturës në fjalë, e cila kishte dëmtuar pamjen e tyre dhe gjoja i ekspozonte ndaj ndotjes akustike dhe vibrimeve. Gjykata arriti në përfundimin se mohimi i kompensimit kishte prishur ekuilibrin e drejtë midis të drejtave individuale konkurruese dhe kërkesave me interes publik.

Gjykata vlerësoi një situatë të ngjashme të krahasueshme në rastin *Bistrović k. Kroacisë*, 2007, §§ 42-45, në lidhje me shpronësimin e pjesshëm të tokës në pronësi të një çifti fermerësh me qëllim ndërtimin e një autostrade. Gjykata konstatoi shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 sepse në procedurat e shpronësimit nuk ishte marrë parasysh ulja e konsiderueshme e vlerës së pronës së tyre të mbetur. Në këtë konkluzion, ajo kishte vënë në dukje, në veçanti, se gjatë caktimit të kompensimit për shpronësimin e pronës së kërkuesve, autoritetet kombëtare nuk kishin marrë parasysh faktin që autostrada e ardhshme do të kalonte dy deri në tre metra nga shtëpia e tyre dhe se pasuria kishte humbur mjedisin e saj të dikurshëm të këndshëm, një oborr të madh dhe ekspozim të ulët zhurmash, të cilat e kishin bërë pronën shumë të përshtatshme për aktivitete bujqësore. Gjykata vuri në dukje

më tej se gjykatat kombëtare ishin mbështetur në një raport eksperti të hartuar pa qenë ndonjëherë eksperti në vend dhe gjithashtu ato nuk kishin verifikuar argumentin e kërkuësve se shtëpia e tyre ishte vizatuar gabimisht në hartën e truallit, gjë që e kishte bërë të pamundur që gjykatat të përcaktonin një shumë të përshtatshme si kompensim. Ajo arriti në përfundimin se duke mos vendosur të gjithë faktorët përkatës për llogaritjen e kompensimit për pronën e shpronësuar të kërkuësve dhe duke mos dhënë dëshmipërbliim për uljen e vlerës së pasurisë së tyre të mbetur, autoritetet kombëtare nuk kishin arritur një ekuilibër të drejtë midis interesave konkurruese të përfshira.

Për krahasim, shih rastin *Couturon k. Francës*, 2015, §§ 38 dhe 43, në lidhje me mungesën e kompensimit për uljen e vlerës (ndërmjet 20% dhe 40%) të një prone për shkak të ndërtimit të një autostrade në një seksion të shpronësuar të pronës. Gjykata vuri në dukje se efektet e afërsisë së autostradës me pronën e kërkuësit kishin qenë të pakrahasueshme me ato në rastet *Ouzounoglou* dhe *Athanasίου* (autostrada kishte qenë ngjitur me pronën e kërkuësit, por 250 metra larg shtëpisë). Ajo nxori përfundimin se kërkuësi nuk duhej të mbante një barrë individuale dhe të tepruar. Për më tepër, duke pasur parasysh procedurat kombëtare, Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

211. Në rastin *Orfanos dhe Orfanou k. Greqisë* (aktv.), 2006 (shih gjithashtu *Calancea dhe të tjerët k. Republikës së Moldavisë* (aktv.), 2018, § 36), Gjykata vlerësoi se praktika gjyqësore në rastin *Ouzounoglou* ishte e pazbatueshme për rastin e një shtëpie që ishte ndërtuar pas një shpronësimi të pjesshëm të kryer me qëllim ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore. Ajo vuri në dukje se kërkuësit kishin zgjedhur qëllimisht të investonin më tej në tokën e tyre të shpronësuar dhe se ata nuk ishin ishin zënë në befasi nga një urdhër shpronësimi që prishte një mënyrë jetese të krijuar prej kohësh *in situ*. Ajo nxori përfundimin se ata nuk ishin justifikuar të pretendonin se shteti kishte vepruar në mënyrë arbitrare duke mohuar kompensimin për humbjen e vlerës së shtëpisë së tyre ose trazirat në jetën e tyre të përditshme. Më tej, duke vënë në dukje se gjykatat kombëtare u kishin dhënë atyre një dëshmipërbliim të posaçëm për uljen e vlerës së tokës së tyre, përveç vendimit të shpronësimit, Gjykata e shpalli ankesën sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1 qartazi të pabazuar.

212. Në rastin *Fotopoulou k. Greqisë*, 2004, §§ 33-38, kërkuësja u ankua se autoritetet kishin refuzuar të prishnin një mur të ndërtuar në mënyrë të paligjshme nga fqinjët pranë pronës së saj, pavarësisht një vendimi përfundimtar të detyrueshëm që urdhëronte një prishje të tillë. Gjykata vuri në dukje se ai refuzim kishte rezultuar në vazhdimësinë e murit të ndërtuar ilegalisht. Duke vënë në dukje se muri i kishte privuar shtëpisë së kërkuëses pamjen nga deti dhe dëmtonte karakterin tradicional të fshatit, duke ulur kështu vlerën e pronës së kërkuëses, Gjykata konkludoi se autoritetet kishin qenë përgjegjëse për ndërhyrjen në të drejtat e saj pronësore, ndërhyrje e cila mbulohej nga fjalia e parë e paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Ajo konstatoi shkelje të dispozitës me arsyetimin se refuzimi ose mosveprimi nga ana e autoriteteve nuk kishte bazë ligjore në legjislacionin kombëtar.

213. Humbja e vlerës së pronës së paluajtshme për shkak të ndotjes akustike nga një aeroport publik është gjithashtu e tillë që shkakton përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të shtetit sipas nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Megjithatë, Gjykata deri më tani nuk ka gjetur kurrë një shkelje të kësaj dispozite në një kontekst të tillë, pasi asnjë kërkuës nuk ka ofruar ndonjëherë prova për një ulje të vlerës së pronave të tyre (*Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës*, 2012, § 190; *Płachta dhe të tjerët k. Polonisë* (aktv.), 2014).

214. Rastet *Ivan Atanasov k. Bullgarisë*, 2010, § 83 dhe *Vecbaštika dhe të tjerët k. Letonisë* (aktv.), 2019, vlen të përmenden gjithashtu. Në rastin e parë, kërkuësi parashtroi se zbatimi praktik i një programi për rehabilitimin e një pellgu mbetjesh nga një ish-minierë bakri që i përkiste një ndërmarrje publike e kishte penguar atë të gëzonte plotësisht pronën e tij dhe kishte ulur vlerën e saj. Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 me arsyetimin se kërkuësi nuk kishte paraqitur asnjë provë që të tregonte se kishte pasur një ndikim në pronën e tij ose se kësaj të fundit i ishte ulur vlera. Në rastin e fundit, kërkuësit u ankuan sipas kësaj dispozite për uljen e vlerës së pronave të tyre dhe prishjen e projekteve të tyre profesionale (në sferën e turizmit fshatar, blegtorisë, bujqësisë dhe bletarisë) si pasojë e autorizimit për instalimin e turbinave me erë në afërsi. Gjykata e shpalli ankesën qartazi të pabazuar me arsyetimin se kërkuësit nuk kishin paraqitur prova as për uljen e vlerës së pronave të tyre dhe as për ndonjë ndikim ekonomik në aktivitetet e tyre profesionale.

B. Dështimi i shtetit për të përmbushur detyrimin e tij pozitiv për të mbrojtur pronën

215. Në një çështje në lidhje me një fatkeqësi mjedisore të shkaktuar nga njeriu, e lidhur me aktivitete të rrezikshme, Gjykata konfirmoi ekzistencën e detyrimeve pozitive për të mbrojtur të drejtën për respektimin e pronës. Në rastin *Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, §§ 134-135, një shpërthim në një vendgrumbullim mbeturinash shtëpiake kishte shkaktuar një rrëshqitje dhe duke vrarë një numër të madh personash dhe duke varrosur njëmbëdhjetë shtëpi të lagjeve të varfra të vendosura poshtë saj, duke përfshirë shtëpinë e kërkuarit. Gjykata theksoi se ushtrimi i vërtetë dhe efektiv i të drejtës së mbrojtur nga kjo dispozitë nuk varej thjesht nga detyra e shtetit për të mos ndërhyrë, por mund të kërkonte masa pozitive mbrojtjeje, veçanërisht kur ekzistonte një lidhje e drejtpërdrejtë midis masave që një kërkuar mund të priste në mënyrë legjitime nga autoritetet dhe gëzimit efektiv të zotërimeve të tij.

216. Pretendimet për dështimin e shtetit për të ndërmarrë veprime pozitive për mbrojtjen e pronës private konsiderohen në parim në dritën e rregullit të përgjithshëm të përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1, i cili parashikon të drejtën për gëzimin paqësor të pronës (*Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 133; *Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, § 172; *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, § 213; *Hadzhiyska k. Bullgarisë* (aktv.), 2012); *Vladimirov k. Bullgarisë* (aktv.), 2018, § 34).

217. Detyrimet pozitive të përcaktuara në nenin 1 të Protokollit Nr. 1 kërkojnë që shteti të rregullojë industrinë private në mënyrë të tillë që të kontrollojë çdo ndotje ose shqetësim të prodhuar (për sa i përket rrezeve mjedisore, rregulloret duhet të përfshijnë një aspekt parandalues; shih më poshtë). Përgjegjësia e shtetit sipas kësaj dispozite mund të rrjedhë nga mungesa e rregulloreve të përshtatshme që rregullojnë industrinë private. Gjykata e theksoi këtë fakt në rastin *Zapletal k. Republikës Çeke* (aktv.), 2010, në lidhje me ndotjen akustike nga një fabrikë kompresimi me pllaka metalike.

218. Për më tepër, në mjedisin si në kontekste të tjera, detyrimet pozitive për të mbrojtur të drejtën e respektimit të pronës përfshijnë kërkesën për të parashikuar procedura gjyqësore të mbuluara nga garancitë procedurale përkatëse, duke u mundësuar gjykatave vendase të përcaktojnë në mënyrë efektive dhe të drejtë mosmarrëveshjet në lidhje me çështjet pronësore (*Bistrović k. Kroacisë*, 2007, § 33; *Couturon k. Francës*, 2015, § 33). Për të vërtetuar nëse ky kusht është përmbushur, Gjykata do të ndërmarrë një qasje gjithëpërfshirëse (*Petar Matas k. Kroacisë*, 2016, § 44). Gjykata e zbatoi këtë parim në rastin *Couturon k. Francës*, 2015, § 42-43, në lidhje me mosdhënien e kompensimit për humbjen e vlerës së një prone për shkak të ndërtimit të një autostrade në një pjesë të asaj prone. Ajo arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1, sepse asgjë nuk kishte ndodhur nga procedurat kombëtare në lidhje me kërkesën e kërkuarit për kompensim që të sugjeronte se ai nuk kishte përfituar nga një shqyrtim i drejtë gjyqësor i çështjes së tij.

1. Shkatërrimi ose dëmtimi i pronës

a. Shkatërrimi ose dëmtimi i pronës si rezultat i fatkeqësive mjedisore

i. Fatkeqësitë mjedisore të tipit industrial

219. Në rastin *Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, §§ 134-136, e cila lidhet me një fatkeqësi mjedisore të tipit industrial, Gjykata vendosi se zyrtarët dhe autoritetet shtetërore nuk kishin bërë gjithçka brenda fuqisë së tyre për të mbrojtur interesat pronësore të kërkuarit. Ajo konstatoi se detyrimi pozitiv sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 kërkonte nga autoritetet kombëtare të merrnin të njëjtat hapa praktikë për të shmangur shkatërrimin e banesës së kërkuarit si ato të vendosura nga detyrimi pozitiv sipas nenit 2 të Konventës (shih më lart).

Gjykata përdori të njëjtin arsyetim në rastin *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, § 216, në të cilin një shkarkim i papritur në shkallë të gjerë i ujit nga një rezervuar për të parandaluar daljen e tij nga shtrati i tij kishte shkaktuar përmbytje në një lagje banimi, duke dëmtuar shtëpitë e kërkuarve.

ii. Fatkeqësitë natyrore mjedisore të parashikueshme

220. Gjykata mban një qasje më të kualifikuar kur dëmtimi i pronës vjen për shkak të një fatkeqësie natyrore.

Në rastin *Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2008, §§ 174-175, në lidhje me një rrëshqitje balte që kishte varrosur një zonë urbane dhe kishte dëmtuar banesat, Gjykata vuri në dukje se fatkeqësitë natyrore, të cilat si të tilla ishin jashtë kontrollit njerëzor, nuk kërkonin të njëjtën masë të përfshirjes së shtetit. Prandaj, detyrimet e saj pozitive në lidhje me mbrojtjen e pronës nga rreziqet e motit nuk shtriheshin domosdoshmërisht në sferën e aktiviteteve të rrezikshme të natyrës së krijuar nga njeriu. Gjykata vuri në dukje se duhet bërë një dallim midis detyrimeve pozitive sipas nenit 2 të Konventës dhe atyre sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Ndërsa rëndësia themelore e së drejtës për jetën kërkon që fushëveprimi i detyrimeve pozitive sipas nenit 2 të përfshijë një detyrë për të bërë gjithçka brenda fuqisë së autoriteteve në sferën e ndihmës në fatkeqësi për mbrojtjen e kësaj të drejte, detyrimi për të mbrojtur të drejtën për gëzimin paqësor të pronës, i cili nuk ishte absolut, nuk mund të shtrihej më tej se sa ishte e arsyeshme për rrethanat. Prandaj, autoritetet gëzonin një hapësirë më të gjerë vlerësimi për të vendosur se çfarë masash të merrnin për të mbrojtur pronën e individëve nga rreziqet e motit sesa në marrjen e masave të nevojshme për të mbrojtur jetët. Për më tepër, detyra procedurale e hetimit të pavarur dhe përgjigjes gjyqësore nuk kishte të njëjtën rëndësi në lidhje me pasurinë e shkatërruar si në rast të humbjes së jetës. Përsëri, detyrimi pozitiv i shtetit për të mbrojtur pronën private nga fatkeqësitë natyrore nuk mund të interpretohet si detyrimi i shtetit për të kompensuar vlerën e plotë të tregut të pronës së shkatërruar.

Gjykata konfirmoi këtë dallim në rastin *Hadzhiyska k. Bullgarisë* (aktv.), 2012, §§ 15-16, në lidhje me përmbajtjen e banesës së kërkuarit nga dalja e një lumi nga brigjet e tij pas reshjeve të mëdha. Ajo theksoi veçanërisht se neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk shkon aq larg sa kërkonte nga shtetet kontraktuese të merrnin masa parandaluese për të mbrojtur zotërimet private në të gjitha situatat dhe të gjitha zonat e përfshira nga përmbajtjet ose fatkeqësitë e tjera natyrore. Duke pasur parasysh zgjedhjet operationale që duhen bërë përse i përket prioritetëve dhe burimeve, çdo detyrim që lind sipas kësaj dispozite duhet të interpretohet në një mënyrë që të mos imponojë një barrë të pamundur ose joproporcionale për autoritetet.

Për të njëjtin efekt, në rastin *Vladimirov k. Bullgarisë* (aktv.), 2018, § 35, në lidhje me dëmin material të shkaktuar nga një rrëshqitje natyrore, Gjykata shtoi se fatkeqësitë natyrore, të cilat për nga natyra e tyre ishin jashtë kontrollit njerëzor, nuk kërkonin të njëjtën masë të përfshirjes së shtetit si aktivitetet e rrezikshme të një natyre të krijuar nga njeriu, dhe nxori përfundimin se detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur pronën kundër të parës nuk shtriheshin domosdoshmërisht aq sa ato në sferën e këtij të fundit. Në rastin *Atasagün k. Turqisë* (aktv.), 2024, i cili gjithashtu kishte të bënte me dëmin e shkaktuar nga një rrëshqitje dheu, Gjykata shtoi se, në lidhje me fatkeqësitë natyrore, fushëveprimi i detyrimit të parandalimit konsistonte në thelb në vendosjen e një kuadri efektiv legjislativ dhe rregullator dhe miratimin e masave për të përforcuar kapacitetin e shtetit për t'u marrë me natyrën e papritur dhe të dhunshme të fenomeneve të tilla natyrore. Ajo specifikoi se, në një kontekst të tillë, parandalimi përfshin, në veçanti, planifikimin e duhur territorial dhe zhvillimin e kontrolluar urban.

b. Shkatërrimi ose dëmtimi i pronës i shkaktuar nga përkeqësimi i mjedisit për shkak të aktiviteteve private

221. Nuk ka vendime në lidhje me shkatërrimin ose dëmtimin e pronës të shkaktuara nga përkeqësimi i mjedisit për shkak të aktiviteteve private. Për një shembull të këtij lloji në kontekstin e një ndërhyrjeje që i atribuohet shtetit, shih *Dimitar Yordanov k. Bullgarisë*, 2018, më lart.

2. Humbja e vlerës së pronës për shkak të dëmtimit të mjedisit përreth

222. Aktivitetet që mund të shkaktojnë probleme mjedisore ose shqetësime të rënda mund të ndikojnë në vlerën e pasurisë së paluajtshme dhe kështu të arrijnë në një shpronësim të pjesshëm (*Taşkin dhe të tjerët k. Turqisë* (aktv.), 2004; *Cokarić dhe të tjerët k. Kroacisë* (aktv.), 2006; *Galev dhe të tjerët k. Bullgarisë* (aktv.), 2009; *Ivan Atanasov k. Bullgarisë*, 2010, § 83; *Vecbaštika dhe të tjerët*

k. Letonisë (aktv.), 2019); ata madje mund ta bëjnë pronën të pashitshme (*Taşkin dhe të tjerët k. Turqisë* (aktv.), 2004).

Kjo mund të zbatohet, për shembull, për "shqetësimin e konsiderueshëm të zhurmës" (*Cokarić dhe të tjerët k. Kroacisë* (aktv.), 2006), i shkaktuar, për shembull, nga një aeroport (*Ashworth dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* (aktv.), 2004).

223. Megjithatë, deri më tani, ankesat e këtij lloji të paraqitura në Gjykatë janë refuzuar me arsyetimin se kërkuesit nuk kanë ofruar prova për humbjen e vlerës së pronës së tyre (*Ashworth dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* (aktv.), 2004; *Galev dhe të tjerët k. Bullgarisë* (aktv.), 2009; *Zapletal k. Çekisë Republikë* (aktv.), 2010; *Marchiş dhe të tjerët k. Rumanisë* (aktv.), 2011, §§ 45-46).

Neni 34 i Konventës (kërkesat individuale)

Neni 34 i Konventës

"Gjykata mund të marrë kërkesat nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë të jenë viktimë të një shkeljeje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose në protokollet e saj. Palët e Larta Kontraktuese zotohen të mos pengojnë në ndonjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte."

I. *Actio popularis* / statusi i viktimës

A. Parimet e përgjithshme

1. Viktima e drejtpërdrejtë – çështja e *locus standi* e shoqatave të ruajtjes së mjedisit

224. Në mjedisin, si në rastet e tjera, për të kërkuar statusin e viktimës për një shkelje të Konventës sipas kuptimit të nenit 34, në parim, njeriu duhet të jetë "ndikuar drejtpërdrejt" personalisht nga shkelja në fjalë (shih, për shembull, *Lambert dhe të tjerët k. Francës* [DhM], 2015, § 89). Me fjalë të tjera, për qëllimet e nenit 34, fjala "viktimë" nënkupton personin e prekur drejtpërdrejt nga veprimi ose mosveprimi në fjalë (*Balmer-Schafroth dhe të tjerët k. Zvicrës*, 1997, § 26).

Kriteret mbi të cilat Gjykata është mbështetur për të përcaktuar statusin e viktimës përfshijnë, më së shumti, çështje të tilla si niveli minimal i seriozitetit të dëmit në fjalë, kohëzgjatja e tij dhe ekzistenca e një lidhjeje të mjaftueshme me kërkuesin ose kërkuesit, duke përfshirë, në disa raste, afërsinë gjeografike midis kërkuesit dhe dëmit mjedisor të kundërshtuar (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 472).

225. Në bazë të praktikës së përgjithshme gjyqësore për nenin 34, të afërmit e një personi që ka vdekur në një kontekst mjedisor, megjithatë mund të pretendojnë se janë viktimë (indirekte) të shkeljes së nenit 2 (*Brincat dhe të tjerët k. Maltës*, 2014, § 87).

226. Në kuadrin e konstatimit të statusit të viktimës së kërkuesve që ankohen për shkelje të nenit 8 për shkak të cenimit të mjedisit, Gjykata do të ketë parasysh faktin se faktori vendimtar për të përcaktuar nëse ka pasur shkelje të nenit 8 është nëse ka pasur një efekt negativ në jetën private ose familjare të një personi dhe jo thjesht ndonjë dëmtim të përgjithshëm në mjedis (*Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë*, 2012, § 80; *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, § 101; *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 91).

Në rastin *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, §§ 100-109, në të cilin një numër individësh u ankuan për shkarkime të dëmshme nga një fabrikë çeliku në Taranto, Gjykata vlerësoi se kërkuesit, të cilët nuk kishin jetuar në bashkitë që ishin identifikuar si të ekspozuara ndaj rrezikut nga Këshilli Italian i Ministrave dhe që nuk kishin ofruar prova të tilla për të hedhur dyshime mbi shtrirjen e zonës së ekspozimit të identifikuar, nuk kishin treguar se ata ishin prekur personalisht nga situata e kontestuar dhe për rrjedhojë nuk mund të pretendonin se ishin viktimë të një shkeljeje të nenit 8. Anasjellas, Gjykata u dha statusin e viktimës atyre që kishin jetuar në komunat në fjalë, duke theksuar se kishte ekzistuar një supozim (i kundërshtueshëm) se ndotja në një zonë specifike ishte potencialisht e

rrezikshme për shëndetin dhe mirëqenien e personave të ekspozuar ndaj saj. Duke parë se dosja e çështjes përmbante raporte dhe studime të shumta shkencore që tregonin një lidhje shkakësore midis aktiviteteve të fabrikës së çelikut dhe përkeqësimit të situatës së shëndetit publik në komunat e ekspozuara, Gjykata arriti në përfundimin se ndotja në fjalë padyshim kishte një ndikim negativ në mirëqenien e kërkuesve që kishin jetuar në zonën e prekur.

Në rastin *Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë*, 2012, §§ 80-81, (shih gjithashtu *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, §§ 92-94), kërkuesit u ankuan për ndotje dhe shqetësime të shkaktuara nga menaxhimi i dobët i shërbimeve të grumbullimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve në rajonin e Campania-s të Italisë. Gjykata vuri në dukje se kërkuesit ishin ankuar për një situatë që kishte prekur të gjithë popullsinë e Campania-s. Megjithatë, duke vërejtur se një nga efektet e keqmenaxhimit në komunën ku ata kishin jetuar kishte qenë se mbeturinat ishin grumbulluar në rrugë për disa muaj, ajo vendosi se dëmi mjedisor për të cilin ankoheshin kërkuesit kishte qenë i tillë që ndikonte drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre personale.

227. Një pasojë e kësaj qasjeje është se personat juridikë, përfshirë shoqatat e ruajtjes së mjedisit, nuk mund të pretendojnë se janë viktimë të një shkeljeje të Konventës që rrjedh nga shqetësimet mjedisore ose shqetësimet që mund të ndjehen vetëm nga personat fizikë. OJQ-ja *Greenpeace* kështu u konsiderua e paaftë për të kërkuar statusin e viktimës *vis-à-vis* të drejtën e saj për të respektuar banesën e saj për shkak të ekspozimit të zyrës së saj të regjistruar ndaj ndotjes nga një fabrikë çeliku (*Asselbourg dhe të tjerët k. Luksemburgut* (aktv.), 1999; *Aly Bernard et 47 autres personnes physiques ainsi que l'association Greenpeace- Luxembourg, k. Luksemburgut* (aktv.), 1999). Shih gjithashtu rastin *Association des Résidents du Quartier Pont Royal, la commune de Lambersart dhe të tjerët k. Francës* (aktv.), 1992, në të cilin Komisioni arriti në përfundimin se një OJQ për mbrojtjen e mjedisit nuk mund të pretendonte se ishte viktimë e shkeljes së nenit 8 për shkak të ndotjes akustike nga një linjë hekurudhore me shpejtësi të lartë; *Maatschap Smits dhe të tjerët k. Holandës* (aktv.), 2001; dhe rastin *Yusufeli İlçesini Güzelleştirme Yaşatma Kültür Varlıklarını Koruma Derneği k. Turqisë* (aktv.), 2021, §§ 38, 41 dhe 43, një rast i paraqitur në Gjykatë nga një OJQ lokale që bën fushatë kundër një hidrocentrali dhe dige të planifikuar, ndërtimi i të cilit do të sillte zhytjen në ujë e një qyteti dhe një numri fshatrash. Ngjashëm, Gjykata ka vënë në dukje se në parim, një shoqatë nuk mund të mbështetet në konsideratat shëndetësore për të pretendua shkelje të nenit 8 (*Greenpeace E.V. dhe të tjerët k. Gjermanisë* (aktv.), 2009).

228. As një OJQ nuk mund të pretendojë të jetë viktimë e masave të cilat, për shkak të ndotjes ose shqetësimeve të mjedisit, supozohet se kanë shkelur të drejtat e dhëna nga Konventa për anëtarët e OJQ-së (shih rastin *Besseau dhe të tjerët k. Francës* (aktv.), 2006, në lidhje me një shoqatë që përpiqet të mbrojë personat që jetojnë në afërsi të një guroreje nga shqetësimet e shkaktuara nga funksionimi i kësaj të fundit, dhe *Yusufeli İlçesini Güzelleştirme Yaşatma Kültür Varlıklarını Koruma Derneği k. Turqisë* (aktv.), 2021, §§ 38 dhe 42, në lidhje me një OJQ lokale që po bën fushatë kundër një hidrocentrali dhe dige të planifikuar).

Ngjashëm, Gjykata konstatoi se OJQ-ja *Greenpeace* nuk mund të pretendonte se ishte viktimë e shkeljes së nenit 3, të marrë vetëm ose në lidhje me nenin 14, për shkak të një sulmi kundër disa prej anëtarëve të saj që kishin dalë vullnetarë për të ndihmuar në luftimin e zjarreve në pyje, një sulm i motivuar ose të paktën i ndikuar nga anëtarësimi i tyre në OJQ (*Kreyndlin dhe të tjerët k. Rusisë*, 2023, §§ 46-47).

229. Nga ana tjetër, një OJQ për ruajtjen e mjedisit e cila ishte palë në procedurat kombëtare në lidhje me një çështje mjedisore, në parim, mund të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje të nenit 6 § 1 të Konventës që pretendohet se ka ndodhur në kuadër të këtyre procedurave (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 590), edhe kur procedurat ishin të orientuara për të garantuar mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj (*Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët k. Spanjës*, 2004, § 36; shih gjithashtu *Yusufeli İlçesini Güzelleştirme Yaşatma Kültür Varlıklarını Koruma Derneği k. Turqisë* (aktv.), 2021, § 43; *krh. Bursa Barosu Başkanlığı dhe të tjerët k. Turqisë*, 2018, §§ 114-116, në të cilën Gjykata konstatoi se një shoqatë për mbrojtjen e mjedisit, ankesa e së cilës ishte shpallur e papranueshme për mungesë të *locus standi* nuk mund të pretendonte statusin e viktimës së shkeljes së nenit 6 § 1 në lidhje me procedurat në fjalë).

Në vendimin e saj në rastin *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM] (2024,

§§ 593 dhe 623), Gjykata arriti në përfundimin se shoqata kërkuese kishte statusin e viktimës në bazë të zbatueshmërisë së nenit 6 § 1 për ankesën e saj.

230. Njëkohësisht, kur një OJQ me qëllimin ligjor të mbrojtjes së interesave të anëtarëve të saj paraqet një padi përpara gjykatave kombëtare, anëtarët e saj mund të kërkojnë statusin e viktimës në lidhje me shkeljet e nenit 6 § 1 që pretendohet se kanë ndodhur në kuadër të atyre procedurave, edhe nëse ata nuk kanë qenë vetë palë në të. Gjykata e mori këtë vendim në rastin e procedurave për të anuluar një vendim për ndërtimin e një dige të sjellë nga një OJQ, qëllimi ligjor i së cilës ishte të koordinonte përpjekjet e anëtarëve të saj për të luftuar projektin e ndërtimit të digave. Ajo konsideroi se banorët e fshatrave që do të përmbytreshin mund të pretendonin se ishin viktimë të shkeljes së kësaj dispozite, duke vënë në dukje se megjithëse nuk kishin qenë palë në procedura në emër të tyre, ata ishin përfshirë përmes ndërmjetësimit të shoqatës të së cilës ishin anëtarë dhe të cilën e kishin krijuar me synimin për të mbrojtur interesat e tyre. Gjykata vuri në dukje sa vijon: "... si në dispozitat e tjera të Konventës, termi "viktimë" në nenin 34 duhet gjithashtu të interpretohet në një mënyrë evolutive në dritën e kushteve të shoqërisë bashkëkohore. Dhe në të vërtetë, në shoqëritë moderne, kur qytetarët ballafaqohen me vendime administrative veçanërisht komplekse, përdorimi i organeve kolektive si shoqatat është një nga mjetet e arritshme, ndonjëherë i vetmi mjet, në dispozicion të tyre, me anë të të cilit ata mund të mbrojnë interesat e tyre të veçanta në mënyrë efektive. Për më tepër, pozita e shoqatave për të ngritur procedura ligjore në mbrojtje të interesave të anëtarëve të tyre njihet nga legjislacioni i shumicës së vendeve evropiane. Kjo është pikërisht situata e krijuar në rastin konkret. Gjykata nuk mund ta shpërfillë këtë fakt kur interpreton konceptin e 'viktimës'. Çdo interpretim tjetër, tepër formalist, i këtij koncepti do ta bënte mbrojtjen e të drejtave të garantuara nga Konventa joefektive dhe iluzore" (*Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët k. Spanjës*, 2004, §§ 38-39).

2. Viktima e mundshme: ekspozimi ndaj rrezikut të dëmtimit mjedisor

231. Neni 34 i Konventës nuk i lejon kërkuetit të ankohen *in abstracto* për shkelje të Konventës. Kjo vlen në veçanti për pretendimet për shkelje të Konventës që rrjedhin nga dëmtimi mjedisor (*Caron dhe të tjerët k. Francës* (aktv.), 2010; *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, § 100).

232. Megjithatë, Gjykata e pranon në një farë mase konceptin e "viktimës së mundshme". Kështu, një kërkuet mund të pretendojë se është viktimë sipas kuptimit të nenit 34 të Konventës nëse ai paraqet prova të besueshme dhe bindëse të materializimit të mundshëm të një shkeljeje që do ta prekte atë personalisht (shih *Udhëzuesin praktik mbi kriteret e pranueshmërisë*, §§ 30-31).

Gjykata i zbatoi këto kritere në çështjet *Asselbourg dhe të tjerët k. Luksemburgut* (aktv.), 1999, dhe *Aly Bernard et 47 autres personnes physiques ainsi que l'association Greenpeace-Luxembourg, k. Luksemburgut* (aktv.), 1999, e cila kishte të bënte me autorizimin për të operuar një fabrikë çeliku duke përdorur skrap. Kërkuetit u ankuan se projekti i fabrikës së çelikut do të rezultonte në dëmtim mjedisor, i cili do të ndikonte në cilësinë e jetës së tyre dhe do t'i privonte ata nga gëzimi paqësor i banesave të tyre, duke cenuar të drejtën e tyre për respektimin e jetës së tyre private dhe familjare. Gjykata vlerësoi se përmendja e thjeshtë e rreziqeve të ndotjes së qenësishme në prodhimin e çelikut nga hekuri i skrapit nuk mjaftonte për të justifikuar pohimin e kërkuetve se ata ishin viktimë të një shkeljeje të Konventës. Ata duhej të ishin në gjendje të pohonin, në mënyrë të diskutueshme dhe të detajuar, se për shkak të mungesës së masave të duhura paraprake të marra nga autoritetet, shkalla e probabilitetit të shfaqjes së dëmit ishte e tillë që mund të konsiderohej se përbënte shkelje, me kusht që pasojat e aktit të ankuar të mos ishin shumë të largëta. Gjykata arriti në përfundimin se nuk ishte evidente nga dosja që kushtet e funksionimit të vendosura nga autoritetet e Luksemburgut, dhe në veçanti normat që kanë të bëjnë me shkarkimin e mbetjeve ndotëse të ajrit, kishin qenë aq të papërshtatshme sa të përbënin një shkelje të rëndë të parimit të kujdesit paraprak.

Gjykata arriti një përfundim të ngjashëm në rastin *Vecbaštika dhe të tjerët k. Letonisë* (aktv.), 2019, §§ 79-84, ku individët ishin ankuar mbi bazën e nenit 8 se shteti kishte lejuar ndërtimin e parqeve me erë në zonën ku ishin vendosur pronat ose banesat e tyre, duke pretenduar se turbinat kishin gjeneruar nivele të larta zhurme dhe kishin shkaktuar shqetësime të tjera (dridhje, tinguj me frekuencë të ulët, hije dhe dridhje hijesh) që ndikonin në shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Gjykata para së gjithash vuri në dukje se projekti ishte shtyrë, apo ndoshta edhe braktisur. Ajo gjithashtu vuri në dukje

se kërkuesit nuk kishin qenë në gjendje të ofronin prova se funksionimi i turbinave me erë pranë pronave ose shtëpive të tyre në famullinë e Dunikës do të ndikonte drejtpërdrejt dhe seriozisht tek ata, me shkallën e nevojshme të probabilitetit; përmendja thjeshtë e disa efekteve negative që lindin nga funksionimi i turbinave me erë në përgjithësi ishte i pamjaftueshëm në këtë drejtim. Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte prova të arsyeshme dhe bindëse se do të kishte rrezik në çështjen në fjalë për të rrezikuar jetën private dhe familjare të kërkuesve.

Në rastin *Maatschap Smits dhe të tjerët k. Holandës* (aktv.), 2001 dhe *Thibaut k. Francës* (aktv.), 2022, në lidhje me planet për një linjë hekurudhore dhe një linjë energjie të tensionit të shtuar, përkatësisht, Gjykata pranoi se personat që jetonin përgjatë rrugëve të projektuara, të cilët ishin ankuar për ndotjen, shqetësimin dhe rreziqet shëndetësore që do të krijonte kjo infrastrukturë, mund të kërkonin statusin e viktimës.

B. Parimet e zbatueshme në kontekstin e ndryshimeve klimatike

1. Individët

233. Për të kërkuar statusin e viktimës sipas nenit 34 të Konventës në kontekstin e ankesave në lidhje me dëmtimin ose rrezikun e dëmtimit që rezulton nga dështimet e pretenduara të shtetit për të luftuar ndryshimet klimatike, një kërkues duhet të tregojë se ai ose ajo është prekur personalisht dhe drejtpërdrejt nga dështimet e kundërshtuara. Më pas i takon Gjykatës të përcaktojë rrethanat e mëposhtme në lidhje me situatën e kërkuesit: (a) kërkuesi duhet t'i nënshtrohet një intensiteti të lartë ekspozimi ndaj efekteve negative të ndryshimeve klimatike, domethënë, niveli dhe serioziteti i (rrezikut të) pasojave negative të veprimit ose mosveprimit qeveritar që prek kërkuesin duhet të jetë i rëndësishëm; dhe (b) duhet të ketë një nevojë urgjente për të siguruar mbrojtjen individuale të kërkuesit, për shkak të mungesës ose papërshtatshmërisë së ndonjë mase të arsyeshme për të reduktuar dëmin (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 487).

Gjykata ka specifikuar se pragu për përmbushjen e këtyre kritereve është veçanërisht i lartë. Në funksion të përjashtimit të *actio popularis* sipas Konventës, fakti nëse një kërkues e përmbush atë prag do të varet nga një vlerësim i kujdesshëm i rrethanave konkrete të rastit. Në lidhje me këtë, Gjykata do të ketë parasysh rrethanat siç janë kushtet lokale mbizotëruese dhe specifikat dhe dobësitë individuale. Vlerësimi i tij do të përfshijë gjithashtu, por nuk do të kufizohet domosdoshmërisht në, konsiderata që kanë të bëjnë me: natyrën dhe fushëveprimin e ankesës së kërkuesit për Konventën, aktualiteti/largësia dhe/ose probabiliteti i efekteve negative të ndryshimeve klimatike në kohë, ndikimi specifik në jetën, shëndetin ose mirëqenien e kërkuesit, madhësinë dhe kohëzgjatjen e efekteve të dëmshme, shtrirjen e rrezikut (të lokalizuar ose të përgjithshëm) dhe natyrën e cenueshmërisë së kërkuesit (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, § 488).

234. Në rastin *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, një shoqatë e grave të moshuara, e krijuar për të promovuar dhe zbatuar mbrojtjen efektive të klimës në emër të anëtarëve të saj dhe katër prej anëtarëve të saj, u ankuan, ndër të tjera sipas nenit 8, për papërshtatshmërinë e masave të marra nga autoritetet zvicerane për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike. Duke u mbështetur në nenin 6 § 1, ata gjithashtu pretenduan se nuk kishin pasur qasje në gjykatë për të ngritur të njëjtën ankesë.

Gjykata konstatoi se kërkuesit individualë nuk mund të pretendonin se ishin viktima të shkeljes së pretenduar të nenit 8. Ajo vuri në dukje se ishte e qartë nga gjetjet e Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike dhe të Zyrës Federale për Mjedisin se, si gra të moshuara, kërkueset i përkisnin një grupi që ishte veçanërisht i ndjeshëm ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike. Megjithatë, ajo deklaroi se në mënyrë që atyre t'u jepej statusi i viktimës, ishte e nevojshme të përcaktohej, në rastin individual të secilit kërkues, që kërkesa për një nivel të caktuar dhe serioziteti i pasojave negative që preknin kërkuesin në fjalë ishte përmbushur, duke përfshirë dobësitë individuale të kërkuesve që mund të krijojnë një nevojë urgjente për të siguruar mbrojtjen e tyre individuale.

235. Në rastin *Carême k. Francës* (aktv.) [DhM], 2024, një individ që kishte jetuar në Grande-Synthe, një komunë bregdetare e vendosur, sipas gjetjeve të *Conseil d'État*, në një sektor që ishte vlerësuar si

në "një nivel shumë të lartë të ekspozimit ndaj ndryshimeve klimatike", veçanërisht ndaj rreziqeve të larta dhe në rritje të përmytjeve, ankohej mbi bazën e neneve 2 dhe 8 për papërshtatshmërinë e masave të marra nga Franca. Gjykata konstatoi se kërkuuesi nuk mund të pretendonte se ishte viktimë sipas kuptimit të nenit 34 dhe se nuk gjeti asnjë arsye për të vënë në dyshim natyrën hipotetike të rrezikut që lidhet me ndryshimet klimatike që prekin kërkuuesin, siç u tha nga gjykata kombëtare, pasi nuk kishte asnjë tregues se ku do të ishte vendbanimi i kërkuessit në vitet në vijim. Ajo gjithashtu vuri në dukje se ai nuk kishte treguar lidhje të rëndësishme me Grande-Synthe: ai nuk jetonte më ose nuk merrte me qira pronë në komunë dhe nuk kishte pronë atje; e vetmja lidhje ishte fakti që i vëllai jetonte aty.

2. Shoqatat: statusi i viktimës/në pritje për të paraqitur një kërkesë në Gjykatë

236. Parimi i përgjithshëm që një shoqatë nuk mund të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje të Konventës të shkaktuar nga shqetësimet mjedisore që mund të hasen vetëm nga personat fizikë (paragrafi 225 më lart) zbatohet gjithashtu në kontekstin e ndryshimeve klimatike. Kështu, Gjykata vuri në dukje në çështjen *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM] (2024, § 796) se një shoqatë nuk mund të mbështetet në konsiderata shëndetësore ose telashe dhe probleme që lidhen me ndryshimin e klimës, të cilat mund të hasen vetëm te personat fizikë kur ata pretendojnë statusin e viktimës.

237. Megjithatë, në të njëjtin rast, Gjykata konstatoi se konsideratat specifike në lidhje me ndryshimet klimatike peshojnë në favor të njohjes së mundësisë që shoqatat, në varësi të kushteve të caktuara, të kenë legjitimitet para Gjykatës si përfaqësues të individëve, të drejtat e të cilëve pretendohet se preken ose do të preken.

Ajo specifikoi se, në mënyrë që të njihet se ka *locus standi* për të paraqitur një kërkesë sipas nenit 34 të Konventës për shkak të dështimit të pretenduar të një Shteti Kontraktues për të marrë masat e duhura për të mbrojtur individët nga efektet negative të ndryshimeve klimatike në jetën dhe shëndetin e njerëzve, shoqata në fjalë duhet të jetë: (a) themeluar në mënyrë të ligjshme në juridiksionin përkatës ose ka të drejtë të veprojnë atje; (b) në gjendje të demonstrojë se ndjek një qëllim të dedikuar në përputhje me objektivat e saj statutoare në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të anëtarëve të saj ose individëve të tjerë të prekur brenda juridiksionit në fjalë, qofshin të kufizuara ose duke përfshirë veprimet kolektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave kundër kërcënimeve që rrjedhin nga ndryshimet klimatike; dhe (c) në gjendje të tregojë se mund të konsiderohet vërtet si e kualifikuar dhe përfaqësuese për të vepruar në emër të anëtarëve ose individëve të tjerë të prekur brenda juridiksionit, të cilët janë subjekt i kërcënimeve specifike ose efekteve negative të ndryshimeve klimatike në jetën, shëndetin ose mirëqenien e tyre siç mbrohen nga Konventa.

Në lidhje me këtë, Gjykata ka parasysh faktorë të tillë si qëllimi për të cilin është themeluar shoqata, faktin që ajo ka karakter jofitimprurës, natyrën dhe shtrirjen e aktiviteteve të saj brenda juridiksionit përkatës, anëtarësimin dhe përfaqësimin e saj, parimet e saj dhe transparencën e qeverisjes dhe nëse në përgjithësi, në rrethana të veçanta të një rasti, dhënia e një statusi të tillë është në interes të administrimit të duhur të drejtësisë.

Duke pasur parasysh veçoritë specifike të rekursit ndaj veprimeve juridike nga shoqatat në këtë kontekst, legjitimiteti i një shoqate për të vepruar në emër të anëtarëve ose individëve të tjerë të prekur brenda juridiksionit në fjalë nuk do t'i nënshtrohet një kërkesë të veçantë për të treguar se ata në emër të të cilëve çështja është paraqitur përpara Gjykatës do të kishin përmbushur vetë kërkesat e statusit të viktimës për individët në kontekstin e ndryshimeve klimatike (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjetër k. Zvicrës* [DhM] (2024, §§ 496-502).

Në rast të kufizimeve ekzistuese në lidhje me legjitimitetin para gjykatave kombëtare të shoqatave që plotësojnë kërkesat e mësipërme të Konventës, Gjykata gjithashtu, në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, mund të marrë parasysh nëse dhe deri në çfarë mase, anëtarët e saj individualë ose individë të tjerë të prekur mund të kenë gëzuar qasje në një gjykatë në të njëjtat procedurave kombëtare ose të lidhura me to (*Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM] (2024, § 503).

238. Në rastin *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM] (2024, §§ 521-526), në

vlerësimin e statusit të viktimës së shoqatës kërkuese në kontekstin e nenit 8, dhe duke zbatuar kriteret e mësipërme, Gjykata vuri në dukje si vijon: sipas statutit të saj, shoqata kërkuese ishte një shoqatë jofitimprurëse e krijuar sipas ligjit zviceran për të promovuar dhe zbatuar mbrojtjen efektive të klimës në emër të anëtarëve të saj; ajo kishte më shumë se 2000 anëtarë femra që jetonin në Zvicër dhe moshë mesatare e të cilave ishte 73 vjeç; 650 nga anëtarët e saj ishin 75 vjeç e lart; statuti i saj parashikonte që ajo ishte e zotuar për t'u angazhuar në aktivitete të ndryshme që synojnë reduktimin e emetimeve të gazeve serrë në Zvicër dhe adresimin e efekteve të tyre në ngrohjen globale; ajo veprroi jo vetëm në interes të anëtarëve të saj, por edhe në interes të publikut të gjerë dhe brezave të ardhshëm, me synimin për të siguruar mbrojtje efektive të klimës; ajo ndoqi qëllimet e saj nëpërmjet veprimeve të ndryshme, duke përfshirë marrjen e veprimeve ligjore për të trajtuar efektet e ndryshimeve klimatike në interes të anëtarëve të saj. Gjykata më pas konstatoi se dhënia e statusit të shoqatës kërkuese para saj ishte në interes të administrimit të duhur të drejtësisë. Në lidhje me këtë, ajo konstatoi, nga njëra anë, duke pasur parasysh bazën e anëtarësimit dhe përfaqësimit e shoqatës kërkuese, si dhe qëllimin e themelimit të saj, ajo përfaqësonte një mjet rekursi kolektiv që synonte mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të individëve kundër kërcënimeve të ndryshimeve klimatike në shtetin e paditur dhe, nga ana tjetër, se kërkuesit individualë nuk kishin pasur qasje në një gjykatë në shtetin e paditur.

Gjykata arriti në përfundimin se shoqata kërkuese ishte themeluar në mënyrë të ligjshme, ajo kishte treguar se ndiqte një qëllim të dedikuar në përputhje me objektivat e saj statute në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të anëtarëve të saj dhe individëve të tjerë të prekur kundër kërcënimeve që lindin nga ndryshimet klimatike në shtetin e paditur dhe se ishte vërtet e kualifikuar dhe përfaqësuese për të vepruar në emër të atyre individëve që mund të pretendonin se ishin subjekt i kërcënimeve specifike ose efekteve negative të ndryshimeve klimatike në jetën, shëndetin, mirëqenien dhe cilësinë e jetës së tyre siç mbrohen nga Konventa. Rrjedhimisht, ankesat e paraqitura nga shoqata kërkuese në emër të anëtarëve të saj binin në objektin e nenit 8, me pasojë që shoqata kërkuese kishte legjitimitet para Gjykatës dhe se neni 8 ishte i zbatueshëm për ankesën e saj.

II. Humbja e statusit të viktimës

239. Thjesht fakti i përfundimit të një rasti të ndotjes ose një shqetësimi mjedisor është i pamjaftueshëm për t'i privuar personat e ekspozuar ndaj tij nga statusi i viktimës (*López Ostra k. Spanjës*, 1994, § 42; *Martínez dhe Pino Manzano k. Spanjës*, 2012, § 28).

Ngjashëm, fakti që një banor lokal kishte lëvizur banesën për t'i shpëtuar ndotjes ose shqetësimit mjedisor ndaj të cilit ishte ekspozuar ishte i pamjaftueshëm për t'i hequr statusin e viktimës (*López Ostra k. Spanjës*, 1994, § 42; *Yevgeniy Dmitriyev k. Rusisë*, 2020, § 37).

240. Që dikush të humbasë statusin e viktimës, autoritetet kombëtare duhet të kenë konstatuar një shkelje dhe të kenë marrë një vendim që përbën kompensim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për atë shkelje (shih Udhëzuesin e Pranueshmërisë, §§ 36-39). Statusi i një kërkuesi si viktimë mund të varet nga kompensimi që jepet në nivel kombëtar në bazë të fakteve për të cilat ai ose ajo ankohet përpara Gjykatës dhe nëse autoritetet kombëtare e kanë pranuar, shprehimisht ose në thelb, shkeljen e Konventës. Gjykata e përsëriti këtë fakt në rastin *Murillo-Saldias dhe të tjerët k. Spanjës* (aktv.), 2006, (shih gjithashtu *Durdaj dhe të tjerët k. Shqipërisë*, 2023, §§ 148-279), ku një i afërm i viktimave të rrëshqitjes së dheut ishte ankuar për shkelje të neneve 2, 6 § 1 dhe 13 të Konventës. Ajo vendosi që kërkuesi nuk mund të pretendonte më se ishte viktimë e këtyre shkeljeve, duke qenë se gjykata kombëtare i kishte dhënë atij një shumë të arsyeshme si kompensim për vdekjen e të afërmeve të tij, duke i mbajtur autoritetet përgjegjëse për aksidentin.

Megjithatë, duhet të theksohet se kur vdekja vjen nga neglizhenca e rëndë, si në rastet e keqtrajtit me dashje që rezulton me vdekje, dhënia e kompensimit për të afërmit e viktimës nuk është e mjaftueshme për të korrigjuar shkeljen e nenit 2 në aspektin e tij substantiv; duhet të ketë edhe një hetim efektiv. Gjykata konstatoi në rastin *Durdaj dhe të tjerët k. Shqipërisë*, 2023, §§ 252-255, në lidhje me një shpërthim në një objekt të çmontimit të armëve, i cili kishte çuar në vdekjen e disa personave që, në të kundërt, kur autoritetet kanë kryer një hetim të përshtatshëm në të cilin u vërtetuan të gjitha faktet përkatëse dhe përgjegjësit u identifikuan dhe u ndëshkuan, pagesa e kompensimit të

përshtatshëm dhe njohja e përgjegjësisë së shtetit për vdekjen e të afërmeve të afërt të kërkuesve, në parim, do të mjaftonte për t'i hequr kërkuesve statusin e viktimës.

Shembuj:

Në rastin *López Ostra k. Spanjës*, 1994, § 42 (shih gjithashtu *Yevgeniy Dmitriyev k. Rusisë*, 2020, § 37), në të cilën kërkuesja që jetonte në afërsi të një impianti për trajtimin e mbetjeve dhe ishte ankuar për aromat, zhurmat dhe tymrat e ndotjes nga impianti, ishte ristrehuar me shpenzimet e komunës, përpara se të transferohej në një banesë të blerë nga familja e saj dhe impianti i trajtimit të mbetjeve ishte mbyllur. Gjykata vlerësoi se ajo kishte ruajtur statusin e viktimës, duke vënë në dukje se as zhvendosja e banesës dhe as mbyllja e impiantit nuk e kishin ndryshuar faktin që kërkuesja dhe familja e saj kishin jetuar për vite vetëm dymbëdhjetë metra larg një burimi erërash, zhurmash dhe tymi. Ajo vuri në dukje se nëse kërkuesja mund të kthehej tani në banesën e saj të mëparshme pas vendimit për mbylljen e fabrikës, ky do të ishte një faktor që do të merrej parasysh në vlerësimin e dëmit që kishte pësuar, por nuk do të nënkuptonte se ajo kishte pushuar së qeni viktimë.

Në rastin *Moe dhe të tjerët k. Norvegjisë* (aktv.), 1999, kërkuesit u ankuan për shqetësimet e shkaktuara nga aktivitetet e një impianti të trajtimit të mbetjeve pranë shtëpisë së tyre. Gjykata vuri në dukje se Gjykata e Lartë Norvegjeze kishte vendosur se, përpara se kërkuesit të kishin aplikuar në gjykatat kombëtare, nivelet e ndotjes kishin tejkaluar kufijtë ligjorë të shqetësimit të tolerueshëm. Ajo nxori përfundimin se Gjykata e Lartë kishte pranuar në thelb se kishte pasur shkelje të së drejtës së tyre për respektimin e jetës private dhe të banesës dhe vuri re se ndërsa kërkuesit nuk kishin marrë asnjë kompensim financiar, procedurat kishin rezultuar në një përshtatje të aktiviteteve të uzinës me synimin për të reduktuar shqetësimet. Gjykata vuri në dukje më tej se siç u konstatua nga Gjykata e Lartë, niveli i shqetësimit nuk i kishte tejkaluar më kufijtë ligjorë pas kërkesës në gjykatën kombëtare, se kërkuesit nuk i kishin paraqitur asaj asnjë provë për të hedhur poshtë atë konstatim ose për të treguar se ai ishte bazuar në standarde të papajtueshme me nenin 8, dhe se niveli i ndotjes kishte qenë dukshëm më i ulët se ai në fjalë në rastin *López Ostra k. Spanjës*, 1994. Më tej, duke pasur parasysh afërsinë në kohë të fillimit të procedurave dhe masat korrigjuese që sjellin shqetësimin brenda kufijve ligjorë, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesit kishin marrë dëmshpërblimin e duhur për çështjen që pretendonte se përbënte shkelje të nenit 8 dhe se për rrjedhojë ata nuk mund të kërkonin më statusin e viktimës për qëllimet e nenit 34.

Në rastin *Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], 2004, § 137, ku kërkuesi ishte ankuar, në veçanti, për shkatërrimin e pronës së tij gjatë një fatkeqësie industriale, Qeveria kishte pretenduar se ai nuk mund të pretendonte më të ishte viktimë pasi i ishte dhënë një kompensim i konsiderueshëm për dëmin material dhe kishte qenë në gjendje të merrte banesa të subvencionuara me kushte shumë të favorshme. Gjykata e hodhi poshtë këtë argument, duke konsideruar se edhe duke supozuar se kushtet e favorshme me të cilat ishte shitur apartamenti në fjalë mund të kishin korrigjuar në një masë të caktuar efektet e lëshimeve të vërejtura në çështjen në fjalë, ato megjithatë nuk mund të konsideroheshin si kompensim i duhur për dëmin e pësuar nga kërkuesi. Rrjedhimisht, çfarëdo avantazhesh që mund t'i ishin dhënë, ato nuk mund të kishin bërë që kërkuesi të humbiste statusin e tij si "viktimë", veçanërisht pasi nuk kishte asgjë në aktin e shitjes dhe dokumentet e tjera të lidhura në dosje që të tregonte ndonjë pranim nga autoritetet për shkeljen e të drejtës së tij për gëzimin paqësor të pasurisë së tij. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se ishte e mjaftueshme të vërehej se kompensimi i dhënë për dëmin material ende nuk ishte paguar edhe pse ishte dhënë një vendim i formës së prerë.

Në rastin *Ledyayeva dhe të tjerët k. Rusisë*, 2006, § 106, ku personat që jetonin pranë një fabrike çeliku ishin ankuar për ndotjen ndaj së cilës ishin ekspozuar, dy vjet pas fillimit të periudhës së shqyrtuar nga Gjykata, një nga kërkuesit ishte ristrehuar nga autoritetet jashtë "zonës së sigurisë sanitare" të fabrikës. Gjykata megjithatë arriti në përfundimin se kërkuesja në fjalë kishte ruajtur statusin e saj të viktimës pasi, edhe pse ristrehimi i saj mund të kishte zgjidhur çështjen e ekspozimit të saj ndaj ndotjes nga fabrika e çelikut, ajo nuk e kishte korrigjuar shkeljen e pretenduar të të drejtave të saj gjatë periudhës së mëparshme, as autoritetet nuk e kishin pranuar shkeljen e pretenduar të të drejtave të saj sipas Konventës, qoftë shprehimisht apo në thelb.

Në rastin *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë*, 2012, §§ 208-210, në lidhje me një shkarkim të papritur

në shkallë të gjerë të ujit nga një rezervuar me qëllim që të parandalohet çarja e kurorës së saj rrethuese, kërkuesit kishin marrë kompensim jashtëgjyqësor. Megjithatë, duke vërejtur se nuk kishte asgjë që të sugjeronte se autoritetet kishin pranuar shkeljen e nenit 8 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 për shkak të dëmtimit të banesave të tyre, Gjykata konstatoi se ato ende mund të pretendonin se ishin viktimë.

Në rastin *M. Özel dhe të tjerët k. Turqisë*, 2015, §§ 157-158, në lidhje me vdekjen e anëtarëve të familjeve të kërkuesve pas shembjes së ndërtesave gjatë një tërmeti, Gjykata arriti në përfundimin se dënimi penal i zhvilluesve përgjegjës për ndërtesat në fjalë kishte qenë i pamjaftueshëm për t'i hequr kërkuesit statusin e viktimës, “duke pasur parasysh natyrën e kërkesave procedurale të nenit 2 dhe faktin që dënimi i ndërtuesve nuk mund të interpretohet si sigurim i ndonjë lloj kompensimi”.

Në rastin *Otgon k. Republikës së Moldavisë*, 2016, §§ 16-20, në të cilin një individ u ankua për një shkelje të nenit 8 për shkak të faktit se ajo kishte marrë dizenteri nga uji i pijshëm i çezmës i furnizuar nga një ndërmarrje publike, Gjykata vendosi që kërkuesja kishte ruajtur statusin e saj të viktimës edhe pse gjykata kombëtare e kishte pranuar shkeljen në thelb, me arsyetimin se shuma e dhënë nga gjykata kombëtare ishte “dukshëm më poshtë” se minimumi i dhënë përgjithësisht nga Gjykata në rastet kur ajo kishte konstatuar shkelje të nenit 8 në lidhje me Republikën e Moldavisë.

Në rastin *Durdaj dhe të tjerët k. Shqipërisë*, 2023, §§ 248-279, një shpërthim në vitin 2008 në një objekt të çmontimit të armëve kishte shkaktuar vdekjen e njëzet e gjashtë personave dhe plagosur më shumë se treqind të tjerë. Prindërit e një fëmije që kishte vdekur në këtë fatkeqësi dhe një viktimë e mbijetuar kishin ngritur procedura për kompensim përpara gjykatës administrative, e cila kishte njohur në thelb përgjegjësinë e shtetit për vdekjen e fëmijës së këtyre kërkuesve dhe rrezikun kërcënues për jetën për viktimën e mbijetuar, dhe u kishte dhënë atyre shuma kompensimi që ishin të ngjashme me shumën e dhëna nga Gjykata në raste të krahasueshme. Pasi konstatoi gjithashtu se hetimi kishte qenë i përshtatshëm, Gjykata konstatoi si pasojë se ata kishin humbur statusin e viktimës.

Në rastin *Besseau k. Francës* (aktv.), 2023, §§ 12-17, një individ u ankua sipas nenit 8 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 në lidhje me shqetësimin e shkaktuar nga zhurma, dridhjet dhe pluhuri i krijuar nga operacionet e një gurorje të hapur mikrograni afër banesës së tij. Në kuadrin e një grupi tjetër procedurash nga ato që kishin përfunduar në kërkesën e tij në Gjykatë, gjykata civile kishte vënë në dukje se kërkuesi dhe gruaja e tij po përjetonin një shqetësim të tepruar për shkak të çarjeve të shkaktuara në strukturën e shtëpisë së tyre nga dridhjet dhe kishte urdhëruar operatorin që t'u paguante atyre kompensim në lidhje me dëmin material dhe humbjen e gëzimit të pronës së tyre. Në të kundërt, ajo kishte hedhur poshtë pretendimet e tyre për aq sa kishin të bënin me shqetësimin tjetër të supozuar të lagjes. Gjykata vuri në dukje se në procedurën përpara saj kërkuesi nuk kishte dhënë asnjë shpjegim në lidhje me nivelin e shqetësimit që ai po përjetonte personalisht dhe ndikimin e tij në cilësinë e jetës dhe aftësinë e tij për të gëzuar banesën e tij, dhe se ai nuk kishte paraqitur asnjë provë për një humbje të vlerës së tregut të banesës së tij për shkak të vendndodhjes së saj pranë gurores. Duke pasur parasysh natyrën e përgjithshme të argumentit të tij dhe në mungesë të provave që mund të tregonin, në mënyrë individuale, shkeljet e pretenduara të Konventës, Gjykata vlerësoi se, në rrethanat e çështjes, pranimi nga gjykata të zakonshme kombëtare e ekzistencës së një shqetësimi të tepruar në lagje dhe vendosja për dëmshpërblimin si të dëmit monetar, ashtu edhe të humbjes së kënaqësisë së jetës, duhet të konsiderohet si një njohje, në thelb e shkeljes së dispozitave ku kërkuesi kishte mbështetur pretendimet e tij. Duke u shprehur më tej se shumën e dhëna përfaqësonin dëmshpërblim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesi nuk mund të pretendonte se ishte viktimë për qëllimet e nenit 34.

Neni 35 (kushtet e pranueshmërisë)

Neni 35 i Konventës

- “1. Gjykata mund të trajtojë çështjen vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore sipas rregullave përgjithësisht të pranura të të drejtës ndërkombëtare dhe brenda një periudhe prej katër muajsh nga data në të cilën është marrë vendimi i formës së prerë.
2. Gjykata nuk merr në shqyrtim asnjë kërkesë individuale të paraqitur sipas Nenit 34, kur
- (a) është anonime; ose
- (b) është në thelb e njëjtë me një çështje të shqyrtuar më parë nga Gjykata ose që i është nënshtruar një procedure tjetër për zgjidhje ose hetim ndërkombëtar dhe nuk përmban fakte të reja përkatëse.
3. Gjykata deklaron çdo kërkesë individuale të bërë në bazë të nenit 34 të papranueshme, kur mendon se:
- (a) kërkesa është e papajtueshme me dispozitat e Konventës ose protokollet e saj, haptazi e paarsyetuar ose përbën abuzim të së drejtës për kërkesë individuale; ose
- (b) kërkuar nuk ka pësuar ndonjë dëm të konsiderueshëm, përveç kur respektimi i të drejtave të njeriut sipas përcaktimit të Konventës dhe protokolleve të saj kërkon shqyrtimin e kërkesës në lidhje me themelin, me kusht që të mos rrëzojë asnjë çështje dhe për këtë shkak nëse nuk është shqyrtuar si duhet nga një gjykatë kombëtare.
4. Gjykata rrëzon çdo kërkesë që e konsideron të papranueshme në zbatim të këtij neni. Ajo mund ta bëjë këtë në çdo fazë të procedimit.”

A. Shterimi i mjeteve të brendshme juridike

241. Kur, në rastet mjedisore në veçanti, procedurat kombëtare u ngritën nga një shoqatë, fakti që një kërkuar individual në Gjykatë nuk ishte personalisht palë në ato procedura nuk do të thotë domosdoshmërisht se mjetet e tij të brendshme juridike nuk janë shteruar siç duhet. Ajo që ka rëndësi në lidhje me kërkesën e shterimit të mjeteve të brendshme juridike është se ankesa ose ankesat që kërkuar synon t'i paraqesë Gjykatës, në lidhje me shkeljen e të drejtave të tij ose të saj sipas Konventës, janë ngritur fillimisht në gjykatat kombëtare. Gjykata ka theksuar në lidhje me këtë se është e detyrueshme të merret parasysh natyra e shoqërisë civile bashkëkohore, ku shoqatat luajnë një rol të rëndësishëm, veçanërisht në sferën e mbrojtjes së mjedisit. Pjesë e këtij roli është mbrojtja, para gjykatave dhe autoriteteve të tjera kombëtare, e interesave dhe të drejtave individuale të anëtarëve të tyre, si dhe për kauzat e interesit publik. Gjykata ka vërejtur se, veçanërisht në çështjet mjedisore, në të cilat individët mund të përballen me grupe komplekse çështjesh për të cilat ata nuk janë në gjendje t'i trajtojnë vetë, një mjet kolektiv si një shoqatë mund të jetë i vetmi mjet në dispozicion për ta për të shtypur çështjen e tyre në mënyrë efektive (*Thibaut k. Francës* (aktv.), 2022, §§ 26-31).

242. Në rastin *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 107, në lidhje me krizën e menaxhimit të mbetjeve në Campania, kërkuar u ankuan sipas nenit 8 për mangësitë, gjatë disa viteve, në ofrimin e shërbimeve të grumbullimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve dhe ndotjes së shkaktuar nga një landfill. Gjykata hodhi poshtë kundërshtimin e Qeverisë se kërkuar nuk kishin shteruar mjetet e brendshme juridike, veçanërisht një mjet kompensues, duke vënë në dukje në veçanti se, megjithëse kjo mund të kishte rezultuar në kompensim për personat në fjalë, nuk do të kishte çuar në heqjen e mbetjeve nga rrugët publike ose në riparimin e vendgrumbullimit, dhe për këtë arsye do të kishte ofruar vetëm një kompensim të pjesshëm për "dëmtimin mjedisor" të ankuar nga kërkuar.

B. Afati kohor gjashtëmuor - situata e vazhdueshme e ndotjes

243. Ndotja e vazhdueshme e mjedisit mund të përbëjë një “situatë të vazhdueshme”. Rrjedhimisht, në mungesë të një mjeti të brendshëm juridik që plotëson kërkesat e nenit 35 § 1, pika e fillimit të afatit gjashtëmuor për paraqitjen e ankesave sipas Konventës në Gjykatë do të shtyhet deri në datën

në të cilën situata ka pushuar (*Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, §§ 131-132). Prandaj, afati kohor mund të fillojë të llogaritet vetëm nga koha kur ndotja e ankuar sipas Konventës ka pushuar.

C. *Ratione Personae* – përfshirja në dëmtimin e mjedisit e ndërmarrjeve të rregulluara nga ligjet e shteteve të tjera anëtare

244. Në rastin *Zeynep Ahunbay dhe të tjerët k. Turqisë, Austrisë dhe Gjermanisë* (aktv.), 2016, personat që kundërshtojnë digën e planifikuar Ilisu, ndërtimi i së cilës do të kishte zhytur zonën arkeologjike dhe kulturore të Hasankeyf në Turqi, kishin paraqitur një kërkesë duke u mbështetur, veçanërisht, në një shkelje të neneve 8 dhe 10, në të cilat ata ankoheshin për efektet shkatërruese që një infrastrukturë e tillë do të kishte në mjedisin dhe shkatërrimin e të gjithë mjedisit të trashëgimisë kulturor. Gjykata vuri në dukje se kompanitë gjermane dhe austriake ishin përfshirë në konsorciumin përgjegjës për kryerjen e projektit. Megjithatë, ajo vuri në dukje se të gjitha masat e kundërshtuara ishin marrë nga autoritetet turke dhe se të gjitha procedurat gjyqësore ishin kryer sipas sistemit gjyqësor turk, me autoritetet gjyqësore turke që kishin juridiksion ekskluziv për të përcaktuar çështjet e ngritura nga kërkuarët. Duke iu referuar praktikës gjyqësore të saj mbi juridiksionin territorial dhe ekstraterritorial të Shteteve Kontraktuese, Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme *ratione personae* për pjesën që ishte drejtuar kundër Austrisë dhe Gjermanisë.

D. *Ratione materiae* – nuk ka të drejtë universale individuale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore specifike

245. Në rastin *Zeynep Ahunbay dhe të tjerët k. Turqisë* (aktv.), 2019, §§ 21-26, Gjykata deklaroi gatishmërinë e saj, në dritën e instrumenteve përkatëse ndërkombëtare dhe emëruesve të përbashkët të standardeve juridike ndërkombëtare, për të konsideruar se një bazë e përbashkët ekzistonte në Evropë dhe ndërkombëtarisht për nevojën për të mbrojtur të drejtën e qasjes në trashëgiminë kulturore. Megjithatë, ajo vuri në dukje se kjo përgjithësisht i referohej të drejtës së pakicave për të gëzuar lirisht kulturën e tyre dhe të drejtës së popujve indigjenë për të ruajtur, kontrolluar dhe mbrojtur trashëgiminë e tyre kulturore. Më tej, ajo vuri në dukje se aktualisht nuk kishte një konsensus evropian, apo edhe një tendencë të përbashkët në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, për të nxjerrë nga dispozitat e Konventës një të drejtë universale individuale për mbrojtjen e një trashëgimie të caktuar kulturore. Prandaj, Gjykata e shpalli kërkesën të papajtueshme *ratione materiae* me dispozitat e Konventës.

E. Abuzimi me të drejtën e ankimit

246. Një kërkesë e motivuar nga publiciteti ose propaganda nuk përbën, vetëm nga ky fakt, një abuzim me të drejtën e ankimit sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës (për një shembull në lidhje me një kërkesë të paraqitur në një kontekst të aktivizmit mjedisor, shih rastin *Friedrich dhe të tjerët k. Polonisë*, 2024).

F. Nuk ka dëm të konsiderueshëm – pragu minimal i seriozitetit të një shkeljeje të supozuar dhe ndikimi mjedisor dhe në shëndetin publik i situatës së kontestuar

247. Në rastin *Cordella dhe të tjerët k. Italisë*, 2019, §§ 133-139, ku banorët ishin ankuar për dështimin e shtetit për të marrë masa për të mbrojtur shëndetin e tyre dhe mjedisin nga emetimet e dëmshme nga një fabrikë çeliku, Qeveria i kishte akuzuar kërkuarët se thjesht i referoheshin në terma shumë të gjerë ndotjes dhe ndikimit të saj në shëndetin e tyre pa dhënë asnjë të dhënë faktike në mbështetje të argumenteve të tyre. Qeveria kishte parashtruar se kjo kishte qenë e pamjaftueshme që dëmi i pretenduar të përshkruhej si "i rëndësishëm" sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (b). Gjykata vuri në dukje se për qëllimet e kësaj dispozite duhej të konstatonte nëse shkelja e pretenduar kishte arritur pragu të seriozitetit, dhe për këtë arsye të merrte parasysh aspektet e mëposhtme: natyrën e së drejtës që pretendohet se është shkelur, seriozitetin e ndikimit të shkeljes së pretenduar në ushtrimin e një të

drejte dhe/ose pasojat e mundshme të shkeljes për situatën personale të kërkuesit. Ajo konstatoi se duke pasur parasysh natyrën e ankesave të ngritura – sipas nenit 8, të marra vetëm dhe në lidhje me nenin 13 – dhe raporteve të shumta shkencore që vënë në dukje ndikimin e ndotjes nga fabrika e çelikut në mjedis dhe shëndetin e njeriut, kriteri i mungesës së dëmit të konsiderueshëm nuk ishte përmbushur. Prandaj, ajo rrëzoi kundërshtimin e Qeverisë.

Neni 46 (forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve)

Neni 46 i Konventës

- “1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër ta respektojnë vendimet e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.
2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikqyr ekzekutimin e tij.
3. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se mbikqyrja e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë pengohet nga një problem i interpretimit të vendimit, ai mund t’ia referojë çështjen Gjykatës për t’u shprehur me vendim për çështjen e interpretimit. Një vendim i tillë kërkon një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitetin e Ministrave.
4. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se një Palë e Lartë Kontraktuese refuzon të respektojë një vendim të formës së prerë të Gjykatës në një çështje ku ajo është palë, pasi t’i ketë dërguar një njoftim formal asaj Palë dhe me vendim që merret me një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që marrin pjesë në të, mund t’i referojë Gjykatës problemin nëse Pala e ka përmbushur detyrimin e saj në bazë të paragrafit 1.
5. Nëse Gjykata gjen shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave për shqyrtimin e masave që duhen marrë. Nëse Gjykata nuk gjen ansjë shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave, i cili e mbyll shqyrtimin e çështjes.”

248. Në rastin *Cordella dhe të tjerët k. Italisë* 2019, §§ 179-182, në të cilin, *ndër të tjera*, ajo konstatoi një shkelje të nenit 8 të Konventës për shkak të ekspozimit të kërkuesve ndaj një niveli të lartë ndotjeje nga një fabrikë çeliku, Gjykata vendosi të mos fillojë një procedurë vendimi pilot. Megjithatë, ajo theksoi se ekzekutimi i vendimit do të kërkonte një operacion emergjent pastrimi në fabrikën e çelikut dhe zonën e prekur nga ndotja e mjedisit në fjalë. Ajo shtoi se strategjia mjedisore (duke renditur masat dhe veprimet e nevojshme për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të popullatës), e cila ishte miratuar nga autoritetet kombëtare në vitin 2014, por zbatimi i së cilës ishte shtyrë deri në vitin 2023, duhet të zbatohet sa më shpejt që të jetë e mundur (krahaso rastin *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, §§ 655-677).

• Vendime që përmendin një të drejtë individuale për mjedisin:

- *Tătar k. Rumanisë*, 2009, § 107, dhe *Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë*, 2012, § 110: “e drejta për të jetuar në një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm”;
- *Băcilă k. Rumanisë*, 2010, § 71: “e drejta për të gëzuar një mjedis të ekuilibruar duke respektuar shëndetin e njeriut”.

• Vendime që përmendin parimin e kujdesit paraprak:

- në kuadër të nenit 6: *Folkman dhe të tjerët k. Republikës Çeke* (aktv.), 2006;
- në kuadër të nenit 8: *Asselbourg dhe të tjerët k. Luksemburgut* (aktv.), 1999; *Aly Bernard et 47 autres personnes physiques ainsi que l’association Greenpeace-Luxembourg, k. Luksemburgut* (aktv.), 1999; *Sdružení Jihočeské Matky k. Republikës Çeke* (aktv.), 2006; *Tătar k. Rumanisë*, 2009, § 120.

• Vendime që e referojnë arsyetimin e tyre në Konventën e Aarhusit për qasjen në

informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në drejtësi për çështjet mjedisore:

- *Collectif national d’information et d’opposition à l’usine Melox – Collectif Stop Melox dhe Mox k. Francës* (aktv.), 2006;
- *Tătar k. Rumanisë*, 2009, § 118;
- *Grimkovskaya k. Ukrainës*, 2011, §§ 69 dhe 72;
- *Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë*, 2012, § 107;
- *Locascia dhe të tjerët k. Italisë*, 2023, § 125;
- *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], 2024, §§ 490-492, 501, 539, 609.

Lista e rasteve të cituara

Praktika gjyqësore e cituar në këtë udhëzues i referohet vendimeve të nxjerra nga Gjykata dhe vendimeve ose raporteve të Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut ("Komisioni").

Përveçse nëse tregohet ndryshe, të gjitha referencat i referohen një vendimi mbi themelin i dhënë nga një Dhomë e Gjykatës. Shkurtesa "(v.)" tregon se citimi është i një vendimi të Gjykatës dhe "[DhM]" se çështja është dëgjuar nga Dhoma e Madhe.

Hiperlidhjet e rasteve të cituara në versionin elektronik të Udhëzuesit i drejtohen databazës HUDOC, (<http://hudoc.echr.coe.int>) e cila siguron qasje në praktikën gjyqësore të Gjykatës (vendimet e Dhomës së Madhe, Dhomës dhe Komitetit, rastet e komunikuara, opinionet këshillimore dhe përmbledhjet ligjore nga Shënimi i Informacionit të Praktikës Gjyqësore) dhe të Komisionit (vendimet dhe raportet), dhe për rezolutat e Komitetit të Ministrave.

Gjykata nxjerr vendimet e saj në anglisht dhe/ose frëngjisht, dy gjuhët e saj zyrtare. HUDOC gjithashtu përmban përkthime të shumë rasteve të rëndësishme në më shumë se tridhjetë gjuhë jozyrtare dhe lidhje me rreth njëqind koleksione të praktikës gjyqësore në internet të prodhuara nga palë të treta.

—A—

- A.S.P.A.S. dhe Lasgrezas k. Francës*, nr. 29953/08, 22 shtator 2011
(*Opinion këshillues mbi ndryshimin në trajtimin ndërmjet shoqatave të pronarëve të tokave "që ka një ekzistencë të njohur në datën e krijimit të një shoqate gjuetarësh të miratuar në komunë" dhe shoqatat e pronarëve të tokave të krijuara pas kësaj date* [DhM], kërkesa nr. P16-2021-002, frëngjisht *Conseil d'État*, 13 korrik 2022
- Aktürk dhe të tjerët k. Turqisë*, nr. 16757/21, 13 qershor 2023
- Alatulkkila dhe të tjerët k. Finlandës*, nr. 33538/96, 28 korrik 2005
- Almeida Azevedo k. Portugalisë*, nr. 43924/02, 23 janar 2007
- Aly Bernard et 47 autres personnes physiques ainsi que l'association Greenpeace-Luxembourg, k. Luksemburgut* (ven.), nr. 29197/95, 29 qershor 1999
- Animal Defenders International k. Mbretërisë së Bashkuar* [DhM], nr. 48876/08, GJEDNJ 2013
- Anonymos Touristiki Etairia Xenodocheia Kritis k. Greqisë*, nr. 35332/05, 21 shkurt 2008
- Ansay dhe të tjerët k. Turqisë* (ven.), nr. 49908/99, 2 mars 2006
- Apanasewicz k. Polonisë*, nr. 6854/07, 3 maj 2011
- Aparicio Benito k. Spanjës* (ven.), nr. 36150/03, 13 nëntor 2006
- Artun dhe Güvener k. Turqisë*, nr. 75510/01, 26 qershor 2007
- Ashworth dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* (ven.), nr. 39561/98, 20 janar 2004
- Asselbourg dhe të tjerët k. Luksemburgut* (ven.), nr. 29121/95, GJEDNJ 1999-VI
- Association Burestop 55 dhe të tjerët k. Francës*, nr. 56176/18 dhe 5 të tjerë, 1 korrik 2021
- Associations of Communally-owned Forestry Proprietors Porceni Plesa dhe Piciorul Batran Banciu k. Rumanisë*, nr. 46201/16, 28 nëntor 2023
- Association des Résidents du Quartier Pont Royal, la commune de Lambersart dhe të tjerët k. Francës* (ven.), nr. 18523/91, 8 dhjetor 1992
- Association Greenpeace France k. Francës* (vene.), nr. 55243/10, 13 dhjetor 2011
- Atasagün k. Turqisë* (vne.), nr. 24621/21, 9 janar 2024
- Athanasiou dhe të tjerët k. Greqisë* [DhM], nr. 2531/02, 9 shkurt 2006
- Athanassoglou dhe të tjerët k. Zvicrës* [DhM], nr. 27644/95, GJEDNJ 2000-IV

—B—

Băcilă k. Rumanisë, nr. 19234/04, 30 mars 2010
Bahia Nova S.A. k. Spanjës (ven.), nr. 50924/99, 12 dhjetor 2000
Balmer-Schafroth dhe të tjerët k. Zvicrës, 26 gusht 1997, Raportet e vendimeve 1997-IV
Barcza dhe të tjerët k. Hungarisë, nr. 50811/10, 11 tetor 2016
Baudinière dhe Vauzelle k. Francës (ven.), nr. 25708/03 dhe 25719/03, 6 dhjetor 2007
Beinarovič dhe të tjerët k. Lituanisë, nr. 70520/10 dhe 2 të tjerë, 12 qershor 2018
Bērziņš dhe të tjerët k. Letonisë, nr. 73105/12, 21 shtator 20210
Besseau dhe të tjerët k. Francës (ven.), nr. 58432/00, 7 shkurt 2006
Besseau k. Francës (ven.), nr. 22622/22, 14 dhjetor 2023
Bil İnşaat Taahhüt Ticaret Limited Şirketi k. Turqisë, nr. 29825/03, 1 tetor 2013
Bistrović k. Kroacisë, nr. 25774/05, 31 maj 2007
Bladet Tromsø dhe Stensaas k. Norvegjisë [DhM], nr. 21980/93, GJEDNJ 1999-III
Bogdel k. Lituanisë, nr. 41248/06, 26 nëntor 2013
Bölükbaş dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 29799/02, 9 shkurt 2010
Budayeva dhe të tjerët k. Rusisë, nr. 15339/02 dhe 4 të tjerë, GJEDNJ 2008
Botti k. Italisë (ven.), nr. 77360/01, 2 dhjetor 2004
Bor k. Hungarisë, nr. 50474/08, 18 qershor 2013
Borysiewicz k. Polonisë, nr. 71146/01, 1 korrik 2008
Brincat dhe të tjerët k. Maltës, nr. 60908/11 dhe 4 të tjerë, 24 korrik 2014
Bryan dhe të tjerët k. Rusisë, nr. 22515/14, 27 qershor 2023
Buckley k. Mbretërisë së Bashkuar, 25 shtator 1996, Raportet e vendimeve 1996-IV
Bumbeş k. Rumanisë, nr. 18079/15, 3 maj 2022
Bursa Barosu Başkanlığı dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 25680/05, 19 qershor 2018
Brândușe k. Rumanisë, nr. 6586/03, 7 prill 2009
Büttner dhe Krebs k. Gjermanisë (ven.), nr. 27547/18, 4 qershor 2024

—C—

Calancea dhe të tjerët Republikës së Moldavisë (vene.), nr. 23225/05, 6 shkurt 2018
Cangı k. Turqisë, nr. 24973/15, 29 janar 2019
Cangı dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 48173/18, 14 nëntor 2023
Carême k. Francës (ven.) [DhM], nr. 7189/21, 9 prill 2024
Caron dhe të tjerët k. Francës (ven.), nr. 48629/08, 29 qershor 2010
Chabauty k. Francës [DhM], nr. 57412/08, 4 tetor 2012
Chagnon dhe Fournier k. Francës, nr. 44174/06 dhe 44190/06, 15 korrik 2010
Chapman k. Mbretërisë së Bashkuar [DhM], nr. 27238/95, GJEDNJ 2001-I
Chassagnou dhe të tjerët k. Francës [DhM], nr. 25088/94 dhe 2 të tjerë, GJEDNJ 1999-III
Chernega dhe të tjerët k. Ukrainës, nr. 74768/10, 18 qershor 2019
Çiçek dhe të tjerët k. Turqisë (ven.), nr. 44837/07, 4 shkurt 2020
Cin dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 305/03, 10 nëntor 2009
Çöçelli dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 81415/12, 11 tetor 2022
Cokarić dhe të tjerët k. Kroacisë (ven.) nr. 33212/02, 19 janar 2006
Collectif national d'information et d'opposition à l'usine Melox – Collectif Stop Melox dhe Mox k. Francës (ven.), nr. 75218/01, 28 mars 2006
Collectif national d'information et d'opposition à l'usine Melox – Collectif Stop Melox dhe Mox k. Francës (ven.), nr. 75218/01, 12 qershor 2007
Consorts Richet dhe Le Ber k. Francës, nr. 18990/07 dhe 23905/07, 18 nëntor 2010
Cordella dhe të tjerët k. Italisë, nr. 54414/13 dhe 54264/15, 24 janar 2019
Costel Popa k. Rumanisë, nr. 47558/10, 26 prill 2016
Couturon k. Francës, nr. 24756/10, 25 qershor 2015
Crash 2000 OOD dhe të tjerët k. Bullgarisë (vene.), nr. 49893/07, 17 dhjetor 2013
Cuenca Zarzoso k. Spanjës, nr. 23383/12, 16 janar 2018

—D—

Deés k. Hungarisë, nr. 2345/06, 9 nëntor 2010
De Geouffre de la Pradelle k. Francës, 16 dhjetor 1992, Seria A nr. 253-B
Depalle k. Francës [DhM], nr. 34044/02, GjEDNj 2010
Desjardin k. Francës, nr. 22567/03, 22 nëntor 2007
De Mortemart k. Francës (ven.), nr. 67386/13, 23 maj 2017
Dimitar Yordanov k. Bullgarisë, nr. 3401/09, 6 shtator 2018
Dimopulos k. Turqisë, nr. 37766/05, 2 prill 2019
Di Sarno dhe të tjerët k. Italisë, nr. 30765/08, 10 janar 2012
Drieman dhe të tjerët k. Norvegjisë (ven.), nr. 33678/96, 4 maj 2000
Duarte Aghostinho dhe të tjerët k. Portugalisë dhe 32 të tjerë (ven.) [DhM], nr. 39371/20, 9 prill 2024
Dubetska dhe të tjerët k. Ukrainës, nr. 30499/03, 10 shkurt 2011
Durdaj dhe të tjerët k. Shqipërisë, nr. 63543/09 dhe 3 të tjerët, 7 nëntor 2023
Dzemyuk k. Ukrainës, nr. 42488/02, 4 shtator 2014

—E—

Ecodefence dhe të tjerët k. Rosisë, nr. 9988/13 dhe 60 të tjerë, 14 qershor 2022
Efgan Çetin dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 14684/18, 3 tetor 2023
Ehrmann dhe SCI VHI k. Francës (ven.), nr. 2777/10, 7 qershor 2011
Ekholm k. Finlandës, nr. 68050/01, 24 korrik 2007
Elefteriadis k. Rumanisë, nr. 38427/05, 25 janar 2011
Erdal Muhammet Arslan dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 42749/19, 21 nëntor 2023
European Air Transport Leipzig GmbH k. Belgjikës, nr. 1269/13 dhe 4 të tjerët, 11 korrik 2023
Executief van de Moslims van België dhe të tjerët k. Belgjikës, nr. 16760/22 dhe 10 të tjerë, 13 shkurt 2024

—F—

Fadeyeva k. Rosisë (ven.), nr. 55723/00, 16 tetor 2003
Fadeyeva k. Rosisë, nr. 55723/00, GjEDNj 2005-IV
Fägerskiöld k. Suedisë (ven.), nr. 37664/04, 26 shkurt 2008
Fieroiu dhe të tjerët k. Rumanisë (ven.), nr. 65175/10, 23 maj 2017
Flamenbaum dhe të tjerët k. Francës, nr. 3675/04 dhe 23264/04, 13 dhjetor 2012
Florea k. Rumanisë, nr. 37186/03, 14 shtator 2010
Folkman dhe të tjerët k. Republikës Çeke (ven.), nr. 23673/03, 10 korrik 2006
Fotopoulou k. Greqisë, nr. 66725/01, 18 nëntor 2004
Frankowski dhe të tjerët k. Polonisë (ven.), nr. 25002/09, 20 shtator 2011
Fredin k. Suedisë (n° 1), 18 shkurt 1991, Seria A nr. 192
Friedrich dhe të tjerët k. Polonisë, nr. 25344/20 dhe 17 të tjerë, 20 qershor 2024
Friend dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar (ven.), nr. 16072/06 dhe 27809/08, 24 nëntor 2009
Furlepa k. Polonisë (ven.), nr. 62101/00, 18 mars 2008

—G—

G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët k. Italisë [DhM], nr. 1828/06 dhe 2 të tjerë, 28 qershor 2018
Gaida k. Gjermanisë (ven.), nr. 32015/02, 3 korrik 2007
Galev dhe të tjerët k. Bullgarisë (aktv.), nr. 18324/04, 29 shtator 2009
Galtieri k. Italisë (ven.), nr. 72864/01, 24 janar 2006
Gavrilova dhe të tjerët k. Rosisë, nr. 2625/17, 16 mars 2021
Geffre k. Francës (ven.), nr. 51307/99, GjEDNj 2003-I
Genç dhe Demirgan k. Turqisë, nr. 34327/06 dhe 45165/06, 10 tetor 2017
Giacomelli k. Italisë, nr. 59909/00, GjEDNj 2006-XI
Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët k. Spanjës, nr. 62543/00, GjEDNj 2004-III
Greenpeace E.V. dhe të tjerët k. Gjermanisë (vene.), nr. 18215/06, 12 maj 009
Grimkovskaya k. Ukrainës, nr. 38182/03, 21 korrik 2011
Gronús k. Polonisë (ven.), nr. 29695/96, 2 dhjetor 1999
Guerra dhe të tjerët k. Italisë, 19 shkurt 1998, *Raportet e vendimeve* 1998-I

Guseva k. Bullgarisë, nr. 6987/07, 17 shkurt 2015

—H—

Hadzhiyska k. Bullgarisë (ven.), nr. 20701/09, 15 maj 2012

Hamer k. Belgjikës, nr. 21861/03, GJEDNJ 2007-V

Hardy dhe Maile k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 31965/07, 14 shkurt 2012

Hashman dhe Harrup k. Mbretërisë së Bashkuar [DhM], nr. 25594/94, GJEDNJ 1999-VIII

Hatton dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar [DhM], nr. 36022/97, GJEDNJ 2003-VIII

Herrmann k. Gjermanisë [DhM], nr. 9300/07, 26 qershor 2012

Howald Moor dhe të tjerët k. Zvicrës, nr. 52067/10 dhe 41072/11, 11 mars 2014

—I—

Iera Moni Profitou Iliou Thiras k. Greqisë, nr. 32259/02, 22 dhjetor 2005

Istanbullu dhe Ayden k. Turqisë (ven.), nr. 20793/07 dhe 29240/07, 29 shtator 2015

Ivan Atanasov k. Bullgarisë, nr. 12853/03, 2 dhjetor 2010

Ivanova dhe Cherkezov k. Bullgarisë, nr. 46577/15, 21 prill 2016

—J—

Jugheli dhe të tjerët k. Gjeorgjisë, nr. 38342/05, 13 korrik 2017

—K—

Kaminskas k. Lituanisë, nr. 44817/18, 4 gusht 2020

Kapsalis et al k. Greqisë (ven.), nr. 20937/03, 23 shtator 2004

Kapa dhe të tjerët k. Polonisë, nr. 75031/13 dhe 3 të tjerë, 14 tetor 2021

Karin Andersson dhe të tjerët k. Suedisë, nr. 29878/09, 25 shtator 2014

Keçeli dhe Başpınar k. Turqisë, nr. 21426/03, 26 janar 2010

Kılıçdaroğlu k. Turqisë, nr. 16558/18, 27 tetor 2020

Kök dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 20868/04, 24 nëntor 2009

Köktepe k. Turqisë, nr. 35785/03, 22 korrik 2008

Kolyadenko dhe të tjerët k. Rusisë, nr. 17423/05 dhe 5 të tjerë, 28 shkurt 2012

Kožul dhe të tjerët k. Bosnje dhe Hercegovinës, nr. 38695/13, 22 tetor 2019

Kotov dhe të tjerët k. Rusisë, nr. 6142/18 dhe 13 të tjerë, 11 tetor 2022

Kreynldin dhe të tjerët k. Rusisë, nr. 33470/18, 31 janar 2023

Kristiana Ltd. k. Lituanisë, nr. 36184/13, 6 shkurt 2018

Kurşun k. Turqisë, nr. 22677/10, 30 tetor 2018

Kyrtatos k. Greqisë, nr. 41666/98, GJEDNJ 2003-VI

Kyrtatou dhe Kyrtatos k. Greqisë (ven.), nr. 41666/98, 13 shtator 2001

—L—

L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar (ven.), nr. 23413/94, 9 qershor 1998

Lam dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar (ven.), nr. 41671/98, 5 korrik 2001

Lambert dhe të tjerët k. Francës [DhM], nr. 46043/14, GJEDNJ 2015

Lazaridi k. Greqisë, nr. 31282/04, 13 korrik 2006

Ledyayeva dhe të tjerët k. Rusisë (ven.), nr. 53157/99 dhe 3 të tjerë, 16 shtator 2004

Ledyayeva dhe të tjerët k. Rusisë, nr. 53157/99 dhe 3 të tjerë, 26 tetor 2006

Lemke k. Turqisë, nr. 17381/02, 5 qershor 2007

Leon dhe Agnieszka Kania k. Polonisë, nr. 12605/03, 21 korrik 2009

L'Erablière A.S.B.L. k. Belgjikës, nr. 49230/07, GJEDNJ 2009

Locascia dhe të tjerët k. Italisë, nr. 35648/10, 19 tetor 2023

Longobardi dhe të tjerët k. Italisë (ven.), nr. 7670/03, 26 qershor 2007

López Ostra k. Spanjës, 9 dhjetor 1994, Seria A nr. 303-C

Lorentzatou k. Greqisë (ven.), nr. 2947/08, 25 shkurt 2010

Luginbühl k. Zvicrës (ven.), nr. 42756/02, 17 janar 2006

—M—

M. Özel dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 14350/05 dhe 2 të tjerët, 17 nëntor 2015
Maatschap Smits dhe të tjerët k. Holandës (ven.), nr. 39032/97 dhe 5 të tjerë, 3 maj 2001
Magomedov dhe të tjerët k. Rusisë, nr. 33636/09 dhe 9 të tjerë, 28 mars 2017
Magyar Helsinki Bizottság k. Hungarisë [DhM], nr. 18030/11, 8 nëntor 2016
Makhmoudov k. Rusisë, nr. 35082/04, 26 korrik 2007
Malfatto dhe Mieille k. Francës, nr. 40886/06 dhe 51946/07, 6 tetor 2016
Mamère k. Francës, nr. 12697/03, GJEDNJ 2006-XIII
Marchiş dhe të tjerët k. Rumanisë (ven.), nr. 38197/03, 28 qershor 2011
Margulev k. Rusisë, nr. 15449/09, 8 tetor 2019
Mastelica dhe të tjerët k. Serbisë (ven.), nr. 14901/15, 17 nëntor 2020
Matczyński k. Polonisë, nr. 32794/07, 15 dhjetor 2015
Matos e Silva, Lda., dhe të tjerët k. Portugalisë, 16 shtator 1996, *Raportet e vendimeve* 1996-IV
Martinez Martinez dhe Pino Manzano k. Spanjës, nr. 61654/08, 3 korrik 2012
McGinley dhe Egan k. Mbretërisë së Bashkuar, 9 qershor 1998, *Raportet e vendimeve* 1998-III
Mileva dhe të tjerët k. Bullgarisë, nr. 43449/02 dhe 21475/04, 25 nëntor 2010
Moe dhe të tjerët k. Norvegjisë (ven.), nr. 30966/96, 14 dhjetor 1999
Moore k. Mbretërisë së Bashkuar (ven.), nr. 40425/98, 15 qershor 1999
Moreno Gómez k. Spanjës, nr. 4143/02, GJEDNJ 2004-X
Mučibabić k. Serbisë, nr. 34661/07, 12 korrik 2016
Murillo-Saldias dhe të tjerët k. Spanjës (ven.), nr. 76973/01, 28 nëntor 2006

—N—

Nane dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 41192/04, 24 nëntor 2009

—O—

Ocak k. Turqisë, nr. 33675/04, 19 janar 2010
Öçkan dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 46771/99, 28 mars 2006
Orfanos dhe Orfanou k. Greqisë (vene.), nr. 36188/03, 14 shkurt 2006
Okyay dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 36220/97, GJEDNJ 2005-VII
Oluic k. Kroacisë, nr. 61260/08, 20 maj 2010
Öneryıldız k. Turqisë [DhM], nr. 48939/99, GJEDNJ 2004-XII
Österreichische Vereinigung zur Erhaltung, Stärkung und Schaffung k. Austrisë, nr. 39534/07, 28 entor 2013
O'Sullivan McCarthy Mussel Development Ltd k. Irlandës, nr. 44460/16, 7 qershor 2018
Otgon k. Republikës së Moldavisë, nr. 22743/07, 25 tetor 2016
Ouzounoglou k. Greqisë, nr. 32730/03, 24 nëntor 2005

—P—

Pavalache k. Rumanisë, nr. 38746/03, 18 tetor 2011
Pavlov dhe të tjerët k. Rusisë, nr. 31612/09, 11 tetor 2022
Płachta dhe të tjerët k. Polonisë (ven.), nr. 25194/08, 25 nëntor 2014
Plathey k. Francës, nr. 48337/09, 10 nëntor 2011
Peradze dhe të tjerët k. Gjeorgjisë, nr. 5631/16, 15 dhjetor 2022
PETA Deutschland k. Gjermanisë, nr. 43481/09, 8 nëntor 2012
Petar Matas k. Kroacisë, nr. 40581/12, 4 tetor 2016
Perinelli dhe të tjerët k. Italisë (ven.), nr. 7718/03, 26 qershor 2007
Pindstrup Mosebrug A/S k. Danimarkës (vene.), nr. 34943/06, 3 korrik 2008
Pine Valley Developments Ltd dhe të tjerët k. Irlandës, 29 nëntor 1991, Seria A nr. 222
Podelean k. Rumanisë (ven.), nr. 19295/12, 26 shkurt 2019
Posti dhe Rahko k. Finlandës, nr. 27824/95, GJEDNJ 2002-VII
Powell dhe Rayner k. Mbretërisë së Bashkuar, 21 shkurt 1990, Seria A nr. 172

—R—

Roche k. Mbretërisë së Bashkuar [DhM], nr. 32555/96, GJEDNJ 2005-X

Ruano Morcuende k. Spanjës (ven.), nr. 75287/01, 6 shtator 2005

—S—

SA Bio d'Ardennes k. Belgjikës, nr. 44457/11, 12 nëntor 2019
S.C. Fiercolect Impex S.R.L. k. Rumanisë, nr. 26429/07, 13 dhjetor 2016
Saarenpään Loma ky k. Finlandës (ven.), nr. 54508/00, 9 maj 2006
Šabanović k. Malit të Zi dhe Serbisë, nr. 5995/06, 31 maj 2011
Sakskoburggotski dhe Chrobok k. Bullgarisë, nr. 38948/10 dhe 8954/17, 7 shtator 2021
Saliba k. Maltës, nr. 4251/02, 8 nëntor 2005
Sapundzhiev k. Bullgarisë, nr. 30460/08, 6 shtator 2018
SCEA Ferme de Fresnoy k. Francës (ven.), nr. 61093/00, GJEDNJ 2005-XIII
Schneider k. Luksemburgut, nr. 2113/04, 10 korrik 2007
Sciavilla k. Italisë (ven.), nr. 36735/97, 14 nëntor 2000
Sdružení Jihočeské Matky k. Republikës Çeke (ven.), nr. 19101/03, 10 korrik 2006
Silahyürekli k. Turqisë, nr. 16150/06, 26 nëntor 2013
Smaltini k. Italisë (ven.), nr. 43961/09, 24 mars 2015
Solyanik k. Rusisë, nr. 47987/15, 10 maj 2022
Steel dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar, 23 shtator 1998, *Raportet e vendimeve* 1998-VII
Steel dhe Morris k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 68416/01, GJEDNJ 2005-II
Stichting Landgoed Steenbergen dhe të tjerët k. Holandës, nr. 19732/17, 16 shkurt 2021
Sylla dhe Nollomont k. Belgjikës, nr. 37768/13 dhe 36467/14, 16 maj 2017

—T—

Tănăsoaica k. Rumanisë, nr. 3490/03, 19 qershor 2012
Tarim k. Turqisë (ven.) nr. 54948/07, 9 mars 2010
Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 46117/99, GJEDNJ 2004-X
Taşkın dhe të tjerët k. Turqisë (vene.), nr. 46117/99, 29 janar 2004
Tătar k. Rumanisë, nr. 67021/01, 27 janar 2009
Tebieti Mühafize Cemiyeti dhe Israfilov k. Azerbajxhanit, nr. 37083/03, GJEDNJ 2009
Temel Conta Sanayi Ve Ticaret A.Ş. k. Turqisë, nr. 45651/04, 10 mars 2009
Thibaut k. Francës (ven.), nr. 41892/19 dhe 41893/19, 14 qershor 2022
Tierbefreier e.V. k. Gjermanisë, nr. 45192/09, 16 janar 2014
TMMOB dhe Karakuş Candan k. Turqisë (vene.), nr. 46514/15, 11 qershor 2024
Tókéş k. Rumanisë, nr. 15976/16 dhe 50461/17, 27 prill 2021
Tolić dhe të tjerët k. Kroacisë (ven.), nr. 13482/15, 4 qershor 2019
Tumeliai k. Lituanisë, nr. 25545/14, 9 janar 2018
Turgut dhe të tjerët k. Turqisë, nr. 1411/03, 8 korrik 2008

—U—

Udovičić k. Kroacisë, nr. 27310/09, 24 prill 2014
Ünver k. Turqisë (ven.), nr. 36209/97, 26 shtator 2000

—V—

Valico S.r.l. k. Italisë (ven.), nr. 70074/01, 21 mars 2006
Valle Pierimpiè Società Agricola S.P.A. k. Italisë, nr. 46154/11, 23 shtator 2014
Vasilescu k. Belgjikës, nr. 64682/12, 25 nëntor 2014
Vecbaštika dhe të tjerët k. Letonisë (ven.), nr. 52499/11, 19 nëntor 2019
Verein gegen Tierfabriken k. Zvicrës (ven.), nr. 48703/03, 20 shtator 2011
Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) k. Zvicrës (n° 2) [DhM], nr. 32772/02, GJEDNJ 2009
Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët k. Zvicrës [DhM], nr. 53600/20, 9 prill 2024
VgT Verein gegen Tierfabriken k. Zvicrës, nr. 24699/94, GJEDNJ 2001-VI
Vides Aizsardzības Klubs k. Letonisë, nr. 57829/00, 27 maj 2004
Vladimirov k. Bullgarisë (ven.), nr. 58043/10, 25 shtator 2018

—W—

Wałkuska k. Polonisë (ven.), nr. 6817/04, 29 prill 2008
Ward k. Mbretërisë së Bashkuar (ven.), nr. 31888/03, 9 nëntor 2004
Wells k. Mbretërisë së Bashkuar (ven.) nr. 63477/00, 16 janar 2007
Winterstein dhe të tjerët k. Francës, nr. 27013/07, 17 tetor 2013

—Y—

Yaşar k. Rumanisë, nr. 64863/13, 26 nëntor 2019
Yevgeniy Dmitriyev k. Rusisë, nr. 17840/06, 1 dhjetor 2020
Yıldırım k. Turqisë, nr. 21482/03, 24 nëntor 2009
Yusufeli İlçesini Güzelleştirme Yaşatma Kültür Varlıklarını Koruma Derneği k. Turqisë (v.), nr. 7857/14, 7 dhjetor 2021

—Z—

Z.A.N.T.E. – Marathonisi A.E. k. Greqisë, nr. 14216/03, 6 dhjetor 2007
Zammit Maempel k. Maltës, nr. 24202/10, 22 nëntor 2011
Zander k. Suedisë, 25 nëntor 1993, Seria A nr. 279-B
Zapletal k. Republikës Çeke (ven.), nr. 12720/06, 30 nëntor 2010
Zeynep Ahunbay dhe të tjerët k. Turqisë, Austrisë dhe Gjermanisë (vene.), nr. 6080/06, 21 qershor 2016
Zeynep Ahunbay dhe të tjerët k. Turqisë (ven.), nr. 6080/06, 29 janar 2019